

FJALA E GVERNATORIT

*E nderuar zonja Kryetare,
Zonja dhe Zotërinj deputetë!*

Viti 2005, në përgjithësi, u karakterizua nga zhvillime pozitive, të cilat përmirësuan më tej ambientin ekonomik-financiar të vendit, duke kontribuar në ruajtjen dhe konsolidimin e mëtejshëm të stabilitetit makroekonomik.

Duke bërë një sintezë të të gjitha zhvillimeve të verifikuara në ekonomi, vlerësohet se gjatë vitit 2005 aktiviteti ekonomik i vendit u zgjerua më tej, në kushtet e një inflacioni nën kontroll dhe të një zvogëlimi të mëtejshëm të deficitit buxhetor. Zhvillime intensive janë regjistruar dhe në financimin e ekonomisë me kredi bankare, e cila pothuajse u dyfishua në krahasim me vitin 2004.

Banka e Shqipërisë ka arritur të përmbushë me sukses misionin e saj ligjor, duke administruar me efikasitet presionet inflacioniste në ekonomi. Edhe pse në kushtet e një tregu bankar tashmë privat dhe më dinamik, ne jemi munduar të administrojmë më së miri situatën e likuiditetit në ekonomi, duke siguruar një furnizim konstant të ekonomisë me para, në përputhje me nevojat për zhvillimin ekonomik të vendit. Politika monetare e zbatuar nga Banka e Shqipërisë ka qenë vigjilente, duke ndjekur hap pas hapi zhvillimet e brendshme dhe ato ndërkombëtare.

Kujdes i veçantë i është kushtuar edhe ruajtjes së stabilitetit të sistemit bankar, në një kohë kur bankat tregtare përbëjnë segmentin më aktiv të sektorit financiar. Për ne mbetet një përparësi absolute forcimi i kapaciteteve mbikëqyrëse dhe i kuadrit rregullator, në përgjithësi. Ky angazhim konstant i Bankës së Shqipërisë, merr një rëndësi të veçantë në kushtet e shtimit të aktivitetit kreditues, që nënkupton sisteme raportimi më efikase, kontrolle më të kujdesshme, shtim të masave dhe të veprimeve korigjuese.

Në fokusin e punës sonë ka qenë edhe zgjerimi dhe thellimi i mëtejshëm i tregut financiar në vend. Në veprimtarinë tonë të përditshme rëndësi i është kushtuar reduktimit të ekonomisë në cash duke e konsideruar atë si një faktor që lidhet drejtpërdrejt me uljen e informalitetit në ekonomi. Për këtë qëllim, kemi ndërmarrë projekte të ndryshme me grupet përkatëse të interesit, duke synuar jo vetëm sensibilizimin e tyre por edhe ndërtimin e infrastrukturave dhe krijimin e lehtësive të tjera, që ndikojnë pozitivisht në këtë drejtim.

Në vijim të fjalës time, do të ndalem më gjerësisht në disa prej zhvillimeve kryesore që karakterizuan ecurinë ekonomiko-financiare të vendit gjatë vitit 2005, duke i kushtuar një vëmendje të veçantë rolit dhe vendimeve të marra prej nesh, në përmbushje të detyrimeve ligjore, që rregullojnë aktivitetin e Bankës së Shqipërisë.

1. EKONOMIA E BRENDSHME

Ekonomia shqiptare gjatë vitit 2005 shënoi një rritje ekonomike afër nivelit 6 për qind, me një inflacion relativisht të ulët rreth 2 për qind dhe një deficit buxhetor nën kontroll.

Aktiviteti ekonomik i vendit gjatë vitit 2005, vlerësohet të jetë rritur¹ në terma realë 5.5 për qind, rreth 0.5 pikë përqindje më pak se vlerësimet e fillimvitit. Sipas analizave më të fundit duket se situata e zgjatur paszgjedhore, ulja e stimulit fiskal gjatë tremujorit të dytë të vitit si dhe përshkallëzimi i krizës energjitike gjatë periudhës tetor – nëntor 2005, kanë ndikuar në mosarritjen e ritmeve të parashikuara të rritjes.

Megjithë rritjen e kënaqshme të Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB), reduktimi i shifrës së papunësisë vazhdon të jetë i ulët si në vlerë absolute ashtu edhe në terma relativë. Këtu duhet përmendur dhe cilësia e statistikave të punësimit, që ndikohet nga lëvizjet e mëdha dhe të pamonitoruara të popullatës brenda dhe jashtë vendit, dhe nga shkalla e lartë e informalitetit në tregun e punës, të cilat mund të fshehin zhvillimet reale në punësim.

Bilanci kursime–investime, vlerësohet të ketë regjistruar një ecuri disi të ndryshme nga ajo e vitit të kaluar. Kursimet publike kanë regjistruar një nivel pozitiv, ndonëse modest në vetëm 0.1 për qind të PBB-së. Ndërkohë kursimet private, në raport me vitin e mëparshëm, janë pakësuar me rreth 2.6 pikë përqindjeje ndaj PBB-së.

Spektori i jashtëm i ekonomisë gjatë vitit 2005, paraqitet me një bilanc negativ në llogarinë korente, shkaktuar nga thellimi i mëtejshëm i deficitit tregtar. Flukset hyrëse të kapitalit kanë qenë përgjithësisht të mjaftueshme për kompensimin e deficitit korent, duke mundur një bilanc të jashtëm pozitiv.

2. ZHVILLIMET SEKTORIALE

Viti 2005, ka regjistruar rritje të aktivitetit ekonomik në të gjithë sektorët e tij. Ashtu si edhe në vitet e kaluara, sektorët më dinamikë vazhdojnë të jenë sektorët e shërbimeve dhe ndërtimit. Nga ana tjetër, vlerësimet tregojnë se sektori i bujqësisë dhe ai i prodhimit industrial, janë ende larg potencialit që kanë, pavarësisht ritmeve pozitive të rritjes.

2.1. BUJQËSIA

Megjithë rritjet e evidentuara vitet e fundit rreth 2 deri 3 për qind në vit, kontributi i prodhimit bujqësor ka ardhur në rënie nga njëri vit në tjetrin, duke arritur në rreth 23 për qind të PBB-së në vitin 2005. Bujqësia vazhdon të karakterizohet nga probleme të mëdha, të lidhura me pronësinë mbi tokën, duke zbehur në këtë mënyrë interesimin e investitorëve të mëdhenj në prodhimin e produkteve të ndryshme me natyrë bujqësore.

Parcelizimi i tokës bujqësore, reflektuar së pari në pamundësinë e përdorimit në shkallë të gjerë të mekanikës bujqësore, ka bërë që rendimenti i prodhimit bujqësor të jetë larg potencialit të tij. Nga ana tjetër, lëvizjet e parreshtura migratore nga zonat rurale në drejtim të qendrave të mëdha të banuara, kanë bërë që një pjesë e mirë e tokës bujqësore të lihet djerrë. Me kalimin e viteve kjo ka çuar në plotësimin e tregut në një masë të madhe me mallra të huaj bujqësorë, kryesisht të importuar nga vendet fqinje. Segmenti më i gjallë i prodhimit bujqësor duket se ka të bëjë me shtimin e pandalshëm të kapaciteteve përpunuese dhe konfeksionuese të inpueteve bujqësore dhe blegtorale. Edhe gjatë vitit 2005, dega e industrisë agroushqimore është rritur më tej, me rreth 10 për qind në terma realë, në nivel gati të njëjtë me atë të vitit 2004.

Megjithatë, kjo degë me potencial të madh sipas vlerësimeve më të fundit vazhdon të thithë shumë pak investime, vetëm 0.3 për qind të PBB-së. Largësia e biznesit bankar nga zonat rurale dhe gjithë problematika e përmendur gjatë kësaj analize, besojmë se përbëjnë faktorët kryesorë prapa kësaj situatë.

2.2. INDUSTRIJA

Sektori i prodhimit industrial paraqet ende një lloj ngërçi, i cili mbi të gjitha pasqyron një mosaktivizim të kapaciteteve prodhuese, kryesisht në industrinë nxjerrëse dhe atë përpunuese minerare. Të dyja këto degë, në mungesë të investimeve gjatë pesëmbëdhjetë viteve të fundit dhe si pasojë e interesimit të pakët nga ana e biznesit vendas dhe të huaj, kanë shënuar rënie të vazhdueshme, për të arritur në ditët e sotme në një situatë shumë të vështirë. Rentabiliteti i ulët, kostot e larta dhe shkalla e lartë e amortizimit të tyre, mund të bëjnë pothuajse të pamundur mbijetesën e tyre. Edhe disa prej ndërmarrjeve që iu dhanë me koncension investitorëve të huaj, janë në një pozicion të vështirë ekonomiko-financiar, duke mos dhënë kontribute të prekshme në riaktivizimin e këtyre industrive.

2.3. TRANSPORTI

Sektori i transportit ka luajtur një rol dinamik në rritjen ekonomike gjatë viteve të fundit. Ai ka patur ritme të larta rritjeje, duke dhënë një kontribut pozitiv në zhvillimin ekonomik. Ritmi i shtimit të vëllimit të shitjeve të sektorit të transportit ka qenë gjatë gjithë kohës pozitiv, duke manifestuar një gjallërim të tyre pas një ngadalësimi që u vërejt gjatë vitit 2004. Gjallërim kanë të gjithë komponentët e tij: transporti ajror, detar dhe ai rrugor. Ndërkohë transporti hekurudhor, vazhdon të manifestojë shenja të qarta kolapsi duke rënë në mënyrë graduale nga njëri vit në tjetrin.

2.4. NDËRTIMI

Përballë nevojave për përmirësimin e kushteve të strehimit, për zgjerimin e kapaciteteve prodhuese dhe për krijimin e një infrastrukture moderne, sektori

i ndërtimit ka shënuar norma të larta rritjeje gjatë dhjetë viteve të fundit. Sektori i ndërtimit është rritur mesatarisht me 13 për qind në vit gjatë kësaj periudhe, duke u shndërruar në një nga katalizatorët e zhvillimit ekonomik të vendit dhe duke e dyfishuar peshën e tij në PBB. Ky sektor kontribuoi me 9 për qind në krijimin e PBB-së gjatë vitit 2005.

Kërkesa e lartë në lidhje me produktet e kësaj dege duket edhe në ecurinë e çmimeve të shitjes, veçanërisht në çmimet e apartamenteve të banimit dhe të sipërfaqeve të destinuara për aktivitet ekonomik, gjatë viteve 2002-2004. Këto zhvillime duhen ndjekur me kujdes, për të vlerësuar drejt rreziqet që shoqërojnë rënien që mund të pasojë rritjen e shpejtë të çmimeve të pasurive të paluajtshme. Veçanërisht kjo do të kishte efekte negative mbi sistemin bankar, në kushtet kur 80 për qind e kolateralit për kreditë e dhëna ekziston në formën e pasurive të paluajtshme.

Duhet theksuar se sipas të dhënave të INSTAT-it, kostoja e ndërtimit është rritur shumë pak gjatë vitit 2005, fakt ky që nxjerr në pah një mospërputhje të madhe midis rritjes së kostos dhe rritjes së çmimeve të shitjes. Pra, kemi të bëjmë me një kërkesë të fortë, e cila gjithësesi nuk i ka burimet në të ardhura të qëndrueshme. Burime të tilla si të ardhurat nga emigracioni dhe nga aktivitetet e jashtëligjshme vlerësohet se janë resurse financiare të përkohshme, të vështira për t'u parashikuar, ndërkohë që janë zërat kryesorë që financojnë degën e ndërtimit. Për rrjedhim, një rënie e mundshme, e shpejtë e burimeve të sipërpërmendura, do të sjellë kufizime të forta në kërkesë, kufizime që do të vinin në vështirësi jo vetëm ndërtuesit por edhe degët e lidhura me të.

2.5. SHËRBIMET

Sektori i shërbimeve është zhvilluar në mënyrë të konsiderueshme gjatë këtyre viteve, duke u bërë kontribuesi kryesor në rritjen e PBB-së. Sipas vlerësimeve më të fundit llogaritet që pesha e sektorit të shërbimeve në PBB, të jetë rreth 45 për qind. Brenda këtij sektori bie në sy ecuria në rritje e degës së tregtisë dhe e asaj të turizmit, ndërkohë që edhe shumë segmente të tjera të reja, të cilat ndonëse me një aktivitet ekonomik ende të brishtë, kanë filluar të rriten duke përbërë premisa për një ecuri të qëndrueshme afatgjatë të këtij sektori. Edhe dega e turizmit vihet re se ka zhvillime sasiore që dëshmojnë në rritjen e saj. Nga të dhënat disponibël evidentohet një ecuri në rritje e të gjithë treguesve. Ka shtim të kapaciteteve akomoduese, ka dyfishim të shpenzimeve për marketing, ka rritje të vëllimit të investimeve si dhe rritje të kënaqshme të numrit të vizitorëve të huaj.

Indeksi i shitjeve dhe indeksi i tregtisë me pakicë. Shitjet totale të ekonomisë u rritën me 16.1 për qind gjatë nëntëmuorit të parë të vitit 2005, kundrejt një rritjeje prej vetëm 6.1 për qind gjatë së njëjtës periudhë të vitit të kaluar. Megjithë rritjen e shpejtë të kërkesës së brendshme, inflacioni vjetor gjatë kësaj periudhe ka mbetur nën kontroll, duke treguar për një rritje korresponduese të prodhimit në ekonomi.

Duhet theksuar se analiza ekonomike e vitit 2005 do të ishte më e plotë në rast të disponimit të të dhënave të tremujorit të fundit të vitit, ku siç dihet u përballëm me një krizë të fortë të prodhimit të energjisë elektrike. Vlerësimet tona paraprake tregojnë se kufizimi i aktivitetit ekonomik në terma rritjeje reale të PBB-së për shkak të problemeve të energjisë së fundvitit 2005, të ketë qenë rreth gjysmë pikë përqindje. Për të përballuar vështirësitë e mungesës së energjisë, shumica e bizneseve iu drejtua përdorimit të burimeve alternative, të cilat vlerësohet të kenë shkaktuar kosto jo të vogël për aktivitetin e tyre. Megjithëse fillimisht u mendua se kriza mund të kishte pasoja më të rënda, absorbimi i saj nga ana e ekonomisë ishte relativisht i shpejtë.

3. ZHVILLIMET NË SEKTORIN FISKAL

Politika fiskale është një faktor i rëndësishëm përcaktues për stabilitetin makroekonomik. Viti 2005 u karakterizua nga një politikë fiskale e disiplinuar në vijim të zbatimit të Programit Buxhetor Afatmesëm për periudhën 2005-2007. Ky program ka synuar shtimin e stimulit fiskal në rritjen ekonomike dhe stabilitetin makroekonomik, nëpërmjet konsolidimit të treguesve buxhetorë dhe prioritizimit të shpenzimeve buxhetore në sektorët e shëndetësisë, të arsimit dhe të infrastrukturës. Në këtë kuptim, shpenzimet e përgjithshme publike, arsimit dhe shëndetësisë patën alokimin e burimeve më të larta në krahasim me funksionet e tjera qeveritare, me respektivisht 3.4, 3.0 dhe 2.5 për qind të PBB-së së vitit të kaluar.

Të ardhurat buxhetore kanë vazhduar të shënojnë rritje dhe gjatë vitit 2005, ndërkohë që deficitin buxhetor është ulur më tej nga 5.1 për qind në vitin 2004 në 3.9 për qind të PBB-së në vitin 2005, duke shënuar nivelin më të ulët të tetë viteve të fundit. Kërkesa e qeverisë për huamarrje të brendshme vlerësohet të jetë 2.8 për qind ndaj PBB-së. Të ardhurat dhe shpenzimet në total për vitin e shkuar, janë realizuar përkatësisht në masën 97 dhe 92 për qind në krahasim me planin ose 23.4 dhe 26.7 për qind të PBB-së. Megjithatë, ashtu si dhe në vitet e mëparshme, përsëri shpërndarja e shpenzimeve buxhetore pati një formë jo të njëtrajshme, duke treguar një përqendrim në mesin e vitit të kaluar.

4. ZHVILLIMET NË INFLACION DHE POLITIKA MONETARE

Çmimet e konsumit kanë qenë relativisht të qëndrueshme gjatë vitit 2005, duke shënuar një tjetër vit pozitiv në drejtim të përmbushjes së objektivit kryesor të Bankës së Shqipërisë, arritjes dhe ruajtjes së stabilitetit të çmimeve. Inflacioni vjetor shënoi vlerën 2.0 për qind në fund të vitit, ndërsa inflacioni vjetor mesatar rezultoi 2.4 për qind. Këta tregues të kostos së jetesës janë ulur në krahasim me vitin e kaluar, duke u luhatur rreth kufirit të poshtëm të objektivit. Inflacioni vjetor qëndroi brenda intervalit 2.0 – 4.0 për qind gjatë pjesës më të madhe të vitit.

Politika monetare e Bankës së Shqipërisë ka patur përgjithësisht një kah neutral gjatë vitit 2005. Ulja me 0.25 pikë përqindjeje e normës bazë të

interesit në fund të tremujorit të parë është pasuar nga një periudhë me presione inflacioniste të qëndrueshme në pjesën e mbetur të vitit. Norma bazë e interesit pas tremujorit të parë është ruajtur e pandryshuar në 5.0 për qind. Dinamika e zhvillimeve makroekonomike dhe e kushteve monetare në ekonomi ka ushtruar presione për rritje të pakta të nivelit të çmimeve të konsumit në përputhje me objektivin e inflacionit. Në ndryshim nga vitet e kaluara, burimi kryesor i zgjerimit monetar gjatë kësaj periudhe ka qenë kreditimi i ekonomisë. Më parë kontributin kryesor e kanë dhënë huamarrja e qeverisë apo flukset hyrëse valutore. Rritja me ritme të larta e kredisë për ekonominë ka kompensuar rënien e huamarrjes së qeverisë.

Banka e Shqipërisë, në përputhje me arritjen e objektivit të rezervës valutore ka qenë e pranishme në tregun valutë, në gjashtëmujorin e dytë të vitit. Ajo ka blerë valutë pothuajse gjatë gjithë periudhës, duke zbutur presionet mbiçmuese mbi kursin e këmbimit dhe duke injektuar likuiditet në treg. Nga ndërhyrjet e saj në këtë treg, vlerësohet se janë injektuar rreth 12.4 miliardë lekë likuiditet, duke ndihmuar sistemin bankar me likuiditet dhe duke kontribuar në stabilizimin e treguesve financiarë. Si një ekonomi e ekspozuar ndaj importeve, Shqipëria ndikohet në mënyrë të pashmangshme nga zhvillimet në kursin e këmbimit. Ndikimi i këtij faktori duhet të analizohet jo vetëm në efektin që ai jep në përcjelljen e goditjeve të ofertës, si rritja e çmimit të naftës, por dhe në nivelin e inflacionit të importuar. Mbiçmimi i monedhës vendase është moderuar ndjeshëm gjatë vitit 2005 krahasuar me mbiçmimin e një viti më parë. Leku u mbiçmua mesatarisht me 2.6 për qind ndaj dollarit amerikan dhe 2.7 për qind ndaj euros. Një vit më parë ky mbiçmim ishte respektivisht 15.7 për qind dhe 7.2 për qind. Mbiçmimi i lekut ndaj euros si dhe normat e qëndrueshme të inflacionit në dy partnerët tanë kryesorë tregtarë Itali dhe Greqi, kanë krijuar kushte për stabilitet në ambientin e jashtëm tregtar, duke lehtësuar kështu presionet inflacioniste të përcjella nga ky faktor i kërkesës.

Ecuria e prodhimit bujqësor gjatë vitit 2005 ka dhënë një ndikim të ndryshëm mbi inflacionin në periudha të ndryshme të vitit. Ndërsa, gjatë gjysmës së parë të vitit 2005 ky faktor i ofertës ndikoi në uljen e normave të inflacionit, për periudhën e mbetur të vitit ai veproi në kahun e kundërt. Rritja më e ulët e prodhimit të brendshëm bujqësor, e kombinuar me rritjen e presioneve inflacioniste të gjeneruara nga çmimet më të larta të mallrave ushqimorë në tregjet partnere si dhe me zbutjen e efektit kompensues të mbiçmimit më të dobët të lekut ndaj euros, rezultoi në çmime më të larta të këtyre mallrave gjatë gjashtëmujorit të dytë.

Në përgjithësi, viti 2005 u karakterizua nga norma të ulta rritjeje të çmimeve të prodhimit. Pas një tremujori të parë me rritje dyshifrore, ndryshimi vjetor i indeksit të çmimeve të prodhimit shënoi norma të ulta rritjeje gjatë periudhës prill–shtator 2005. Në fund të nëntëmujorit të parë të vitit, çmimet e prodhimit janë 2.3 për qind më të larta sesa niveli i tyre për të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Pagat. Viti 2005 u shoqërua nga një situatë e qëndrueshme në pagat e tregut e privat dhe një rritje e moderuar e pagave të sektorit publik. Këto rritje nuk kanë përcjellë presione inflacioniste nëpërmjet spirales pagë – inflacion.

Çmimi i naftës. Rritja e çmimit të naftës ka qenë një shqetësim i vazhdueshëm në drejtim të rritjes së kostos së jetës gjatë vitit 2005. Rritjet mesatare të çmimit të naftës në tregun ndërkombëtar prej 43.0 për qind në gjysmën e parë të vitit dhe 34.0 për qind në pjesën e dytë të vitit 2005, u përkthyen në rritje mesatare në nivelin 27 për qind të çmimit të këtij produkti në tregun vendas. Megjithatë, pesha e vogël që zë ky produkt në shportën e mallrave të konsumit nënkupton një ndikim të vogël të rritjes së çmimit të naftës në inflacionin total. Rritja më e ulët e çmimit të naftës në vend ka ardhur si pasojë e disa faktorëve. Së pari, pozitat e forta të lekut kundrejt usd gjatë dy viteve të fundit kanë amortizuar një pjesë të rritjes së çmimit të naftës në tregun ndërkombëtar. Zbutja e mbiçmimit të lekut ndaj dollarit gjatë gjashtëmuajorit të dytë të vitit 2005, ndikoi në një rritje më të shpejtë të çmimit të naftës gjatë kësaj periudhe. Së dyti, çmimi i naftës të prodhuar në vend, ka patur një rritje më të ulët prej 3.2 për qind në nivel vjetor. Duke zëvendësuar një pjesë të importeve, kjo ka zbutur disi goditjen e çmimeve ndërkombëtare të naftës. Së fundi, importuesit janë kufizuar në aplikimin e çmimeve tepër të larta, duke qenë se rritja e çmimit të naftës ka sjellë uljen e kërkesës për këtë produkt. Kështu, gjatë tremujorit të katërt kërkesa për naftë është ulur me 21 për qind në terma vjetorë. Kostoja e jetesës rritet jo vetëm nga efekti direkt në inflacion por edhe nga rritja e kostove të lidhura me çmimet e naftës. Megjithatë, gjatë këtij viti nuk janë vërejtur efekte të konsiderueshme dytësore ose indirekte, në formën e përcjelljes të kësaj kostoje mbi çmimin e produkteve të tjera.

5. ZHVILLIMET NË OFERTËN E PARASË

Zhvillimet monetare gjatë vitit 2005 kanë konsistuar në rritjen relativisht të lartë të ofertës monetare (M3) në krahasim me prirjen e saj historike; uljen e mëtejshme të shpejtësisë së qarkullimit të parasë; dhe në një ndërmjetësim më të lartë të sistemit bankar në ekonomi. Rritja vjetore e ofertës monetare kulmoi në periudhën e verës, në sajë të kërkesës së lartë të ekonomisë për mjete monetare dhe rritjes së papritur të kërkesës të qeverisë për financimin e deficitit buxhetor. Në tremujorin e fundit të vitit, ritmi i rritjes së kërkesës për mjete monetare u kthye drejt prirjes historike të saj.

Struktura kohore dhe valutore e ofertës monetare ka shënuar zhvillime pozitive. Paraja jashtë bankave u rrit me vetëm 8.4 për qind në vitin 2005. Në vlerë absolute ky tregues pësoi rritje prej 11.6 miliardë lekësh, kundrejt rritjes prej 34.7 miliardë lekësh të ofertës monetare në lekë të shprehur nga agregati M2. Pas këtyre rritjeve, raporti i parasë jashtë bankave ndaj M2 në fund të vitit, rezultoi 35.1 për qind kundrejt 35.3 për qind në fund të vitit 2004. Rënia e këtij raporti është në përputhje me parashikimet e programit monetar të Bankës së Shqipërisë. Qëndrueshmëria e raportit të parasë jashtë bankave ndaj agregatit M2 gjatë vitit ka përcjellë sinjale pozitive për rënien e presioneve inflacioniste në ekonomi. Prirja rënëse e parasë jashtë bankave është akoma më e theksuar në raport ndaj agregatit të gjerë M3, si pasojë e rritjes së shpejtë të depozitave në valutë. Në fund të vitit, ky raport rezultoi 25.9 për qind ose 1.3 pikë përqindjeje më pak se në fund të vitit 2004.

Komponenti kohor i ofertës monetare reflektoi parashikimin e Bankës së Shqipërisë mbi ecurinë e kërkesës së ekonomisë për mjete monetare në lekë. Rritja vjetore e depozitave në lekë rezultoi 9.1 për qind. Kjo rritje përbën shtim të nivelit të depozitave në lekë në sistemin bankar prej 23.2 miliardë lekësh gjatë periudhës dymbëdhjetëmuajore të vitit 2005. Normat pozitive të interesit real kanë siguruar kanalizimin e parasë së krijuar në depozita. Në tërësi, niveli i depozitave ka qenë i mjaftueshëm për të mbuluar nevojat për likuiditet të sistemit bankar.

Depozitat në valutë kanë ruajtur ritmet pozitive të rritjes gjatë vitit 2005. Në fund të vitit ato përbënin 26.3 për qind të ofertës monetare, rreth 4.3 pikë përqindje më shumë se në vitin 2004. Ecuria e nivelit të depozitave në valutë ka manifestuar rritje më të shpejtë, krahasuar me vitet e mëparshme. Rritja vjetore e tyre në fund të vitit rezultoi 31.2 për qind. Burimi kryesor i rritjes së depozitave në valutë konsiston në prurjet valutore në formën e remitancave, të cilat kanë demonstruar një tendencë në rritje të kanalizimit të tyre nëpërmjet sistemit bankar. Ky burim ka qenë i pranishëm ndër vite. Megjithatë, zhvillimet në kursin e këmbimit të lekut reflektohen në madhësinë e hyrjeve valutore të shprehura në monedhën vendase. Efekti i kursit të këmbimit për nivelin e depozitave në valutë të shprehura në lekë është rreth 5.8 miliardë lekë.

6. KËRKESA PËR MJETE MONETARE

Në kushtet e konsolidimit të politikës fiskale gjatë vitit 2005, vihet re zhvendosje e kërkesës për mjete monetare nga qeveria drejt ekonomisë. Për herë të parë në vitin 2005, kredia për ekonominë ka qenë nxitësi kryesor i kërkesës për para, duke kontribuar në 75 për qind të rritjes vjetore të ofertës monetare.

Pozicioni valutor i sistemit bankar nuk ka patur ndryshime të ndjeshme gjatë vitit 2005. Mjetet valutore neto të sistemit bankar kanë mbetur në nivelin 2 miliardë usd, si pasojë e zhvillimeve të ekuilibruara në nivelet e mjeteve valutore të Bankës së Shqipërisë dhe bankave tregtare. Rezerva valutore neto e Bankës së Shqipërisë ka arritur nivelin 1.3 miliardë usd në fund të vitit, duke shënuar një rritje vjetore prej 59 milionë dollarësh amerikanë. Tendencë në rritje e rezervës valutore neto u vu re gjatë pjesës së dytë të vitit, si rezultat i blerjeve valutore prej 126 milionë usd të Bankës së Shqipërisë. Ecuria e mjeteve valutore neto të bankave të nivelit të dytë ka qenë më e luhatshme, duke reflektuar ecurinë relative të treguesve që ndikojnë këto mjete. Në përgjithësi, përshpejtimi i rritjes së kredisë në valutë gjatë vitit, ka tejkalluar rritjen e hyrjes së depozitave në valutë në bankat tregtare, duke ulur dhe nivelin e mjeteve valutore neto. Në terma vjetorë, këto mjete janë ulur me 63 milionë usd.

Financimi i deficitit buxhetor gjatë vitit 2005 është mbuluar pothuajse tërësisht nga financimi i brendshëm - sistemi bankar dhe publiku. Në fund të vitit, niveli i financimit të brendshëm në total shënoi rreth 20.6 miliardë lekë. Banka e Shqipërisë ka qenë e pranishme në financimin e deficitit gjatë

muajve korrik dhe shtator, me qëllim shmangien e luhatjeve të mëdha të normave të interesit në tregun ndërbankar dhe në atë të bonove të thesarit. Obligacionet qeveritare dy dhe tre - vjeçare kanë përbërë burimin kryesor të financimit të deficitit buxhetor. Gjatë vitit 2005, qeveria ka shitur 18.6 miliardë lekë obligacione qeveritare dyvjeçare. Obligacionet qeveritare me maturim trevjeçar, të shitura në total rreth 6 miliardë lekë, u emetuan për herë të parë gjatë këtij viti. Niveli i bonove të thesarit të emetuara u ul me rreth 4 miliardë lekë gjatë vitit 2005. Portofoli i bonove të thesarit të bankave të nivelit të dytë u ul me rreth 21.9 miliardë lekë. Në të kundërt, individët dhe Banka e Shqipërisë kanë rritur përkatësisht portofolet e tyre të bonove të thesarit me 12.2 miliardë lekë dhe 3.1 miliardë lekë. Portofoli i bonove të thesarit të institucioneve financiare jobankare është rritur lehtësisht, me rreth 0.1 miliardë lekë. Pjesëmarrja aktive e individëve në blerjen e bonove të thesarit dëshmon për një dukuri pozitive, si në zgjerimin e tregut të bonove të thesarit, ashtu dhe në diversifikimin e portofolit të bonove të thesarit përsa i përket mbajtësve të tyre.

Kreditimi i ekonomisë ka shënuar një rritje të dukshme gjatë vitit 2005. Portofoli i kredisë së sistemit bankar, gjatë vitit 2005 u rrit me 74.3 për qind ose 52 miliardë lekë në vlerë absolute. Ritmi i rritjes së kredisë gjatë vitit 2005 ishte dy herë më i lartë se ai i regjistruar në vitin paraardhës. Kjo rritje e shpejtë është reflektuar edhe në përmirësimin e treguesve të ndërmjetësimit të sistemit bankar. Kështu, në fund të vitit 2005, teprica e kredisë për ekonominë përbënte 25 për qind të totalit të aktiveve të sistemit bankar. Gjithashtu, në fund të vitit 2005, teprica e kredisë për ekonominë shënoi vlerën 14.6 për qind të PBB-së, duke shënuar një rritje vjetore prej 6.2 pikësh përqindjeje. Rritja e kredidhënies në terma afatgjatë, ka ndikuar në zhvendosjen e strukturës së portofolit të kredisë drejt maturiteteve afatgjata. Pesha e kredisë me maturitet mbi 5 vjet ka njohur rritje të vazhdueshme gjatë vitit 2005, ndërkohë që pesha e kredisë afatshkurtër ndaj totalit ka shënuar rënie. Shpërndarja e kredisë, në kredi për individë dhe kredi për biznese, nuk ka patur ndryshime të ndjeshme gjatë vitit 2005. Kredia për individët në fund të vitit përbënte 31.6 për qind të totalit të kredisë, duke shënuar një rritje të lehtë prej 1 pikë përqindjeje ndaj vitit 2004. Kredia për bizneset zë rreth 69 për qind të totalit. Kjo kredi regjistroi një rritje vjetore prej 74 për qind gjatë vitit 2005. Në ndryshim nga viti i kaluar, kreditimi i korporatave ka marrë shtysë edhe nga orientimi i bankave për të kredituar bizneset në monedhën vendase. Viti 2005 u karakterizua nga një rritje e shpejtë e kredisë në lekë, rritja vjetore e së cilës shënoi vlerën 127 për qind. Në ndryshim nga viti 2004, në vitin 2005 vihet re një angazhim i bankave për të kredituar në lekë jo vetëm individët, por edhe bizneset. Stabiliteti në kursin e këmbimit dhe ulja e diferencave të normave të interesit për kredinë në valutë kundrejt asaj në lekë, mendohet të kenë nxitur interesin e bizneseve për të marrë kredi në lekë. Megjithatë, me 74.5 për qind të totalit, kredia në valutë vazhdon të zërë peshën kryesore në kredidhënie. Shpërndarja sektoriale e kredisë për vitin 2005, dëshmon rritje të interesimit të bankave për sektorin e pasurive të paluajtshme, për sektorin e ndërtimit dhe më të moderuar për bujqësinë. Pesha e secilit sektor ndaj totalit ka njohur përkatësisht rritje me 4.4, 3.2 dhe 1.2 pikë përqindje krahasuar me një vit më parë. Ndërkohë që sektori i tregtisë vazhdon të mbetet sektori më

i kredituar i ekonomisë, me 18.9 për qind të totalit të kredive nga 23.3 për qind që zinte në vitin 2004.

7. TREGJET FINANCIARE DHE NORMAT E INTERESIT

Aktiviteti në tregun financiar dhe normat e interesit kanë manifestuar luhatje më të larta gjatë vitit 2005. Në gjysmën e parë të vitit, rritja e depozitave në sistemin bankar dhe ulja e kërkesës së qeverisë për mjete monetare, bënë që sistemi bankar të karakterizohej nga teprica likuiditeti (mesatarisht 7.4 miliardë lekë), që çuan në ulje të normave të interesit. Duke ndjekur prirjen e shfaqur në dy vitet e fundit, normat e interesit të pranimit të depozitave në lekë arritën nivelet më të ulëta historike, në 3.5 për qind në muajin qershor.

Gjatë tremujorit të tretë, rritja e kredisë për ekonominë, kërkesa e përqendruar për financim të deficitit buxhetor në periudhën para - dhe paszgjedhore, dhe ngadalësimi i fluksit të depozitave, çuan në rënien e shpejtë të likuiditetit në sistem. Kjo shkaktoi rritjen e normave të interesit në tregun ndërbankar dhe në atë të bonove të thesarit.

Mungesa e likuiditetit u ndje më tepër në tregun primar, ku kërkesa e qeverisë për financim në disa raste mbeti e paplotësuar, ndërsa *yield*-i i bonove të thesarit u rrit nga 6.77 për qind në muajin qershor në 9.14 për qind në muajin shtator, për afatin dymbëdhjetëmuajor. Për administrimin e kësaj situate, fillimisht Banka e Shqipërisë gjatë muajit korrik ndryshoi kahun e operacioneve monetare, me qëllim plotësimin e nevojave afatshkurtra të sistemit për likuiditet, nëpërmjet kryerjes së repove të anasjellta. Blerja e bonove të thesarit në mënyrë të vazhduar si dhe ndërhyrja në tregun valutor ishin instrumente shtesë të përdorura nga Banka e Shqipërisë për qetësimin e tregjeve financiare.

Viti 2005 shënoi një rritje të ndjeshme të interesit të individëve për të investuar në bono thesari. Individët financuan një pjesë të konsiderueshme të deficitit buxhetor, gjatë vitit të shkuar. Banka e Shqipërisë e ka mbështetur dhe inkurajuar këtë zhvillim, si një hap i nevojshëm për zgjerimin e tregut të bonove të thesarit dhe rritjen e përdorimit të instrumenteve financiare në ekonomi. Në mungesë të pjesëmarrjes së individëve, luhatjet e *yield*-it të bonove të thesarit do të ishin më të mëdha dhe efektet e tyre do të ishin më serioze.

8. INSTRUMENTET E POLITIKËS MONETARE

Në mbështetje të operacioneve të saj monetare, Banka e Shqipërisë ka vënë në dispozicion të bankave të nivelit të dytë lehtësitë e kuadrit të saj operacional. Instrumenti kryesor i përdorur në kuadrin e operacioneve monetare gjatë gjysmës së parë të vitit 2005, ka qenë marrëveshja e riblerjes me maturim njëjavor me çmim fiks. Niveli mesatar javor i likuiditetit të tërhequr gjatë kësaj periudhe, ka rezultuar mesatarisht 6.35 miliardë lekë. Gjithashtu, nevoja për të strukturuar nivelin e lartë të likuiditetit ka kushtëzuar

përdorimin e ankandit të marrëveshjes së riblerjes me maturim njëmuor nga ana e Bankës së Shqipërisë me shumën e përcaktuar 1.5 miliardë lekë, gjatë gjysmës së parë të vitit.

Shtërngimi i kushteve të likuiditetit të sistemit dhe tendenca për rritje e normave të interesit të bonove të thesarit në tremujorin e tretë të vitit, bënë të nevojshme ndërhyrjen e Bankës së Shqipërisë me anë të instrumenteve të saja injektuese. Kështu, u krye injektimi i rreth 2.4 miliardë lekëve gjatë periudhës gusht-shtator, me anë të marrëveshjes së anasjelltë të riblerjes me maturim javor me çmim fiks. Qëllimit të injektimit të likuiditetit në treg i shërbyen edhe veprimet e ndërmarra nga Banka e Shqipërisë në tregun e letrave me vlerë si dhe në tregun valutor. Në tregun e letrave me vlerë Banka e Shqipërisë bleu bono thesari me një vlerë prej 3.5 miliardë lekësh ndërsa, në tregun valutor bleu valutë për një vlerë 2.5 miliardë lekë. Në total, shuma e injektuar arriti nivelin e 8.5 miliardë lekëve. Këto ndërhyrje rikthyen gjendjen e tepricës së likuiditetit në sistemin bankar dhe mundësuan zbutjen e presioneve të normave të interesit në tregun e letrave me vlerë. Kalimi i sistemit bankar në tepricë likuiditeti, gjatë tremujorit të fundit, u shoqërua me ndryshimin e kahut të ndërhyrjes në tregun bankar, duke tërhequr likuiditet me anë të marrëveshjeve njëjavore me çmim fiks.

Funksionimi më i mirë i tregut ndërbankar gjatë vitit 2005, bëri që të kufizohej përdorimi i depozitës njëditore dhe i kredisë njëditore, përkatësisht në investimin e mesatarisht të 0.76 miliardë lekëve në ditë dhe tërheqjen e kredisë prej mesatarisht 0.02 miliardë lekëve në ditë, nga bankat e nivelit të dytë. Kredia lombard nuk ka gjetur përdorim gjatë vitit 2005.

Përdorimi i instrumentit të rezervës së detyruar i ka shërbyer zbatimit të politikës monetare dhe mbajtjes nën kontroll të rrezikut potencial të sistemit bankar. Banka e Shqipërisë ka në dispozicion të bankave të nivelit të dytë lehtësinë e përdorimit të 20 për qind të rezervës së detyruar, me synim plotësimin e nevojave afatshkurtra për likuiditet të sistemit. Kështu, gjatë vitit 2005, bankat kanë përdorur mesatarisht rreth 11 për qind të nivelit maksimal të lejuar prej 20 për qind, të përdorimit të rezervës së detyruar. Në krahasim me një vit më parë është vënë re një ulje e përdorimit të kësaj lehtësie. Njëkohësisht, Banka e Shqipërisë ka vijuar zbatimin e politikës së remunerimit të rezervës së detyruar. Normat e remunerimit kanë reflektuar ndryshimet në normën bazë të interesit të monedhave në të cilat mbahet rezerva e detyruar. Në tërësi, niveli i gjendjes së llogarisë është mirëadministruar nga bankat e sistemit, duke kufizuar në minimum rastet e mosplotësimit të rezervës së detyruar.

9. MBIKËQYRJA BANKARE

Viti 2005 pati si karakteristikë vazhdimin e zhvillimit dinamik të sistemit bankar në Shqipëri. Kjo dinamikë u reflektua në zgjerimin e aktivitetit bankar në përgjithësi ku mund të përmendim: rritjen e ndjeshme të kredive; aplikime të reja për licencë bankare; shitje dhe ndryshime të strukturës së aksionerëve

të bankave; dhe zgjerim të fuqishëm të rrjetit të bankave ekzistuese në zona të ndryshme të vendit.

Në shkurt të vitit që shkoi u miratua paraprakisht dhe më vonë iu dha licenca përfundimtare për të kryer aktivitet bankar në Republikën e Shqipërisë, një banke të re shqiptare. Me licencimin e saj numri i bankave me kapital tërësisht shqiptar shkon në tre dhe numri total i bankave në 17.

Në qershor të vitit 2005 u dha miratimi për ndryshimin e pronësisë së bankës "Dardania". Gjatë vitit që shkoi u aplikua për marrjen e licencës nga ana e një banke tjetër, e cila do të transformohet nga degë e një banke të huaj në filial të po asaj banke.

Në vitin 2005 shtrirja dhe zgjerimi i rrjetit të bankave me degë dhe agjenci njohu një zhvillim edhe më të madh se një vit më parë. Gjatë vitit u dhanë lejet për hapjen e 48 degëve dhe agjencive të reja në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Sistemi bankar raporton një rezultat neto pozitiv për vitin 2005, rreth 6.6 miliardë lekë apo 29.2 për qind më të lartë se një vit më parë. Treguesit kryesorë të rentabilitetit, norma e kthimit mbi aktivet mesatare (RoAA) dhe norma e kthimit mbi kapitalin mesatar (RoAE), kanë patur një ecuri të mirë gjatë vitit 2005. Kthimi mbi aktivet paraqet një rritje më të shpejtë sesa kthimi mbi kapitalin, duke reflektuar edhe rritjen e kërkesave ligjore për kapital nga Banka e Shqipërisë. Rritja e RoAA konfirmon përmirësimin cilësor të rentabilitetit të sistemit bankar. Pavarësisht nga niveli i lartë i kthimit nga kapitali aksioner, të ardhurat nuk janë shërndarë në dividendë por kanë shërbyer si një mbështetje e mirë e bankave për të zgjeruar aktivitetin e tyre nëpërmjet shtimit të kapitalit.

Gjatë vitit 2005, aktivet e sistemit bankar shënuan rritje me 70.1 miliardë lekë (ose 16.4 për qind), rreth 17.3 miliardë lekë më e lartë se rritja e aktiveve e evidentuar në vitin 2004. Përveç bankave të mëdha, në zgjerimin e bilancit të sistemit kontribuan dhe disa nga bankat e mesme e të vogla.

Gjatë vitit 2005, teprica e kredisë së sistemit bankar u rrit me rreth 52 miliardë lekë, nga 19.3 miliardë lekë një vit më parë. Ritmi i lartë rritës flet për shtrirjen e konsiderueshme të sistemit bankar në kredidhënie, e nxitur kjo dhe nga privatizimi i bankës më të madhe në sistem, Bankës së Kursimeve. Treguesi "kredi me probleme ndaj tepricës së kredisë (neto)", i cili mat madhësinë neto të ekspozimit ndaj rrezikut të kredisë shënoi nivele të ulëta, madje me një tendencë në rënie përgjatë vitit 2005. Po kështu, edhe aftësia e sistemit bankar për të mbuluar me kapital humbjet e rrjedhura nga kreditë evidentohet e përmirësuar, rrjedhojë e ritmit më të lartë rritës të kapitalit rregullator (+34.7 për qind), kundrejt rritjes së tepricës neto të kredisë me probleme (+23 për qind).

Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit për sistemin bankar në fund të vitit, shënon nivelin 19 për qind duke respektuar dhe tejkaluar nivelin minimal

të mjaftueshmërisë së kapitalit prej 12 për qind. Megjithatë, evidentohen disa banka të cilat gjatë vitit 2005 kanë patur nivele të këtij treguesi shumë afër nivelit minimal. Ky zhvillim na obligon të rrisim kujdesin ndaj treguesve të qëndrueshmërisë financiare të sistemit bankar, dhe ilustron nevojën për konsolidim të mëtejshëm të tij.

10. BILANCI I BANKËS SË SHQIPËRISË

Gjatë vitit 2005, totali i aktiveve të Bankës së Shqipërisë u rrit më tej, duke regjistruar nivelin 224,6 miliardë lekë, rreth 11 për qind më i lartë se ai i fundvitit 2004.

Rritje pasqyrojnë të dyja grupet përbërëse, si aktivet e huaja ashtu edhe ato vendase, ndërkohë që grupi i parë zë rreth 68 për qind të totalit të aktiveve nga 65 për qind në fund të vitit të kaluar. Në krahun e pasiveve, detyrimet e huaja kanë qëndruar në të njëjtin nivel me atë të një viti më parë ndërsa detyrimet vendase kanë pësuar rritje në masën 11 për qind. Paraja në qarkullim është treguesi që jep ndikimin kryesor në këtë rritje.

Në përgjithësi, bilanci kontabël i Bankës së Shqipërisë dhe pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve, reflektojnë disa nga zhvillimet bazë që janë regjistruar në ekonomi, ku Banka e Shqipërisë ka një rol të rëndësishëm. Duke pasqyruar një rënie të nivelit të interesave në lekë në përgjithësi, të ardhurat e realizuara prej tyre janë në vlerë më të vogël nga ato të vitit 2004, ndërkohë që e ardhura e realizuar prej interesave në valutë është më e lartë, duke reflektuar ecurinë e normave të interesit në tregjet e huaja valutore.

Në përfundim, nisur nga fakti se shpenzimet e vitit ushtrimor 2005 janë pothuajse të njëjta me ato të vitit të mëparshëm, si dhe mbështetur në faktin tjetër se të ardhurat nga veprimet në lekë nuk janë kompensuar plotësisht nga të ardhurat në veprimet me valutë, rezulton që fitimi neto i Bankës së Shqipërisë të jetë në nivelin 5,2 miliardë lekë, rreth 281 milionë lekë më pak se fitimi neto i realizuar gjatë vitit 2004.

11. AKTIVITETE TË TJERA

Vitin e kaluar, u vu në zbatim sistemi i kryqëzimit të pagesave në vlerë të vogël. Bëhet fjalë për një sistem shumë bashkëkohor në fushën e pagesave, i cili i kombinuar dhe me sistemin tjetër, atë të pagesave në vlera të mëdha, kanë krijuar një shtrat të sigurtë për përsosje të mëtejshme. Megjithë zhvillimet e shpejta në vitin 2005, Banka e Shqipërisë gjykon se ka hapësira më të mëdha veçanërisht në drejtim të kanalizimit të pagave të sektorit privat nëpërmjet bankave, të shlyerjes së faturave të shërbimeve utilitare nëpërmjet llogarisë bankare dhe të shtimit numerik të pagesave elektronike.

Një drejtim tjetër i rëndësishëm ka të bëjë me aspiratat e vendit tonë për një anëtarësim të mundshëm në BE. Banka e Shqipërisë ka qenë e angazhuar

në bisedimet zyrtare për nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA) ndërmjet Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian si dhe ka mbajtur kontakte të ngushta me Ministrinë e Integritimit Evropian. Gjatë vitit të shkuar u vendosën kontaktet e drejtpërdrejta me Komisionin Evropian, me Bankën Qendrore Evropiane si dhe u rigjallëruan dhe u ngritën në nivel më të lartë marrëdhëniet me BIS (Banka për Rregullime Ndërkombëtare) dhe me shumë institucione të tjera pjesë e Eurosistemit. Aktualisht, kemi ndërtuar disa projekte të ndryshme bashkëpunimi dypalësh dhe shumëpalësh me partnerë bankat qendrore të Eurozonës, bankat qendrore të anëtarëve të rinj të BE-së si dhe institucionet e Brukselit. Në të njëjtën kohë, në kuadër të zhvillimit të bashkëpunimit rajonal, janë vendosur kontakte të ngushta me bankat qendrore të rajonit si dhe janë nënshkruar Memorandume të Bashkëpunimit në fushën e Mbikëqyrjes Bankare me Autoritetin e Bankave dhe Pagesave të Kosovës, me Bankën Qendrore të Republikës së Maqedonisë dhe me Bankën Qendrore të Malit të Zi.

Viti 2005 forcoi më tej marrëdhëniet e ngushta të bashkëpunimit midis Bankës së Shqipërisë dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN). Vlerësimet e bëra prej ekspertëve të FMN-së, në përgjithësi karakterizohen nga nota pozitive, në lidhje me arritjet e Bankës së Shqipërisë në ruajtjen e stabilitetit makroekonomik, në kontrollin e trysnive inflacioniste si dhe në hapat e ndërmarrë për zhvillimin dhe konsolidimin e sektorit bankar. Në muajin nëntor, autoritetet shqiptare negociuan me misionin e FMN-së mbi marrëveshjen e re, e cila u zyrtarizua në muajin janar të vitit 2006. Kjo marrëveshje është një përzierje midis programit për Zbutjen e Varfërisë dhe Rritjen Ekonomike dhe programit "Lehtësia e Financimit Afatmesëm (Extended Fund Facility)", e cila parashikon një huamarrje më afër termave tregtarë.

Bashkëpunimi i suksesshëm midis Bankës së Shqipërisë dhe Bankës Botërore ka vazhduar me intensitet edhe gjatë vitit 2005. Ky bashkëpunim është përqendruar në asistencën financiare dhe teknike që Banka Botërore vazhdon t'i japë Bankës së Shqipërisë. Në këtë kuadër, me rëndësi të veçantë është mbështetja financiare për Projektin e Kryqëzimit të Pagesave në Vlerë të Vogël (AECH), i cili përfundoi me sukses dhe u përrua në muajin korrik.

Pa dyshim, kontributi më i spikatur i të dyja institucioneve të sipërpërmendura ka të bëjë me zbatimin e Programit për Vlerësimin e Sektorit Financiar (FSAP) në Shqipëri. Për këtë qëllim, misioni i përbashkët i këtyre dy institucioneve vizitoi Shqipërinë në muajt shkurt dhe maj, ndërkohë që përfundimet e raportit FSAP u bënë publike në korrik. Raporti FSAP, përgjithësisht vlerësoi me nota pozitive formulimin, vendimmarrjen si dhe zbatimin e politikës monetare dhe në të njëjtën kohë, e vlerësoi sistemin bankar shqiptar si të qëndrueshëm dhe të shëndetshëm. Raporti FSAP doli edhe me një grup rekomandimesh për institucionet përgjegjëse, për ruajtjen e stabilitetit financiar në vend. Mbështetur në rekomandimet e mësipërme, Banka e Shqipërisë është angazhuar në bashkëpunim me institucionet përkatëse, për hartimin e një plani konkret masash zbatimi, i cili do të adresojë përparësitë e paraqitura në raportin FSAP.

Një projekt tjetër shumë i rëndësishëm lidhet me nënshkrimin në muajin shtator 2005, në selinë e Bankës Botërore në Uashington, të marrëveshjes

“Për Administrim dhe Konsulencë të Investimit të Rezervës Valutore”. Kjo marrëveshje, përveç administrimit të një pjese të rezervës valutore të Bankës së Shqipërisë nga ana e Bankës Botërore, parashikohet të sjellë edhe asistencë e programe kualifikuese për stafin teknik të Bankës së Shqipërisë, të përfshirë në procesin e administrimit të rezervës valutore.

Gjatë vitit 2005, kuadri ligjor dhe rregullator ka vijuar të plotësohet dhe të përmirësohet më tej. Këto ndryshime janë kryer në kuadër të angazhimeve që rrjedhin nga procesi i Stabilizim-Asociimit me Bashkimin Evropian, si dhe janë diktuar nga nevojat e zhvillimit me ritme të shpejta të sistemit bankar shqiptar. Në kuadrin e procesit të Stabilizim-Asociimit, Banka e Shqipërisë ka realizuar në mënyrë të kënaqshme prioritetet afatshkurtra, të përcaktuara në Planin Kombëtar të Përafrimit të Legjislacionit Vendas me atë të BE-së dhe Zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.

Rritja e transparencës së Bankës së Shqipërisë gjatë vitit 2005, ka qenë në qendër të vëmendjes së punës sonë. Jemi munduar që analizat, studimet dhe konkluzionet, projektet tona të së ardhmes, këshillat për institucionet e tjera të vendit e shumë çështje të tjera të kësaj natyre, t’i bëjmë prezente në forume shkencore, në tryeza debatesh, me pjesëmarrje aktive tonën si brenda ashtu dhe jashtë vendit, pa harruar të përmend edhe aktivitete të tjera brenda institucionit.

Gjithësesi, dëshiroj të them se pas Konferencës së Pestë të Bankës së Shqipërisë në muajin mars 2005, në qytetin e Durrësit, kulmi i aktivitetit publik u arrit në muajin dhjetor të vitit kaluar kur, në praninë e Drejtorit të Përgjithshëm të Bankës të Rregullimeve Ndërkombëtare, z. Night, të shumë guvernatorëve të nderuar, të një grupi elitar ekspertësh ndërkombëtarë, Banka e Shqipërisë bëri një prezantim të aspiratave të saj të politikës monetare të së ardhmes drejt regjimit bashkëkohor të shënjestrimit të inflacionit.

Të nderuar deputetë,

Shpresoj që në fjalën time të kem paraqitur qartë aktivitetin tonë gjatë vitit 2005. Sigurisht që sfidat që kemi përpara imponojnë ritme më të larta. Për këtë qëllim, në programet e punës për vitin 2006 jemi më kërkues dhe më të orientuar drejt politikave dhe praktikave që çojnë përpara procesin e integritit të vendit.

Banka e Shqipërisë, duke vlerësuar rolin e saj si një nga institucionet kyçe në përmbushjen me sukses të objektivave ambiciozë të programit afatmesëm, ka hartuar tashmë programin monetar për vitin 2006. Duke u mbështetur në supozimet bazë të këtij programi për një rritje ekonomike 5 për qind në kushtet e një inflacioni mesatar 3 për qind, Banka e Shqipërisë parashikon që rritja e ofertës do të jetë në nivelin 11.8 për qind. Kjo rritje vlerësohet të jetë e mjaftueshme për të përmbushur nevojat e ekonomisë për mjete monetare dhe veçanërisht, për të mundësuar një zgjerim të kredisë në kufirin e 53 miliardë lekëve ose rreth 45 për qind të totalit. Duke vazhduar logjikën

pozitive ekonomike të vitit 2005, financimi i deficitit buxhetor nga sistemi bankar parashikohet të konsumojë rreth 12.8 miliardë lekë ose $\frac{1}{4}$ e fondeve të parashikuara për kreditim. Banka e Shqipërisë vlerëson se mbështetja në rritje e biznesit shqiptar me fonde të brendshme, përbën një premisë pozitive për ruajtjen e ritmeve të larta të rritjes ekonomike edhe në të ardhmen.

Sigurisht, që detyrë themelore do të mbetet përmbushja e detyrimit tonë ligjor për kontrollin e inflacionit, por gjithnjë duke i kushtuar vëmendje të madhe ruajtjes dhe promovimit të stabilitetit financiar të sistemit bankar. Për këtë qëllim, ne do të mbetemi thellësisht të angazhuar, dhe duke përfituar nga kjo foltore dëshiroj të siguroj Kuvendin e Shqipërisë, se Banka e Shqipërisë do të jetë një institucion i përgjegjshëm, transparent dhe i pavarur në përmbushjen e objektivave të saj.

Shënim

¹ Vlerësimi për rritjen ekonomike të vitit 2005, është një produkt i përbashkët i Misionit EU1 të FMN-së, Ministrisë së Financave dhe Bankës së Shqipërisë.



KAPITULLI I
EKONOMIA BOTËRORE

KAPITULLI I. EKONOMIA BOTËRORE

I.1 EKONOMITË E MËDHA DHE BANKAT QENDRORE

Ekonomia botërore ka shënuar rritje edhe gjatë vitit 2005. Vlerësimet paraprake tregojnë se aktiviteti ekonomik në nivel botëror është rritur me 3.2 për qind gjatë vitit të shkuar ¹. Kjo rritje është nxitur kryesisht nga faza e favorshme e ciklit ekonomik të ekonomisë amerikane dhe të ekonomive të vendeve aziatike, nga rritja e tregtisë botërore. Megjithë kahun shtrëngues, politikat makroekonomike kanë qëndruar në nivele stimuluese, duke ndikuar pozitivisht aktivitetin ekonomik. Nga ana tjetër, viti 2005 është karakterizuar nga një sërë ngjarjesh të cilat kanë frenuar rritjen ekonomike. Çmimi i lartë i naftës si dhe maturimi i ciklit të investimeve pas një viti me rritje të shpejtë ekonomike, bënë që rritja e aktivitetit ekonomik në vitin 2005 të jetë më e ngadaltë se niveli i regjistruar në vitin 2004. Ngadalësimi i rritjes ekonomike vlerësohet të ketë përfshirë pothuajse të gjitha rajonet ekonomike. Kjo dukuri vihet re edhe në vendet në zhvillim, të cilat, gjatë viteve të fundit, kanë demonstruar ritme rritjeje më të shpejta në krahasim me ekonomitë e zhvilluara. Megjithatë, në sajë të peshës së tyre të madhe, këto të fundit mbeten motori i zhvillimit botëror.

	2003	2004	2005 (vlerësim)	2006 (parashikim)
Ekonomia botërore	2.5	3.8	3.2	3.2
Vendet e zhvilluara	1.8	3.1	2.5	2.5
USA	2.7	4.2	3.5	3.5
Eurozonë	0.7	1.7	1.3*	1.4
Japoni	1.4	2.6	2.3	1.8
Vendet në zhvillim	5.5	6.8	5.9	5.7

Burimi: Banka Botërore, "Prospects for the Global Economy," Nëntor 2005.

*Burimi: Eurostat, vlerësim paraprak.

Tabelë 1. Ecuria e rritjes ekonomike.

	PBB-T3	Norma e papunësisë	IÇK	Deficiti buxhetor (% e PBB-së)
USA	+3.5	4.9 (dhjetor)	+3.4 (dhjetor)	-3.7
Eurozonë	+1.6	8.3 (nëntor)	+2.2 (dhjetor)	-2.9
Gjermani	+1.4	11.2 (dhjetor)	+2.1 (dhjetor)	-3.9
Francë	+1.8	9.6 (nëntor)	+1.5 (dhjetor)	-3.2
Itali	+0.1	7.5 (shtator)	+2.0 (dhjetor)	-4.3
Britani	+1.7	5.0 (nëntor)	+2.0 (dhjetor)	-3.1
Japoni	+2.9	4.6 (nëntor)	-0.8 (nëntor)	-6.5

Burimi: Departamenti Amerikan i Punës, Departamenti Amerikan i Tregtisë, revista "The Economist", 21 janar 2006.

Tabelë 2. Disa tregues ekonomikë kryesorë në terma vjetorë (në përqindje).

- EKONOMIA AMERIKANE

Rritja ekonomike në Shtetet e Bashkuara të Amerikës vlerësohet të ketë ngadalësuar ritmin e saj në 3.5 për qind² gjatë vitit 2005. Normat e ulëta

të interesave afatgjatë kanë patur një ndikim pozitiv në nxitjen e kërkesës vendase, ndërkohë që nënçmimi i akumuluar i dollarit ka ndihmuar eksportet amerikane. Ekonomia amerikane ka përfituar, gjithashtu, edhe nga rritja e vazhdueshme e produktivitetit gjatë vitit 2005. Përveç ndikimit pozitiv në rritjen ekonomike, ky faktor ka ndihmuar në zbutjen e presioneve inflacioniste duke mos lejuar përshkallëzimin e mëtejshëm të nivelit të çmimeve. Norma vjetore e inflacionit në muajin dhjetor shënoi 3.4 për qind, nga 3.3 për qind që ishte një vit më parë. Rritja ekonomike ka ndikuar edhe në krijimin e vendeve të reja të punës. Në muajin dhjetor, norma e papunësisë shfaqte vlerat 4.9 për qind nga 5.4 për qind që ishte një vit më parë, duke shënuar ndër nivelet më të ulëta të vendeve të zhvilluara.

Parashikimet afatshkurtra për ekonominë amerikane mbeten pozitive, megjithë shqetësimet mbi ecurinë e buxhetit federal dhe mbi deficitin e lartë të llogarisë korente. Deficiti buxhetor për vitin 2005 vlerësohet të jetë 3.5 për qind e PBB-së. Gjithashtu, ngadalësimi i rritjes ekonomike gjatë tremujorit të katërt, si pasojë e çmimeve të larta të naftës dhe e dëmeve të shkaktuara nga uraganët, ka rritur dyshimet për ruajtjen e rritjes ekonomike në të njëjtat ritme për vitin 2006.

- EKONOMIA E EUROZONËS

Ritmi i rritjes ekonomike për vitin 2005 vlerësohet të jetë 1.6 për qind në 25 vendet e Bashkimit Evropian dhe 1.3 për qind³ në Eurozonë. Ngadalësimi i ritmit të rritjes ekonomike gjatë tremujorit të fundit ishte më pak i spikatur se në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Norma vjetore e inflacionit të harmonizuar në muajin dhjetor ishte 2.2 për qind, duke qëndruar mbi objektivin e Bankës Qendrore Evropiane. Ndryshimet e fundit të çmimeve të administruara dhe të taksave indirekte, rritja e ndjeshme monetare dhe ajo e kredive në kushtet e një likuiditeti tashmë të bollshëm në Eurozonë, si dhe mundësia e konkretizimit të efektit indirekt të rritjes së çmimit të naftës mbi zërat e tjerë të indeksit të çmimeve, forcojnë gjasat e shtimit të presioneve inflacioniste në periudhën afatmesme dhe afatgjatë. Megjithatë, këto rreziqe nuk janë manifestuar plotësisht në pritshmëritë afatmesme të inflacionit, të cilat duhet të mbeten të qëndrueshme në nivele të pajtueshme me stabilitetin e çmimeve. Në këtë mënyrë, qëndrimi i politikës monetare të BQE-së konsiderohet se gjatë vitit 2005 ka patur një efekt pozitiv në rritjen e qëndrueshme ekonomike dhe në reduktimin gradual të normës së papunësisë.

Në krahun tjetër, situata në sektorin e jashtëm të Eurozonës duket se është kthyer në anën e kundërt. Llogaria korente deri në muajin tetor shënoi një deficit prej 9 miliardë eurosh, në krahasim me një suficit prej 43 miliardë eurosh që u regjistrua një vit më parë. Kjo zhvendosje shpjegohet me rritjen e ndjeshme në vlerën e importeve në krahasim me atë të eksporteve, të shkaktuar kryesisht nga rritja në çmimet e importeve.

Shumica e vendeve të Eurozonës kanë nënshkruar programet e rinovuara të stabilizimit, që përfshijnë dhe planin afatmesëm të buxhetit. Vlerësimi i këtyre programeve nga Këshilli i ECOFIN⁴ dhe implementimi i tyre përbën një

mundësi për të përforcuar angazhimin për një politikë të shëndetshme fiskale dhe implementimin rigoroz të Paktit të Rritjes dhe Stabilitetit⁵. Efekti pozitiv i saj do të jetë i konsiderueshëm nëse do t'i vihet rëndësi besueshmërisë së konsolidimit, kufizimeve të kryerjes së shpenzimeve dhe përfshirjes së masave fiskale në një axhendë reformash gjithëpërfshirëse.


- NORMA E INTERESIT

Banka e Rezervës Federale (FED) edhe gjatë këtij viti ka vazhduar të zbatojë politikë shtrënguese monetare. Norma bazë e interesit është rritur 8 herë gjatë vitit 2005, duke arritur në 4.25 për qind në fund të vitit nga 2.25 për qind, që ishte në fillim të tij. Banka Qendrore Evropiane (BQE) rriti me 25 pikë bazë normën bazë të interesit në muajin dhjetor të këtij viti, duke e çuar në 2.25 për qind. Kjo ishte edhe hera e parë që BQE ndryshonte politikën e saj monetare nga nivelet më të ulta historike që prej mesit të vitit 2003. Arsyeja kryesore që çoi politikëbërësit në BQE, të rrisin normën bazë të interesit në ekonomi ishte identifikimi i disa presioneve mbi stabilitetin e çmimeve përgjatë vitit 2005. Ndërkohë, Banka e Japonisë vazhdon politikën e mbajtjes së normës së interesit të pandryshuar pranë zeros, në përpjekje për të luftuar deflacionin e zgjatur të çmimeve, që pritet të marrë fund gjatë vitit 2006.


- KURSI I KËMBIMIT

Fillimi i vitit 2005 e gjeti monedhën amerikane të këmbëhej me një çmim inferior me monedhën e përbashkët evropiane. Megjithatë, kursi i këmbimit të dy monedhave filloi gradualisht të ndryshonte nga nivelet e larta fillestare, duke dëshmuar kohë pas kohe një tendencë mbiçmuese të dollarit amerikan pothuajse gjatë gjithë vitit. Në fund të muajit dhjetor 2005, 1 euro këmbëhej më 1.179 usd nga rekordi 1.362 usd që ajo arriti në dhjetor të vitit 2004, duke u mbiçmuar kështu me 13.4 për qind. Forcimi i monedhës amerikane shpjegohet kryesisht me rritjen e vazhdueshme të normave afatshkurtra të interesit nga Banka e Rezervës Federale në SHBA gjatë vitit 2005, dhe me rënien në krahun tjetër të normave afatgjata të interesave në Evropë, të shkaktuara nga një performancë më e ngadaltë e aktivitetit ekonomik në Eurozonë. Diferenca e madhe e krijuar midis normave të interesit të vendosura nga dy bankat qendrore, ndikoi ndjeshëm në rritjen e aseteve financiare të emetuara në dollarë amerikanë, pavarësisht

Grafik 1. Normat bazë të interesit në ekonomitë e mëdha (në përqindje).




Grafik 2. Ecuria e kursit të këmbimit usd/euro.



deficitit të frikshëm fiskal dhe bilancit negativ të stërmadhuar të llogarisë korente në SHBA, i cili për vitin 2005 parashkohet të kalojë 750 miliardë dollarë amerikanë⁶.

• ÇMIMI I NAFTËS

Rritja ekonomike botërore ka sjellë rritjen e kërkesës për naftë gjatë vitit 2005. Kërkesa botërore për naftë arriti një mesatare ditore prej 83.3 milionë fuçi në ditë gjatë tremujorit të fundit të vitit, duke shënuar një rritje prej 1.2 milionë fuçish. Megjithë ekspansionin e shpejtë të kërkesës, rritja e çmimeve të naftës i atribuohet kryesisht gërryerjes së kapaciteteve të tepërta dhe problemeve të tjera gjatë zinxhirit të ofertës së naftës në treg.



Kërkesa botërore mesatare për naftë në vitin 2006 është parashikuar të rritet me 1.6 milionë fuçi në ditë ose me 1.9 për qind nga viti 2005. Megjithatë, rritja e ofertës së vendeve prodhuese të naftës dhe zgjerimi i pritshëm i kapaciteteve përpunuese dhe magazinuese, sugjerojnë presione më të pakta mbi çmimet e naftës gjatë vitit 2006.

1.2 EKONOMIA E VENDEVE TË RAJONIT

Aktiviteti ekonomik në vendet e rajonit ka patur një ecuri të kënaqshme gjatë vitit 2005. Ritmi i rritjes ekonomike të vendeve të Evropës Juglindore⁷ vlerësohet të luhatet rreth nivelit 5 për qind. Megjithëse ritmi i rritjes shënon një ngadalësim nga rritja ekonomike prej 6.5 për qind e shënuar në vitin 2004, ai mbetet dukshëm më i lartë se ekonomia e Eurozonës⁸. Burimi kryesor i rritjes së vendeve të Evropës Juglindore mbetet kërkesa e brendshme. Ngadalësimi i kësaj të fundit në vitin 2005 solli edhe uljen e ritmit të rritjes.

Tabelë 3. Treguesit kryesorë makroekonomikë për ekonomitë e rajonit gjatë vitit 2005*.

	PBB reale (në %)	Inflacioni vjetor (në %)	Bilanci fiskal (% ndaj PBB)	Llogaria korente (% ndaj PBB)	Norma e papunësisë (në %)
Greqia	3.5	3.6*	-4.6	-3.2*	10.0*
Kroaci	3.4	3.0*	-4.2	-6.9 (T2)	13.8 (nëntor)
Serbi - Mal i Zi	4.8	15.4*	1.2	-10.6*	32.6*
Maqedoni	3.8	0.6	-0.8	-7.4	28.0 (shtator)
Bosnje-Hercegovinë	5.4	3.5	0.1	-16.8*	35.9 (nëntor)
Kosovë	-0.5	-1.5*	-4.2	--	46.3 (nëntor)
Turqi	5.0	8.0*	-4.4*	-6.2*	9.4

Burimi: FMN, bankat qendrore.

* Parashikime.

Ekonomitë e Evropës Juglindore kanë bërë progres në konsolidimin e stabilitetit makroekonomik gjatë vitit 2005. Inflacioni ka qenë në nivele

relativisht të ulta gjatë vitit 2005. Gjithashtu, deficitin mesatar buxhetor për këto vende është më i ulët se ai i vendeve të reja anëtare në Bashkimin Evropian. Deficitin mesatar buxhetor dhe për këtë vit pritët që të qëndrojnë pothuajse në të njëjtin nivel me atë të shënuar një vit më parë, rreth 2 për qind të PBB-së. Në përgjithësi, pozicioni i mirë fiskal reflekton rritjen e të ardhurave, të shkaktuar nga rritja ekonomike, ndërkohë që shpenzimet buxhetore kanë mbetur të kontrolluara. Një nga problemet kryesore makroekonomike për këto vende mbetet deficitin i lartë i llogarisë korente. Ky deficitin pritët të thellohet më tej gjatë vitit 2005 në sajë të deficitit të lartë tregtar, i cili është ndikuar edhe nga rritja e çmimit të energjisë. Nga ana tjetër integrimi i shpejtë i këtyre ekonomive me ekonominë shumë më të zhvilluara e të begata të Bashkimit Evropian, mund të ndikojë në thellimin e deficitit të llogarisë korente për këto vende. Integrimi i tregut të mallrave e bën më tërheqëse huamarrjen nga jashtë ndërsa, liberalizimi i tregut të brendshëm financiar dhe reduktimi i normave të interesit nxit konsumin dhe inflacionin në vend të kursimit, duke tentuar të reduktojë balancën e llogarisë korente.

Gjithashtu, viti 2005 shënoi progres në drejtim të realizimit të aspiratës së shumë vendeve të rajonit për integrim në Bashkimin Evropian. Shumë vende kanë çelur bisedime, paraprake apo përfundimtare, me Brukselin. Së fundi, edhe Shqipëria iu bashkua këtij grupi, duke hapur bisedimet paraprake për nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.

Boks 1.1. Kriteret e konvergencës.

Anëtarësimi në Bashkimin Evropian kërkon plotësimin e një sërë kushtesh ekonomike dhe politike. Kriteret ekonomike që duhet të përmbushin vendet për t'u anëtarësuar në Bashkimin Monetar Evropian janë kriteret e Maastrichtit, të quajtura edhe kriteret e konvergencës. Më konkretisht, këto kriteret janë:

- *Raporti i deficitit buxhetor ndaj prodhimit të brendshëm bruto nuk duhet të kalojë nivelin 3 për qind.*
- *Raporti i borxhit të qeverisë me prodhimin e brendshëm bruto nuk duhet të kalojë nivelin 60 për qind.*
- *Stabiliteti i çmimeve duhet të jetë i qëndrueshëm. Norma mesatare e inflacionit, gjatë një periudhe njëvjeçare para ekzaminimit, nuk duhet të kalojë me më shumë se 1.5 pikë përqindjeje normën e inflacionit të tre vendeve anëtare, me performancën më të mirë përsa i përket zhvillimeve në inflacion.*
- *Normat nominale afatgjata të interesit nuk duhet të jenë më të larta se 2 pikë përqindjeje mbi normën e interesit të tre vendeve anëtare, të cilat kanë performancën më të mirë në terma të ruajtjes së stabilitetit të çmimeve.*
- *Kursi i këmbimit, për dy vitet e fundit, të mos kalojë kufijtë normalë të luhatjes dhe vendi të mos ketë zhvlerësuar monedhën e vet, në mënyrë të njëanshme ndaj monedhave të vendeve të tjera anëtare.*

- EKONOMIA E GREQISË

Rritja ekonomike e Greqisë ka qenë e konsiderueshme gjatë viteve të fundit. Ajo është ndikuar pozitivisht nga rënia e ndjeshme e normave të interesit, si rrjedhojë e adoptimit të euros, nga rritja e shpejtë e kredisë për sektorin privat, e cila pasoi liberalizimin e sektorit financiar dhe nga politika fiskale, e cila ka patur tipare ekspansioniste. Ndërkohë, përfundimi i shpenzimeve për zhvillimin e Lojërave Olimpikë solli edhe shtrëngimin e politikës fiskale. Deficiti buxhetor parashikohet të arrijë në 4.6 për qind të PBB-së në vitin 2005, duke shënuar një ulje prej dy pikësh përqindjeje në krahasim me vitin 2004. Pjesërisht edhe për këtë arsye, rritja e PBB-së u ngadalësua në 3.5 për qind gjatë vitit 2005, nga niveli 4.7 për qind i shënuar në vitin 2004. Gjithsesi, kjo rritje mbetet e konsiderueshme në krahasim me vendet e tjera të Eurozonës. Norma e inflacionit në mënyrë të vazhdueshme gjatë vitit 2005 ka qenë mbi normën mesatare të vendeve të Eurozonës.

- EKONOMIA E MAQEDONISË

Aktiviteti ekonomik në Maqedoni ka pasur një performance të mirë gjatë gjysmës së parë të vitit 2005. PBB-ja për periudhën janar-qershor është rritur me 4.7 për qind në terma vjetorë. Zhvillimet ekonomike dhe stabiliteti i çmimeve janë arritur duke mbajtur inflacionin në një nivel mesatar prej 0.6⁹ për qind. Prodhimi industrial për vitin 2005 u rrit me 7 për qind. Në tregtinë e jashtme u regjistrua një rënie e deficitit tregtar në 50.6 milionë euro ose 5 për qind. Niveli i papunësisë arrin në 28 për qind, duke mbetur në nivele të larta ashtu si dhe në vendet e tjera të rajonit.

- EKONOMIA E KOSOVËS

Performanca ekonomike e Kosovës gjatë kësaj periudhe ka qenë e dobët. Ajo është ndikuar negativisht nga paqartësitë në lidhje me statusin përfundimtar, duke frenuar investimet vendase dhe të huaja. Ekonomia e Kosovës ka përjetuar stanjacion gjatë vitit 2005. Parashikohet që për vitin 2005 rritja e PBB-së të arrijë në -0.5 për qind¹⁰. Një nga problemet kryesore në vend mbetet niveli i lartë i papunësisë, e cila shënonte 46.3 për qind në muajin nëntor.

Deficiti tregtar gjatë periudhës janar-nëntor arriti në rreth 1 miliard euro. Niveli i eksporteve është shumë i ulët dhe arrin deri në 42.8 milionë euro. Produktet kryesore të eksportuara gjatë vitit kanë qenë produktet e metaleve bazë dhe produktet minerale. Importet janë në nivele shumë të larta. Zërat kryesorë që ndikojnë në rritjen e importeve janë produktet ushqimore, pije dhe duhan, dhe produktet blegtorale.

- EKONOMIA E SERBISË

Sipas vlerësimeve më të fundit të Fondit Monetar Ndërkombëtar, rritja ekonomike e Serbisë për vitin 2005 është 4.8 për qind. Faktorët kryesorë që kanë ndikuar në përmirësimin e ritmit të rritjes ekonomike janë performanca e

mirë e eksporteve, niveli i lartë i kërkesës së brendshme dhe rritja e investimeve nga kompanitë vendase dhe ato të huaja. Norma e inflacionit ka qenë e lartë gjatë gjithë vitit, duke arritur në 18 për qind në muajin tetor. Për këtë arsye, politika monetare ka patur një natyrë shtrënguese, duke synuar reduktimin e ritmit të rritjes së kredive, veçanërisht të kredive konsumatore. Megjithë përmirësimin, deficitin i llogarisë korente mbetet i lartë, në nivelin 10.6 për qind të PBB-së. Borxhi i jashtëm është rreth 60 për qind e PBB-së.

- EKONOMIA E KROACISË

Aktiviteti ekonomik në Kroaci është karakterizuar nga një rritje e moderuar ekonomike, normë e ulët inflacioni dhe stabilitet në kursin e këmbimit. Rritja ekonomike parashikohet të arrijë në nivelin 3.4 për qind gjatë vitit 2005. Kontributin kryesor në përmirësimin e rritjes ekonomike e ka dhënë rritja e shpenzimeve konsumatore. Presionet inflacioniste, të shkaktuara nga rritja e çmimeve të energjisë dhe rritja në çmimet e ushqimeve, si rrjedhojë e kushteve të pafavorshme atmosferike, kanë sjellë rritjen e normës mesatare të inflacionit vjetor nga 2.1 për qind në vitin 2004, në 3 për qind në muajin shtator 2005. Nga ana tjetër, stabiliteti i kursit të këmbimit të kunas¹¹ kundrejt euros ka ndikuar në stabilizimin e pritjeve inflacioniste. Deficiti buxhetor parashikohet të arrijë në 4.2 për qind të PBB-së në fund të vitit 2005, nga 4.9 për qind që ishte një vit më parë. Deficiti i llogarisë korente për gjysmën e parë të vitit është thelluar, duke arritur në 6.9 për qind të PBB-së nga 5.3 për qind që ishte në vitin 2004.

- EKONOMIA E TURQISË

Performanca ekonomike në Turqi dhe gjatë këtij viti ka qenë pozitive. Inflacioni është në nivele njëshifrore dhe rritja ekonomike megjithëse e moderuar, përsëri mbetet e qëndrueshme. Ritmi i rritjes ekonomike, për vitin 2005, parashikohet të jetë rreth 5 për qind dhe të ruajë të njëjtën vlerë edhe për vitin 2006. Investimet dhe aktiviteti i ndërtimit kanë qenë ndër faktorët kryesorë që kanë ndikuar pozitivisht në rritjen ekonomike gjatë këtij viti. Norma e inflacionit për vitin 2006 parashikohet të bjerë nën 8 për qind, normë e shënjestruar për fundvitin 2005. Zhvillimet pozitive ekonomike dhe politika e kujdesshme fiskale, kanë ndikuar në reduktimin e deficitit të përgjithshëm buxhetor nën 3 për qind të PKB-së¹² dhe në reduktimin e borxhit publik nën 60 për qind të PKB-së. Rritja e çmimit të naftës dhe forcimi i monedhës vendase kanë ndikuar në thellimin e deficitit të llogarisë korente, reduktimi i të cilës është dhe një nga sfidat e ekonomisë turke.

Vazhdimësia e politikave të kujdesshme monetare dhe fiskale dhe progresi i mëtjshëm në reformat strukturore, do të mundësojnë ruajtjen e qëndrueshmërisë së rritjes ekonomike për vitet në vazhdim.

SHËNIME

¹ Sipas vlerësimeve të Bankës Botërore.

² Të dhënat për ekonominë amerikane janë marrë nga Departamenti Amerikan i Punës, Departamenti Amerikan i Tregtisë, Zyra Ekzekutive e Presidentit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës .

³ Burimi: Eurostat, vlerësime paraprake.

⁴ Takimi i ministrave të ekonomisë dhe financës të të gjitha vendeve të Bashkimit Evropian.

⁵ Marrëveshje e vitit 1997 midis vendeve pjesëmarrëse në Bashkimin Monetar Evropian për koordinimin e politikave fiskale, me qëllim kufizimin e borxhit dhe të deficitit buxhetor.

⁶ Banka Botërore.

⁷ Në vendet e Evropës Juglindore përfshihen: Shqipëria, Bosnje - Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Republika e Maqedonisë, Rumania dhe Serbia e Mali i Zi.

⁸ Kombet e Bashkuara, Situata dhe Parashikimi i Aktivitetit Ekonomik 2006.

⁹ www.stat.gov.mk Njoffim për shtyp. 02 shkurt, 2006.

¹⁰ www.bpk-kos.org. Buletini mujor statistikor. Nëntor '05. Nr.51.

¹¹ Monedha vendase.

¹² PKB – Produkti Kombëtar Bruto.



KAPITULLI II
EKONOMIA E BRENDSHME

KAPITULLI II. EKONOMIA E BRENDSHME

Ekonomia shqiptare hyri në vitin 2005 si pjesë e një procesi të vazhdueshëm konsolidimi makroekonomik. Përgjithësisht, ky proces është materializuar në një rritje ekonomike rreth nivelit 6 për qind, me një inflacion nën kontroll rreth nivelit 3 për qind, me një deficit buxhetor në tkurrje dhe me përmirësim të vazhdueshëm të kushteve monetare. Ekonomia e vendit vlerësohet të jetë rritur me 5.5 për qind në terma realë gjatë vitit 2005, duke u shoqëruar me inflacion të ulët, brenda objektivit të synuar nga Banka e Shqipërisë.

Shenjat e rritjes ekonomike manifestohen nga një sërë treguesish, të drejtpërdrejtë apo të tërthortë. Ndër ta duhen veçuar rritja me 13.8 për qind e shitjeve reale të ekonomisë, rritja e kënaqshme e të ardhurave nga TVSH dhe e të ardhurave nga tatimi mbi fitimin dhe rritja e numrit të të punësuarve në ekonomi. Kjo rritje është reflektuar edhe në opinionin e bizneseve dhe konsumatorëve (shih boksën II.3). Vrojtimi i besimit të biznesit dhe vrojtimi i besimit të konsumatorëve tregojnë një përmirësim të kushteve ekonomike gjatë vitit 2005, megjithë ngadalësimin e tij në tremujorin e fundit. Nga ana tjetër, zhvillimet e sektorit financiar dhe, në veçanti, zgjerimi i dukshëm i kredisë për ekonominë ilustrojnë rritjen e investimeve dhe rritjen e konsumit në ekonomi.

Megjithatë, viti 2005 nuk ishte i imunizuar nga zhvillimet e papritura ose me natyrë *shock*, të cilat, në analizë të fundit, ndikuan në uljen me 0.5 pikë përqindjeje të ritmit të rritjes ekonomike nga parashikimi. Për më tepër, këto ngjarje paraqitën sfida të mirëfillta për administrimin e ekuilibrave ekonomikë dhe monetarë. Në rafshin politik, eveniment kryesor ishin zgjedhjet politike për Parlamentin e ri. Situata e zgjatur paszgjedhore, përshkallëzimi i krizës energjitike gjatë periudhës tetor – nëntor 2005, si dhe rritja e çmimit të naftës kanë ndikuar në uljen e ritmeve të rritjes ekonomike (shih, bokset II.1 dhe II.2). Gjithashtu, këta faktorë ndikuan edhe në luhatjen e likuiditetit të sistemit bankar gjatë gjashtëmujorit të dytë dhe në rritjen e volatilitetit të interesit të bonove të thesarit.

Kjo rritje e PBB-së ka bërë të mundur rritjen e të ardhurave për frymë përtej nivelit 2500 dollarë amerikanë në vit, e cila gjithsesi mbetet një shifër nga më të ultat në rajon. Megjithë rritjen e pandërprerë të PBB-së ndër vite, performanca e punësimit pasqyron një sjellje më të moderuar. Reduktimi i shifrës së papunësisë vazhdon të jetë i vogël si në vlerë absolute ashtu edhe në shprehje relative. Ndoshta cilësia e dobët e statistikave të punësimit, që ndikohen shumë nga lëvizjet e mëdha dhe të pamonitoruara të popullatës brenda vendit si dhe nga shkalla e lartë e informalitetit në tregun e punës, mund të fshehë zhvillimet e vërteta në punësim. Nga ana tjetër, duhet thënë se ka mundësi që rritja e produktivitetit si rezultat i investimit në teknologji bashkëkohore, të mos kërkojë shumë krahë pune. Gjithësesi, mbetet e qartë

se statistikat e punësimit kanë nevojë për përmirësime të mëtejshme, që nënkuptojnë si shtimin sasior të tyre ashtu dhe përmirësimin cilësor.

Bilanci kursime – investime vlerësohet të ketë regjistruar një ecuri pak më të ndryshme nga ajo e vitit të kaluar. Për herë të parë kursimet publike, ndonëse në nivel shumë modest vetëm 0.1 për qind e PBB-së, kanë regjistruar një nivel pozitiv, ndërkohë që kursimet private janë tkurrur jo pak, me rreth 2.6 pikë përqindjeje. Ngushtimi i dallimit midis nivelit të normave të interesit në lekë me atë në valutë, ambienti global dhe ai kombëtar me norma relativisht të ulëta kthimi për një periudhë relativisht të gjatë, rritja e kredisë konsumatore për individët si dhe shkaqe të tjera të pamundura për t’u identifikuar me nivelin aktual të informacionit statistikor, kanë ndikuar në një sjellje të individëve më agresive drejt konsumit.

Në kushtet kur ecuria e investimeve ka qenë shumë e ngjashme me atë të vitit 2004, rënia e kursimeve private ka çuar në një thellim të deficitit korent¹, i cili nga niveli 3.8 për qind i PBB-së në vitin 2004, vlerësohet të ketë arritur në 5.5 për qind të PBB-së në vitin 2005. Sektori i jashtëm i ekonomisë, gjatë vitit 2005, paraqitet me një bilanc të thelluar negativ në llogarinë korente, shkaktuar nga zgjerimi i mëtejshëm i deficitit tregtar. Flukset hyrëse të kapitalit kanë qenë përgjithësisht të mjaftueshme për kompensimin e deficitit korent, duke mundësuar një bilanc të përgjithshëm pozitiv.

Zgjerimi i deficitit të llogarisë korente nuk përbën më ndonjë surprizë për ekonomitë e Evropës Lindore, pjesë e së cilës është edhe vendi ynë. Integrimi i shpejtë i tregjeve të mallrave me ekonomi më të mëdha dhe më të pasura të Bashkimit Evropian, e bën më atraktive huamarrjen e jashtme nga ana jonë, ndërkohë që liberalizimi i tregut të brendshëm financiar dhe shoqërimi i tij me uljen e përqindjes së interesit shton presionet për rritje të shpenzimeve në raport me kursimet.

Treguesit e tjerë ekonomik – financiarë kanë ruajtur në përgjithësi tendencat e verifikuara në periudhat e mëparshme, me shmangie të vogla nga kufijtë e programuar.

Tabelë 1. Disa tregues të ekonomisë në vite.

	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005
Rritja reale e PBB-së (në %) ²	8.9	7.7	6.5	4.7	6.0	6.0	5.5
PBB (me çmime korente, në milionë lekë ³)	488611	530900	588700	630000	695100	780100	836800
PBB (me çmime korente, në milionë usd)	3548	3694	4102	4497	5702	7581	8379
PBB (në usd për frymë) ⁴	1052	1086	1329	1460	1833	2434	2550
Numri i të punësuarve (në mijë)	1081	1068	1065	921	928	917	931
Përqindja e papunësisë	18.0	16.9	14.6	15.8	15.0	14.6	14.2
Përqindja e inflacionit (v/v)	-1.0	4.2	3.5	1.7	3.3	2.2	2.0
Deficiti i buxhetit (me grantet, në % të PBB-së)	-12.1	-8.2	-7.9	-6.6	-4.9	-4.9	-3.8
Borxhi publik (në % të PBB-së)	69.7	71.3	66.8	65.1	60.7	55.3	54.9
Borxhi i jashtëm (në % të PBB-së) ⁵	-32.3	29.4	25.8	23.4	20.7	17.8	16.8
Llogaria korente (pa transfertat zyrtare, në % të PBB-së)	-8.5	-7.0	-6.1	-10.2	-8.2	-6.2	-7.0
Kursi mesatar i këmbimit, lek/usd	137.7	143.7	143.5	140.1	121.9	102.8	99.8
Kursi mesatar i këmbimit, lek/euro	147.0	132.6	128.5	132.4	137.5	127.7	124.2

Burimi: INSTAT, Ministria e Financave, vlerësime të FMN-së dhe Banka e Shqipërisë.

Sektori financiar i vendit gjatë vitit 2005 iu nënshtrua një vlerësimi të kujdesshëm nga ana e misionit të Bankës Botërore dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar. Analiza që iu bë çdo qelize të sektorit financiar nxori në pah progresin e bërë prej tij gjatë viteve të fundit. Konkluzionet e dala nga ky vlerësim, janë një ndihmesë e madhe për të gjithë ne, autoritetet mbikëqyrëse të sektorit financiar. Rekomandimet e lëna tashmë janë konvertuar në axhenda pune gjithëpërfshirëse, me masa dhe vendime konkrete, zbatimi i të cilave ka filluar që vitin e kaluar dhe do të intensifikohet më tej në vitet në vijim.


Megjithatë, duhet theksuar se ende pas shumë viteve tranzicion, të dhënat statistikore të drejtpërdrejta apo edhe të tërthorta, që hedhin dritë mbi aktivitetin ekonomik të vendit në përgjithësi ende nuk janë të plota, e për rrjedhim edhe shkalla e analizës, veçanërisht në aspektin sasior, vazhdon të pasqyrojë këto kufizime statistikore. Përveç rrallësisë së informacionit që lidhet me prodhimin e siguruar nga degët e veçanta të ekonomisë, ekziston edhe problemi i publikimit me vonesë të tyre. Për më tepër, në disa raste informacioni statistikor i botuar në ecurinë e tij sipas tremujorëve pasqyron luhatje të mëdha, duke vështirësuar shkallën e kuptimit dhe të interpretimit të saktë të tij.

Boks II.1 Problemet e energjisë dhe prodhimi vendas.

Që prej vitit 1990 konsumi i energjisë elektrike në Shqipëri është rritur me një ritëm mesatar vjetor prej 6 për qind, jo shumë larg ritmeve mesatare të rritjes së ekonomisë reale. Në anën tjetër, prodhimi bruto i energjisë është karakterizuar nga luhatje të ndjeshme gjatë së njëjtës periudhë. Humbjet në rrjet mbeten të konsiderueshme në mbi 30 për qind të prodhimit. Megjithë problemet në prodhimin dhe shpërndarjen e energjisë elektrike, rritja e aktivitetit të bizneseve në vitet 1990 nuk duket të jetë kufizuar ndjeshëm nga oferta e energjisë. Në vitet 2000 nevojat e aktivitetit ekonomik arritën nivele që kapërcyen kapacitetin e burimeve të brendshme. Kjo bëri që niveli i importit të energjisë në vitet 2000 të rritet disa herë krahasuar me importin e viteve 1990.

Natyra e tregut të energjisë nuk lejon ruajtjen apo zëvendësimin e saj në kohë, ndaj bëhet i domosdoshëm parashikimi i saktë i nevojave që dalin mbi ato të burimeve të brendshme, duke mbajtur parasysht çmimet më të larta të importit. Problemi i minimizimit të kostos ndërlkohet nga varësia e prodhimit më të lirë vendas ndaj kushteve të motit. Nëse planifikohet më shumë import kjo rrit koston duke rënduar buxhetin e qeverisë, por nëse planifikohet më pak kjo mund të çojë në një situatë të ngjashme me atë të fundvitit të kaluar kur Shqipëria u përballua me një rënie të prodhimit vendas, i cili u kompensua vetëm pjesërisht nga importi.

Grafik1 boks 2. Prodhimi dhe konsumi i energjisë elektrike në Shqipëri.



Cila ishte kostoja e mosplotësimit të nevojave të ekonomisë me energji? Bazuar në anketimet e Bankës së Shqipërisë aktiviteti ekonomik i bizneseve gjatë periudhës së krizës vlerësohet të jetë kufizuar rreth 27 për qind kundrejt nivelit të aktivitetit që pritej gjatë së njëjtës periudhë. E konvertuar në terma rritjeje reale të PBB-së, kjo shifër vlerësohet të jetë rreth 0.5 pikë përqindje, duke e zvogëluar rritjen vjetore reale në 5.5 për qind nga 6 për qind që pritej. Shumë biznese u munduan të kompensonin mungesat e energjisë me burime alternative kryesisht gjeneratorë nafte, që shkaktoi një rritje të kostove rreth 20 për qind. Rritja e kostos u reflektua si në uljen e prodhimit, të punësimit ashtu dhe në sakrifikimin e një pjese të investimeve. Sektori më i prekur ishte ai i prodhimit, ku përdorimi i alternativave zëvendësuese nuk mund të mbulonte lehtë nevojat e konsiderueshme për energji elektrike që ka ky sektor. Pozitive mbetet pritja e bizneseve që, me përmirësimin e situatës, aktiviteti ekonomik do të mund të rikuperohet brenda tremujorit të parë të vitit 2006. Zhvillimet e fundit në sektorin energjistik duket se mbështesin kushtet që kjo pritje të materializohet.

Megjithë recuperimin e shpejtë të ekonomisë nga kriza e fundit energjike, në një plan më afatgjatë ajo dëshmon qartë se zgjidhja e problemeve energjike në lidhje me prodhimin e vendas ashtu dhe me plotësimin e nevojave me importe në kohë, është bërë kritike për të siguruar ruajtjen e normave të larta të rritjes ekonomike.

II.1. ECURIA E PRODHIMIT SIPAS SEKTORËVE TË EKONOMISË

II.1.1 SEKTORI I BUJQËSISË

Megjithë, rritjet e evidentuara në dy – tre vitet e fundit në harkun 2 – 3 për qind çdo vit, përsëri kontributi i prodhimit bujqësor vazhdon të ulet nga njëri vit në tjetrin. Në vitin 2005 prodhimi bujqësor zinte 22.8 për qind të prodhimit të përgjithshëm, një nivel ky i ulët në raport me kontributin e tij në fundin e viteve '80 deri në mesin e viteve '90. Ndonëse ka kaluar një kohë relativisht e gjatë, bujqësia vazhdon të karakterizohet ende nga probleme të mëdha, ku mbizotërojnë ato të lidhura me pronësinë mbi tokën, duke zbehur në këtë mënyrë interesimin e investitorëve të mëdhenj në prodhimin e produkteve të ndryshme me natyrë bujqësore.

Parcelizimi i tokës bujqësore ka bërë që rendimenti i prodhimit bujqësor të jetë larg potencialit të tij, duke reflektuar pamundësinë e përdorimit në shkallë të gjerë të mekanikës bujqësore. Nga ana tjetër, lëvizjet e parreshtura migratore nga zonat rurale në drejtim të qendrave të mëdha të banuara, kanë bërë që mijëra hektare tokë bujqësore të lihen djerrë. Të gjitha këto, kanë krijuar një ambient të përshtatshëm për hyrjen në vend të një game të gjerë mallrash bujqësorë të huaj (të papërpunuar), të cilët kryesisht vijjnë nga vendet fqinje.

Edhe nëndegët e tjera të bujqësisë si blegtorja dhe frutikultura, duket se nuk po arrijnë ritme zhvillimi të qëndrueshme. Blegtorja, pas një hopi cilësor në

fillim të viteve '90 duket se aktualisht po vuan mungesën e shërbimit veterinar të specializuar dhe të infrastrukturave të përshtatshme, që sigurojnë ushqim dhe mbarështrim bashkëkohor. Po kështu, edhe frutikultura vazhdon të vuajë dëmet e mëdha në drurët frutorë të bëra këto vitet e fundit, duke zbehur ndjeshëm një përparësi të madhe që siguron klima shqiptare në këtë drejtim. Megjithë përpjekjet sporadike të disa investitorëve vendas, përsëri rikuperimi i inventarit të frutikulturës është ende në shkallë të ulët, duke bërë që edhe kontributi i kësaj nëndege në prodhimin e përgjithshëm bujqësor të jetë i ulët.

Megjithatë, siç vihet re në tabelën në vijim të gjitha degët e bujqësisë vlerësohet se kanë njohur ritme pozitive rritjeje në terma realë, duke çuar në një rritje të mundshme të të gjithë prodhimit bujqësor, në masën 3.7 për qind, rreth 1 pikë përqindjeje më pak se viti 2004 dhe po kështu, diçka më pak se vlerësimet e mëhershme gjatë vitit 2005. Problemet që shkaktuan përmytjet e tokës në muajt e parë të vitit të kaluar, në kushtet e një marketingu inekzistent, të një sistemi grumbullimi joeficient si dhe të një infrastrukture të dobët ujitëse dhe kulluese vlerësohet se përbëjnë shkaqet e kësaj ecurie në rënie të prodhimit bujqësor për vitin 2005.

	2001	2002	2003	2004	2005
Bujqësi	1.4	2.3	2.8	3.4	2.3
- blegtoria	3.5	3.4	4.8	3.1	3.9
- bimët e arave	-1.1	1.8	-1.7	2.3	
- pemëtaria	4.7	-0.2	15.5	9.2	
Agroindustri	7.8	13.1	10.2	11.2	10.0
Peshkim	4.0	18.8	9.7	7.9	10.0
Total	2.3	4.1	3.9	4.7	3.7


Tabelë 2. Prodhimi bujqësor (me çmime të vitit 2000).

Burimi: Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorëve.

Duke u ndalur në prodhimin fizik të bimëve të arave, bie në sy se viti 2005 ka regjistruar rritje të mëtejshme të të gjithë zërave kryesorë, si në grupin e drithërave ashtu edhe në atë të perimeve dhe të bimëve industriale. Megjithatë, siç duket edhe nga grafiku në vazhdim, prodhimi i bimëve të arave gjatë gjithë periudhës 1993 – 2005 shfaqet me oshilacione të dukshme, megjithë një lloj stabilizimi në këto vitet e fundit në vlerat 2 – 3 për qind, në terma të ndryshimit vjetor. Sipas vlerësimeve të fundit bie në sy një lloj zhvillimi sporadik i bimëve industriale, të cilat vazhdojnë të jenë në sasi shumë të vogla dhe deri-diku me ndryshime të ndjeshme nga njëri vit në tjetrin.

Në vitin 2005 bie në sy se kemi një rritje të përgjithshme të sipërfaqeve të mbjelljeve të para, përfshirë dhe shtimin e ullinjve. Rritje të madhe kanë zënë sipërfaqet e mbjella me perime, misër dhe vreshta. Ndoshta këto zhvillime kanë ndikuar në një lloj rënieje të çmimeve të grupit fruta – perime, gjatë nëntë muajve të parë të vitit 2005. Ndërkohë, ashtu siç e theksuam dhe më sipër, sipërfaqet e mbjella me dru frutorë kanë pësuar rënie në krahasim me një vit më parë, ku pa dyshim tërheq vëmendjen ngadalësimi me 10 për qind i shtimit të sipërfaqes së mbjellë me dru frutorë.

Grafik 1. Prodhimi i bimëve të arave (ndryshimi vjetor në përqindje; në mijë tonë).



Burimi: INSTAT dhe Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorëve, Vjetori Statistikor.

Një potencial të madh mbart edhe prodhimi në sera, i cili megjithë rritjet e evidentuara në tabelën në vijim mund të thuhet se ende ka peshë të vogël në raport me prodhimin total. Ndërkohë që vihet re se edhe rendimenti i prodhimit në serra luhetet ndjeshëm nga njëri vit në tjetrin, duke pasqyruar më së shumti probleme me bazën materialo - teknike, me infrastrukturën si dhe me mungesën e agjencive të specializuara në grumbullimin dhe përpunimin e produkteve të tyre.

Megjithatë, vlen të theksohet se prodhimi fizik i tyre gjatë vitit 2005 ishte rreth 41 për qind më i lartë se i njëjti prodhim në vitin 2000.

Ndërkohë, sektori më gjallë i prodhimit bujqësor duket se ka të bëjë me shtimin e pandalshëm të kapaciteteve përpunuese dhe konfeksionuese të inputeve bujqësore dhe blegtorale. Duket se edhe gjatë vitit 2005, dega e industrisë agroushqimore është rritur më tej me rreth 10 për qind në terma vjetorë, pothuajse në të njëjtin nivel me atë të vitit 2004.

Tabelë 3. Prodhimi bujqësor në serra.

	2000	2001	2002	2003	2004	2005
Sipërfaqja e mbjellë në hektarë						
Serra me ngrohje	17	13	13	19	28	35
Serra diellore	445	424	496	533	632	615
Gjithsej	462	437	509	552	660	650
Rendimenti në kv/ha						

Serra me ngrohje	992	541	675	847	708	737
Serra diellore	829	795	795	795	826	912
Gjithsej	835	720	814	854	821	916
Prodhimi në ton						
Serra me ngrohje	1,688	714	877	1,610	1,983	2,580
Serra diellore	36,892	33,712	41,520	45,529	52,209	6,082
Gjithsej	38,580	34,426	42,661	47,139	54,192	58,662

Burimi: Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorëve.

Megjithatë, kjo degë me potencial të madh sipas vlerësimeve më të fundit, duket se ende nuk është e aftë të thithë investime në shkallë të madhe. Ashtu si dhe në vitet e mëparshme, investimet në të gjitha format private, publike dhe ato në formën e kredive bankare duket se nuk arrijnë të kalojnë kufirin 0.3 për qind ndaj PBB-së, një shifër kjo shumë e vogël që besojmë se nuk ka nevojë për koment. Largësia e biznesit bankar nga zonat rurale dhe gjithë problematika e përmendur gjatë kësaj analize të shkurtër, përbëjnë faktorët kryesorë që qëndrojnë prapa kësaj shifre të vogël. Degët e tjera të bujqësisë, prodhimi blegtoral dhe peshkimi pasqyrojnë një qëndrueshmëri më të madhe në ritmet e tyre të rritjes.


II.1.2 SEKTORI I INDUSTRIJË

Sektori i prodhimit industrial paraqet ende një lloj ngërçi, i cili mbi të gjitha pasqyron një mosaktivizim të kapaciteteve prodhuese, kryesisht në industrinë nxjerrëse dhe atë përpunuese minerare. Të dyja këto degë, të cilat kanë qenë shumë të rëndësishme në ekonominë e centralizuar, në mungesë të subvencioneve të mëtijshme dhe të interesimit nga ana e biznesit vendas dhe atij të huaj, gjatë pesëmbëdhjetë viteve të fundit, kanë shënuar një lloj degradimi të vazhdueshëm për të arritur në ditët e sotme në një kolaps të plotë. Rentabiliteti i ulët, kostot e larta dhe shkalla e lartë e amortizimit e bënë pothuajse të pamundur mbijetesën e tyre. Ndërkohë, edhe disa prej ndërmarrjeve që iu dhanë me koncension investitorëve të huaj, janë në një pozicion të vështirë ekonomiko-financiar, duke mos dhënë kontribute të prekshme në riaktivizimin e këtyre industrive.

Gjatë vitit 2005 vlerësohet se kjo degë e aktivitetit të ekonomisë ka kontribuar në masën 13.8 për qind në realizimin e PBB-së. Në mungesë të të dhënave më të plota në analizën e këtij sektori, i jemi referuar vëllimit të shitjeve në vlerë⁶. Siç shihet nga grafiku i mësipërm ecuria e shitjeve të industrisë nxjerrëse ka njohur rënie të fortë që nga fillimi i vitit 2004.


Nga ana tjetër, industria përpunuese shfaq një ecuri më të stabilizuar dhe siç bie në sy gjatë vitit të fundit, ka pasur një lloj qëndrueshmërie rreth nivelit 10 për qind në terma realë. Megjithatë,

Grafik 2. Vëllimi i shitjeve (qmime konstante; seri 12-mujore; ndryshim vjetor).



Burimi: INSTAT dhe përllogaritje të staftit të Bankës së Shqipërisë.

duhet theksuar se përfytyrimi mbi vitin 2005 do të ishte më i plotë, në rast të disponimit të të dhënave të tremujorit të fundit të vitit 2005. Siç dihet kjo periudhë, përkoi me një krizë të fortë të prodhimit të energjisë elektrike⁷, zhvillim që u pasqyrua në rishikimin në ulje të rritjes ekonomike me 50 pikë të përqindjes ndaj vlerësimeve më të hershme. Megjithëse fillimisht u mendua se kriza mund të kishte pasoja më të rënda, zbutja e saj në muajin dhjetor bëri të mundur që absorbimi nga ana e ekonomisë të ishte relativisht i shpejtë. Po kështu, efektet e ashtuquajtura të raundit të dytë edhe pse jemi në fund të tremujorit të parë të vitit 2006, përsëri nuk janë verifikuar. Kjo për shkak të faktorëve që lidhen me praninë e sindikatave të dobëta, informalitetit të lartë që karakterizon ekonominë tonë etj..



Duke u ndalur në sektorin e energjisë vihet re se ecuria dymbëdhjetëmuajore e prodhimit të energjisë elektrike, duke nisur që nga muaji mars i vitit 2005, ka filluar një kurbë në rënieje, ndërkohë që importet kanë shënuar ecuri të kundërt. Po kështu, edhe humbjet duke filluar që nga mesi i vitit të kaluar kanë regjistruar një tendencë në rritje⁸, duke kulmuar në muajin nëntor 2005. Nga ana tjetër, duket qartë se përdorimi i energjisë gjatë pjesës më të madhe të vitit 2005, ka njohur një ecuri konstante në harkun 5 – 10 për qind.

Duke parë zërat përbërës të saj, vihet re se rritja e fortë e kërkesës për energji nga ana e përdoruesve jo-familjarë është në zbutje të pandërprerë gjatë gjithë vitit 2005, duke shënuar vetëm 3 për qind rritje në terma vjetorë.

Përdorimi i energjisë nga përdoruesit familjarë, pasi ka mbetur konstant rreth nivelit 0 për një kohë të gjatë, muajt e fundit të vitit 2005 ka njohur rritje negative në terma vjetorë.


Boks II.2. Çmimet e naftës dhe ekonomia shqiptare.

Çmimet në tregun botëror të naftës janë rritur ndjeshëm vitet e fundit. Faktorët nga ana e ofertës lidhen drejtpërdrejt me paqëndrueshmërinë që ka karakterizuar vendet kryesore eksportuese gjatë kësaj periudhe: situata e vështirë në vendet e Lindjes së Mesme si rajoni me pasuritë më të mëdha të naftës, shqetësimi mbi stabilitetin e brendshëm të Arabisë Saudite dhe zhvillimet politike në Venezuelë. Ndikim ka patur dhe rritja e kostos së nxjerrjes së naftës. Megjithatë, e veçanta e niveleve të reja historike të çmimeve të naftës qëndron në ndryshimet strukturore të ekonomisë botërore që kanë ndikuar ndjeshëm në kërkesën për këtë produkt. Rigjallërimi i ekonomive të mëdha si ajo e Kinës dhe e Indisë, ka sjellë një rritje të shpejtë të kërkesës botërore për naftë dhe nënprodukte të saj. Duke u nisur nga këto ndryshime strukturore pritet që nivelet e reja të çmimeve të jenë të pranishme për një kohë të gjatë.

Rritja e çmimeve të naftës në tregjet ndërkombëtare mund të çojë në një ngadalësim të rritjes ekonomike. Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë vlerëson se një rritje prej 10 dollarësh e çmimeve të naftës, redukton rritjen ekonomike botërore me 0.5 pikë përqindje. Vendet në zhvillim karakterizohen nga një eficiencë më e ulët e shfrytëzimit të lëndëve të para, ndaj preken më shumë nga rritja e çmimit të naftës se sa vendet e zhvilluara. Kështu, duke vazhduar shembullin e mësipërm, rritja me 10 dollarë e çmimeve të naftës do të shkaktonte reduktim të rritjes ekonomike në vendet e Azisë me 0.8 për qind dhe 1.6 për qind në vendet e varfra, nga 0.4 për qind për vendet e OECD-së.


Ekonomia shqiptare është, gjithashtu, një importuese neto e produktit të naftës pasi kapacitetet e burimeve vendase nuk i përbushin kërkesat e brendshme për naftë. Aktualisht, prodhimi vendas mbulon vetëm 30 për qind të nevojave dhe pjesa tjetër mbulohet me importe. Duke qenë një vend importues, çmimi i naftës në Shqipëri ka ndjekur ngushtë luhatjet e çmimit të naftës në tregjet ndërkombëtare (grafik 1). Kjo rritje e çmimit të naftës ka çuar në rritjen e kostos së faktorëve të prodhimit dhe rrjedhimisht, në rritjen e çmimeve të të mirave dhe shërbimeve në treg. Nga disa vlerësime bazuar në opinionet e bizneseve, rezulton se rritja e çmimit të naftës ka ndikuar mesatarisht me 3.2 për qind në rritjen e çmimeve të prodhimit, të ndërtimit dhe të shërbimeve. Rritja e çmimeve të naftës ka filluar të ushtrojë presion dhe mbi aktivitetin ekonomik të bizneseve që janë më të ndjeshme ndaj kërkesës së tregut dhe e kanë të vështirë t'ia përcjellin konsumatorit rritjen e kostos.

Grafik 1, boks 2. Çmimet e naftës në tregun botëror (majtas) dhe tregun vendas (djathtas).



Burimi: INSTAT.

Grafik 2, boks 2. Importi i naftës (në ton).




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Rritja e çmimit të naftës ka patur një ndikim akoma më të drejtpërdrejtë mbi buxhetin familjar, nëpërmjet rritjes së kostos së transportit. Kjo mund të çojë në zvogëlimin e shpenzimeve të produkteve të tjera, pavarësisht nga ulja e përdorimit të mjeteve të transportit. Kështu, 30 për qind e konsumatorëve shqiptarë e kanë modifikuar sjelljen e tyre duke ulur kërkesën për produkte të tjera në treg, ndërkohë që 43 për qind kanë reduktuar përdorimin e automjeteve.


Ndikimi i çmimeve të larta të naftës mbi ekonominë e vendit tonë ka rezultuar më i zbutur, për shkak të përdorimit të burimeve alternative energjitike, kryesisht asaj elektrike. Aktualisht, konsumi i energjisë elektrike në totalin e energjisë zë rreth 62 për qind. Në këtë mënyrë, çmimet e larta të naftës rrisin akoma më shumë presionet për përmirësimin e situatës energjitike në vend.

Grafik 4. Vëllimi i shitjeve (çmime konstante; seri 12-mujore; ndryshim vjetor).



Burimi: INSTAT dhe përlogaritje të statit të Bankës së Shqipërisë.

Grafik 5. Trafiku ajror dhe detar i pasagjerëve në vite (në mijë persona).



Burimi: Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.

II.1.3 SEKTORI I TRANSPORTIT

Sektori i transportit ka patur një rol dinamik në rritjen ekonomike gjatë viteve të fundit. Ky sektor ka shënuar ritme të larta rritjeje, duke dhënë një kontribut pozitiv në zhvillimin ekonomik. Ritmi i shtimit të vëllimit të shitjeve të sektorit të transportit ka qenë gjatë gjithë kohës pozitiv, duke manifestuar një gjallërim të tyre pas një ngadalësimi që u vërejt gjatë vitit 2004. Gjallërim kanë të gjithë komponentët e tij ku veçanërisht spikasin transporti ajror, detar dhe ai rrugor. Ndërkohë transporti hekurudhor, vazhdon të manifestojë shenja të qarta kolapsi, duke rënë në mënyrë graduale nga njëri vit në tjetrin.

Megjithatë, efektet negative të shtrenjimit të çmimeve të karburanteve në gjysmën e dytë të vitit 2005, e kanë dhënë ndikimin e tyre siç duket qartë edhe në grafikun e mëposhtëm, kur kurba e shitjeve ka ndryshuar kahjen përsëri. Kjo ka bërë që pesha e këtij sektori në ekonomi të ketë pësuar një rritje shumë modeste, duke arritur në nivelin 9.3 për qind nga 9.0 për qind që ishte në vitin 2004.

Transporti ajror ka patur një rritje vjetore mesatare prej rreth 15 për qind, gjatë 10 viteve të fundit. Kjo ecuri pozitive ka vazhduar edhe në vitin 2005, gjatë të cilit u vu re një rritje me 20 për qind e fluturimeve dhe e lëvizjes së pasagjerëve.

Transporti detar i pasagjerëve gjithsej u ul me 0.7 për qind gjatë këtij viti, në krahasim me të

njëjtën periudhë të një viti më parë. Pasagjerët shqiptarë përbëjnë rreth 76.7 për qind të trafikut detar përkundrejt 23.3 për qind, të cilët janë të huaj. Numri i pasagjerëve të hyrë u rrit me 0.4 për qind ndërsa niveli i pasagjerëve të dalë u ul me 1.8 për qind.

Transporti detar i mallrave pati një rritje prej rreth 12.2 për qind gjatë këtij viti, në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Rritja e vëllimit të transportit detar ka ardhur si pasojë e rritjes me 8.7 për qind të importeve të mallrave dhe e rritjes me 14.4 për qind të eksporteve të tyre. Porti i Durrësit, si porti kryesor në vend, përpunon rreth 79 për qind të mallrave totale në porte. Vëllimi i transportit të mallrave në të u rrit me 5.1 për qind gjatë vitit 2005. Gjithashtu, transporti në portet e Vlorës, të Sarandës dhe të Shëngjinit u rrit respektivisht me 34.2 për qind, 30.6 për qind dhe 17.4 për qind.

Transporti hekurudhor në Shqipëri përbën vetëm 1 për qind të trafikut të mallrave dhe atij të pasagjerëve. Transporti hekurudhor i pasagjerëve pati një rënie me 59 për qind, ndërsa transporti hekurudhor i mallrave u ul në masën 3 për qind, gjatë vitit 2005. Po kështu investimet në këtë sektor në vlerë absolute kanë rënë në masën 20.7 për qind në krahasim me një vit më parë. Totali i investimeve publike dhe i atyre me projekte të huaja vazhdon të jetë në nivele të ulta në raport me PBB-në, mesatarisht në harkun 2 – 3 pikë përqindjeje. Ndërkohë që në dy vitet e fundit ka një rënie të këtij niveli, duke kulmuar në vitin 2005 në vetëm 1 për qind të PBB-së.


Është e vështirë të bësh koment për investimet e mbuluara me burime të brendshme, ndërsa ato të financuara me burime të huaja kanë vazhduar trendin rënës si në vlerë relative ashtu edhe në atë absolute. Investimet në sektorin e transportit janë mbështetur gjithnjë e më shumë me fonde të brendshme buxhetore. Kështu, gjatë viteve 1997 – 2003 investimet buxhetore përbënin mesatarisht 33.1 për qind të investimeve totale në këtë sektor përkundrejt investimeve të huaja, të cilat ishin përgjegjëse për 66.9 për qind të tyre. Ndërsa në dy vitet e fundit kjo situatë ka ndryshuar në mënyrë të konsiderueshme. Investimet buxhetore përbëjnë 63.4 për qind të investimeve totale përkundrejt vlerës prej 36.6 për qind të mbuluara me investime të huaja.

Objektivi kryesor i zhvillimit strategjik të sektorit të transportit është krijimi gradual i një hapësire unike e të lidhur qarkullimi në nivel kombëtar dhe rajonal. Krijimi i një rrjeti infrastrukturor modern do të ndihmojë zhvillimin ekonomik dhe meriton një vëmendje parësore në alokimin e fondeve buxhetore.

II.1.4 SEKTORI I NDËRTIMIT

Në përgjigje të nevojave për përmirësimin e kushteve të strehimit, për zgjerimin e kapaciteteve

Grafik 6. Investimet në transport
(në përqindje ndaj PBB-së).




Burim: Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.

prodhuese dhe për krijimin e një infrastrukture moderne, sektori i ndërtimit ka shënuar norma të larta rritjeje gjatë dhjetë viteve të fundit. Sektori i ndërtimit është rritur mesatarisht me 13 për qind në vit gjatë kësaj periudhe, duke u shndërruar në një nga katalizatorët e zhvillimit ekonomik të vendit dhe duke e dyfishuar peshën e tij në PBB. Ky sektor kontribuoi me 9 për qind në krijimin e PBB-së gjatë vitit 2005.

Viti 2005 vazhdoi të shënojë zhvillime pozitive në sektorin e ndërtimit. Vëllimi i shitjeve të realizuara nga ky sektor është rritur në mënyrë të ndjeshme nga njëra periudhë në tjetrën, duke manifestuar një tendencë të fortë rritjeje. Më konkretisht, gjatë tremujorit të tretë të vitit 2005, vëllimi dymbëdhjetëmujor i shitjes në terma konstantë kulmoi në nivelin 28 për qind, duke treguar në këtë mënyrë se ky sektor edhe gjatë vitit 2005, ka qenë shumë atraktiv për biznesin në përgjithësi. Zhvillimet kanë qenë shumë dinamike, duke reflektuar një kërkesë gjithnjë e më rritje. Sipas të dhënave të nëntëmujorit, vlerësohet se konsumi i çimentos ka shënuar rritje konstante nga njëri tremujor në tjetrin, në raport me të njëjtat periudha të vitit të kaluar. Tremujorët e parë, të dytë dhe të tretë të vitit 2005 regjistruan një konsum respektivisht më të lartë në masën 20, 34 dhe 14 për qind se të njëjtat periudha të vitit të kaluar.

Grafik 7. Vëllimi i shitjeve (çmime konstante; seri 12-mujore; ndryshim vjetor).



Burimi: INSTAT dhe përlogaritje të stafit të Bankës së Shqipërisë.

Kërkesa e lartë në lidhje me prodhimet e kësaj dege duket edhe në ecurinë e çmimeve të shitjes, veçanërisht në çmimet e apartamenteve të banimit dhe të sipërfaqeve të destinuara për aktivitet ekonomik. Ndonëse nuk disponohen të dhëna në këtë drejtim, përsëri realiteti i përditshëm pasqyron një tendencë të pandërprerë në rritjen e çmimeve. Ky fakt duhet studjuar me kujdes, për të vlerësuar drejt ndonjë rrezik të mundshëm që shoqëron bum-in e shpejtë të çmimeve të pasurive të paluajtshme. Një efekt "tullumbace" do të ishte i padëshirueshëm dhe do të krijonte efekte negative zinxhir në gjithë rrjetin e bizneseve që ushqejnë dhe furnizojnë industrinë e ndërtimit.

Për më tepër efekti kontaminues do të shtrihej edhe mbi vetë sistemin bankar, përderisa rreth 80 për qind e kolateraleve për kreditë e dhëna janë në formën e pasurive të paluajtshme.

Indeksi i Kushtimit të Ndërtimit ka pësuar një rritje modeste gjatë vitit 2005 vetëm në masën 0,7 për qind, ndërkohë që shpenzimet direkte janë diçka më shumë, rreth 1.5 për qind. Pra, megjithëse kostoja e ndërtimit ka ndryshuar shumë pak gjatë vitit 2005 vihet re një mospërputhje e madhe e saj në raport me rritjen e çmimit të shitjes. Edhe një herë, ky është një faktor domethënës që tregon për praninë e një kërkesë të fortë në degën e ndërtimit, kërkesë e cila gjithësesi nuk i ka burimet në të ardhura të qëndrueshme. Burime të tilla si të ardhurat nga emigracioni dhe nga aktivitetet e jashtëligjshme, vlerësohet se janë resurse financiare të përkohshme, të vështira për t'u parashikuar,

ndërkohë që janë zërat kryesorë që financojnë aktualisht degën e ndërtimit. Për rrjedhim, një rënie e mundshme, e shpejtë e burimeve të sipërpërmendura, do të sjellë kufizime të forta në kërkesë, kufizime që do të vinin në vështirësi jo vetëm prodhuesit e ndërtimit por edhe degët e lidhura me të.

Një tregues tjetër i rritjes së madhe të sektorit të ndërtimit, ka të bëjë me rritjen e investimeve në këtë sektor, gjithnjë duke iu referuar në terma absolutë. Gjatë nëntë muajve të parë të vitit 2005, investimet në ndërtesat për banim dhe ato industriale patën respektivisht një rritje vjetore me 157 për qind dhe 38 për qind gjatë kësaj periudhe. Siç mund të vihet re, çdo efekt zhvlerësues i matshëm apo jo, nuk do të ishte në gjendje që “të eliminonte” këtë rritje të fuqishme në terma nominalë të investimeve.


Megjithatë, duke iu kthyer edhe një herë vitit 2005, duhet theksuar se ka një tendencë të fortë drejt ndërtimeve për banesa ndërkohë që motivimi apo dobishmëria e destinacioneve të tjera ndërtimore, mbetet ende e ulët.

II.1.5 TREGTIA DHE TURIZMI

Sektori i shërbimeve është zhvilluar në mënyrë të konsiderueshme gjatë viteve të fundit, duke u bërë kontribuesi kryesor në rritjen e PBB-së. Sipas vlerësimeve më të fundit llogaritet që pesha e këtij sektori në PBB të jetë rreth nivelit 45 për qind. Brenda këtij sektori bie në sy ecuria në rritje e degës së tregtisë dhe e asaj të turizmit, ndërkohë që edhe shumë segmente të tjera të reja, të cilat ndonëse me një aktivitetet ekonomik ende të brishtë, kanë filluar të rriten duke përbërë premisa për një ecuri të qëndrueshme afatgjatë të këtij sektori.


Sipas të dhënave të vëllimit të shitjeve të realizuara nga tregtia dhe turizmi, bie në sy se rritja vjetore e tyre në terma konstantë gjatë tre tremujorëve të parë të vitit 2005, ka qenë relativisht e qëndrueshme në harkun 10 – 15 për qind. Në degën e tregtisë, rritjet më të forta i kanë regjistruar zërat tregti me shumicë dhe me

Grafik 8. Indeksi i Kushtimit në Ndërtim (ndryshim 12-mujor).




Burimi: INSTAT

Grafik 9. Ndërtimet sipas llojeve të tyre (në miliardë lekë).



Burimi: INSTAT


Grafik 10. Vëllimi i shitjeve (çmime konstante; seri 12-mujore; ndryshim vjetor).



Burimi: INSTAT dhe përilogaritë të stafit të Bankës së Shqipërisë.

pakicë si dhe tregtimi i automjeteve, përfshirë mirëmbajtjen dhe riparimin e tyre. Edhe zërat e tjerë kanë regjistruar rritje të vëllimit të shitjeve, megjithatë intensiteti i rritjes së tyre është diçka më i ulët, poshtë ritmit të totalit të degës. Edhe në degën e turizmit vihet re se ka zhvillime sasiore që dëshmojnë në rritjen e saj. Ndonëse ende nuk janë publikuar të dhënat për tremujorin e fundit të vitit 2005, ato evidentojnë një ecuri në rritje të të gjithë treguesve të disponueshëm. Ka shtim të kapaciteteve akomoduese, ka dyfishim të shpenzimeve për marketing, ka rritje të vëllimit të investimeve etj..

Më konkretisht, kapacitetet akomoduese u rritën ndjeshëm gjatë nëtëmujorit të parë të vitit 2005. Numri i shtretërve është rritur me 43 për qind, ndërkohë që numri i dhomave është rritur me 48 për qind. Kjo rritje e fortë e kapaciteteve akomoduese është shoqëruar më dyfishimin e shpenzimeve për marketing, megjithëse duhet pranuar se vlera absolute është ende e vogël.



Rritje të konsiderueshme ka pësuar edhe numri i shtetasve të huaj që vizitojnë Shqipërinë, duke krijuar kështu burime të rëndësishme për financimin e deficitit të llogarisë korente. Vetëm në nëntë muajt e parë të vitit 2005, në Shqipëri kanë hyrë rreth 50 për qind më shumë vizitorë se sa gjithë viti 2004.

Boks 11.3. Indeksi i Besimit të Biznesit dhe Indeksi i Besimit të Konsumatorit.


Ndër treguesit ekonomikë të cilëve i referohen tregjet ndërkombëtare, renditen duke i dhënë një rëndësi të veçantë edhe indekset e besimit. Kjo, sepse ato interpretohen si parashikime për ecurinë e ekonomisë për një të ardhme të afërt. Indekset e besimit mbështeten në vrojtime periodike mbi një grup të përzgjedhur biznesesh dhe konsumatorësh. Ato tentojnë të diktojnë ndryshime në aktivitetin e ekonomisë – një rritje e besimit të biznesit/konsumatorit interpretohet si prirje për rritjen e aktivitetit ekonomik në një periudhë afatshkurtër dhe anasjelltas. Në fakt, përvoja në ndërtimin e serive të indekseve të besimit, ka treguar se ekziston një lidhje e qëndrueshme statistikore midis pritjeve të mbledhura nga vrojtimet e besimit dhe treguesve faktikë.

Nevoja për krijimin e indekseve të besimit buron nga fakti se pavarësisht nga shkalla e zhvillimit të statistikave të një vendi, metoda e vërtetimit është metoda më e shpejtë dhe direkte për mbledhjen e informacionit.

Puna për ndërtimin e indekseve të besimit në Bankën e Shqipërisë ka filluar që prej vitit 2002. Vërtetimet kryhen me një periodicitet tremujor. Në bashkëpunim me INSTAT-in, për vërtetimin e bizneseve janë përzgjedhur biznese përfaqësuese për sektorët që japin kontributin më të madh në rritjen e PBB-së. Ndërsa, vërtetimi për indeksin e besimit të konsumatorit mbështetet në zgjedhjen e rastësishme të individëve që jetojnë në zonat urbane, ku matet IÇK-ja. Gjithashtu, pyetësorët e përdorur janë përshtatur sipas standardeve të vendosura nga Komuniteti Evropian për këtë qëllim, duke krijuar bazat për krahasueshmërinë e tyre me këto vende.

Në rastin e Shqipërisë, krijimi i indekseve të besimit merr më tepër rëndësi për faktin se ato plotësojnë sistemin e sotëm të informacionit, për atë pjesë të statistikave të sektorit real të ekonomisë që lidhet me punësimin, investimet, konkurrencën, perceptime të publikut për inflacionin etj.. Aktualisht, të dhënat për ekonominë reale publikohen me vonesë kohore tre deri gjashtë muaj, ndërkohë që jo të gjithë treguesit mbulojnë me të dhëna. Po për këtë arsye, dhe interpretimi i vlerësimeve që sigurohen nga vërtetimet është i vështirë, pasi këto të fundit nuk mund të krahasohen me statistika të sakta. Krahas pyetjeve standarde, karakteristikat e përzgjedhjes së dy vërtetimeve lejojnë përdorimin e tyre për përfshirjen e rubrikave speciale, me pyetje të ndërtuara për dukuri specifike të ekonomisë shqiptare.


Deri tani, rezultatet e vërtetimeve kanë paraqitur përputhshmëri të kënaqshme me të dhënat statistikore. Opinione të bizneseve kanë regjistruar korrelacion të lartë me ecurinë aktuale të shitjeve, të publikuar nga INSTAT. Ky korrelacion është më i lartë për sektorin e shërbimeve dhe industrinë, ndërkohë që, devijimet e dukshme në



sektorin e ndërtimit mund të shpjegohen nga natyra e punës në këtë sektor, ku ka një diferencë kohore midis prodhimit dhe shitjes së produktit. Sikurse shihet në figurën 1, sipas vetë bizneseve, aktiviteti ekonomik për tremujorin e katërt 2005 mendohet të ketë pësuar një përkeqësim më të ndjeshëm sesa në vitet e kaluara. Një sjellje e tillë është rrjedhë logjike e krizës energjitike që kaloi vendi në këtë periudhë.

Vrojtimi i konsumatorit synon të identifikojë ndryshime në sjelljen e konsumit të individëve nga një tremujor në tjetrin, të cilat lidhen ngushtë me pritjet e çmimeve dhe me tendencën për kursim. Për Bankën e Shqipërisë, vlerësimi i pritjeve të konsumatorit mbi ecurinë e çmimeve përbën aspektin kryesor të shfrytëzimit të këtij vrojtimi për momentin. Vrojtimet e deritanishme tregojnë një lidhje të qartë midis pritjeve të konsumatorit mbi çmimet dhe ecurinë faktike të tyre. Ndonëse përgjigjet e pyetjeve janë cilësore, perceptimi i konsumatorit është i saktë përsa i përket kahut të ndryshimit të çmimeve. Aktualisht, po bëhen përpjekje për kuantifikimin e këtyre ndjesive në vlera konkrete për pritshmëritë e inflacionit dhe përfshirjen e tyre në modelet statistikore për parashikimin e inflacionit.

Grafik 2, boks 3. Norma e inflacionit dhe pritjet e konsumatorit për ecurinë e çmimeve.



Vrojtimet e besimit pa dyshim që përbëjnë një burim të dobishëm informacioni, si përsa i përket përmbajtjes ashtu dhe kohës së shkurtër në të cilën sigurohet ai. Megjithatë, duhet theksuar se këta tregues mbështeten në përgjigje subjektive. Si të tillë, ata mbeten orientues dhe jo vendimtarë të asaj çka pritet të ndodhë në periudhën afatshkurtër. Në rastin e Shqipërisë, përdorimi i tyre duhet vlerësuar me kujdes më të madh, për vetë faktin se historiku i tyre është i shkurtër për të provuar konsistencën e indekseve. Banka e Shqipërisë është duke punuar për konsolidimin e mëtejshëm të tyre në mënyrë që të rrisë shkallën e besueshmërisë së indekseve të besimit, si përfaqësues të ecurisë së ekonomisë.

II.2. ZHVILLIMET NË SEKTORIN FISKAL

Autoritetet fiskale kanë ndjekur një politikë buxhetore të kujdesshme gjatë vitit 2005, në vijim të zbatimit të Programit Buxhetor Afatmesëm për periudhën 2005-2007. Ky program ka synuar shtimin e stimullit fiskal në rritjen ekonomike dhe stabilitetin makroekonomik, nëpërmjet konsolidimit të treguesve buxhetorë dhe priorizimit të shpenzimeve buxhetore në sektorët e shëndetësisë, të arsimit dhe të infrastrukturës. Në zbatim të këtij programi, të ardhurat buxhetore kanë vazhduar të shënojnë rritje dhe gjatë vitit 2005, ndërkohë që deficitin buxhetor është ulur më tej. Kështu, të ardhurat dhe shpenzimet në total për vitin e shkruar janë realizuar përkatësisht në masën 97 dhe 92 për qind në krahasim me planin ndërkohë që të dy këta tregues janë rritur përkatësisht me 8.9 për qind dhe 2.7 për qind, në krahasim me një vit më parë. Nga ana tjetër pesha e të ardhurave, shpenzimeve dhe deficitit në PBB-në ka qenë përkatësisht 23.4 për qind, 26.7 për qind dhe 3.2 për qind për vitin 2005.

	1998	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005
Të ardhurat totale	22.68	22.67	22.72	20.88	22.20	22.41	21.93	23.4
Të ardhura tatimore	13.76	13.79	15.83	14.06	15.25	19.48	19.71	21.4
Shpenzime totale	34.35	34.93	32.14	28.85	28.41	26.95	26.46	26.7
Shpenzime kapitale	5.87	7.19	6.83	6.94	5.60	4.22	4.58	4.1
Deficiti buxhetor	-11.67	-12.27	-9.41	-7.98	-6.20	-4.55	-4.53	-3.2
Financimi i brendshëm	6.03	5.89	5.64	4.71	3.16	3.21	3.67	2.7
Financimi i huaj	5.64	6.38	3.77	3.27	3.05	1.34	0.86	0.5

Burimi: Ministria e Financave. Treguesit fiskalë sipas buxhetit të konsoliduar.

Tabelë 4. Tregues fiskalë në përqindje ndaj PBB-së.

II.2.1 TË ARDHURAT BUXHETORE

Të ardhurat totale u rritën me 8.9 për qind gjatë vitit 2005, duke realizuar planin në nivelin 97.3 për qind. Kjo rritje ishte më e ulët se niveli i parashikuar prej 11.9 për qind. Gjithashtu, ajo ishte më e ulët se rritja mesatare e shtatë viteve të fundit prej 11.6 për qind. Edhe pse grupet kryesore të të ardhurave buxhetore shënuan rritje, ajo ishte poshtë niveleve të parashikuara. Kështu, të ardhurat nga doganat dhe të ardhurat jotatimore kanë patur performancën më të dobët në krahasim me planin.

Tabelë 5. Rritja vjetore e treguesve kryesorë të të ardhurave buxhetore (në përqindje).

	T1 05	T2 05	T3 05	T4 05	2003	2004	2005	Mesatare 1998-05	Real. Planit 05
Të ardhurat totale	9.8	7.7	6.1	11.6	11.1	10.4	8.9	11.6	97.3
-Të ardhura tatimore	8.8	8.7	8.6	10.8	40.7	14.2	10.8	18.8	100.9
Tatimi mbi Vlerën e Shtuar	7.9	8.2	10.4	16.1	9.8	14.9	11.0	12.5	101.9
Tatimi mbi fitimin	35.1	6.4	9.7	22.0	7.8	24.1	18.0	24.2	120.1
Akcizat	20.4	11.1	11.7	27.0	31.5	28.9	17.2	21.8	101.3
Të ardhurat personale	-2.3	15.5	10.5	8.6	4.3	6.8	8.0	38.2	97.1
Taksa doganore	-4.0	-8.3	1.4	2.6	3.5	0.1	-1.7	1.6	87.4
Pusheteti lokal	-0.2	13.5	22.4	90.6	196.0	21.3	25.0	57.0	116.1
Tatimi mbi biznesin e vogël	-22.0	17.0	-55.8	125.0	15.6	37.8	-6.6	24.3	97.3
Buxheti i pavarur	11.7	10.6	7.3	6.4	11.9	15.9	8.8	12.7	98.7
-Të ardhura jotatimore	6.1	-6.3	-10.8	-22.7	-10.7	-16.7	-11.4	3.7	81.7

Burimi: Ministria e Financave. Treguesit fiskalë sipas buxhetit të konsoliduar.

Rritja e të ardhurave tatimore ka qenë përparësi e administratës në vitet e fundit, për shkak se këto të ardhura përbëjnë burimin kryesor të të ardhurave totale. Përmirësimet në administratën tatimore pritet të rezultojnë në rritjen vjetore të numrit të tatimpaguesve prej 10,000 subjektsh në vit.

Tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH) është i lidhur ngushtë me ecurinë e qarkullimit të mallrave dhe shërbimeve vend. Ecuria e mirë ekonomike gjatë vitit 2005, bëri që të ardhurat nga TVSH të realizoheshin në masën 101.9 për qind të planit. Gjithashtu, ky tregues ka peshën më të madhe në grupin e të ardhurave tatimore, duke përbërë 32.1 për qind të të ardhurave totale buxhetore të vitit 2005. Në përgjithësi, situata tremujore e të ardhurave mbi vlerën e shtuar paraqitet në një rritje progresive, duke shfaqur rritjen më të lartë në tremujorin e tretë.

Tatimi mbi fitimin është një tregues tjetër i rëndësishëm, i cili është i lidhur ngushtë me aktivitetin ekonomik të vendit. Kështu, rritja pozitive ekonomike


në vend çoi në rritje të kënaqshme të këtij tatimi dhe tejkalimin e nivelit të planifikuar për këtë tregues me 20.1 për qind. Tremujori i parë dhe ai i fundit i vitit, patën rritjen më të lartë në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Duhet theksuar fakti se rritja prej 22 për qind, në tremujorin e fundit është realizuar në kushtet e një norme tatimore më të ulët sesa ajo e vitit 2004.

Akcizat patën një nga rritjet më të larta të prurjeve vjetore në grupin e të ardhurave tatimore për vitin 2005. Tremujori i katërt ishte më produktivi për akcizat në vitin e kaluar, duke regjistruar nivelin më të lartë të rritjes së të ardhurave me 27 për qind në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Për arsye të ndryshme, duke filluar që nga problemet në planifikim e deri tek rendimenti i realizimit të planit, të ardhurat doganore ndryshe nga ato tatimore janë realizuar në masën 87 për qind. Megjithatë, është fakt që pati një ngadalësim të vjeljes së të ardhurave doganore në muajt e tranzicionit politik ndërkohë që në muajt e fundit të vitit, si për efekt të ndikimit të sezonit ashtu dhe për eficiencë më të lartë të autoriteteve doganore, u evidentua një shtim i lartë i të ardhurave doganore.

Të ardhurat nga tatimi mbi të ardhurat personale për vitin 2005 patën ritme të kënaqshme rritjeje por duke mos arritur nivelin e parashikuar në buxhetin e fillimvitit. Problem në këtë fushë mbetet evazioni i lartë fiskal. Edhe pse nuk realizuan nivelin e parashikuar, të ardhurat nga buxheti i pavarur (kontributet) patën një rritje prej 8.8 për qind për vitin e kaluar. Administrata publike ka vazhduar programin e saj për të përfshirë sa më shumë punonjës të sektorit privat në skemën e sigurimeve shoqërore.

II.2.2 SHPENZIMET BUXHETORE

Shpenzimet buxhetore u realizuan në masën 92 për qind të nivelit të parashikuar për vitin 2005. Rritja prej 2.7 për qind e shpenzimeve totale është dukshëm më e ulët se ritmi mesatar i rritjes së këtij treguesi në shtatë vitet e fundit.



Në ritmin e ulët të shpenzimeve ka kontribuar ulja e shpenzimeve me 6.1 për qind në tremujorin e fundit. Shpenzimet korente vazhdojnë të mbajnë raporte të larta ndaj shpenzimeve kapitale, duke përbërë respektivisht 84.8 dhe 15.2 për qind të shpenzimeve totale për vitin 2005. Ndërsa shpenzimet korente ishin në vijë me nivelin e parashikuar, ato kapitale u realizuan vetëm në masën 69 për qind, duke përbërë respektivisht 22.6 dhe 4.1 për qind të PBB-së.

Tabelë 6. Rritja vjetore e treguesve kryesorë të shpenzimeve buxhetore (në përqindje).

	T1 05	T2 05	T3 05	T4 05	2003	2004	2005	Mes. 1998-05	Real. Planit 05
Totali i shpenzimeve	7.9	9.9	3.4	-6.1	4.5	10.7	2.7	7.2	92.0
Shpenzime korente	8.0	6.7	5.4	2.2	9.8	8.5	5.3	7.6	100.6
Personeli	11.7	9.5	11.2	6.7	6.7	9.5	9.6	9.6	97.2
Sigurimet shoqërore	8.4	11.8	11.4	9.0	12.7	10.0	10.2	17.1	99.4
Interesat	-7.0	-21.5	-3.8	1.9	20.4	-4.7	-8.4	-3.3	87.2
Të brendshme	-7.0	-23.4	-4.4	-0.1	12.7	5.5	-9.5	-4.2	88.6
Të huaja	-5.4	2.5	9.4	19.6	-28.1	3.8	7.8	22.7	71.4
Operative mirëmbajtjeje	10.2	6.5	-5.8	0.5	8.0	8.3	2.1	5.2	111.6
Shpenzimet kapitale	7.5	33.4	-5.7	-31.6	-17.0	22.5	-9.6	7.1	69.0
Financim i brendshëm	-19.0	52.5	-2.9	-35.3	-3.7	50.7	-12.0	16.1	86.9
Financim i huaj	36.2	-4.8	-12.8	-18.8	-30.4	-16.7	-3.7	-2.1	46.8

Burimi: Ministria e Financave. Treguesit fiskalë sipas buxhetit të konsoliduar.

Shpenzimet e personelit për vitin 2005 arritën në nivelin 6.3 për qind të PBB-së, duke u rritur me 9.6 për qind në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Reduktimet e muajve të fundit në personelin e administratës publike nuk pritet të shoqërohen me rënie të dukshme dhe të menjëhershme në këtë tregues, pasi shumë nga këta punonjës do të vazhdojnë të kompensohen për një periudhë deri njëvjeçare.

Pagesat për interesat kanë arritur nivelin 3 për qind të PBB-së në vitin 2005, duke qenë 12.8 për qind më të ulëta në krahasim me planin dhe 3.3 për qind më pak se një vit më parë. Në këtë reduktim kanë ndikuar si normat e ulëta të interesit në tregun e huamarrjes, ashtu edhe ulja e raportit të borxhit publik ndaj PBB-së.

Shpenzimet e përgjithshme publike, arsimit dhe shëndetësia patën gjithashtu alokimin e burimeve më të larta në krahasim me funksionet e tjera qeveritare, për vitin 2005. Këta tregues përbëjnë respektivisht 3.4, 3.0 dhe 2.5 për qind të PBB-së së vitit të kaluar. Arsimit dhe shëndetësia patën rritje të konsiderueshme në shpenzime, duke u rritur respektivisht me 8.9 dhe 11.8 për qind, në krahasim me një vit më parë. Ndërsa shpenzimet për mbrojtje pësuan një rënie prej 7.7 për qind, në krahasim me të njëjtën periudhë.

Shpenzimet kapitale u realizuan vetëm në masën 69 për qind të planit. Për vitin 2005 shpenzimet kapitale përbëjnë 4.1 për qind të PBB-së, duke shfaqur sezonalitet të fortë në tremujorin e fundit të vitit. Performancën më të dobët në këtë drejtim e kanë patur shpenzimet kapitale me financim të huaj. Shkaku i mosrealizimit të investimeve të financuara me burim të huaj, lidhet me problemet e parashikimeve të pasakta si dhe me mosplotësimin e kushteve të parashikuara në marrëveshjet e kredive dhe ndihmave. Kjo fushë kërkon një vëmendje më të madhe në të ardhmen, për t'iu përgjigjur më mirë nevojave të zhvillimit të vendit.

II.2.3 DEFICITI BUXHETOR

Deficiti buxhetor u zvogëlua me 27 për qind gjatë vitit 2005, çka përbën uljen më të madhe të tetë viteve të fundit. Kjo rënie është rezultat i zbatimit të masave të suksesshme, të marra për reduktimin e deficitit buxhetor.

Gjithashtu, normat më të ulëta të interesit kanë ndihmuar në zbutjen e barrës së shlyerjes së borxhit të brendshëm. Gjatë vitit 2005 u regjistruan 4 muaj, në të cilët buxheti kishte suficit ndërkohë që në 8 vitet e fundit ka rezultuar se ka patur mesatarisht vetëm 1 muaj në vit me suficit.

Deficiti vazhdoi ritmet në ulje si përqindje e PBB-së, duke arritur nivelin 3.2 për qind. Për sa i përket shpërndarjes së deficitit në këtë periudhë, vërehet se tremujori i tretë pati nivelin më të lartë të deficitit me 9.5 miliardë lekë.

Tabelë 7. Rritja vjetore e treguesve kryesorë të deficitit buxhetor (në përqindje).

	2001	2002	2003	2004	2005	Mes. 1998-05	Real. Planit 05	Përqindje ndaj PBB
Deficiti	-2.6	-13.7	-19.3	12.4	-27.0	-6.2	66.1	3.2
Financimi i brendshëm	-4.1	-25.5	11.8	29.0	-24.6	0.9	84.2	2.7
Financimi i huaj	-0.3	3.4	-51.6	-27.2	-37.3	-16.7	33.0	0.5

Burimi: Ministria e Financave. Treguesit fiskalë sipas buxhetit të konsoliduar.

II.3 TREGU I PUNËS

Tregu i punës dhe treguesit e punësimit, ndonëse në nivele modeste, u karakterizuan nga zhvillime pozitive gjatë vitit 2005, duke reflektuar ecurinë e mirë të ekonomisë gjatë kësaj periudhe. Numri i të punësuarve gjatë vitit 2005 u rrit mesatarisht me 8 mijë vetë në krahasim me mesataren e një viti më parë. Sipas të dhënave të Institutit të Statistikës, numri i të punësuarve ishte 931 mijë në tremujorin e tretë të vitit 2005, duke shënuar një rritje prej 1.5 për qind në krahasim me fillimin e vitit.

Të punësuarit në sektorin privat jobuqësor vazhduan të shënojnë rritje, e shoqëruar kjo edhe nga rritja e punësimit në sektorin e bujqësisë përgjatë vitit 2005. Ndërkohë, rritje ka shënuar edhe numri i të punësuarve në sektorin shtetëror. Struktura e punësimit sipas sektorëve të ekonomisë nuk ka pësuar ndryshime të ndjeshme gjatë vitit 2005. Peshën kryesore vazhdon ta zërë sektori bujqësor, i cili punëson rreth 58 për qind të totalit të të punësuarve në të gjithë ekonominë.

Bazuar në të dhënat e Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Mundësive të Barabarta për vitin 2005, një e katërta e të punësuarve në ekonominë shqiptare në total janë të punësuar në rrethin e Tiranës. Rrethet që kanë dhe numrin më të vogël të të punësuarve janë Kukësi, Gjirokasta dhe Vlora, përafërsisht vetëm 10 për qind të të punësuarve në total.

	2004				2005		
	Tr. I	Tr. II	Tr. III	Tr. IV	Tr. I	Tr. II	Tr. III
Forcat e punës gjithsej (në mijë)	1080	1081	1080	1074	1087	1086	1086
A. Të punësuar gjithsej (në mijë)	919	921	922	917	931	931	931.2
i) në sektorin shtetëror	179	179	177	171	176	175.6	175.6
ii) në sektorin privat jobujqësor	206	208	211	212	213	213.4	214
iii) në sektorin privat bujqësor	534	534	534	534	542	542	542
B. Papunësia (në mijë)							
i) të papunë gjithsej	161	160	158	157	156	155	154.8
ii) përfitojnë pagesë papunësie	11.7	12.3	12	11	11.5	11.5	11.5
C. Shkalla e papunësisë (në %)	14.9	14.8	14.6	14.4	14.3	14.3	14.2


Burimi: INSTAT, Konjuktura.

Tabelë 8. Treguesit e tregut të punës (në mijë vetë)

Pas një tendence të gjatë rënëse, viti 2005 regjistroi një rritje të forcës së aftë për punë, e shkaktuar nga rritja e numrit të të punësuarve në sektorët privatë të ekonomisë. Numri i të papunëve, sipas informacionit të marrë nga Ministria e Çështjeve Sociale dhe e Shanseve të Barabarta, në vitin 2005 u ul me 2.4 përqind nga viti 2004. Norma e papunësisë e matur si raporti i numrit të të papunëve ndaj forcës së aftë për punë, ka ardhur në rënie nga tremujori në tremujor. Kjo tregon se gjithnjë e më pak njerëz regjistrohen si punëkërkues të papunë. Sipas rajoneve të vendit, norma më e lartë e papunësisë është në rrethin e Kukësit, 34 përqind dhe më e ulët në Tiranë, vetëm 8.4 përqind. Problem shqetësues në tregun e punës është fakti që papunësia afatgjatë përbën 83 përqind të të papunëve në total.

Papunësia ndihet më shumë në grupmoshat 35-45 vjeç, e cila është dhe grupmosha më e vështirë për të gjetur një punë të re dhe për t'u përshtatur me kushtet e tregut. Më shumë se gjysma e të papunëve janë me arsim tetëvjeçar.

Grafik 13. Përqindja e papunësisë.




Burimi: INSTAT, Konjuktura; Komisioni Evropian, Parashikimet Ekonomike, Vještë 2005; të dhëna kombëtare.

Informacioni që disponojmë në lidhje me pagat është i varfër dhe mbulon vetëm të dhënat mbi pagat në sektorin shtetëror. Kjo e fundit ka ardhur në rritje gjatë vitit 2005 dhe në fund të tremujorit të tretë shënon 27 179 lekë (paga

mesatare), përafërsisht një rritje prej 2 200 lekësh nga tremujori i tretë i vitit 2004. Kjo rritje është ndikuar nga rritja e pagave në sektorët e shëndetësisë dhe të arsimit, gjatë pjesës së parë të vitit dhe në disa kategori ushtarakësh, kryesisht në pjesën e dytë të vitit. Rritja e pagës shtetërore është ndikuar dhe nga rritja e pagës minimale me 1 mijë lekë, gjatë tremujorit të tretë të vitit.

II.4 ZHVILLIMET NË INFLACION DHE POLITIKA MONETARE

Çmimet e konsumit kanë qenë relativisht të qëndrueshme gjatë vitit 2005, duke shënuar një tjetër vit pozitiv në drejtim të përmbushjes së objektivit kryesor të Bankës së Shqipërisë, arritjes dhe ruajtjes së stabilitetit të çmimeve⁹. Inflacioni vjetor shënoi vlerën 2.0 për qind në fund të vitit, ndërsa inflacioni vjetor mesatar rezultoi 2.4 për qind. Të dy këta tregues të kostos së jetesës janë ulur në krahasim me vitin e kaluar, duke u luhatur rreth kufirit të poshtëm të objektivit. Inflacioni vjetor qëndroi brenda intervalit 2 – 4 për qind, gjatë pjesës më të madhe të vitit.



Gjallërimi i aktivitetit ekonomik gjatë vitit 2005¹⁰, politikat makroekonomike të orientuara drejt ruajtjes së stabilitetit makroekonomik, qëndrueshmëria e kursit të këmbimit dhe rritjet e moderuara të pagave¹¹, kanë ndihmuar në kontrollin e presioneve inflacioniste. Nga ana tjetër, ecuria e çmimeve gjatë vitit 2005 është ndikuar edhe nga disa faktorë me natyrë *shock*, si shtrenjtimi i çmimit të naftës dhe situata e rënduar energjitike. Këta faktorë kanë ndikuar në rritjen inflacionit gjatë pjesës së dytë të vitit, por pa kompromentuar respektimin e objektivit të inflacionit dhe perspektivën afatgjatë të stabilitetit të çmimeve.

Luhatjet e normës vjetore të inflacionit gjatë vitit 2005 kanë reflektuar kryesisht lëvizjet e theksuara të çmimeve të mallrave ushqimorë, si pasojë e peshës së madhe të tyre në shportën e çmimeve të konsumit. Inflacioni vjetor pati një tendencë rënëse gjatë katër muajve të parë të vitit, duke zbritur nën kufirin e poshtëm të objektivit të Bankës së Shqipërisë. Kjo rënie u ndikua nga reduktimi i ndjeshëm i çmimeve të mallrave ushqimorë dhe zbutja e efektit të rritjes së çmimit të energjisë elektrike. Gjithashtu, pozitat mbiçmuese të lekut ndaj valutave të huaja ndihmuan në absorbimin e presioneve inflacioniste të faktorëve të ofertës. Zbutja e efektit reduktues të inflacionit negativ të produkteve bujqësore ndikoi në rritjen e inflacionit gjatë tremujorëve të dytë dhe të tretë të vitit. Gjithashtu, çmimet e konsumit u ndikuan edhe nga rritja e çmimit të naftës gjatë gjysmës së dytë të vitit. Ndikimi i këtij faktori u përforcua nga efekti i zbutur kompensues që dha kursi i këmbimit të lekut ndaj usd¹². Krahas këtij faktori, në inflacionin e periudhës tetor–nëntor 2005, ndikoi edhe kriza e përkohshme energjitike. Mungesa e energjisë elektrike, e cila shkaktoi rritjen

e çmimeve të lëndëve djegëse, si dhe çmimet e larta të mallrave ushqimorë bënë që inflacioni të merrte vlera pranë mesit të intervalit objektiv. Ndërkohë, intensiteti i ulët i rritjes spekulative të çmimeve në muajin dhjetor, ndikoi në uljen e inflacionit vjetor të këtij muaji në nivelin 2.0 për qind.

	2001	2002	2003	2004	2005
Janar	2.2	6.5	0.0	3.3	3.3
Shkurt	1.5	7.6	1.1	4.4	1.8
Mars	2.9	7.5	1.3	4.0	1.6
Prill	3.0	6.5	2.3	3.2	1.3
Maj	2.5	4.6	2.8	2.6	2.0
Qershor	4.0	3.7	2.6	2.9	2.9
Korrik	5.6	4.2	3.0	3.1	1.8
Gusht	4.1	5.5	3.0	2.7	2.3
Shtator	3.5	5.3	2.8	2.0	3.1
Tetor	1.8	5.8	2.9	2.0	3.3
Nëntor	2.8	3.7	3.4	2.2	3.0
Dhjetor	3.5	1.7	3.3	2.2	2.0
Mesatar	3.1	5.2	2.2	2.9	2.4

Tabelë 9. Norma vjetore e inflacionit (në përqindje).

Burimi: INSTAT, Banka e Shqipërisë.


II.4.1 ECURIA E INFLACIONIT DHE E GRUPEVE PËRBËRËSE

Tabloja e presioneve inflacioniste gjatë vitit 2005 nuk ka pësuar ndryshime të ndjeshme nga viti i kaluar. Inflacioni vjetor është ndikuar në kahun rritës nga artikujt e grupit “Qira, ujë, lëndë djegëse, energji”, ndërkohë që grupi “Ushqime dhe pije joalkolike” ka kontribuar kryesisht në reduktimin e inflacionit vjetor. Grupet e tjera të shportës kanë patur efekt marxhinal në normën e inflacionit vjetor.

Grupi “Ushqime dhe pije joalkolike” shënoi një inflacion vjetor negativ gjatë shtatë muajve të parë të vitit 2005¹³, duke ndjekur tendencën rënëse të vërejtur që prej muajit maj 2004.

Ecuria e çmimeve të këtij grupi kontriboi mesatarisht me 0.4 pikë përqindjeje në uljen e normës të inflacionit vjetor për këtë periudhë. Rënia e çmimeve të mallrave të këtij grupi u udhëhoq nga çmimet e ulëta të prodhimeve bujqësore, të cilat i japin luhatshmëri çmimeve të këtij grupi. Rritja e inflacionit të grupit “Ushqime dhe pije joalkolike” gjatë pjesës së mbetur të vitit u ndikua nga veprimi i faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm. Ecuria poshtë parashikimeve e prodhimit bujqësor, zbutja e efektit kompensues të mbiçmimit të lekut ndaj euros, si dhe rritja e çmimeve të këtyre mallrave në tregjet partnere të Shqipërisë (Itali dhe Greqi) shtuan presionet inflacioniste në çmimet e mallrave ushqimorë.

Grafik 15. Kontributi i grupeve kryesore të shportës së IÇK-së (në pikë përqindjeje).



Burimi: INSTAT, Banka e Shqipërisë.


Tabelë 10. Inflacioni vjetor i grupit "Ushqime dhe pije joalkolike" dhe kontributi tij në inflacionin total.

	Inflacioni vjetor'04	Kontributi (pp)	Inflacioni vjetor'05	Kontributi (pp)	Itali ¹⁴ Inflacioni vjetor'05	Greqi ¹⁵ Inflacioni vjetor'05
Mars	2.3	1.0	-1.7	-0.7	-0.2	-1.4
Qershor	-0.7	-0.3	1.6	0.7	-0.5	-0.5
Shtator	-2.9	-1.2	1.5	0.6	0.1	2.1
Dhjetor	0.3	0.1	-1.9	-0.8	0.8	0.9

Burimi: Banka e Shqipërisë; Sekretariati i Përgjithshëm i Shërbimit Kombëtar të Statistikave të Greqisë, ISTAT- Itali.


Ashtu si dhe gjatë vitit të kaluar, inflacioni mbeti nën ndikimin e fortë të çmimeve të administruara¹⁶, të cilat ishin burimi kryesor i inflacionit gjatë vitit 2005. Kontributi mesatar i tyre në inflacion ishte 1.4 pikë përqindjeje. Rritja me 25.7 për qind e çmimit të energjisë në muajin janar dhe rritja e tarifave shëndetsore dhe arsimore, gjatë muajve të fundit të vitit ishin faktori kryesor në këtë kontribut. Tarifat publike për shërbimet shëndetsore dhe arsimore shënuan një rritje mesatare vjetore prej 20.4 për qind, gjatë nëntë muajve të parë të vitit¹⁷. Për rrjedhojë, grupet "Shëndeti" dhe "Shërbimi arsimor" kontribuan mesatarisht me 0.1 dhe 0.07 pikë përqindjeje në normën e inflacionit vjetor.

Grafik 16. Ecuria e inflacionit vjetor dhe inflacionit neto.



Burimi: INSTAT, Banka e Shqipërisë.

Grafik 17. Inflacioni vjetor i grupit "Qira, ujë, lëndë djegëse, energji" dhe kontributi i tij në inflacionin total (në pikë përqindje).




Burimi: INSTAT, Banka e Shqipërisë.

Zhvillimet në çmimet e grupit "Qira, ujë, lëndë djegëse, energji" dhe gjatë këtij viti vazhduan të formojnë normën vjetore të inflacionit. Ky grup dha një kontribut mesatar prej 2.2 pikë përqindjeje në inflacionin vjetor përgjatë vitit 2005; kontribut i njëjtit ky me atë të dhënë gjatë vitit të kaluar. Krahas rritjes së çmimit të administruar të energjisë, grupi "Qira, ujë, lëndë djegëse, energji" u ndikua ndjeshëm edhe nga rritja e çmimeve të tregut thuajse në të gjitha nëngrupet përbërëse. Çmimet e qirasë dhe të rentës së imputuar regjistruan norma të larta rritjeje gjatë tremujorit të parë të vitit. Norma mesatare e rritjes vjetore për këtë periudhë ishte 5.7 për qind. Krahas rritjes së këtyre çmimeve, situata e rënduar energjitike dha një shock të përkohshëm në çmimet e gazit dhe të druve të zjarrit. Kërkesa e rritur për këta mallra zëvendësues të energjisë elektrike solli rritjen e çmimit të tyre gjatë tremujorit të fundit.

Grupi "Transport" u ndikua nga rritja e çmimit të naftës në tregjet ndërkombëtare dhe nga ecuria e kursit të këmbimit të lekut ndaj dollarit amerikan. Prej mëse dy vjetësh, rritja e çmimit të naftës ka vepruar si faktor inflacionist në shumë

vende importuese. Megjithatë, ndikimi i saj në vendin tonë është ndjerë kryesisht në gjashtëmuorin e dytë të vitit 2005. Efekti i tij i vonshëm dhe relativisht i vogël në çmimet e konsumit ishte rezultat i mbiçmimit të ndjeshëm të lekut ndaj dollarit amerikan gjatë vitit 2004 dhe pjesës së parë të vitit 2005. Gjithashtu, pesha e vogël që zë ky grup në shportën e konsumit¹⁹, ka kufizuar ndikimin e tij në inflacionin e përgjithshëm. Ndërkohë, ritmi më i ulët i mbiçmimit të lekut ndaj dollarit amerikan gjatë nëntë muajve të parë të vitit 2005, si dhe ndryshimi i raportit midis këtyre dy monedhave gjatë muajve të fundit të vitit (leku u nënçmua mesatarisht me 5.7 për qind gjatë periudhës tetor – dhjetor '05) nuk arritën të zbusin këtë kosto për konsumatorin shqiptar. Grupi “Transport” shtoi mesatarisht normën vjetore të inflacionit me rreth 0.2 pikë përqindje, në krahasim me 0.1 pikë përqindje dhënë në inflacionin vjetor të vitit të kaluar.

Grafik 18. Inflacioni vjetor i 4 grupeve kryesore të shportës së IÇK-së (në përqindje).




Viti 2005 u karakterizua nga rritje më e ulët në çmimet e sektorit të shërbimeve. Grupi “Hotele, kafene, restorante” ka regjistruar norma pozitive inflacioni, kryesisht gjatë gjashtëmuorit të dytë të këtij vitit. Megjithatë, ky grup ka dhënë një kontribut mesatar prej 0.16 pikësh përqindjeje në shifrën vjetore të inflacionit.

Grupet e tjera të shportës kanë ruajtur tendencat e tyre përgjatë gjithë vitit. Norma pozitive rritjeje kanë shënuar grupet “Pije alkoolike dhe duhan” dhe “Mallra dhe shërbime të ndryshme”. Zhvillimet në këto grupe janë

kundërbalancuar nga inflacioni negativ i grupeve si “Veshje dhe këpucë” dhe “Mobilim, pajisje dhe mirëmbajtje shtëpie”. Rezultatja e kontributeve të tyre në inflacionin vjetor të këtij viti ishte 0 pikë përqindjeje.

II.4.2 AMBIENTI MAKROEKONOMIK DHE ÇMIMET E KONSUMIT

Rritja e moderuar e çmimeve të konsumit gjatë vitit 2005 u favorizua nga kordinimi i frutshëm i politikave monetare dhe fiskale. Këto politika ndihmuan në kontrollin e kërkesës së brendshme, duke krijuar një ambient makroekonomik të favorshëm. Politika monetare ka qenë e suksesshme në krijimin e kushteve të përshtatshme monetare për kontrollin e normës së inflacionit. Zbatimi i kujdesshëm i politikës fiskale, duke respektuar parametrat e planifikuar të treguesve fiskalë nuk ka përcjellë presione të tepërta inflacioniste dhe ka kontribuar në ruajtjen e stabilitetit të çmimeve. Gjithashtu, zhvillimet në mjedisin e jashtëm ekonomik, të karakterizuara nga mbiçmimi i kursit të këmbimit të lekut ndaj euros dhe nga norma të qëndrueshme inflacioni në vendet partnere, nuk kanë ushtruar presione inflacioniste.




- Politika fiskale dhe treguesit fiskalë

Politika fiskale është një faktor i rëndësishëm përcaktues në rritjen ekonomike dhe stabilitetin makroekonomik. Viti 2005 u karakterizua nga një politikë fiskale e kujdesshme. Treguesit fiskalë²⁰ u realizuan brenda niveleve të parashikuara në buxhetin e miratuar. Shpenzimet buxhetore shënuan ritme të përsheptuara rritjeje gjatë muajve të parë të vitit, të cilat u qetësuan gjatë gjashtëmuajorit të dytë. Deficiti buxhetor në fund të këtij viti vlerësohet të jetë 3.9 për qind ndaj PBB-së, rreth 1.2 pikë përqindjeje më i ulët se ai i vitit të kaluar. Kërkesa e qeverisë për huamarrje të brendshme vlerësohet të jetë 2.8 për qind ndaj PBB-së. Ky tregues që shërben për të matur presionet inflacioniste të injektuara nga ky faktor i kërkesës, dëshmon për një rritje të lehtë ndaj vitit të kaluar (2.3 për qind ndaj PBB-së), por pa krijuar presione mbi treguesit monetarë.

- Politika monetare

Politika monetare e Bankës së Shqipërisë ka patur përgjithësisht një kah neutral gjatë vitit 2005. Ulja me 0.25 pikë përqindjeje e normës bazë të interesit, në fund të tremujorit të parë, është pasuar nga një periudhë me presione inflacioniste të qëndrueshme në pjesën e mbetur të vitit. Norma bazë e interesit, pas tremujorit të parë, është ruajtur e pandryshuar në 5 për qind. Dinamika e zhvillimeve makroekonomike dhe e kushteve monetare në ekonomi, ka ushtruar presione për rritje të pakta të nivelit të çmimeve të konsumit në përputhje me objektivin e inflacionit.


Grafik 20. Ecuria e kushteve monetare në ekonomi.



Kushtet e favorshme monetare janë shoqëruar me rritjen e kërkesës për mjete monetare. Burimi kryesor i zgjerimit monetar gjatë kësaj periudhe ka qenë kreditimi i ekonomisë, në ndryshim nga vitet e kaluara, kur këtë funksion e ka realizuar huamarrja e qeverisë apo flukset hyrëse valutore. Rritja me ritme të larta e kredisë për ekonominë, ka kompensuar rënien e huamarrjes së qeverisë. Normat e ulëta të inflacionit gjatë kësaj periudhe kanë mundësuar ritme të larta rritjeje të agregatëve monetarë në terma realë. Rritja vjetore e treguesit M3 real ka ruajtur tendencën rritëse të dy viteve të fundit.


Prania e Bankës së Shqipërisë në tregjet e parasë, gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit është kufizuar në tërheqjen e likuiditetit nëpërmjet marrëveshjeve të riblerjes me çmim fiks dhe shumë të pakufizuar. Gjithashtu, Banka e Shqipërisë ka lehtësuar funksionimin e tregjeve monetare me anë të instrumenteve mbështetëse, kryesisht përdorimit të depozitës njëditore. Zhvillimi i operacioneve monetare ka krijuar kushtet për transmetimin e politikës monetare dhe është shoqëruar me stabilitet të tregjeve monetare.

Grafik 21. Kontributi i kredisë për ekonominë në zgjerimin e kredisë së brendshme.



Tregjet financiare patën një luhatje të ndjeshme gjatë tremujorit të tretë, si rezultat i rritjes së kërkesës së ekonomisë dhe qeverisë për mjete monetare, duke sjellë mungesa likuiditeti në sistem. Mungesa e likuiditetit u përcoll më tej në rritjen e shpejtë të *yield*-it të bonove të thesarit gjatë tremujorit të tretë të vitit. Kjo luhatshmëri e bëri të nevojshme ndërhyrjen e Bankës së Shqipërisë për stabilizimin e normave të interesit. Në këto kushte, operacionet monetare u fokusuan në plotësimin e nevojave të tregut për likuiditet dhe zbutjen e presioneve mbi normat e interesit në tregun e parasë. Për këtë qëllim, Banka e Shqipërisë ndryshoi kahun e operacioneve të repos, duke i shndërruar ato në injektuese likuiditeti në sistem. Vëllimi mesatar i injektuar nëpërmjet instrumentit të repove të anasjellta ishte 1.7 miliardë lekë, gjatë periudhës korrik-shtator.

Gjithashtu, përdorimi në mënyrë të përkohshme i kreditimit direkt të qeverisë, mundësoi shmangien e spekulimeve dhe presioneve të tepërta në drejtim të rritjes së *yield*-it të bonove të thesarit. Zhvillimi i këtyre operacioneve mundësoi plotësimin e nevojave për likuiditet të sistemit bankar dhe kthimin e *yield*-it të bonove të thesarit afër trendit të mëparshëm.



Banka e Shqipërisë ka qenë e pranishme në tregun valutor, në gjashtëmuorin e dytë të vitit. Ajo ka blerë valutë pothuajse gjatë gjithë periudhës, duke zbutur presionet mbi kursin e këmbimit dhe duke injektuar likuiditet në treg. Nga ndërhyrjet e saj në këtë treg, vlerësohet se janë injektuar rreth 12.4 miliardë lekë likuiditet, duke ndihmuar sistemin bankar me likuiditet dhe duke kontribuar në stabilizimin e treguesve financiarë.

- Inflationi i importuar

Si një ekonomi e ekspozuar ndaj importeve, Shqipëria²¹ ndikohet në mënyrë të pashmangshme nga zhvillimet në kursin e këmbimit. Ndikimi i këtij faktori duhet të analizohet jo vetëm në efektin që ai jep në përcjelljen e goditjeve të ofertës, si rritja e çmimit të naftës, por dhe në nivelin e inflacionit të importuar. Nga një vrojtim i bërë nga INSTAT-i gjatë vitit 2004, rezultoi se rreth 46 për qind e mallrave të shportës së konsumit janë mallra importi. Për këtë arsye, ecuria e çmimeve të tyre (kombinimi i çmimit të tyre në monedhën vendase me kursin e këmbimit) merr mjaft rëndësi në shpjegimin e normës së inflacionit në vend.

Monedha vendase ndoqi tendencën mbiçmuese të trashëguar nga viti i kaluar edhe gjatë vitit 2005, por me ritme më të zbutura mbiçmimi. Leku u mbiçmua mesatarisht me 2.6 dhe 2.7 për qind ndaj dollarit amerikan dhe euros. Një vit më parë ky mbiçmim ishte respektivisht 15.7 për qind dhe 7.2 për qind.

	Mars	Qershor	Shtator	Dhjetor
Lek/Euro	-3.1	-1.0	-1.0	-3.2
Lek/Usd	-9.8	-1.2	-1.4	9.5
Greqi ²²	2.9	3.3	3.9	3.4
Itali ²³	1.7	1.8	2.0	2.0

Burimi: INSTAT, Sekretariati i Përgjithshëm i Shërbimit Kombëtar të Statistikave të Greqisë, ISTAT-Itali.

Tabelë 11. Inflacioni vjetor i vendeve partnere dhe ndryshimi vjetor i kursit të këmbimit (në përqindje).


Megjithëse në rënie, dinamika vjetore mbiçmuese e lekut ka mundur të amortizojë presionet inflacioniste të mallrave të importuar. Aktorët kryesorë në marrëdhëniet tregtare vazhdojnë të jenë Italia dhe Greqia - eksportet dhe importet e të cilave përfaqësojnë përkatësisht 83 për qind dhe 47 për qind të vëllimit të përgjithshëm. Mbiçmimi i lekut ndaj euros si dhe normat e qëndrueshme të inflacionit në këto vende kanë krijuar kushte për stabilitet në ambientin e jashtëm tregtar, duke lehtësuar kështu presionet inflacioniste të përcjella nga ky faktor i kërkesës.

- Ecuria e prodhimit të brendshëm bujqësor

Ecuria e prodhimit bujqësor gjatë vitit 2005 ka dhënë një ndikim jo të njëtrajtshëm në normën e inflacionit. Ndërsa, gjatë vitit 2004 dhe gjysmës së parë të vitit 2005, ky faktor i ofertës ndikoi në uljen e normave të inflacionit, për periudhën e mbetur të vitit ai veprroi në kahun e kundërt. Prodhimi i bollshëm i vitit të kaluar dhe kombinimi i rënies së çmimeve të mallrave ushqimorë në tregjet e huaja me mbiçmimin më të ndjeshëm të lekut ndaj euros gjatë muajve të parë të këtij viti, sollën rënie e çmimeve të këtyre mallrave në tregun e brendshëm gjatë kësaj periudhe. Efekti rënës i këtij faktori në çmimet e mallrave ushqimorë nuk veprroi me të njëjtën forcë gjatë pjesës së mbetur të vitit. Të dhënat e Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit flasin për një parashikim pesimist të prodhimit bujqësor të këtij viti. Parashikimi i fillimvitit për rritjen e prodhimit bujqësor ishte 2.5 për qind (kundrejt rritjes 3.3 për qind të regjistruar në vitin 2004). Ndërkohë, të dhënat e fundit flasin për një rritje afër nivelit 1.3 për qind.


Rritja më e ulët e prodhimit të brendshëm bujqësor, e kombinuar me rritjen e presioneve inflacioniste të gjeneruara nga çmimet më të larta të mallrave ushqimorë në tregjet partnere si dhe me zbutjen e efektit kompensues të mbiçmimit më

Grafik 23. Ndryshimi vjetor i kursit nominal të këmbimit lek/euro, i inflacionit të importuar (boshti majtas) dhe i inflacionit në vend (boshti djathtas).



Burimi: Banka e Shqipërisë, Sekretariati i Përgjithshëm i Shërbimit Kombëtar të Statistikave të Greqisë, ISTAT-Itali.

Grafik 24. Ndryshimet vjetore të indeksit të çmimeve të bujqësisë (boshti majtas) dhe inflacioni total vjetor dhe i grupit "Ushqime dhe pije joalkoholike" (boshti djathtas) në përqindje.



Burimi: Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorëve, INSTAT, Banka e Shqipërisë.

të dobët të lekut ndaj euros, rezultoi në çmime më të larta të këtyre mallrave gjatë gjashtëmuajorit të dytë.


- Indeksi i çmimeve të prodhimit²⁴.

Në përgjithësi, viti 2005 u karakterizua nga norma të ulta rritjeje të çmimeve të prodhimit. Pas një tremujori të parë me rritje dyshifrore, ndryshimi vjetor i indeksit të çmimeve të prodhimit shënoi norma të ulta rritjeje gjatë periudhës prill–shtator 2005. Në fund të nëntëmuajorit të parë të vitit, çmimet e prodhimit janë 2.3 për qind më të larta sesa niveli i tyre për të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Rënia në nivelin e përgjithshëm të çmimeve në hallkën e parë të tregtimit, u udhëhoq nga ecuria e çmimeve thuajse në të gjithë sektorët. Sektori “Industria përpunuese” shënoi rënie më të madhe nga

13.5 për qind në tremujorin e parë të vitit, në 1.5 për qind në tremujorin e tretë. Në këtë industri rënie u regjistrua kryesisht tek sektorët “Industria ushqimore”, “Industria e duhanit” dhe “Industria tekstile dhe e veshjeve”. Ecuria e çmimeve të këtyre industrive është reflektuar dhe në ecurinë e çmimeve të konsumit. Ndryshimi vjetor i çmimeve në sektorin “Prodhimi, shpërndarja e energjisë elektrike, e gazit dhe e ujit” u ul nga 17.8 për qind në tremujorin e parë të vitit, në 4.4 për qind në tremujorin e tretë. Sektorët që shënuan rritje ishin: “Industria nxjerrëse”, “Silvikultura, shfrytëzimi i pyjeve, shërbime plotësuese” dhe “Peshkimi, kultivimi i peshkut, kulturat ujore dhe shërbime”.



Pavarësisht çmimeve më të larta në hallkën e parë të tregtimit, çmimet përfundimtare që konsumatori paguan nuk janë rritur nën presionet e kostove më të larta. Ky fakt shpjegohet me rritjen e konkurrencës në të gjitha segmentet e ekonomisë shqiptare.



- Tregues të tjerë

Indeksi i shitjeve dhe indeksi i tregtisë me pakicë²⁵. Shitjet totale të ekonomisë u rritën me 16.1 për qind gjatë nëntëmuajorit të parë të vitit 2005, kundrejt një rritjeje prej vetëm 6.1 për qind gjatë së njëjtës periudhë të vitit të kaluar. Megjithë rritjen e shpejtë të kërkesës së brendshme, inflacioni vjetor gjatë kësaj periudhe ka mbetur nën kontroll, duke treguar për një rritje korresponduese të prodhimit në ekonomi.

Papunësi - paga. Viti 2005 u shoqërua nga një situatë e qëndrueshme në tregun e punës. Norma e papunësisë shënoi një ulje të lehtë gjatë vitit. Ky tregues u ul nga 14.4 për qind në tremujorin e parë, në 14.2 për qind në tremujorin e tretë të vitit. Kjo situatë u shoqërua me një rritje të moderuar të pagave në sektorin publik. Paga mesatare e këtij sektori u rrit me 3.0 për qind gjatë tremujorit të parë dhe me 2.2 për qind, në tremujorin e tretë të vitit. Gjithashtu, paga minimale u rrit me 9.3 për qind në tremujorin e tretë. Këto rritje nuk kanë përcjellë presione inflacioniste nëpërmjet spirales pagë – inflacion.


Çmimi i naftës. Rritja e çmimit të naftës ka qenë një shqetësim i vazhdueshëm në drejtim të rritjes së kostos së jetës gjatë vitit 2005. Rritjet mesatare prej 43.0 për qind dhe 34.0 për qind të çmimit të naftës në tregun ndërkombëtar përkatësisht gjatë pjesës së parë dhe së dytë të vitit, u përkthyen në rritje prej 27 për qind të çmimit të këtij produkti në tregun vendas, në çdo gjashtëmuor.

Megjithatë, pesha e vogël²⁶ që zë ky produkt në shportën e mallrave të konsumit nënkupton një ndikim të vogël të rritjes së çmimit të naftës në inflacionin total. Ky faktor rriti me rreth 0.2 pikë përqindjeje koston e jetës së konsumatorit shqiptar gjatë vitit 2005.

Rritja më e ulët e çmimit të naftës në vend ka ardhur si pasojë e disa faktorëve. Së pari, pozitat e forta të lekut kundrejt usd gjatë dy viteve të fundit kanë amortizuar një pjesë të rritjes së çmimit të naftës në tregun ndërkombëtar. Zbutja e dinamikës mbiçmuese të lekut ndaj dollarit gjatë gjashtëmuorit të dytë, ndikoi në një rritje më të shpejtë të çmimit të naftës gjatë kësaj periudhe. Së dyti, çmimi i naftës së prodhuar në vend ka patur një rritje të ulët prej 3.2 për qind në nivel vjetor, duke zëvendësuar një pjesë të importeve nga tregu dhe duke rritur konkurrencën. Së fundi, rritja e çmimit të naftës ka sjellë uljen e kërkesës për këtë produkt, duke kufizuar mundësinë e aplikimit të çmimeve më të larta. Kështu, gjatë tremujorit të katërt kërkesa për naftë është ulur me 21 për qind në terma vjetorë²⁷.


Kostoja e jetës rritet jo vetëm nga efekti direkt në inflacion por edhe nga rritja e kostove të lidhura me çmimet e naftës. Megjithatë, gjatë këtij viti nuk janë vërejtur efekte të raundit të dytë, në formën e kalimit të kësaj kostoje në çmimin e produkteve të tjera.

Grafik 27. Ndryshimi vjetor i indeksit të shitjeve me bazë tremujore (në përqindje).



Burimi: INSTAT.

Grafik 28. Ndryshimi vjetor i çmimeve të naftës në vend, në tregun ndërkombëtar dhe i kursit të këmbimit lek/usd.



Burimi: INSTAT, Bloomberg, Banka e Shqipërisë.

Zhvillimet makroekonomike kanë mundësuar krijimin e një mjedisi të favorshëm për ruajtjen e stabilitetit të çmimeve. Presionet e dobëta inflacioniste nga ana e politikës fiskale, politika e kujdesshme monetare, si dhe qëndrueshmëria e pozitive të lekut kundrejt valutave të huaja, kanë siguruar një normë të ulët pozitive të inflacionit, gjatë vitit 2005.

Boks II.4. Parashikimi në Bankën e Shqipërisë.

Politika monetare, ashtu si politikat e tjera ekonomike në përgjithësi, ndikimin e saj e jep disa periudha pas momentit që zbatohet. Kjo do të thotë që vendimmarrja duhet t'i paraprijë zhvillimeve të ardhshme ekonomike. Ndaj, njohja sa më e mirë e pritjeve është kritike për efektivitetin e politikave ekonomike. Në rastin e bankës qendrore, kontrolli i inflacionit lidhet në mënyrë të pashmangshme me njohjen e pritshmërive të çmimeve. Për zbulimin e këtyre pritshmërive Banka e Shqipërisë bazohet në disa metoda.

Grupi i parë i metodave konsiston në pyetjen drejtpërdrejt të konsumatorëve dhe bizneseve për pritshmëritë e çmimeve, me anë të anketimeve. Anketimi është një mënyrë efektive që jep një informacion të shpejtë mbi ndjesitë e agjentëve ekonomikë. Në të njëjtën kohë, anketimi shërben si tregues i besueshmërisë së politikës së ndjekur nga banka qendrore. Nëse pritshmëritë nuk tregojnë shmangie të mëdha nga objektivi i bankës qendrore, kjo mund të interpretohet si shenjë që politika e ndjekur është në rrugë të drejtë. Por, eksperiencia ka treguar se pritjet e konsumatorëve dhe bizneseve mund të ndryshojnë mjaft shpejt, pa dhënë shenja paralajmëruese. Ndaj lind nevoja e përdorimit të metodave të tjera parashikuese, të cilat mund të kapin në kohë ndryshime që mund t'i shpëtojnë syrit të një konsumatori apo biznesi individual.

Metodat parashikuese kategorizohen në metoda jostrukturore dhe metoda strukturore. Metodat jostrukturore konsistojnë në modele relativisht të thjeshta, bazuar në korrelacionet e vërejtura midis variablave të ndryshëm në kohë. Këto modele sot përdoren gjerësisht në tregjet financiare për parashikimin e treguesve të ndryshëm, përfshi dhe ndryshimin e çmimeve. Performanca e modeleve jostrukturore deri më sot ka qenë e kënaqshme, pavarësisht logjikës minimale ekonomike pas këtyre modeleve. Por, është pikërisht kjo e fundit që i bën ato jo shumë të përshtatshme për të analizuar reagueshmërinë e pritshmërive ndaj goditjeve jo të zakonshme me të cilat mund të përballet ekonomia. Për shembull, këto modele mund të mos jenë në gjendje të kapin me saktësi efektet dytësore të një ngritjeje të menjëhershme të çmimeve të naftës.

Modelet strukturore, në anën tjetër, bazohen gjerësisht në teoritë ekonomike dhe i shikojnë lëvizjet e çmimeve si rezultat i ndërveprimit të variablave të ndryshëm ekonomikë (të ardhurat, konsumi, kursimet, investimet etj.). Modelet strukturore janë një sistem kompleks identitetesh teorike për mënyrën se si funksionon ekonomia, ku secili identitet ka një sfond teorik dhe empirik po aq të pasur pas tij. Këto modele bëjnë që gjykimi për zhvillimet e ardhshme të ekonomisë të jetë më i strukturuar në aspektin e supozimeve dhe të argumenteve teoriko-praktike. Modelet strukturore nuk mund të trajtohen thjesht në kuadrin e modeleve parashikuese. Këto modele, që zakonisht quhen dhe makromodele, lejojnë simulimin e skenareve të ndryshme për rreziqet ose goditjet e mundshme me të cilat mund të përballet ekonomia e një vendi. Ç'është më e rëndësishme, banka qendrore mund të përdorë këto modele për të vlerësuar sa duhet të ndryshojë instrumentet e politikës së saj monetare (në rastin e Bankës së Shqipërisë norma bazë e interesit) për arritjen dhe/ose ruajtjen e objektivit të inflacionit. Por, këto modele i lejojnë bankës qendrore të analizojë reagueshmërinë e një numri më të gjerë variablash ekonomikë përtej çmimeve, duke

e bërë atë të vetëdijshme dhe ndaj volatilitetit të treguesve të tjerë ekonomikë, që mund të shkaktojnë politikat e saj.

Në mënyrë që të minimizojë gabimin në vlerësimin e pritshmërive, Banka e Shqipërisë aktualisht kombinon rezultatet e të gjitha metodave të mësipërme. Anketimet e konsumatorëve dhe biznesit, dhe modelet jostrukturore apo gjysmë strukturore kanë hyrë në një fazë konsolidimi. Ndërkohë që përgatitja e modelit strukturor, për vetë natyrën e tij komplekse dhe intensitetin e serive të të dhënave ekonomike që kërkon, është një proces disi më i shtrirë në kohë. Pavarësisht nga niveli i zhvillimit të secilës metodë, ato janë në proces të vazhdueshëm rishikimi dhe përmirësimi, jo thjesht me zhvillimet më të fundit teorike por dhe me ndryshimet strukturore që pëson ekonomia e vendit. Kohë pas kohe këto modele do të botohen dhe në formën e materialeve të diskutimit.

Rezultatet e pritshmërive të metodave të ndryshme, përbëjnë vetëm një pjesë të informacionit dhe të analizave më të gjera mbi të cilat bazohet vendimmarrja e politikës monetare. Një komponent i rëndësishëm i vendimmarrjes mbetet gjykimi ekspert për të interpretuar informacionet dhe rezultatet e modeleve të ndryshme, të cilat megjithëse minimizojnë hapësirat e gjykimit abstrakt nuk mund ta zëvendësojnë plotësisht atë.


II.5 KURSIMET DHE INVESTIMET

Disbalanca e kursimeve dhe investimeve të brendshme u rrit në 5.5 për qind të PBB-së gjatë vitit 2005, kundrejt nivelit 3.8 për qind të shënuar në vitin 2004²⁸. Ky fakt është manifestuar edhe në zgjerimin e deficitit të llogarisë korente. Zgjerimi i kësaj difference reflektoi ecurinë e kundërt të kursimeve dhe të investimeve. Kështu, raporti i investimeve ndaj PBB-së u rrit me 0.4 pikë përqindjeje gjatë vitit 2005, ndërkohë që raporti i kursimeve ndaj PBB-së shënoi një rënie prej 1.4 pikësh përqindjeje. Normat e ulëta të interesit kanë ulur stimulin për kursim, duke nxitur në të njëjtën kohë rritjen e investimeve.

Ulja e kursimeve të brendshme gjatë vitit 2005 erdhi si rezultat i rënies me gati 2.7 pikë përqindjeje të raportit të kursimeve private ndaj PBB-së. Nga ana tjetër, kursimet publike u rritën me 1.3 pikë përqindjeje krahasuar me një vit më parë. Përmirësimi i deficitit buxhetor në vazhden e konsolidimit fiskal ndikoi në rritjen e kursimeve publike.

Raporti i investimeve ndaj PBB-së u rrit me 0.4 pikë përqindjeje gjatë vitit 2005. Ai arriti në 24.2 për qind të PBB-së, duke ruajtur të njëjtin nivel mesatar të 4 viteve të fundit. Si investimet publike ashtu dhe ato private u rritën me 0.2 pikë përqindjeje gjatë vitit 2005. Kjo rritje vlerësohet si e kënaqshme, duke qenë se rritja e investimeve publike nuk u ndikua këtë vit nga


Grafik 29. Ecuria e kursimeve dhe e investimeve në përqindje ndaj PBB-së.



Burimi: FMN, Janar 2006²⁹.


të ardhurat e realizuara nga privatizimet e pronës publike, por u mbështet kryesisht në burimet e brendshme. Përveç normave të ulta reale të interesit, rritja e investimeve private është mbështetur edhe nga rritja e shpejtë e kredihënies bankare. Gjithashtu, vazhdimi i periudhës së rritjes ekonomike dhe të konsolidimit të stabilitetit makroekonomik, ka krijuar një ambient të përshtatshëm për kryerjen e investimeve afatgjata dhe për një shpërndarje më afatgjatë në kohë të konsumit.

Grafik 30. Ecuria e investimeve publike dhe private ndaj PBB-së.



Burimi: FMN, Janar 2006.

Grafik 31. Deficiti korent ndaj PBB-së (në përqindje).



Burimi: FMN, Banka e Shqipërisë.

Shkalla e përfaqësimit të tyre në totalin e eksporteve, këtë vit, ra në 58 nga 61 për qind në vitin 2004.

Në të njëjtën kohë, çmimet e larta të naftës në tregjet ndërkombëtare si dhe rritja e aktivitetit kreditues kanë çuar në rritje të importeve me rreth 16 për qind. Si rezultat i rritjes më të shpejtë të importeve krahasimisht me atë të eksporteve, mbulimi i importeve nga eksportet ka rënë në nivelin 26 për qind nga 28 për qind në vitin e kaluar.

II.6 BILANCI I PAGESAVE

Sektori i jashtëm i ekonomisë, gjatë vitit 2005, paraqitet me një bilanc të thelluar negativ në llogarinë korente, shkaktuar nga një deficit i lartë tregtar. Flukset hyrëse të kapitalit kanë qenë përgjithësisht të mjaftueshme për kompensimin e deficitit korent, duke mundur një bilanc të përgjithshëm pozitiv.

Treguesi relativ i deficitit korent (përfshijtur transfertat zyrtare) ndaj PBB-së, ka arritur në 7.7 për qind në vitin 2005 nga 5.7 për qind vlerësuar për vitin 2004. Thellimi i deficitit korent është shkaktuar nga përkeqësimi i bilancit tregtar – përgjatë një periudhe me vlerësim të vazhdueshëm të Lekut (gjatë dy viteve të fundit kursi real efektiv i këmbimit - llogaritur bazuar në indeksin e çmimeve të konsumit - është vlerësuar mesatarisht me 5 për qind).

Eksporti ka ngadalësuar ritmet e rritjes. Rritja vjetore në eksporte gjatë këtij viti u vlerësua rreth 9 për qind, përkundrajt 23 për qind në vitin e kaluar. Përveç humbjes në aftësitë konkurruese (zhvillimet në kursin e këmbimit), ngadalësimi në eksporte mendohet të jetë pasojë edhe e rritjes së konkurrencës në sektorin e tekstileve, me hapjen e tregjeve evropiane drejt Kinës dhe Indisë. Duhet përmendur se tekstilet dhe këpucët kanë përfaqësuar mesatarisht 64 për qind të eksporteve tona, për periudhën 2000-2004.

Statistikat e bilancit të pagesave për vitin 2005, tregojnë se tregtia e jashtme në shërbime evidentohet si aktivitet shumë i rëndësishëm për ekonominë shqiptare. Kështu, transaksionet e shërbimeve (rreth 2 miliardë euro) kanë regjistruar një rritje prej 22.5 për qind kundrejt vitit 2004.

Deficiti tregtar (mallra dhe shërbime) vlerësohet të ketë arritur në 24 për qind të PBB-së ose 4 pikë përqindjeje më shumë, krahasuar me një vit më parë.

	2004	2005	2004	2005
	në milionë euro		në % ndaj PBB-së	
Llogaria korente	-347.0	-519.0	-5.7	-7.7
Bilanci tregtar	-1,276.7	-1,476.7	-20.8	-21.8
Eksport	485.6	530.2	7.9	7.8
Import	-1,762.3	-2,006.9	-28.7	-29.6
Shërbime (neto)	-40.5	-167.1	-0.7	-2.5
Të ardhura (neto)	140.7	144.3	2.3	2.1
Transferta korente (neto)	890.3	1,045.8	14.5	15.4
Llogaria kapitale (neto)	179.6	297.7	2.9	4.4
Bilanci i përgjithshëm	233.7	124.8	3.8	1.8

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 12. Treguesit kryesorë të bilancit të pagesave në raport ndaj PBB-së.

Rritja e vëllimit të transaksioneve të mallrave dhe të shërbimeve, gjatë vitit 2005, ka çuar në përmirësimin e treguesit të hapjes ekonomike të Shqipërisë³⁰, i cili për këtë vit vlerësohet në rreth 68 për qind nga niveli 64 për qind në vitin 2004.

Deficitet e larta tregtare, në vite, janë financuar jo vetëm nga flukset hyrëse në kapitale, por mundësi të konsiderueshme financimi janë vërejtur brenda vetë llogarisë korente, përmes dërgesave nga emigrantët. Gjatë vitit 2005, fluksi neto i transfertave korente arriti në rreth 1 miliard euro, nga të cilat vlerësohet se mëse 90 për qind janë kontribut i emigracionit shqiptar. Dërgesat e emigrantëve, për vitin 2005, vlerësohen në 939 milionë euro ose në rreth 14 për qind të PBB-së.

Hyrjet neto të kapitalit regjistruan një nivel prej 423 milionë eurosh, duke mundësuar në masën 93 për qind financimin e deficitit korent. Ky import kapitali, gjithashtu, është reflektuar në rritje të rezervave valutore të autoritetit monetar, me rreth 197 milionë euro. Rezerva valutore në fund të vitit 2005 shënoi nivelin 1.204 miliardë euro, duke qenë e mjaftueshme për të përballuar rreth 4.7 muaj importe mallrash dhe shërbimesh.

II.6.1 LLOGARIA KORENTE

Viti 2005 është karakterizuar nga një aktivitet intensiv në sektorin e jashtëm të vendit, i shprehur në rritje të konsiderueshme të të ardhurave dhe të shpenzimeve korente. Vëllimi i transaksioneve korente është rritur me 21 për qind krahasuar me vitin 2004, duke shënuar një nivel prej 6.2 miliardë eurosh. Mëse 93 për qind e shpenzimeve korente kanë shkuar për blerje

mallrash dhe shërbimesh prej jorezidentëve. Rreth 43 për qind e të ardhurave korente kanë ardhur në formën e transfertave korente, ndërkohë që eksporti i shërbimeve dhe ai i mallrave kanë siguruar përkatësisht 32 për qind dhe 18 për qind të të ardhurave.

Deficiti korent, kundrejt një viti më parë, është rritur me rreth 168 milionë euro, duke shënuar 454 milionë euro. Rritja e deficitit tregtar në mallra dhe në shërbime u balancua pjesërisht nga rritja e të ardhurave neto në llogaritë e transfertave dhe të të ardhurave. Deficiti tregtar ka përbërë një tipar të përhershëm të zhvillimeve të tregtisë së jashtme, duke diktuar nivelet e larta të deficitit të llogarisë korente. Treguesi relativ i importeve ndaj PBB-së, vlerësohet në rreth 30 për qind. Në rreth 58 për qind të totalit importi gjatë këtij viti, prezantohet në importe mallrash kapitalë dhe në importe mallrash të ndërmjetëm, ndërkohë që kërkesa e brendshme për mallra konsumi ka mbetur e lartë.

Megjithëse, investimet private në kapitalin prodhues shoqërohen me rritje të kapaciteteve prodhuese për eksporte, një tipar i dallueshëm i ekonomisë mbetet niveli i ulët i eksporteve. Përgjatë vitit 2005 ato kanë përbërë mesatarisht rreth 7.8 për qind të PBB-së, duke përballuar financimin e vetëm rreth 26 për qind të vëllimit të importeve të ekonomisë. Llogaria e shërbimeve gjatë vitit 2005 ka regjistruar rritje si në kahun e të ardhurave ashtu edhe në atë të shpenzimeve. Në krahasim me vitin 2004, shpenzimet janë rritur më shpejt se të ardhurat. Rezultati neto i transaksioneve në shërbime ka çuar në rritje të deficitit të kësaj llogarie, me rreth 127 milionë euro.

Ndërkohë, bilanci pozitiv i hyrjeve korente në formën e transfertave dhe të të ardhurave korente, vlerësohet të jetë rreth 159 milionë euro më i lartë krahasuar me vitin e kaluar. Kjo rritje është efekt i rritjes së të ardhurave korente në formën e prurjeve nga emigrantët ndërkohë që, bilanci pozitiv i llogarisë së të ardhurave regjistroi një rritje modeste.

- Tregtia e mallrave

Vëllimi i tregtisë së jashtme, importe plus eksporte, vlerësohet në rreth 2.5 miliardë euro, duke përfaqësuar rreth 41 për qind të totalit të transaksioneve korente. Shpenzimet për import mallrash shënuan afërsisht vlerën 2 miliardë euro ose 245 milionë euro më shumë, krahasuar me vitin 2004. Të ardhurat nga eksporti i mallrave u rritën me 9 për qind, duke arritur në 530 milionë euro.

Shkalla e mbulimit të importit nga eksportet rezultoi 25 për qind, duke shënuar një rënie të lehtë ndaj nivelit prej 27 për qind të vitit të kaluar, gjë që rezultoi me një thellim të mëtejshëm të deficitit tregtar. Ekonomia shqiptare për mëse një dekadë ka krijuar një profil të sajën, i cili karakterizohet nga importe të larta në mallra. Këtë e tregon edhe fakti që gjatë këtij viti importet përfaqësuan 80 për qind të vëllimit të tregtisë së jashtme. Deficiti tregtar për vitin 2005 arriti në 1.5 miliardë euro, duke qenë 16 për qind më i lartë se ai i vitit paraardhës.

Kodi	Përshkrimi	Import	Eksport	Bilanci tregtar
0	Ushqime dhe kafshë të gjalla	272.33	20.41	(251.91)
1	Pije dhe duhan	64.71	9.64	(55.07)
2	Materiale të papërpunuara	75.91	25.62	(50.29)
3	Lëndë djegëse	181.77	15.35	(166.42)
4	Yndyrna bimore dhe shtazore	28.50	0.24	(28.26)
5	Produkte kimike	201.75	4.77	(196.97)
6	Mallra të përpunuar	509.85	114.31	(395.54)
7	Makineri dhe pajisje	488.97	22.14	(466.83)
8	Mallra të tjerë të përpunuar	260.07	317.70	57.64
9	Mallra të paklasifikuar diku tjetër	-	-	-
	Total	2,083.85	530.19	(1,553.66)

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 13. Shpërndarja e eksport/importit sipas grupmallrave³¹ (në milionë usd).

Eksporti i mallrave vazhdon të vuajë shkallën e ulët të diversifikimit edhe pse vërehen shenja modeste pozitive në këtë drejtim. Në pjesën më të madhe të tij ai përfaqësohet nga eksporte të tekstileve, të veshjeve të këmbëve dhe metalet bazë. Theksojmë që tekstilet pothuajse kanë ruajtur të njëjtat nivele si të një viti më parë, ndërkohë që është rritur eksporti i dy kategorive të tjera.

Edhe këtë vit ecuria e eksportit të mallrave u përcaktua ndjeshëm nga ndryshimet në industrinë e përpunimit në vend. Eksportet e kësaj kategorie realizuan 70 për qind të të ardhurave vjetore në eksporte mallrash. Gjatë këtij viti, vërejmë një rritje të theksuar të eksporteve nga prodhimi vendas duke përfaqësuar 30 për qind ndaj totalit, krahasuar me 25 për qind të vitit paraardhës. Kërkesa për importe mbetet e lartë. Pozitiv është fakti që në masë të konsiderueshme, rritja vjetore në importe është shkaktuar nga rritja e importeve në makineri dhe pajisje, dhe në mjete transporti. Pesha që zënë këto importe ndaj totalit është rreth 24 për qind, duke ruajtur kështu të njëjtat nivele përfaqësimi të një viti më parë.

Kërkesa e lartë e sektorit privat për mallra kapitalë është një tregues pozitiv për nivelin e investimeve, për rinovimin e bazës teknologjike si dhe produktivitetin e tij. Importet e lëndës së parë për industrinë e përpunimit aktiv në vend, të përqëndruara kryesisht në tekstile, veshjet e këmbëve dhe metaleve, u rritën duke përfaqësuar 15 për qind të totalit nga 17 për qind në vitin paraardhës. Ecuria e këtyre importeve reflekton zhvillimet e vërejtura në sektorin e rieksperteve.

Eksporti	Pesha në totalin e eksportit			Ndryshimi (2005/2004) %
	2003	2004	2005	
Total	100	100	100	9.2
Vendet e BE-15	93.3	89.9	88.0	6.9
Itali	74.9	73.0	72.4	8.3
Greqi	12.8	12.0	10.5	-5.1
Gjermani	3.4	3.1	3.3	17.2
Vendet e Evropës Juglindore	4.0	8.5	9.2	19
Ish-Jugosllavia	0.6	0.4	0.8	143
Maqedoni	0.7	1.2	1.6	38
Kosovë	1.7	4.5	4.1	-1
Vende të tjera	2.7	1.6	2.7	86

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 14. Shpërndarja e eksporteve sipas partnerëve tregtarë në vite dhe ndryshimi vjetor për vitin 2005.

Parë nga pikëpamja gjeografike, destinacioni kryesor i produkteve shqiptare mbetet Bashkimi Evropian, duke zënë 88 për qind të totalit të eksporteve. Shitjet në tregjet evropiane kanë regjistruar një rritje vjetore prej 30 milionë eurosh ose prej 7 për qind ndaj vitit të kaluar. Megjithatë, ky treg ka humbur terren në favor të zgjerimit të tregut në vendet e rajonit.

Eksportet me vendet e rajonit të Evropës Juglindore (EJL), me të cilat Shqipëria tregton nën marrëveshjet e tregtisë së lirë, janë rritur me 19 për qind kundrejt një viti më parë, duke e zgjeruar tregun e eksporteve shqiptare në këtë zonë nga 8.5 në 9.2 për qind të totalit të eksporteve. Kosova dhe Maqedonia përfaqësojnë tregun më të madh për eksporte të produkteve shqiptare.

Përsa i përket importeve, gjeografia tregtare paraqet një larmi më të madhe tregjesh. Bashkimi Evropian plotëson rreth 60 për qind të nevojave të brendshme për importe dhe gjatë vitit 2005 janë rritur me 5.7 për qind. Italia dhe Greqia mbeten partnerët kryesorë tregtarë të Shqipërisë. Importet nga të dyja shtetet së bashku zënë 76 për qind të shpenzimeve të ekonomisë shqiptare në tregjet e Bashkimit Evropian. Importet me vendet e rajonit të Evropës Juglindore (EJL) të përfshira në procesin e krijimit të zonës së lirë tregtare, kanë shfaqur një rritje të konsiderueshme rreth 31.5 për qind dhe pesha e tyre në totalin e importeve ka pësuar rritje nga niveli 12.8 për qind në vitin 2004, në 14.8 për qind për vitin në fjalë.

Tabelë 15. Shpërndarja e importeve sipas partnerëve tregtarë në vite dhe ndryshimi vjetor për vitin 2005.

Importi	Pesha në totalin e importit			Ndryshimi (2005/2004)
	2003	2004	2005	%
Total	100	100	100	13.8
Vendet e BE-15	78.2	65.0	60.4	5.7
Itali	38.1	32.6	29.3	2.4
Greqi	24.2	18.6	16.6	1.5
Gjermani	6.3	6.2	5.4	-0.9
Vendet e Evropës Juglindore	14.7	12.8	14.8	31.5
Bullgari	2.9	2.0	2.8	60.2
Bosnje-Hercegovinë	0.1	0.0	0.1	195.6
Kroaci	1.7	1.3	1.2	5.0
Serbi Mal i Zi	0.5	0.6	0.6	23.3
Maqedoni	1.0	1.0	1.2	35.0
Rumani	0.9	0.4	0.7	92.3
Turqi	7.5	7.1	7.5	19.4
Rusi	2.8	2.8	4.1	63.7
Ukrainë	2.5	2.5	2.9	31.6
Vende të tjera	7	22	25	27.5

Burimi: Banka e Shqipërisë.

- Shërbimet

Tregtia në shërbime gjatë vitit 2005 karakterizohet nga një deficit i lartë neto prej 167 milionë eurosh në krahasim me deficitin prej 40 milionë eurosh në vitin 2004. Bilanci i tregtisë së shërbimeve u mbyll me një bilanc negativ prej 167 milionë eurosh, konsiderueshëm në rritje kundrejt deficitit prej 40 milionë eurosh, regjistruar në vitin 2004. Ky deficit ka ardhur kryesisht si pasojë e një bilanci negativ në kategorinë e shërbimeve të tjera kulturore dhe biznesi.


Të ardhurat nga shërbimet e turizmit përforcojnë edhe një herë faktin që ky sektor po i krijon ekonomisë shqiptare oportunitete konkrete tregtare, pavarësisht nga niveli i zhvillimit të tij. Kështu, sipas vlerësimeve të Bankës së Shqipërisë për vitin 2005 eksporti i shërbimeve të turizmit ka gjeneruar të ardhura prej 692 milionë eurosh, rreth 30 për qind më të larta se ato të gjeneruara nga eksporti i mallrave. Kjo rritje, ka ardhur kryesisht nga rritja e fluksit të shtetasve të huaj dhe e emigrantëve, që kanë vizituar vendin si dhe nga rritja e lehtë e koeficientëve vlerësues të shpenzimeve ditore. Gjatë vitit 2005, numri i shtetasve të huaj që kanë vizituar Shqipërinë është rritur me 21 për qind, në krahasim me vitin 2004, ku pesha kryesore e kësaj rritjeje bie në periudha sezonale pushimesh dhe fundviti. Një rritje me norma të larta vjetore vihet re edhe në importin e shërbimeve të turizmit. Viti 2005 regjistroi rreth 635 milionë euro, shifër kjo e barabartë me rreth 68 për qind të dërgesave nga emigrantët.

Është tashmë e ditur se shërbimet e transportit dhe të sigurimeve ndjekin zhvillimet në aktivitetin tregtar të mallrave. Rritja e vëllimit të importit ka shkaktuar rritjen e importit të shërbimeve të këtyre kategorive. Kështu, në fund të vitit importi i shërbimeve të kësaj kategorie vlerësohet respektivisht rreth 12 dhe 38 për qind më i lartë, prej atyre të vitit 2004.

Shërbimet e telekomunikacionit, u mbyllën me një bilanc pozitiv prej rreth 46 milionë eurosh, si pasojë e zgjerimit të gamës së shërbimeve të ofruara nga sektori i telekomunikacionit.

Kategoria “Shërbime të tjera” ka pësuar një rritje të konsiderueshme në kahun e importeve, e cila së bashku me shërbimet e transportit kanë çuar në deficit bilancin e shërbimeve për vitin 2005.

Grafik 32. Shërbimet – fluksi neto në milionë euro.



Burimi: Banka e Shqipërisë.


- Të ardhurat dhe transfertat korentë

Çdo vit ekonomia shqiptare përfiton burime valutore prej punës së punonjësve sezonalë dhe investimeve të rezervave valutore të sistemit bankar në institucionet financiare jorezidente, duke paguar njëkohësisht interesa për borxhin e jashtëm. Bilanci pozitiv i të ardhurave në fund të vitit 2005, vlerësohet rreth 144 milionë duke qenë 4 milionë më i lartë ndaj vitit 2004. Të ardhurat nga puna, përfaqësojnë rreth 70 për qind të bilancit pozitiv të të ardhurave. Fluksi neto i të ardhurave të kësaj kategorie ka rënë me rreth 3 për qind kundrejt një viti më parë, vit në të cilin organizimi i Lojërave Olimpikë mbajti të lartë kërkesën për fuqi punëtore në vendin fqinj dhe, për rrjedhojë, gjeneroi flukse të larta të ardhurash nga puna. Ndërkohë, të ardhurat neto në formën e interesit nga investimet kanë pësuar rritje (rreth 19 për qind ose 7 milionë euro). Shqipëria gjatë vitit 2005 ka paguar 22 milionë euro për të shlyer interesat mbi borxhin e saj të jashtëm ose 19 për qind më shumë se në vitin e kaluar.

Transfertat korente, ashtu si edhe gjatë viteve të kaluara, kanë marrë formë prej prurjeve nga emigrantët. Këto të fundit përfaqësojnë një burim të rëndësishëm mbështetës për ekonominë shqiptare, duke siguruar një fluks të vazhdueshëm financimi për deficitin korent. Totali i dërgesave nga emigrantët, për vitin 2005 vlerësohet të jetë rreth 939 milionë euro ose 14 për qind e PBB-së. Kontributi i këtyre dërgesave në zbutjen e deficitit tregtar llogaritet në rreth 64 për qind. Prurjet nga emigrantët janë shoqëruar edhe nga transfertat zyrtare, kryesisht në formë të asistencës teknike (47 milionë euro), të cilat vlerësohen lehtësisht në rritje kundrejt një viti më parë (4 për qind).

II.6.2 LLOGARIA KAPITALE DHE FINANCIARE

Lëvizjet e kapitalit, gjatë vitit 2005, rezultuan në një fluks neto prej rreth 423 milionë eurosh, duke mundur financimin e deficitit korent me 93 për qind. Transfertat kapitale shënojnë 99 milionë euro ose 7 milionë më pak krahasuar me fundin e vitit 2004, ndërkohë që, llogaria financiare u mbyll me një bilanc pozitiv prej 323 milionë eurosh.



Detyrimet financiare të Shqipërisë ndaj pjesës tjetër të botës janë rritur me rreth 346 milionë euro dhe vlerësohen të jenë 22 për qind më pak se një vit më parë. Kjo rritje i dedikohet flukseve hyrëse të investimeve të huaja direkte si dhe të borxhit të jashtëm.

Fluksi i investimeve të huaja direkte gjatë vitit 2005 arriti vlerën 213 milionë euro kundrejt 278 milionë euro realizuar në vitin e kaluar. Duhet përmendur që në vitin 2004, kanë qenë flukset hyrëse të kapitalit në formën e privatizimit një faktor që ka përcaktuar madhësinë dhe karakterin e investimeve të huaja në vend. Flukset e kapitalit në formën e IHD-ve janë shndërruar në një faktor dominues në rritjen e detyrimeve financiare dhe në zhvillimet e transaksioneve kapitale e financiare të vendit. IHD-të vlerësohen si një burim i rëndësishëm për mbulimin e deficitit korent dhe të atij fiskal, gjithashtu. Krahasuar me mundësitë e tjera të financimit, IHD-të mundësojnë transferimin e teknologjisë dhe të përhapjes së njohurive, ndikojnë në hapjen e vendeve të reja të punës, ndihmojnë kompanitë e brendshme të zgjerohen në tregjet e huaja etj.. Ndërkohë që, megjithëse Shqipëria paraqet relativisht më pak kufizime mbi veprimtarinë e investitorëve të huaj në krahasim me shtetet e tjera të Evropës Juglindore, ajo duket të ketë tërhequr më pak investime direkte në krahasim me vendet e rajonit.

Një tipar dallues i zhvillimeve financiare të Shqipërisë me jashtë, gjatë këtyre viteve të fundit, është akumulimi i borxhit të jashtëm duke rritur nivelin e detyrimeve për ripagime dhe pagesa interesi. Shqipëria, deri në fund të

vitit 2005, ka grumbulluar një borxh të jashtëm shtetëror prej 1.039 miliardë eurosh dhe borxh shtetëror të garantuar prej 145 milionë eurosh.

Ky nivel borxhi, si në terma absolutë ashtu edhe i vlerësuar ndaj PBB-së (mesatarisht për periudhën 2004-2005 vlerësohet në rreth 18 për qind) apo si stok detyrimesh për frymë, paraqitet relativisht i ulët krahasuar me vendet e tjera të rajonit. Shtesa vjetore e stokut të borxhit të jashtëm gjatë këtij viti vlerësohet 139 milionë euro përkundrejt 181 milionësh euro që shënoi vitin e kaluar. Kjo rritje ka financuar kryesisht konsumin e ekonomisë, e reflektuar kjo edhe në rritje të importeve për konsum si dhe ka financuar nevojat për kapital dhe/ose mallra kapitalë të kompanive. Në këtë borxh, nuk përfshihet përdorimi i huave dhe i kredive në Fond prej 9.4 milionë eurosh.

Sipas të dhënave statistikore, peshën kryesore në pozicionin e borxhit të jashtëm e zë huamarrja qeveritare, e cila në fund të vitit 2005 u rrit me 84 milionë euro. Ndërkohë, një zhvillim i viteve të fundit është pjesëmarrja e sektorit privat në aktivitetin huamarrës me jashtë. Për vitin 2005, huamarrja private arriti në rreth 39 për qind të totalit, me një rritje vjetore prej 54 milionë eurosh, duke rritur kështu nivelin e përfaqësimit në totalin e borxhit të jashtëm. Struktura e borxhit të jashtëm sipas monedhave dominohet nga Sdr (rreth 56 për qind) e ndjekur nga monedha evropiane dhe dollari amerikan.

Shërbimi i borxhit të jashtëm vlerësohet në nivele modeste, duke arritur në rreth 4 për qind të totalit të eksporteve gjatë vitit 2005 ose shumë poshtë nivelit prej 25 për qind, të konsideruar si nivel kritik. Përgjithësisht, arrihet përfundimi se Shqipëria nuk është në prag të ballafaqimit me aftësi paguese të borxhit të jashtëm. Detyrimet financiare në formën e depozitave të jorezidentëve në sistemin tonë bankar, janë ulur me rreth 30 milionë euro. Detyrimet në formën e kredisë tregtare u rritën me rreth 8 milionë euro, e reflektuar kjo edhe në rritje të importeve për këtë periudhë. Rritje e konsiderueshme prej 47 milionë eurosh vihet re në detyrimet e tjera valutore në formën e huave afatshkurtra, marrë nga njësitë jorezidente.

Pretendimet financiare të Shqipërisë ndaj pjesës tjetër të botës janë rritur në 22 milionë euro. Peshën më të madhe në këtë rritje e mban rritja e mjeteve të tjera valutore në formën e huave afatmesme dhe afatshkurtra, dhënë nga njësitë rezidente jashtë. Kjo rritje është rreth 69 milionë euro ose rreth 44 milionë më e lartë se fundi i vitit të kaluar.


Mjetet valutore të zotëruara nga sistemi bankar në formën e depozitave jashtë, janë ulur me rreth 53 milionë euro. Kjo rënie mund të jetë si pasojë e politikave rritëse të kreditimit të bankave të nivelit të dytë. Në përbërjen e depozitave të zotëruara nga sistemi bankar, 55 për qind e tyre janë në dollarë, ndërsa pjesa tjetër është në euro (40 për qind) dhe stërlina angleze (5 për qind).

Përsa i përket mjeteve valutore cash, gjatë vitit 2005 kanë shënuar një rritje prej 1.4 milionë eurosh dhe nuk kanë shfaqur luhatje domethënëse. Në përbërjen e tyre në fund të vitit 2005, mjetet valutore cash në dollarë

amerikanë zinin 29 për qind dhe ato në euro 66 për qind, stërlina angleze 4 për qind dhe franga zvicerane 1 për qind. Gjendja e mjeteve financiare në

formën e investimeve të portofolit kapi shumën 120 milionë euro, duke shënuar një rritje vjetore prej rreth 2 milionë eurosh. Në përbërjen strukturore sipas monedhave, investimet e portofolit gjatë këtij viti mbizotërohen nga ato në dollarë rreth 70 për qind, në euro 26 për qind dhe në stërlinën angleze 4 për qind.

Grafik 34. Rezerva valutore në muaj importe.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

II.6.3 REZERVAT VALUTORE

Flukset hyrëse të mjeteve valutore në formën e kapitaleve financiare u reflektuan në rritje të rezervave valutore të autoritetit monetar, me rreth 197 milionë euro. Rezerva valutore në fund të vitit 2005 shënoi nivelin 1.204 miliardë euro, duke qenë e mjaftueshme për të mbuluar rreth 4.6 muaj importe mallrash dhe shërbimesh.

Tabelë 17. Bilanci i pagesave në vite (në milionë euro).

	2000	2001	2002	2003	2004	2005
Llogaria korentë	(179.8)	(245.2)	(440.0)	(355.3)	(286.2)	(453.7)
Eksporti i mallrave	277.0	340.3	348.4	396.1	485.6	530.2
Importi i mallrave	(1,174.2)	(1,489.1)	(1,566.5)	(1,577.0)	(1,762.3)	(2,006.9)
Bilanci tregtar	(897.2)	(1,148.8)	(1,218.1)	(1,180.9)	(1,276.7)	(1,476.7)
Shërbimet: kredi	482.9	596.8	612.3	635.2	807.5	930.4
Shërbimet: debi	(471.1)	(497.0)	(620.5)	(707.6)	(848.0)	(1,097.5)
Të ardhurat: kredi	126.9	181.9	155.4	172.9	164.0	183.3
Të ardhurat: debi	(10.0)	(15.0)	(21.8)	(21.6)	(23.3)	(39.1)
Transferta private pa shpërblim	484.2	605.6	611.9	693.4	829.7	984.5
Transferta shtetërore pa shpërblim	104.6	31.4	40.7	53.2	60.7	61.4
Llogaria kapitale	84.8	131.9	127.4	138.7	106.2	99.2
Llogaria financiare	200.1	108.9	218.9	167.8	297.4	313.9
Investime direkte	156.6	230.7	141.4	157.4	267.4	212.6
Investime portofoli	(28.7)	(25.7)	(40.3)	(20.6)	4.6	(2.0)
Kapitale të tjera*	72.2	(96.1)	117.8	31.0	25.4	103.3
Gabime dhe harresa neto	22.3	152.1	118.8	128.1	106.5	156.0
Bilanci i përgjithshëm	147.0	161.4	30.6	89.3	233.7	124.8
Rezervat dhe zëra të lidhur me to						
Mjetet e rezervës	(147.0)	(161.4)	(30.6)	(89.3)	(233.7)	(124.8)
Përdorim huash e kredish nga FMN	19.5	13.6	5.5	10.0	9.6	9.4
Për t'u mbajtur në vëmendje						
Ndryshimi total në rezerva	(141.4)	(146.2)	(102.7)	(158.6)	(276.1)	(47.4)
nga të cilat: ndryshim nga kursi i këmbimit	(5.6)	(15.2)	72.1	69.3	42.4	(77.4)

* Nuk përfshihen përdorime huash e kredish nga FMN.

Burimi: Banka e Shqipërisë.

SHËNIME

¹ Në rastin e bilancit kursim investime, për të llogaritur kursimet e huaja është përdorur deficieti korent plus transfertat zyrtare.

² Të dhënat për PBB-në dhe rritjen reale të saj për vitet 1999-2000 janë të INSTAT-it. Për pjesën tjetër të dhënat janë vlerësime të Ministrisë së Financave, të FMN-së dhe të dhëna të Bankës së Shqipërisë.

³ Tabela është ndërtuar duke u bazuar në PBB-në nominale të rishikuar.

⁴ PBB nominale, e konvertuar me kursin mesatar të periudhës.

⁵ Borxhi qeveritar duke përfshirë borxhin e garantuar nga qeveria.

⁶ Për arsye të analizës, vëllimi i shitjeve në vlerë absolute me çmime korente, një informacion i ofruar nga INSTAT në bazë tremujore është zhveshur nga ndikimet inflacioniste, duke përdorur indeksin e çmimeve të konsumit. Për momentin, ky tregues përbën të vetmin indikator të disponueshëm dhe të besueshëm për të llogaritur efektet zhvlerësuese në ekonomi.

⁷ Shih Box.II.1 në lidhje me efektet negative të krizës energjitike sipas një pyetësoi të drejtuar bizneseve.

⁸ Humbjet duket se janë zëri që kanë përcaktuar dhe tendencën rritëse të përdorimit në total të energjisë elektrike, në periudhën shtator '05 – nëntor '05.

⁹ Ligji nr. 8269, datë 27.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë".

¹⁰ Indeksi i shitjeve të ekonomisë ka shënuar rritje të kënaqshme gjatë nëntë muajve të parë të vitit.

¹¹ Të dhënat e rritjes së pagave mbulojnë sektorin shtetëror, por shërbejnë si indikator edhe për pagat në sektorin privat.

¹² Mbiçmimi i kursit të këmbimit të lekut ndaj usd, monedhës në të cilën faturohen pjesa më e madhe e importeve të naftës, ndihmon në amortizimin e përcjelljes në vend të rritjes së çmimit të naftës në tregjet ndërkombëtare.

¹³ Me përjashtim të muajit qershor. Rritja e inflacionit të këtij grupi në muajin qershor erdhi si rrjedhojë e tkurrjes së përkohshme të ofertës, si pasojë e zëvendësimit të produkteve të serave me produkte të fushës.

¹⁴ Burimi: ISTAT; faqja e internetit <http://www.istat.it>

¹⁵ Burimi: Sekretariati i Përgjithshëm i Shërbimit Kombëtar të Statistikave të Greqisë; faqja e internetit: <http://www.statistics.gr>

¹⁶ Në çmimet e administruara janë përfshirë çmimet e energjisë, ujit, bukës, kujdesit shëndetsor, arsimit dhe komunikimit. Këto produkte përbëjnë 15.6 për qind të shportës së çmimeve të konsumit.

¹⁷ Burimi: INSTAT; Konjuktura Korrik – Shtator'05, Çmimet.

¹⁸ Inflacioni neto është llogaritur si diferencë e inflacionit total me inflacionin e çmimeve të administruara.

¹⁹ Grupi "Transport" zë një peshë prej 4.8 për qind, ndërsa nëngrupi që mat direkt ndryshimet e çmimeve të këtij produkti zë rreth 1.6 për qind.

²⁰ Të ardhurat dhe shpenzimet buxhetore u realizuan respektivisht në masën 97 për qind dhe 92 për qind ndaj planit vjetor, gjatë vitit 2005.

²¹ Importet rezultuan 3.6 herë më të larta sesa eksportet gjatë nëntëmuajorit të parë të vitit 2005.

²² Burimi: Sekretariati i Përgjithshëm i Shërbimit Kombëtar të Statistikave të Greqisë; faqja e internetit: <http://www.statistics.gr>

²³ Burimi: ISTAT; faqja e internetit <http://www.istat.it>

²⁴ Burimi: INSTAT, Indeksi i Çmimeve të Prodhimit.

²⁵ Burimi: INSTAT – këto indekse mund të përdoren për të marrë një vlerësim për ecurinë e kërkesës së brendshme.

²⁶ Pेशa e grupit “Transport” në shportën e mallrave të konsumit është 4.8 për qind. Pेशa e nëngrupit “Shërbimi ndaj mjeteve personale” ku bën pjesë dhe nafta përbën vetëm 1.6 për qind.

²⁷ Burimi: INSTAT, Konjuktura Korrik – Shtator 2005.

²⁸ Diferenca midis kursimeve të brendshme me investimet. Sipas identiteteve bazë makroekonomike, kjo diferencë reflekton ecurinë e deficitit të llogarisë korente.

²⁹ Të dhënat mbi kursimet dhe investimet i referohen vlerësimeve të publikuara nga FMN-ja në Albania, Basic Indicators and Macroeconomic Framework, 2001-2009, janar 2006.

³⁰ I llogaritur si raport i vëllimit tregtar në mallra dhe shërbime ndaj PBB-së.

³¹ Sipas klasifikimit SITC.



KAPITULLI III

ZHVILLIMET MONETARE
DHE TREGJET

KAPITULLI III. ZHVILLIMET MONETARE DHE TREGJET

III.1 PROGRAMI MONETAR DHE OBJEKTIVAT SASIORË

Zbatimi i politikës monetare të Bankës së Shqipërisë në funksion të ruajtjes së stabilitetit të çmimeve në ekonomi, parashikon monitorimin e treguesve monetarë dhe analizën e konsistencës së tyre në raport me objektivin e inflacionit. Në mbështetje të politikës monetare, Banka e Shqipërisë harton çdo vit një program monetar, i cili shërben si një skenar orientues i kushteve të dëshiruara monetare në ekonomi. Në përputhje me objektivin e normës së inflacionit prej 3 për qind, programi monetar përcakton kuadrin afatshkurtër të zhvillimeve monetare.

Bazuar në supozimet¹ e rritjes së kredisë për ekonominë dhe në pritjet e prurjeve të larta valutore, programi monetar i vitit 2005 parashikoi rritje vjetore të ofertës monetare prej 14.1 për qind. Në vlerë absolute, oferta monetare u parashikua të rritej me 70.9 miliardë lekë. Zgjerimi i ofertës monetare do të mbështeste rritjen e ekonomisë në intervalin 5-6 për qind dhe ruajtjen e inflacionit afër objektivit 3 për qind.

Zhvillimet monetare dhe ecuria e treguesve monetarë gjatë vitit 2005, kanë qenë në përputhje me synimin e politikës monetare për ruajtje të normës së inflacionit në periudhën afatmesme afër objektivit 3 për qind të inflacionit. Rritja e ofertës monetare në fund të vitit rezultoi 13.8 për qind. Ky ritëm i lartë reflektoi intensifikimin e thellimit financiar në vend dhe përsheptimin e kredisë për ekonominë. Gjithsesi, si pasojë e uljes së shpejtësisë së qarkullimit të parasë, rritja e ofertës monetare nuk përcolli në ekonomi presione të tepërta inflacioniste.

	Parashikimi	Aktuale
Rritja vjetore e faktorëve të kërkesës (në miliardë lekë)		
Kredia për ekonominë	47.0	52.6
Kërkesa e qeverisë	12.4	6.0
Mjetet Valutore Neto të Sistemit	22.6	21.9
Rritja vjetore e agregatëve të ofertës (në përqindje)		
M3	14.1	13.8
M2	8.2	8.4
M1	35.8	31.5
Baza Monetare	11.8	11.0
Pesha e komponentëve të ofertës në fund të vitit (në përqindje)		
Paraja jashtë bankave / M3	26.3	26.1
Depozitat në valutë / M3	25.9	25.6

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 1. Ecuria e treguesve kryesorë krahasuar me programin monetar.

Rritja, më e lartë se parashikimi, e kredisë për ekonominë është balancuar nga një huamarrje më e ulët e qeverisë nga sistemi bankar, gjatë vitit 2005.

Gjithashtu, rritja më e lartë e M3 kundrejt rritjes prej 8.4 për qind të agregatit M2, konfirmon kontributin pozitiv të prurjeve valutore në formën e depozitave në valutë në sistemin bankar. Këto depozita janë burimi kryesor i fondeve, i cili financon rritjen e kredisë në valutë për ekonominë. Kërkesa e ekonomisë për kredi në valutë gjatë vitit 2005, përbënte rreth 2/3 e kreditimit total të ekonomisë nga sistemi bankar. Krahasuar me një vit më parë, ky raport rezultoi më i ulët. Kreditimi në lekë i ekonomisë ka patur tendencë rritëse edhe gjatë vitit 2005. Ulja në terma relativë dhe absolutë e huamarrjes së qeverisë ka nxitur rritjen e kreditimit të ekonomisë në monedhën vendase.

Megjithë rritjen më të lartë se parashikimi të kredisë për ekonominë, rritja e bazës monetare është realizuar brenda parashikimit të programit monetar. Kjo ka mundësuar kontrollin e objektivave sasiorë të Bankës së Shqipërisë. Objektivat sasiorë gjatë gjashtëmujorit të parë, i cili përkoi me mbylljen e marrëveshjes trevjeçare PRGF me FMN, janë respektuar. Ndërkohë, gjashtëmujori i dytë i vitit 2005 nuk ka qenë i mbuluar me marrëveshje formale midis organizmave financiarë ndërkombëtarë dhe Shqipërisë. Megjithatë, Banka e Shqipërisë ka realizuar ruajtjen e këtyre treguesve brenda parametrave të qëndrueshëm me stabilitetin afatmesëm të nivelit të çmimeve.


Tabelë 2. Realizimi i objektivave sasiorë të Bankës së Shqipërisë.

	Mars'05	Qershor'05	Shtator'05	Dhjetor'05*
Rezervat Ndërkombëtare Neto (milionë dollarë)				
Objektivi	1,073	1,086.7	1,094.6	1,184
Aktuale	1,107	1,098.0	1,094.6	1,184
Diferenca	35	11.3	0.0	0
Mjetet e Brendshme Neto (miliardë lekë)				
Objektivi	61	60.0	65.7	82.0
Aktuale	53	63.6	65.7	82.0
Diferenca	-8	3.6	0.0	0
Kredia e Brendshme Neto për Qeverinë (miliardë lekë)				
Objektivi	292	297.7	302.7	306.7
Aktuale	288	294.4	301.6	306.7
Diferenca	-4	-3.2	-1.1	0

Burimi: Banka e Shqipërisë.

* Të dhëna operative.

Grafik 1. Ritmi i rritjes së ofertës monetare.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

III.2 ZHVILLIMET NË OFERTËN E PARASË

Zhvillimet monetare gjatë vitit 2005 kanë konsistuar në rritjen relativisht të lartë të M3, uljen e mëtejshme të shpejtësisë së qarkullimit të parasë dhe ndërmjetësimin më të lartë të sistemit bankar në ekonomi. Rritja vjetore e ofertës monetare² kulmoi në periudhën e verës, në sajë të kërkesës së lartë të ekonomisë për mjete monetare dhe kërkesës së lartë josezonale të qeverisë për financimin e deficitit buxhetor. Ndërkohë, ritmi i rritjes së kërkesës për mjete monetare pësoi rënie drejt tendencave historike në tremujorin e fundit të vitit.

Në tërësi, në gjysmën e dytë të vitit ritmet e larta të M3 kanë patur mbështetjen e hyrjeve valutore në sistemin bankar në formë depozitash. Kjo tendencë mbështetet nga ngadalësimi i dukshëm, në gjashtëmuajorin e dytë të vitit, i agregatit monetar M2, i cili nuk përfshin depozitat në valutë në sistemin bankar. Agregati likuid i parësë, M1 ka pësuar ritme të larta rritjeje vjetore në sajë të rritjes së depozitave pa afat në lekë pas riklasifikimit të një pjese të depozitave me afat në depozita pa afat.

	Normat e rritjes vjetore (në %)				Niveli 2005
	2002	2003	2004	2005	
Paraja jashtë bankave	9.8	-4.3	10.3	8.4	149.7
Depozitat totale	4.2	13.1	14.2	16.1	428.4
- Depozita në lekë	4.1	15.7	12.9	9.1	276.5
- Depozita në valutë	4.2	7.6	17.1	31.2	151.9
M1	6.8	-5.2	19.4	31.7	227.7
M2	6.4	7.6	12.0	8.9	426.2
M3	5.9	7.6	13.1	14.0	578.0
Baza monetare	7.7	-2.0	11.2	11.0	198.2

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 3. Ecuria e treguesve monetarë (në miliardë lekë).

III.2.1 ZHVILLIMET NË STRUKTURËN KOHORE TË M3


Struktura kohore e ofertës monetare në vitet e fundit, ka reflektuar pozitivisht kushtet monetare në ekonomi dhe stabilitetin makroekonomik në vend. Megjithë tendencën rënëse të interesave nominalë, normat reale të interesit në ekonomi kanë qëndruar në intervale pozitive, duke motivuar rritjen e peshës së depozitave ndaj ofertës monetare. Qëndrueshmëria e peshës së depozitave ka mundësuar rritjen e ndërmjetësimit të sistemit bankar në financimin e aktivitetit ekonomik. Kanalizimi i kursimeve nëpërmjet sistemit bankar nxit uljen e *spread*-it të përdorimit të fondeve nga sistemi dhe rrjedhimisht, uljen e kostos së procesit të ndërmjetësimit. Në kushtet e normave më të ulëta të interesit, efektet pozitive të rritjes së peshës së depozitave ndaj M3 në nxitjen e aktivitetit ekonomik janë të dyanshme.

- Paraja jashtë bankave

Qëndrueshmëria e raportit të parësë jashtë bankave ndaj agregatit M2, ka qenë faktor pozitiv në stabilitetin financiar të sistemit. Gjithsesi, në prani të rritjes së shpejtë të depozitave në valutë, raporti i parësë jashtë bankave ndaj ofertës monetare ka demonstruar tendenca rënëse gjatë vitit 2005.


Ecuria e raportit të parësë jashtë bankave ndaj ofertës monetare dhe ndaj agregatit M2 në periudhën afatmesme, tenton të ndjekë ritmet

Grafik 2. Raporti i depozitave në lekë ndaj M3 dhe interesi mesatar real (shkalla djathtas).




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 3. Raporti PjB/M3 dhe rritja vjetore e parasë jashtë bankave (shkalla djathtas).




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 4. Ecuria e depozitave në lekë.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 5. Struktura valutore e M3 dhe interesi real i depozitave në lekë (djathtas).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

e konsolidimit makroekonomik të ekonomisë shqiptare dhe ritmet e zhvillimit të sistemit financiar. Hapja e mëtejshme e ekonomisë ndaj konkurrencës së huaj dhe futja e produkteve të reja financiare, kontribuojnë pozitivisht në uljen e mëtejshme të raportit të parasë jashtë bankave ndaj agregatëve M2 dhe M3. Ruajtja e një tendence të tillë në të ardhmen, do të ketë efekte pozitive në zgjerimin e potencialit të rritjes ekonomike.

• Depozitat në lekë

Performanca e kërkesës agregate në ekonomi dhe qëndrueshmëria e normave të interesit, kanë rezultuar të mjaftueshme për të garantuar gjenerimin dhe qarkullimin e mjeteve monetare, që sigurojnë një rritje ekonomike në përputhje me potencialin prodhues. Në tërësi, sistemi financiar ka qenë në gjendje të ndërmjetëssojë me sukses kreditimin e ekonomisë gjatë vitit 2005, pa krijuar presione inflacioniste në kahun e kërkesës. Normat e larta të rritjes së depozitave në lekë në sistemin bankar kanë financuar, në pjesën më të madhe, kreditë në lekë për ekonominë, ndërkohë që financimi i borxhit të qeverisë ka devijuar vetëm 1/4 e totalit të rritjes së depozitave në lekë, prej rreth 23.2 miliardë lekë të gjeneruara gjatë vitit 2005. Rritja vjetore e depozitave në lekë, në fund të vitit 2005, rezultoi 9.1 për qind.

III.2.2 ZHVILLIMET NË STRUKTURËN VALUTORE

Depozitat në valutë kanë paraqitur zhvillime pozitive gjatë vitit 2005. Në fund të vitit ato përbënin 26.3 për qind të ofertës monetare, duke u rritur me 4.3 pikë përqindje krahasuar me vitin 2004. Në terma nominalë, depozitat në valutë kanë shfaqur përshejtim të ndjeshëm të rritjes vjetore, nga 17.1 për qind në vitin 2004, në 31.2 për qind në vitin 2005. Zhvlerësimi me 11 për qind i lekut ndaj dollarit ka balancuar vlerësimin e lehtë të tij ndaj euros, duke dhënë një rezultante pozitive për depozitat në valutë. Duke pastruar serinë nga efektet e lëvizjes së kursit në vite, në terma realë depozitat në valutë

kanë ruajtur të njëjtin ritëm vjetor rritjeje prej 27.3 për qind, sikurse edhe në vitin 2004.

Komponenti valutore i ofertës agregate, në vitin 2005 ka ndjekur trendin pozitiv të tij në përgjigje të ngushtimit të normave të interesit midis depozitave në lekë dhe atyre në valutë. Ngushtimi i *spread*-it ka ndjekur rritjen e normave të interesit në valutë në përgjigje të zhvillimeve ndërkombëtare. Gjithsesi edhe për vitin 2005, mendohet se burimi kryesor i rritjes së depozitave në valutë mbeten kursimet nga emigrantët dhe kanalizimi i tyre në sistemin bankar. Depozitat në valutë me afat kanë pasqyruar rritje të mëtejshme gjatë vitit 2005, duke përbërë 66 për qind të totalit të depozitave në valutë, krahasuar me 63 për qind në fund të vitit 2004.

në milionë lekë	Dhjetor 2005	Ndryshimi vjetor	
		absolut	përqindje
Para jashtë bankave	149.7	11.6	8.4
Depozitat totale	428.4	59.2	16.1
- depozita në lekë	276.5	23.2	9.1
- depozita në valutë	151.9	36.1	31.2
Depozita pa afat	129.4	51.9	66.9
- në lekë	78.0	43.3	124.6
- në valutë	51.4	8.6	20.1
Depozita me afat	298.9	7.4	2.5
- në lekë	198.5	-20.1	-9.2
- në valutë	100.4	27.5	37.7
M1	227.7	54.9	31.7
M2	426.2	34.7	8.9
M3	578.0	70.8	14.0
Baza monetare	198.2	19.7	11.0

Tabelë 4. Treguesit monetarë.


Burimi: Banka e Shqipërisë.

III.3 KËRKESA PËR MJETE MONETARE


Në kushtet e konsolidimit të politikave fiskale gjatë vitit 2005, vihet re zhvendosje e kërkesës për mjete monetare nga qeveria drejt ekonomisë. Për herë të parë në vitin 2005, kredia për ekonominë ka qenë nxitësi kryesor i kërkesës për para, duke kontribuar në 75 për qind të rritjes vjetore të ofertës monetare. Ndërkohë, kontributi prej 30.4 për qind i mjeteve valutore neto në rritjen vjetore të M3, ka qenë më i ulët se ai i shënuar në vitin 2004.

III.3.1 MJETET VALUTORE NETO

Pozicioni valutore i sistemit bankar nuk ka patur ndryshime të ndjeshme gjatë vitit 2005. Mjetet




Grafik 7. Ecuria e mjeteve valutore neto të sistemit bankar (në milionë dollarë).




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 8. Huamarrja e brendshme neto ndaj PBB-së (në përqindje).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 9. Ecuria kumulative e financimit të deficitit buxhetor (në miliardë lekë).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

valutore neto të sistemit bankar kanë mbetur në nivelin 2 miliardë usd, si pasojë e zhvillimeve të ekuilibruara në nivelet e mjeteve valutore të Bankës së Shqipërisë dhe të bankave tregtare. Ndërhryja e Bankës së Shqipërisë në tregun valutor dhe rritja e kredisë në valutë kanë qenë ndikuesit kryesorë në zhvillimet e këtyre mjeteve gjatë vitit 2005.

Rezerva valutore neto e Bankës së Shqipërisë ka arritur nivelin 1.3 miliardë usd në fund të vitit, duke shënuar një rritje vjetore prej 59 milionë usd. Tendenca në rritje e rezervës valutore neto u vu re gjatë pjesës së dytë të vitit, si rezultat i blerjeve valutore prej 126 milionë usd të Bankës së Shqipërisë. Duke shmangur efektin e kursit të këmbimit⁴, rritja reale e rezervës valutore neto të Bankës së Shqipërisë gjatë vitit është rreth 143 milionë usd.

Ecuria e mjeteve valutore neto të bankave të nivelit të dytë ka qenë më e luhatshme, duke reflektuar ecurinë relative të treguesve që ndikojnë këto mjete. Në përgjithësi, përshpejtimi i rritjes së kredisë në valutë gjatë vitit ka tejkalluar rritjen e hyrjes së depozitave në valutë në bankat tregtare, duke ulur dhe nivelin e mjeteve valutore neto. Në terma vjetorë këto mjete janë ulur me 63 milionë usd.

III.3.2 KËRKESA PËR PARA E QEVERISË

Rezultatet e procesit të konsolidimit fiskal janë bërë evidente gjatë vitit 2005. Ato janë shprehur në përmirësimin e bilancit fiskal dhe në reduktimin e kërkesës së qeverisë për financim të brendshëm. Deficiti buxhetor në vitin 2005 arriti në 3.8 për qind të PBB-së, ndërkohë që ky tregues ishte në nivelin 5.1 për qind në vitin 2004. Tendenca e viteve të mëparshme – përqendrimi i deficitit buxhetor në pjesën e dytë të vitit - ishte e pranishme edhe gjatë këtij viti, madje me tone më të theksuara. Rritja mujore e deficitit në muajin dhjetor ishte rreth 9 miliardë lekë ose 44 për qind e deficitit total.

Deficiti buxhetor është mbuluar pothuajse tërësisht nga financimi i brendshëm - sistemi

bankar dhe publiku. Në fund të vitit, niveli i financimit të brendshëm në total shënoi rreth 20.6 miliardë lekë. Banka e Shqipërisë ka qenë e pranishme gjatë muajve korrik dhe shtator në financimin e deficitit, me qëllim shmangien e luhatjeve të normave të interesit në tregun ndërbankar dhe në atë të bonove të thesarit.

Obligacionet qeveritare dy dhe tre – vjeçare kanë përbërë burimin kryesor të financimit të deficitit buxhetor. Gjatë vitit 2005, qeveria ka shitur 18.6 miliardë lekë obligacione qeveritare dyvjeçare. Obligacionet qeveritare me maturim trevjeçar, të shitura në total rreth 6 miliardë lekë, u emetuan për herë të parë gjatë këtij viti. Niveli i bonove të thesarit të emetuara u ul me rreth 4 miliardë lekë gjatë vitit 2005. Portofoli i bonove të thesarit të bankave të nivelit të dytë u ul me rreth 21.9 miliardë lekë. Në të kundërt, individët dhe Banka e Shqipërisë kanë rritur përkatësisht portofolet e tyre të bonove të thesarit me 12.2 dhe 3.1 miliardë lekë. Portofoli i bonove të thesarit të institucioneve është rritur lehtësisht, me rreth 0.1 miliardë lekë. Pjesëmarrja aktive e individëve në blerjen e bonove të thesarit dëshmon për një dukuri pozitive, si në zgjerimin e tregut të bonove të thesarit, ashtu dhe në diversifikimin e portofolit të bonove të thesarit përsa i përket mbajtësve të tyre.

Boks III.1. Aspekte të pavarësisë së Bankës së Shqipërisë.

"...Nëse qeverisë i duhen para, ajo duhet t'i sigurojë ato në rrugën e saj legjitime; duke taksuar popullin; duke emetuar apo shitur letra me vlerë ose duke marrë kredi nga bankat tregtare në vend; por në asnjë rast nuk duhet të lejohet që qeveria të marrë borxh nga ata që e kanë fuqinë të emetojnë para."

David Rikardo (1824)*

Megjithëse Rikardo tërhoqi vëmendjen mbi këtë çështje rreth 180 vjet më parë, vetëm në dhjetëvjeçarët e fundit bankat qendrore kanë mundur t'i thonë "Jo" financimit të deficiteve buxhetore. Gjithmonë ka ekzistuar një konflikt midis pavarësisë së një banke qendrore dhe financimit prej saj të deficitit buxhetor, një konflikt i cili shpesh është zgjidhur në kurriz të inflacionit. Studimet tregojnë që vendet me banka qendrore (ligjërisht) më të pavarura tentojnë të kenë norma inflacioni më të ulëta. Literatura ekonomike njeh disa përmasa të pavarësisë së një banke qendrore:


1. Pavarësi institucionale – që nënkupton pavarësi në përmbushjen e detyrimeve dhe të përgjegjësisë të parashikuara në ligjin e bankës qendrore.
2. Pavarësi operacionale - që nënkupton pavarësi në caktimin e objektivit të inflacionit dhe instrumenteve për të përmbushur objektivin.
3. Pavarësi personale - që nënkupton mënjanimin e presioneve politike mbi zgjedhjen apo heqjen e anëtarëve të bordit drejtues të një banke qendrore.
4. Pavarësi financiare - që nënkupton ndalimin e çdo lloji financimi të drejtpërdrejtë të sektorit publik dhe të përfaqësuesve të tij.

Duke filluar nga krijimi i saj në vitin 1992, Banka e Shqipërisë ka patur një pavarësi ligjore relativisht të kënaqshme. Ndërsa tre përmasat e para të pavarësisë përmbushen nga ligji ekzistues i Bankës së Shqipërisë, përmasa e katërt, ajo e pavarësisë financiare, nuk është ende në nivelet e duhura. Ligji nr. 8269, datë 23.12.1997 (Për Bankën e Shqipërisë) e lejon financimin direkt të qeverisë nga Banka e Shqipërisë. Shuma e huasë apo e kredisë që Banka e Shqipërisë mund t'i japë qeverisë gjatë vitit bazohet në disa kushte të përcaktuara në ligj. Sipas këtij ligji, pjesa e padisbursuar e huasë

nuk duhet të kalojë vlerën 5 për qind të mesatares së të ardhurave normale të buxhetit të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, gjatë tre viteve financiarë paraardhës. Parë në kontekstin e kohës së hartimit të ligjit, parashikimi i një hapësire të tillë ligjore bazohej në idenë se niveli i zhvillimit të ekonomive në tranzicion, siç është Shqipëria, nuk krijon siguri për mbulimin e shpenzimeve të nevojshme buxhetore me të ardhurat buxhetore.

Realiteti financiar ka evoluar me shpejtësi gjatë viteve të fundit. Akordimi i kredisë për qeverinë nga Banka e Shqipërisë në vite, ka qenë në nivele të ulëta dhe me tendencë rënëse.

Grafik 1, boks 1. Kontributi i Bankës së Shqipërisë në financimin e deficitit buxhetor (në përqindje).



Prej kohësh Banka e Shqipërisë është duke vlerësuar heqjen e mundësisë së financimit të qeverisë, si një parakusht për zbatimin më me efektivitet të politikës monetare. Ky hap është në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian, madje një kërkesë ligjore e procesit të integritit. Për më tepër, ky hap është në linjë me kërkesat për adoptimin e regjimit të inflacionit të shënjestruar, një regjim që Banka e Shqipërisë synon të adoptojë në periudhën afatmesme.

Banka e Shqipërisë mendon se heqja e mundësisë së financimit të drejtpërdrejtë duhet të jetë një proces gradual, pasi ajo është e vetëdijshme mbi vështirësitë që mund të hasë qeveria nga mungesa e menjëhershme e kësaj forme financimi. Ky proces do të lehtësohej nga përmirësimi i parashikimit afatshkurtër të likuiditetit të qeverisë, duke mbledhur informacion nga bankat tregtare ose nga degët e thesarit në kohën e duhur. Gjithashtu, eksperiencia botërore ofron zgjidhje të pranueshme edhe në rastin e nevojave të paparashikuara për likuiditet. Banka e

Shqipërisë gjykon se puna e përbashkët me Ministrinë e Financave në këtë drejtim, do të krijojë kushtet e duhura për heqjen graduale dhe pa pasoja të financimit direkt të qeverisë.

* "Plan for establishment of a national bank", David Ricardo, 1824.

III.3.3 KREDIA PËR EKONOMINË

Kreditimi i ekonomisë ka shënuar një përshpejtim të dukshëm gjatë vitit 2005. Portofoli i kredisë së sistemit bankar u rrit me 74.3 për qind ose 52 miliardë lekë në vlerë absolute, gjatë kësaj periudhe. Ritmi i rritjes së kredisë gjatë vitit 2005 ishte dy herë më i lartë se ai i regjistruar në vitin paraardhës. Kjo rritje e shpejtë ka ndikuar edhe në përmirësimin e treguesve të ndërmjetësimit të sistemit bankar. Kështu, në fund të vitit 2005, teprica e kredisë për ekonominë përbënte 25 për qind të totalit të aktiveve të sistemit bankar. Gjithashtu, në fund të vitit 2005, teprica e kredisë për ekonominë shënoi vlerën 14.6 për qind të PBB-së, duke shënuar një rritje vjetore prej 6.2 pikësh përqindjeje. Ambienti i qëndrueshëm makroekonomik dhe financiar ka krijuar kushte të përshtatshme për zgjerimin e kreditimit. Gjithashtu, ai ka ndikuar edhe në zgjatjen e horizontit kohor të kreditimit, duke i shërbyer më

mirë nevojave të ekonomisë dhe duke ndikuar në përshejtimin e rritjes së kredisë. Përveç këtyre faktorëve, boom-i në kredihënien është ndikuar edhe nga rritja e konkurrencës në sistemin bankar, nga forcimi i marrëdhënieve bankë-klient dhe nga shfrytëzimi i hapësirave të pambuluara të tregut, nëpërmjet prezantimit të instrumenteve të reja të kredisë.

Tabelë 5. Ecuria e disa treguesve kryesorë.

	2002	2003	2004	2005			
				T1	T2	T3	T4
Oferta e parasë (në miliardë lekë)	416.7	448.4	507.2	521.6	541.8	566.2	578.0
Kredi e brendshme (në % ndaj M3)	70.8	71.5	68.9	68.7	69.9	69.1	70.0
- kredi për qeverinë (në % ndaj M3)	61.5	60.2	55.1	53.4	52.2	50.3	48.9
- kredi për ekonominë (në % ndaj M3)	9.3	11.3	13.8	15.3	17.7	18.7	21.1
Kredi për ekonominë (% ndaj totalit të aktiveve)	11.5	13.7	16.9	17.9	20.8	22.2	25.1
Kredi për ekonominë (në % ndaj PBB)	5.7	6.8	8.4	9.5	11.5	12.7	14.6
Depozita gjithsej (në % ndaj PBB)	42.2	43.4	44.1	46.9	48.5	50.7	51.2
Raporti kredi/depozita (në %)	13.5	15.7	19.0	20.3	23.6	25.0	28.5

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Kredia e re e akorduar gjatë vitit 2005 ishte rreth 120 miliardë lekë ose rreth 20 për qind më e lartë se gjatë vitit 2004. Ndërkohë, struktura kohore e kësaj kredie ka patur një zhvendosje të dukshme drejt maturiteteve afatmesme dhe afatgjata, pesha e të cilave ndaj kredisë së re në total është rritur me 13.5 pikë përqindjeje gjatë vitit 2005.

	2002	2003	2004	T1-05	T2-05	T3-05	T4-05	2005
Kredi e re (në mld lekë)	62.6	92.6	99.7	22.1	32.8	32.1	32.9	119.9
Kredi afatshkurtër	44.7	63.1	62.3	53.2	47	47.4	48.7	48.8
Kredi afatmesme	13.0	22.2	22.5	22.4	31	30.3	25.6	27.7
Kredi afatgjatë	4.8	7.4	14.9	24.4	22	22.2	25.7	23.5
Lekë	20.8	30.8	32.5	30.1	32.8	30.2	31.4	31.2
Valutë	41.8	61.8	67.2	70	67.2	69.8	68.6	68.8

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 6. Ecuria e kredisë së re në vite (në përqindje).

Rritja e kredihënies në terma afatgjatë ka ndikuar në zhvendosjen e strukturës së portofolit të kredisë drejt maturiteteve afatgjata. Pesha e kredisë me maturitet mbi 5 vjet ka njohur rritje të vazhdueshme gjatë vitit 2005, ndërkohë që pesha e kredisë afatshkurtër ndaj totalit ka shënuar rënie. Gjithsesi, krahasuar me vitet e mëparshme, vihet re një spostim i kredive nga maturiteti 1-5 vjet drejt investimeve afatgjata mbi 5 vjet. Një fakt i tillë merr shtysë dhe nga angazhimi në rritje i bankave për pasuri të paluajtshme si dhe për financimin e projekteve afatgjata të bizneseve.

Shpërndarja e kredisë, në kredi për individë dhe në kredi për biznese, nuk ka patur ndryshime të ndjeshme gjatë vitit 2005. Kredia për individët në fund të vitit përbënte 31.6 për qind të totalit të kredisë, duke shënuar një rritje të lehtë prej 1 pike përqindjeje ndaj vitit 2004. Tregu i kredive për individët ka patur një zhvillim të shpejtë gjatë dy viteve të fundit. Bankat janë duke treguar një interesim në rritje për të, duke u nisur nga fakti se ai ka qenë një segment relativisht i pazhvilluar, i cili ofron norma të larta interesi. Kredia për bizneset


zë rreth 69 për qind të totalit. Kjo kredi regjistroi një rritje vjetore prej 74 për qind gjatë vitit 2005. Në ndryshim nga viti i kaluar, kreditimi i korporatave ka marrë shtysë edhe nga orientimi i bankave për të kredituar bizneset në monedhën vendase.

Tabelë 7. Ecuria e treguesve të tepricës së kredisë (në përqindje).

	2002	2003	2004	T-1 '05	T-2 '05	T-3 '05	T-4 '05
Teprica e kredisë (në mld lekë)	38.7	50.7	69.3	79.0	95.9	106.0	121.9
Kredi afatshkurtër	53.8	46.0	34.0	34.1	33.7	31.6	32.8
Kredi afatmesme	30.1	33.3	36.0	34.5	33.1	31.2	30.3
Kredi afatgjatë	16.1	20.7	30.0	31.4	33.1	36.9	37.0
Kredi për individët	24.3	24.5	30.6	31.0	30.8	31.4	31.6
Kredi për sektorin privat	75.7	75.5	69.4	69.0	69.2	68.6	68.4
Lekë	21.3	19.6	19.5	20.1	22.9	23.7	25.5
Valutë	73.7	80.4	80.5	79.9	77.1	76.3	74.5

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 10. Ecuria e kreditimit të sektorëve kryesorë të ekonomisë në miliardë lekë.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Viti 2005 u karakterizua nga një rritje e shpejtë e kredisë në lekë, rritja vjetore e së cilës shënoi vlerën 127 për qind. Në ndryshim nga viti 2004, në vitin 2005 vihet re një angazhim i bankave për të kredituar në lekë jo vetëm individët, por edhe bizneset. Stabiliteti në kursin e këmbimit dhe ulja e diferencave të normave të interesit për kredinë në valutë kundrejt asaj në lekë, mendohet të kenë nxitur interesin e bizneseve për të marrë kredi në lekë.

Ndërkohë, ritmi i rritjes vjetore të kredisë në valutë ishte pothuaj dy herë më i ulët se ai i kredisë në lekë. Për rrjedhojë, pesha e kredisë në valutë ndaj totalit të kredisë u zvogëlua me 6 pikë përqindjeje gjatë vitit 2005. Megjithatë, me 74.5 për qind të totalit, kredia në valutë vazhdon

të zërë peshën kryesore në kredidhënie.

Shpërndarja sektoriale e kredisë për vitin 2005, dëshmon rritje të interesimit të bankave për sektorin e pasurive të paluajtshme, për sektorin e ndërtimit dhe më të moderuar për bujqësinë. Pesha e secilit sektor ndaj totalit ka njohur përkatësisht rritje me 4.4, 3.2 dhe 1.2 pikë përqindje krahasuar me një vit më parë.

Ndërkohë që sektori i tregtisë vazhdon të mbetet sektori më i kredituar i ekonomisë, me 18.9 për qind të totalit të kredive nga 23.3 për qind që zinte në vitin 2004.

Tabelë 8. Teprica e kredisë sipas degëve të ekonomisë (në përqindje).

	2002	2003	2004	T-1 '05	T-2 '05	T-3 '05	T-4 '05
1 Bujqësia, gjuetia dhe sivikultura	0.8	1	1.5	1.5	1.5	2.4	2.7
2 Peshkimi	0.2	0	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1
3 Industria nxjerrëse	0.2	1	0.3	0.7	0.6	0.5	0.5
4 Industria përpunuese	17.0	17	17.1	16.7	15.6	13.9	13.8
5 Prodhimi, shpërndarja energji elektrike, gaz dhe ujë	3.3	3	2.8	2.3	2.9	2.9	2.6
6 Ndërtimi	8.6	10	9.8	11.2	11.2	12.8	13.0
7 Tregtia, riparimi i automobilitave dhe artikujve shtëpiakë	40.4	34	23.3	20.6	19.1	20.0	18.9
8 Hotele dhe restorante	6.0	6	8.3	5.2	4.7	4.4	4.3
9 Transporti dhe telekomunikacioni	2.4	1	2.0	1.8	1.7	1.7	1.48
10 Aktivitete financiare	-	0	0.2	1.0	1.1	0.7	0.8
11 Pasuri të patundshme	9.1	13	9.8	14.7	13.5	13.9	14.2
12 Shëndeti dhe veprimtaritë sociale	0.5	0	0.5	0.8	0.4	0.6	0.6
13 Shërbime kolektive, sociale dhe personale	4.2	8	4.8	6.5	7.4	5.9	5.8
14 Kredi konsumatore						3.3	4.5
15 Të tjera	7.3	4	19.3	16.7	20.2	16.9	16.7
Totali	100	100	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Boks III.2. Implikimet e ekspansionit të kredisë në rastin e Shqipërisë.

Një literaturë e gjerë studimesh teorike dhe empirike thekson lidhjen pozitive që ekziston midis zhvillimit financiar dhe rritjes ekonomike. Sektori financiar luan një rol thelbësor në shpërndarjen e kursimeve në drejtim të bizneseve, duke rritur eficiencën ekonomike dhe duke lehtësuar akumulimin e kapitalit. Gjithashtu, mundësia për të përfutur kredi bankare i lejon individëve të rrisin mirëqenien e tyre, duke përshtatur nivelin aktual të konsumit me fluksin afatgjatë të të ardhurave të tyre. Në këtë kontekst, rritja e shpejtë e kredisë gjatë vitit 2005, paraqet një zhvillim pozitiv për ekonominë shqiptare. Thellimi i ndërmjetësimit financiar është një proces, nga i cili pritet të përfitojë e gjithë ekonomia.

Megjithatë si çdo variabël tjetër, rritja e kredisë ka implikime për treguesit e tjerë ekonomikë dhe për vetë stabilitetin makroekonomik dhe financiar. Duke qenë një ndër faktorët kryesorë që ndikojnë investimet dhe konsumin, rritja e shpejtë e kredisë shkakton rritje në kërkesën agregate, e cila mund të çojë në prishjen e ekuilibrave makroekonomikë. Në vitin 2005, megjithë ritmet e përsheptuara të kredisë, impakti i rritjes së saj në çënimin e ekuilibrave ekonomikë dhe financiarë ka qenë i moderuar.

Në aspektin makroekonomik, kjo konsideratë mbështetet në argumentet e mëposhtme:

- Ekspansioni i shpejtë i dukshëm i kredisë, mbart në të vërtetë një efekt më të vogël në ekonominë reale seç sugjerojnë shifrat. Kjo, sepse një pjesë e kredisë të dhënë nëpërmjet sistemit bankar ka zëvendësuar tregun jozyrtar* të kredisë.
- Megjithë rritjen e shpejtë të kredisë, Shqipëria mbetet vendi me treguesit më të ulët relativë të kredisë ndër vendet e rajonit. Po kështu, bankat në Shqipëri ndërmjetësojnë vetëm 28.5 për qind të depozitave për përmbushjen e nevojave të ekonomisë, duke përbërë vendin me nivelin më të ulët në rajonin e Ballkanit. Baza e ulët nga e cila nis procesi i kreditimit në Shqipëri, tregon se ekonomia shqiptare ka hapësira për një ekspansion më të shpejtë të kreditimit.

Tabelë 1, boks 2. Ecuria e treguesve kryesorë të kredisë në vendet e rajonit.

	Depozita / PBB	Norma vjetore e rritjes	Kredia / PBB	Norma vjetore e rritjes	Norma reale e interesit të kredisë
Bullgari	42.4	30.9	42.3	35.3	-
Rumani	25.4	30.6	19.7	50.7	17.8
Maqedoni	34.6	22.8	25.2	21.8	12.1
Shqipëri	51.2	16.1	14.6	74.3	11.3
Serbi & Mali i Zi	21.1	46.6	23.5	52.6	13.9
Mesatare e rajonit	34.9	29.4	25.1	46.9	13.8

Burimi: Buletini i ekonomive të Evropës Juglindore dhe mesdhetare me tregje financiare në zhvillim, vëllimi 6, botim i BKG-së.

- Nga ana tjetër, rritja e kredisë ka shkuar në pjesën më të madhe (rreth 2/3) për zgjerimin e aktivitetit të biznesit, ndërkohë që kredia konsumatore mbetet në nivele relativisht të ulëta.
- Gjithashtu, përshejtimi i kredisë nga sistemi bankar është balancuar disi nga ndjekja e një politike fiskale të kujdesshme. Kërkesa e qeverisë për mjete monetare ka qenë e ulët gjatë vitit 2005, duke lënë hapësirë për një ekspansion më të shpejtë të kredisë për ekonominë.

Ekspansioni i kredisë krahas implikimeve makroekonomike shoqërohet dhe me rritjen e mundësisë së moskthimit të saj, duke ndikuar në performancën financiare të bankave. Në përgjithësi, me rritjen e portofolit të kredive bankat ekspozohen më shumë ndaj rrezikut të kredisë. Rreziku i moskthimit të kredive bëhet më real në kushte e një tregu kredie jo shumë të zhvilluar, i cili ka mjaft probleme infrastrukturore si: probleme të zbatimit të ligjeve, në veçanti për detyrimin e përmbushjes së kontratave të huave; probleme me hipotekën; probleme me regjistrimin e pasurive të paluajtshme; ekzistenca e tregut joformal të kredisë; mungesa e Zyrës së Informacionit të Kredisë etj.. Në këto kushte, ekspansioni i kredisë bën të domosdoshëm forcimin e sistemit rregullator e mbikëqyrës të sistemit bankar dhe ndjekjen e kujdesshme të treguesve që do të sinjalizonin në kohë problemet në sistem.

Së fundi, edhe pse Banka e Shqipërisë mbështet rritjen e kredive në kontekstin e zhvillimeve ekonomike, ajo nuk është e gatshme të kompromentojë perspektivën afatgjatë të rritjes së ekonomisë në interes të zhvillimit afatshkurtër. Për këtë, ajo do të monitorojë vazhdimisht performancën e kredive, për të parë në kohë shfaqjen e efekteve të sipërpërmendura, duke rezervuar të drejtën e përdorimit të instrumenteve të saj për shmangien e tyre.

* Për më tepër shiko vrojtimin mbi "Aktivitetin depozitues dhe kreditues të bankave të nivelit të dytë, për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2005" nga Banka e Shqipërisë, shkurt 2006.

III.4 ECURIA E KURSIT TË KËMBIMIT GJATË VITIT 2005

Për një periudhë trevjeçare leku ka ruajtur tendenca mbiçmuese ndaj valutave kryesore. Në fund të vitit 2005 ai gjendet i mbiçmuar mesatarisht me rreth 23 për qind kundrejt usd dhe 11 për qind kundrejt euros, krahasuar me tre vjet më parë. Mbiçmimi i lekut në mënyrë të vazhdueshme, më së shumti ka reflektuar ecurinë pozitive të bilancit të pagesave, sidomos hyrjet e konsiderueshme valutore nëpërmjet transferatve private. Për më tepër, ky mbiçmim është dhe shprehje e

diferencave të normave të interesave lek – valutë në favor të lekut. Gjithashtu, të dhënat ekonomike sugjerojnë si faktor të mundshëm që ndikon në mbiçmimin e lekut dhe efektin e përmirësimit të produktivitetit të sektorit të mallrave të tregtueshëm (efekti Balassa Samuelson⁶), karakteristikë kjo e vendeve në zhvillim.


Tendenca mbiçmuese e lekut është zbehur gjatë vitit 2005. Kundrejt një viti më parë, leku është nënçmuar mesatarisht me 9.25 për qind ndaj usd dhe është mbiçmuar mesatarisht me 3.32 për qind ndaj euros. Ndjekja e një politike monetare lehtësuese nga Banka e Shqipërisë deri në mars të vitit 2005, solli ngushtimin e diferencës së normave të interesave lek-valutë, duke zbehur mbështetjen e këtij faktori në mbiçmimin e lekut. Megjithatë, edhe pse normat e interesit kanë qenë në rënie të vazhdueshme, normat e ulëta të inflacionit kanë ndihmuar në mbajtjen lart të normave reale në lekë. Në terma nominalë efektivë, në fund të vitit 2005 leku është nënçmuar me 0.8 për qind kundrejt një viti më parë.

Karakteristikë e këtij viti në sjelljen e kursit të këmbimit ka qenë efekti i zbehur sezonal i muajve të verës në mbiçmimin e lekut. Periudha e verës është karakterizuar nga një ofertë e lartë e valutës së huaj, por dhe nga një kërkesë e lartë për të, si rezultat i rritjes së aktivitetit turistik të shqiptarëve jashtë Shqipërisë. Nga ana tjetër, jeta ekonomike e vendit është zhvilluar nën një atmosferë pasigurie, si rezultat i zgjedhjeve të përgjithshme parlamentare, duke plogështuar zhvillimet në kursin e këmbimit.

Banka e Shqipërisë ka qenë relativisht aktive në tregun valutor gjatë pjesës së dytë të vitit, duke blerë valutë të huaj me qëllim plotësimin e nivelit të objektivit për Rezervën Ndërkombëtare Neto. Në periudhën shtator – dhjetor 2005, Banka e Shqipërisë ka blerë rreth 126 milionë usd nga bankat e nivelit të dytë. Kjo ndërhyrje ka ndikuar në mbajtjen në nivele relativisht të qëndrueshme të kursit të këmbimit për pjesën e dytë të vitit. Gjatë procesit të ndërhyrjes valutorë, Banka e Shqipërisë i ka kushtuar një rëndësi të veçantë komunikimit me agjentët e tregut valutor mbi synimet e ndërhyrjes. Ky komunikim ka ndihmuar ndjeshëm në realizimin e ndërhyrjeve, pa shkaktuar luhatshmëri të tepërt në kursin e këmbimit.


Ecuria e kurseve të këmbimit në tregun ndërkombëtar ka ndikuar kryesisht sjelljen e kursit të lekut ndaj dollarit. Gjatë vitit 2005, forcimi i dollarit me

Grafik 11. Ndryshimet vjetore të NEER⁷ (+/mbyçmim).




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 12. Diferenca e normave të interesave reale lekë - valutë.




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 13. Ecuria e kursit të këmbimit të lekut.




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 14. Vëllimi ditor në tregun ndërbankar (në milionë lekë).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 15. Ecuria e normave të interesit në tregje, në përqindje.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

rreth 12 për qind kundrejt euros në tregun ndërkombëtar, u reflektua në një forcim të dollarit kundrejt lekut me 11.8 për qind. Këmbimi i lekut ndaj euros ndikohet më së shumti nga faktorë të brendshëm, duke qenë se euro është valuta kryesore e tregtisë me jashtë dhe zë një pjesë të konsiderueshme në transaksionet e brendshme në tregun vendas.

III.5 TREGJET FINANCIARE DHE NORMAT E INTERESIT

Aktiviteti në tregun financiar dhe normat e interesit pësuan luhatje të konsiderueshme, gjatë vitit 2005. Rritja e depozitave në sistemin bankar dhe ulja e kërkesës së qeverisë për mjete monetare në gjysmën e parë të vitit, bënë që sistemi bankar të krijonte teprica likuiditeti (mesatarisht 7.4 miliardë lekë). Duke lëvizur sipas tendencës së tyre gjatë dy viteve të fundit, normat e interesit të pranimit të depozitave në lekë arritën nivelet me të ulëta historike. Kjo situatë u përmbys në tremujorin e tretë. Si rezultat i ngadalësimit të rritjes së depozitave në lekë, rritjes përtej pritjeve të kreditimit në monedhën vendase dhe rritjes së huamarrjes së qeverisë, sistemi bankar kaloi në mungesë likuiditeti gjatë kësaj periudhe. Mungesa e likuiditetit solli rritjen e aktivitetit huadhënës në tregun ndërbankar dhe rritjen e normave të interesit në të.

Në këtë kohë, normat e huadhënies në tregun ndërbankar u ndikuan dhe nga ndryshimi i interesave të lehtësive njëditore të Bankës së Shqipërisë, i cili synonte ngushtimin e korridorit të këtyre lehtësive. Mungesa e likuiditetit u ndje më tepër në tregun primar, ku kërkesa e qeverisë për financim në disa raste mbeti e paplotësuar, ndërsa *yield*-i i bonove të thesarit u rrit ndjeshëm, nga 6.77 për qind në muajin qershor në 9.14 për qind në muajin shtator për afatin dymbëdhjetëmuor.

Mungesa e likuiditetit vazhdoi për një periudhë katërjavore (gusht-shtator 2005). Ndërhyrja e Bankës së Shqipërisë me operacione strukturore, duke injektuar në mënyrë të vazhdueshme 3.5 miliardë lekë, si dhe rritja e depozitimit në

sistemin bankar dhe në bonot e thesarit, stimuluar nga rritja e diferencës midis normave të interesit në këto tregje, risolli tepricën e likuiditetit në sistemin bankar gjatë tremujorit të katërt. Në fund të vitit, *yield*-et e bonove të thesarit u rikthyen pranë vlerave të mesvitit, ndërsa diferenca e tyre me interesat e depozitave në lekë është më e ulëta në tre vitet e fundit.

- Tregu ndërbankar

Aktiviteti i tregut ndërbankar gjatë vitit 2005 ka shënuar vëllimin më të lartë të arritur ndonjëherë. Niveli mesatar ditor i huadhënies njëjavore arriti në vlerën 0.71 miliardë lekë nga 0.25 miliardë lekë në vitin 2004; ndërsa niveli mesatar ditor i huadhënies njëditore ishte rreth 0.30 miliardë më tepër se në vitin paraardhës, rreth 0.70 miliardë lekë. Ky vit shënoi dhe rastin e parë të përdorimit të transaksioneve dyjavore. Zhvillimi i mëtejshëm i tregut ndërbankar gjatë vitit 2005, evidentohet edhe nga fakti që përdorimi i njëkohshëm i lehtësive të Bankës së Shqipërisë është kufizuar vetëm në 10 raste gjatë vitit 2005, raste që gjithësesi kanë qenë në shumica të vogla.


Lëvizja e interesave të tregut ndërbankar të parasë ka qenë në përputhje me lehtësimin e politikës monetare në muajin mars 2005 dhe me ngushtimin e korridorit të lehtësive njëditore në muajin korrik 2005. Në fund të muajit maj 2005, interesat për transaksionet njëditore, arritën nivelet e veta më të ulëta historike, 2.37 për qind. Nga ana tjetër, ato janë luhatur vazhdimisht në varësi të raportit kërkesë-ofertë në treg. Me rritjen e kërkesës për likuiditet dhe vendosjen e një korridori të ri, interesat për transaksionet njëditore u rritën deri në 5.83 për qind (në muajin shtator) duke iu afruar interesave për transaksionet shtatëditore. Vendosja e korridorit të ri ka bërë që normat e interesit në tregun ndërbankar të luhaten rreth normës bazë të interesit. Në fund të vitit, interesi për transaksionet njëditore dhe shtatëditore shënon 4.13 për qind dhe 5.43 për qind, përkatësisht.

Interesi mesatar i marrëveshjeve njëjavore gjatë vitit 2005 rezultoi 5.31 për qind krahasuar me 6.15 për qind në vitin 2004, ndërsa interesi mesatar i marrëveshjeve njëditore u rrit në nivelin 3.64 për qind, në krahasim me 3.44 për qind në vitin 2004.


- Tregu primar i bonove të thesarit

Tregu primar i bonove të thesarit mbetet mjete kryesor i investimit të likuiditetit të sistemit bankar, megjithë uljen e emetimeve të qeverisë të këtyre letrave me vlerë. Ky treg u karakterizua nga një nivel i qëndrueshëm i likuiditetit në pjesën e parë të vitit, duke bërë që kërkesa e qeverisë për financim të plotësohej në të gjitha rastet. Në fakt, raporti i likuiditetit të ofruar për blerjen e bonove të thesarit ndaj shumës së shpallur për emetim në këtë periudhë, llogaritet 1.4:1. Rritja e konkurrencës

Grafik 16. Normat ditore të interesit në tregun ndërbankar dhe të lehtësive të Bankës së Shqipërisë.



për investimin në bonot e thesarit solli uljen e vazhdueshme të *yield*-eve të këtyre letrave me vlerë. Në fund të muajit qershor, niveli i *yield*-eve sipas afateve tre, gjashtë dhe dymbëdhjetë mujore ishte 5.05 për qind, 6.42 për qind dhe 6.77 për qind respektivisht, duke u ulur me 0.96, 0.78 dhe 1.33 pikë përqindjeje në krahasim me nivelin në fund të vitit 2004.



Mungesa e likuiditetit në sistemin bankar në tremujorin e tretë ndikoi në uljen e financimit të qeverisë nga sistemi bankar si dhe ushtroi presion për rritjen e *yield*-eve të bonove të thesarit. Në disa raste, likuiditeti i ofruar në ankand nuk plotësonte nevojat për financim, ndërkohë që pati raste kur disa nga ofertat u përjashtuan për shkak të *yield*-it tepër të lartë. Ndërhryjet e Bankës së Shqipërisë për stabilizimin e gjendjes së likuiditetit dhe frenimin e rritjes së mëtejshme të *yield*-eve rezultuan të suksesshme. Në fund të vitit, niveli respektiv i *yield*-eve u ul në 5.35 për qind për afatin tremujor dhe 6.91 për qind, për afatin gjashtë dhe dymbëdhjetë mujor.

- Tregu primar i obligacioneve

Krahas obligacioneve dyvjeçare, gjatë vitit 2005, për herë të parë u emetuan obligacione trevjeçare. Ky treg filloi të funksionojë në muajin prill dhe ankandet për këto letra me vlerë organizohen çdo tre muaj. Investimi në letra me vlerë afatgjata nga sistemi bankar është rritur, krahasuar me një vit më parë. Në fund të vitit 2005, borxhi me maturim dy dhe tre - vjeçar përbënte 17.0 për qind të portofolit total të letrave të borxhit të qeverisë, në krahasim me 6.1 për qind, në fund të vitit 2004. Paralelisht, pesha e bonove të thesarit në portofolin e letrave me vlerë është ulur me 11 pikë përqindjeje.

Sikurse në tregjet e tjera, tendenca e *yield*-it të obligacioneve, fillimisht ishte rënëse madje deri në nivelet më të ulëta historike në muajin maj 2005⁸, ku *yield*-i i obligacioneve dyvjeçare arriti në 7.55 për qind, nga 9.00 për qind në fund të vitit 2004. Pas rritjes të përkohshme të *yield*-it në tremujorin e tretë, në fund të vitit 2005, ai zbriti në nivelin 8.00 për qind, ndërsa *yield*-i i obligacioneve trevjeçare qëndron në nivelin 8.50 për qind (janar 2006), nga 8.30 për qind që ishte në emetimin e parë të tij.

- Normat e interesit të depozitave dhe kredive

Në gjysmën e parë të vitit 2005, në kushtet e një politike lehtësuese, bankat tregtare vazhduan tendencën rënëse të interesave të depozitave në lekë, të nisur që në vitin 2003. Në muajin qershor 2005, interesat e depozitave në lekë, arritën nivelet më të ulëta në 13 vitet e fundit. Kjo situatë u korrigjua shpejt në muajin korrik, duke qenë se bankat u përballën me ngadalësimin e fluksit të depozitave në lekë. Kjo solli më pas kthimin drejt stabilitetit, i

cili u reflektua fillimisht në interesat e depozitave afatshkurtra (1, 3 dhe 6 - mujore), ndërkohë që pritet një reagim i mëvonshëm edhe në interesat afatgjatë. Një veçori tjetër e vitit 2005 ka qenë shtrirja e depozitave në afate më të gjata se dy vjet, duke u bërë kështu një mbështetje për zhvillimin e tregut të kredive me afat të gjatë dhe të tregut të obligacioneve qeveritare.


Tregu i kredive në lekë, ndikohet ndjeshëm nga faktorë të rrezikut e të ndryshimit të strukturës së kredidhënies nga njeri muaj në tjetrin, duke u karakterizuar nga luhajtje të normave interesit dhe reagim më i vonuar ndaj sinjaleve të politikës monetare. Megjithatë, gjatë vitit 2005 niveli mesatar i ponderuar i interesave të kredive në lekë, ka ndjekur pak a shumë, tendencën e tregjeve të tjera. Luhajtjet e normave të interesit për të gjitha afatet, janë bërë në kufij më të ngushtë sesa në dy vitet e kaluara, gjë që tregon për rritjen e stabilitetit dhe të konkurrencës në këtë treg.

Në tregun e depozitave në valutë, janë vënë re tendenca të forta rritjeje të interesave gjatë gjithë vitit, sidomos në ato të monedhës amerikane për afate të gjata. Këto prirje, janë ndikuar nga politika monetare shtrënguese e ndjekur nga Rezerva Federale, e cila ka rritur normën bazë të interesit 8 herë me nga 25 pikë përqindjeje gjatë vitit 2005; prishmëritë për rritjen e normës bazë të interesit nga Banka Qendrore Evropiane (gjë e cila reflektohet më shumë në rritjen e interesave afatgjatë); rritja pas dy vitesh e gjysmë e normës bazë të interesit nga Banka Qendrore Evropiane me 25 pikë për qind; rritja e shpejtë e interesave libor dhe euribor në tregjet ndërkombëtare; rritja e konkurrencës në tregun e depozitave në valutë etj..

Tendencat në kahe të kundërta, sidomos në gjysmën e parë të vitit 2005, të interesave të depozitave me afat në lekë me ato në valutë, kanë çuar në ngushtimin e ndjeshëm të *spread*-it midis këtyre normave të interesit në nivele mjaft të ulëta.


Në muajin qershor 2005, *spread*-i i interesave realë të depozitave me afat 12 - mujor lekë-

Grafik 18. Interesat mesatarë të ponderuar të kredisë në lekë.




Burimi: Banka e Shqipërisë dhe bankat e nivelit të dytë.

Grafik 19. Normat e interesit të depozitave në valutë.



Burimi: Banka e Shqipërisë dhe bankat e nivelit të dytë.

Grafik 20. *Spread*-i midis interesave reale të depozitave në lekë me ato në valutë.



Burimi: Banka e Shqipërisë dhe bankat e nivelit të dytë.

valutë rezultoi në nivele të ulëta rekord të 13 viteve të fundit (-1.22 pikë përqindjeje *spread*-i lekë-usd dhe -1.63 për qind *spread*-i lekë-euro).

Tregu i kredive në valutë edhe gjatë vitit 2005, është karakterizuar nga luhatjet e normave të interesit. Në muajin dhjetor 2005, në nivel mesatar të ponderuar, interesat e kredive në dollarë arritën në 8.47 për qind nga 7.79 për qind që ishin një vit më parë, ndërsa interesat e kredive në euro arritën në 7.95 për qind nga 8.17 për qind që ishin një vit më parë. Në ecurinë e interesave të kredive në valutë ka ndikuar, rritja e interesave të depozitave në valutë, rritja e interesave libor dhe euribor në tregjet ndërkombëtare, ndryshimi i strukturës së kredidhënies nga njeri muaj në tjetrin, rritja e konkurrencës si rezultat edhe i pjesëmarrjes së Bankës Raiffeisen në këtë treg, shkalla e rrezikut të kredidhënies, sipas llojit të kredisë, afatit të saj apo garancisë që ofron kredimarrësi, akordimi në disa raste i kredive me interesa më të ulët për klientë preferencialë, politikat që ndjekin bankat për kredidhënien në valutë etj..

III.6 INSTRUMENTET E POLITIKËS MONETARE

III.6.1 MARRËVESHJET E RIBLERJES (REPO) DHE MARRËVESHJET E ANASJELLTA TË RIBLERJES (R/REPO)

Marrëveshja e riblerjes me maturim njëjavor me çmim fiks është instrumenti kryesor i përdorur gjatë gjysmës së parë të vitit 2005. Niveli mesatar javor i likuiditetit të tërhequr gjatë kësaj periudhe ishte 6.35 miliardë lekë. Për të strukturuar nivelin e lartë të likuiditetit, në fillim të vitit Banka e Shqipërisë, krahas ankandit të marrëveshjeve të riblerjes me maturim njëjavor organizoi edhe ankandin e marrëveshjes së riblerjes me maturim njëmuajor, me shumën e përcaktuar 1.5 miliardë lekë.

Rënia e likuiditetit gjatë tremujorit të tretë të vitit 2005, bëri të nevojshëm injektimin e likuiditetit nga Banka e Shqipërisë. Instrumenti i përdorur ishte marrëveshja e anasjelltë e riblerjes me maturim javor me çmim fiks. Niveli mesatar javor i likuiditetit të injektuar gjatë periudhës gusht-shtator, ishte 2.4 miliardë lekë. Për të stimuluar konkurrencën në tregun primar, me qëllim zbutjen e presioneve ndaj interesave të bonove të thesarit, Banka e Shqipërisë vazhdoi organizimin e operacioneve injektuese, deri në gjysmën e dytë të muajit tetor pavarësisht gjendjes me tepricë të likuiditetit në sistemin bankar.

Instrumenti i përdorur gjatë kësaj periudhe ishte marrëveshja e anasjelltë e riblerjes me maturim njëjavor me shumë të shpallur, instrument i cili gjatë kësaj periudhe nuk pati interes përdorimi nga sistemi bankar. Me kthimin e likuiditetit në sistemin bankar dhe zbutjen e presioneve mbi interesat e tregut primar, Banka e Shqipërisë ndryshoi kahun e ndërhyrjes duke tërhequr likuiditet me marrëveshje javore në nivelin 1.97 miliardë lekë deri në fund të vitit 2005.

III.6.2 TRANSAKSIONET E SHITBLERJEVE ME TË DREJTA TË PLOTA (OUTRIGHTS)

Për të ulur presionet dhe për të shmangur spekulimet me interesat e tregut primar gjatë periudhës së mungesës së likuiditetit, në muajin shtator u kryen dy transaksione blerjeje me të drejta të plota, me vlerë nominale total 3.5 miliardë lekë. Këto ndërhyrje rikthyen gjendjen e tepricës në sistemin bankar dhe shërbyen në frenimin e rritjes së *yield*-eve të tregut primar.

III.6.3 DEPOZITA NJËDITORE

Për investimin e likuiditeteve të lira, bankat e nivelit të dytë përdorën instrumentin e depozitës njëditore pranë Bankës së Shqipërisë. Në këtë instrument u investuan mesatarisht 0.76 miliardë lekë në ditë ose 0.08 miliardë lekë më pak se në vitin 2004. Vëllimin më të lartë të përdorimit, ky instrument e pati gjatë dy javëve të para të muajit tetor, periudhë gjatë të cilës Banka e Shqipërisë ndërhyri me marrëveshje të anasjelltë riblerjeje në kushtet e tepricës së likuiditetit të sistemit bankar.

III.6.4 KREDIA NJËDITORE DHE KREDIA LOMBARD


Funksionimi më i mirë i tregut ndërbankar gjatë vitit 2005, bëri që të kufizohej përdorimi i kredisë njëditore, megjithë mungesën e likuiditetit gjatë tremujorit të tretë të vitit. Injektimi i likuiditetit nëpërmjet këtij instrumenti ishte mesatarisht 0.02 miliardë lekë në ditë, në krahasim me 0.16 miliardë lekë që ishte niveli respektiv gjatë vitit 2004. Ndërsa instrumenti i fundit kreditues i Bankës së Shqipërisë, kredia lombard, nuk pati asnjë rast përdorimi gjatë vitit 2005.

III.6.5 REZERVA E DETYRUAR

Edhe gjatë vitit 2005 vazhdoi përdorimi i instrumentit të rezervës së detyruar për të tërhequr likuiditetin e sistemit bankar. Rritja e nivelit të rezervës së detyruar në lekë, reflektoi rritjen në kategoritë respektive që përfshihen në llogaritjen e rezervës së detyruar. Përjashtim bëri muaji gusht, ku si rezultat i uljes së normave të interesit të depozitave me afat në një nga bankat e sistemit, pati tërheqje të depozitave, çka u rikuperua shpejt nga pjesa tjetër e sistemit bankar në muajt në vazhdim. Norma e remunerimit për rezervën e detyruar në lekë, në muajin mars reflektoi uljen e normës bazë të interesit të Bankës së Shqipërisë, duke mbetur konstante në nëntëmuajorin tjetër të vitit. Në fund të vitit, kjo normë ishte 3.50 për qind në krahasim me vlerën respektive prej 4.05 për qind që ishte një vit më parë.


Bankat kanë përdorur mesatarisht rreth 11 për qind të nivelit maksimal të lejuar (20 për qind) të përdorimit të rezervës së detyruar për plotësimin e

Grafik 21. Ecuria e rezervës së detyruar në lekë e sistemit bankar dhe norma e remunerimit.



Burimi: Banka e Shqipërisë dhe bankat e nivelit të dytë.

Grafik 22. Ecuria e rezervës së detyruar në valutë e sistemit bankar dhe norma e remunerimit.



Burimi: Banka e Shqipërisë dhe bankat e nivelit të dytë.

nevojave ditore për likuiditet. Në krahasim me një vit më parë është vënë re një ulje e përdorimit të kësaj lehtësie. Kjo sepse gjatë vitit 2005 pati një tendencë për të mbajtur gjendje të lartë të rezervave të lira nga një numër i kufizuar i bankave të sistemit. Niveli i gjendjes së llogarisë është mirëadministruar nga bankat e sistemit, duke kufizuar në minimum rastet e mosplotësimit të rezervës.

Rritja e konsiderueshme e rezervës së detyruar në euro tregoi një rritje të preferencës së depozitorëve për këtë monedhë, ndërkohë që rezerva e detyruar në dollarë mbeti pothuajse konstante gjatë gjithë vitit. Interesi i remunerimit të rezervës së detyruar në valutë, reflektoi rritjen e normave të liborit dhe euriborit. Rritjen më të lartë e pati norma libor, e cila në krahasim me fundvitin 2004 është rritur me 2.02 pikë përqindjeje, në nivelin 3.17 për qind, ndërsa norma e euriborit është rritur me 0.21 pikë përqindjeje në nivelin 1.67 për qind.

III.7 ADMINISTRIMI I REZERVËS VALUTORE

Banka e Shqipërisë është përfshirë në Programin Këshillues për Administrimin e Rezervave (RAMP) të ngritur nga Banka Botërore, me synim dhënien e asistencës së nevojshme në fushën e administrimit të rezervave valutore. Marrëveshja, në kuadër të së cilës do të realizohet dhënia e asistencës, presupozon kalimin e shumës 100 milionë dollarë nën administrimin e Bankës

Botërore (IBRD). Kjo marrëveshje, e firmosur nga Guvernatori në muajin shtator, do të synojë ngritjen profesionale të stafit të Bankës së Shqipërisë, të angazhuar në çdo hallkë të procesit të administrimit të rezervës valutore. Ky program, që parashikohet të zgjasë për një periudhë trevjeçare, do të mundësojë dhënien e një eksperience mjaft të vyer, që pritet të realizohet përmes një bashkëpunimi të ngushtë me ekspertët e Bankës Botërore.

- Ndryshime në bazën rregullative

Në muajin maj, pas rishikimit të përvitshëm, u miratua nga Këshilli Mbikëqyrës rregullorja e re “Mbi politikën e administrimit të rezervës valutore”. Në këtë rregullore u pasqyrua përveç të tjerash dhe rikompozimi (ndryshim i përqindjes që zë çdo monedhë) i rezervës valutore nga këndvështrimi i monedhave në përbërje të portofolit, duke reflektuar më mirë orientimin

e ekonomisë shqiptare drejt vendeve të Eurozonës. Aktualisht, monedha e përbashkët evropiane (euro) zë një peshë më të madhe në rezervën valutore, krahasuar me dollarin amerikan (usd).

- Statistika

Gjatë këtij viti rezerva valutore bruto është rritur vetëm 50.87 milionë dollarë, duke regjistruar në fund të muajit dhjetor vlerën 1,425.05 milionë usd. Ndër faktorët që kanë ndikuar pozitivisht në rritjen e rezervës bruto përmendim:

- hyrje nga lëvrimi i huave të dhëna nga Fondi Monetar Ndërkombëtar, Agjencia Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA) etj., në masën 61.3 milionë dollarë;
- veprimet e blerjes së valutës nga bankat e nivelit të dytë, nga Ministria e Financave dhe institucione të tjera në shumën 136 milionë dollarë;
- 8.5 milionë usd (Ministria e Financave),
- 125.7 milionë usd (sistemi bankar),
- 1.8 milionë usd (institucione të tjera);
- derdhje nga bankat e nivelit të dytë pranë Bankës së Shqipërisë për plotësimin e rezervës së detyruar apo dhe veprime të tjera që lidhen me kapitalin e tyre, 54.9 milionë dollarë.

Ndërkohë, të ardhurat e siguruara nga investimi i rezervës valutore deri në fund të muajit dhjetor, llogariten në rreth 36.3 milionë dollarë. Lulatjet në kursin e këmbimit të monedhave në përbërje të rezervës valutore kanë ndikuar ndjeshëm vlerën e rezervës bruto, duke regjistruar një efekt negativ gjatë vitit 2005, rreth 100 milionë dollarë.

Daljet nga rezerva valutore gjatë kësaj periudhe arrijnë në 135 milionë dollarë dhe përfaqësohen nga transfertat e kryera me urdhër të Ministrisë së Financave, të bankave të nivelit të dytë (në total rreth 74.5 milionë dollarë) si dhe nga kryerja e pagesave të borxhit të jashtëm për Qeverinë Shqiptare (51.4 milionë usd) apo shlyerja e detyrimeve të Bankës së Shqipërisë ndaj FMN-së (9 milionë usd).

SHËNIME

¹ Programi Monetar i Bankës së Shqipërisë rishikohet çdo gjashtëmuor, me qëllim përfshirjen e fenomeneve të ndryshme që ndikojnë në tendencat e treguesve monetarë dhe analizimin e tyre në perspektivën e inflacionit. Në këtë analizë janë mbajtur në konsideratë vlerat më të përditësuara të programit monetar për vitin 2005.

² Shprehjet ofertë monetare dhe paraaja e gjerë përdoren si terma sinonimë të termit teknik, agregati M3.

³ Interesi mesatar real është llogaritur si mesatare rrëshqitëse dymbëdhjetëmuore e interesit real.

⁴ Gjatë një viti euro është nënçmuar me 13.2 për qind kundrejt usd, duke ulur vlerën e investimeve në euro të shprehura në usd.

⁵ Për vitin 2004 niveli më i ulët i huamarrjes së brendshme i detyrohet financimit të deficitit buxhetor me anë të të ardhurave nga privatizimi i Bankës së Kursimeve.

⁶ Për një diskutim të mëtejshëm shih: "A është tepër i ulët inflacioni në Shqipëri? Themelet makroekonomike dhe zhvillimi ekonomik – shoqëror" Jan-Peter Olters, Konferenca V e Bankës së Shqipërisë, Durrës 2005.

⁷ NEER – kursi nominal efektiv i këmbimit i llogaritur kundrejt dy monedhave, sipas një peshe të përafërt që zënë në tregtinë me jashtë, euro (80 për qind) dhe usd (20 për qind).

⁸ Tendenca rënëse e *yield*-it të bonove të thesarit dhe e *yield*-it të obligacioneve qeveritare dyvjeçare, ka ndikuar në uljen e kostos së borxhit të brendshëm të qeverisë.



KAPITULLI IV

MBIKËQYRJA BANKARE



KAPITULLI IV. MBIKËQYRJA BANKARE

IV.1 LICENCIMI

Viti 2005 pati si karakteristikë vazhdimin e zhvillimit dinamik të sistemit bankar në Shqipëri. Kjo dinamikë, në kuptim të licencimit të bankave dhe institucioneve të tjera financiare jobanka, reflektohet në aplikime të reja për licencë bankare, në shitje dhe ndryshime të strukturës së aksionerëve të bankave si dhe në një zgjerim të fuqishëm të rrjetit të bankave ekzistuese, në zona të ndryshme të vendit. Në shkurt të vitit që shkoi u dha një miratim paraprak për licencë për një bankë dhe në fund të dhjetorit kësaj banke, iu dha licenca përfundimtare për të kryer aktivitet bankar në Republikën e Shqipërisë. Me licencimin e Bankës Union shkon në tre numri i bankave me kapital tërësisht shqiptar dhe në 17 numri total i bankave.

Në qershor të vitit 2005 u dha miratimi për ndryshimin e pronësisë së bankës Dardania. Gjatë vitit që shkoi u aplikua për marrjen e licencës për një bankë tjetër, e cila do të transformohet nga degë e një banke të huaj në filial të asaj banke.

Gjatë vitit 2005 shtrirja dhe zgjerimi i rrjetit të bankave me degë dhe agjenci njohu një zhvillim edhe më të madh se një vit më parë. Gjatë vitit u dha pëlqimi për hapjen e 48 degëve dhe agjencive të reja në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Nr.	Bankat	Nr. i degëve	Nr. i agjencive
1	Banka Raiffeisen	14	83
2	Banka Kombëtare Tregtare	20	5
3	Banka e Bashkuar e Shqipërisë	3	
4	Banka Italo Shqiptare		5
5	Banka Italiane e Zhvillimit (ish Dardania)	1	
6	Banka Tirana	25	2
7	Dega e Bankës Kombëtare të Greqisë		4
8	Banka Ndërkombëtare Tregtare	4	
9	Dega e Bankës Alfa	8	1
10	Banka Amerikane e Shqipërisë	5	7
11	Banka ProCredit	16	
12	Dega e Bankës së Parë të Investimeve		2
13	Banka Emporiki	2	1
14	Banka e Kreditit të Shqipërisë		1
15	Banka Credins	7	2
16	Banka Popullore	22	
	Totali	127	113

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 1. Treguesit e shtrirjes së rrjetit të bankave në fund të vitit 2005.

Gjatë vitit 2005 aktiviteti licencues njohu zhvillime dinamike. Shkurtimisht, këto zhvillime mund të përmbliidhen si më poshtë:

- Në fillim të vitit 2005 iu dha miratimi paraprak për licencë Bankës Union sh.a, një shoqëri me kapital vendas për fillimin e aktivitetit bankar. Licenca përfundimtare iu dha kësaj banke nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, në dhjetor të vitit 2005.
- Po në vitin 2005 Banka e Parë e Investimeve – Bullgari, një subjekt me kapital të huaj, paraqiti kërkesën për të marrë licencën për të ushtruar veprimtari bankare për Bankën e Parë të Investimeve - Shqipëri. Dhënia e miratimit paraprak për licencë u bë në janar 2006 dhe licenca përfundimtare pritet të jepet gjatë vitit 2006. Ky aplikim ka një veçori që lidhet me transformimin nga degë në filial të Bankës së Parë të Investimeve – Bullgari.
- Një zhvillim të spikatur pati sistemi bankar shqiptar në vitin 2005 në drejtim të zgjerimit të rrjetit të tij brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. Në vitin 2005 u hapën 48 degë dhe agjenci të reja me një shtrirje në të gjithë Shqipërinë, ku peshën më të madhe e zë rrethi i Tiranës. 23 degët dhe agjencitë e reja të hapura në Tiranë janë të shtrira në të gjithë territorin e saj duke mbuluar me shërbime bankare edhe zonat periferike dhe gjithashtu, zonat ku janë përqëndruar aktivitetet e biznesit të prodhimit, të tregtisë dhe të shërbimit.
- Në qershor të vitit 2005 u miratua shitja e 100 për qind të aksioneve të kapitalit të bankës Dardania tek një individ dhe një bankë me origjinë përkatësisht italiane.
- Është rritur interesi i kapitalit të huaj, për të investuar në sistemin bankar në Shqipëri. Kështu, pas përfundimit të procesit të ndryshimit të pronësisë të ish-bankës Dardania (aktualisht, Banka Italiane e Zhvillimit), ka përparuar ndjeshëm procesi i shitjes së aksioneve të Shtetit Shqiptar në Bankën Italo-Shqiptare. Njëkohësisht, po përgatitet aplikimi për ndryshimin e pronësisë të aksioneve të kapitalit të Bankës Kombëtare Tregtare. Këto ndryshime pritet të miratohen në vitin 2006.
- Gjatë vitit 2005 nuk ka patur aplikime të bankave për rritjen e nivelit të kapitalit që lidhet me rritjen e veprimtarive të lejuara financiare.
- Në vitin 2005 u dha miratimi për ndryshimin e emrit të bankës Dardania në Banka Italiane e Zhvillimit.
- Në vitin 2005 në Bankën e Shqipërisë u paraqiten 6 kërkesa për licencim të zyrave të këmbimit valutor dhe u dha licenca për këto zyra, si edhe iu revokua licenca 2 zyrave të tjera, të cilat kishin ndërprerë aktivitetin.
- Gjatë vitit 2005 u licencuan 3 shoqëri të reja të kursim-kreditit dhe iu revokua licenca 7 shoqërive të tjera. Shoqëritë e kursim-kreditit, të cilave iu është revokuar licenca, janë bashkuar mbi bazën e 3 shoqërive ekzistuese të kursim- kreditit.

Në fund të vitit 2005, pas ndryshimeve të ndodhura, lista e subjekteve të licencuara nga Banka e Shqipërisë sipas viteve paraqitet si më poshtë:

Nr.	Subjektet	2000	2001	2002	2003	2004	2005
1	Banka dhe degë të bankave të huaja	13	13	14	15	16	17
2	Subjekte financiare jobanka	2	4	5	7	7	7
3	Zyra të këmbimit valutor	19	38	58	58	54	58
4	Shoqëri të kursim-kreditit			113	131	130	131
5	Unione të shoqërive të kursim-kreditit			2	2	2	2

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 2. Lista e subjekteve të licencuara nga Banka e Shqipërisë.

IV.2 ECURIA E SISTEMIT BANKAR

Sistemi bankar gjatë vitit 2005 u shfaq me zhvillime pozitive. Gjendja financiare e tij vlerësohet e mirë, me një ecuri në nivele shumë të mira të treguesve të rentabilitetit; mjaftueshmëri kapitali mbi nivelin minimal të përcaktuar nga Banka e Shqipërisë dhe me një tendencë në rënie; rritje e thellësisë së ndërmjetësimit bankar si shprehje e rritjes së raportit të portofolit të huave ndaj totalit të aktiveve dhe rritje e totalit të aktiveve në tërësi; zgjerim në vazhdimësi i rrjetit të bankave dhe futja e bankave të reja në treg; shtim i produkteve të reja bankare dhe rritje e përdorimit të tyre si shprehje e rritjes së vëllimit të aktivitetit bankar në tërësi si edhe një situatë likuiditeti e kënaqshme, ku Banka e Shqipërisë ka luajtur një rol aktiv në ofrimin e instrumenteve lehtësuese për mundësimin e administrimit të likuiditetit të sistemit bankar.

Sistemi bankar raporton një rezultat neto pozitiv për vitin 2005, rreth 6.6 miliardë lekë apo 29.2 për qind më të lartë se një vit më parë. Në raport me PBB-në, shifra në fjalë zë peshën prej 0.79 për qind ndaj 0.66 për qind që përlllogaritej për vitin 2004.

	Dhjetor '03	Dhjetor '04	Dhjetor '05
Rezultati neto	4.45	5.11	6.60

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 3. Rezultati neto (në miliardë lekë).

Të ardhurat nga aktivitetet kryesore, të cilat pasqyrohen në të ardhurat neto nga interesi rezultojnë 40.7 për qind më shumë se një vit më parë, duke reflektuar orientimin e aktivitetit të sistemit bankar në aktive me më tepër rrezik si edhe rritjen e vëllimit të aktiveve në tërësi. E ardhura neto nga interesat përbën rreth 84 për qind të të ardhurave bruto të sistemit bankar¹, nga rreth 80 për qind një vit më parë, shprehje e qëndrueshmërisë së të ardhurave neto në tërësi. Treguesit kryesorë të rentabilitetit, RoAA dhe RoAE kanë patur një ecuri të mirë gjatë vitit 2005.

	Dhjetor '03	Dhjetor '04	Dhjetor '05
RoAA	1.24	1.28	1.40
RoAE	19.5	21.10	22.24

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 4. Treguesit e rentabilitetit (në përqindje).

Sistemi bankar pasqyron një trend në rritje të rentabilitetit, i cili ka pësuar një zhvillim dukshëm pozitiv, veçanërisht gjatë vitit 2005. Treguesi i RoAA paraqet një rritje më të shpejtë sesa treguesi i RoAE, çka tregon se ritmi i rritjes së të ardhurave neto ka qenë më i madh ndaj aktiveve mesatare sesa kapitalit aksioner mesatar të sistemit bankar. Gjithashtu, rritja e RoAA konfirmon përmirësimin cilësor të rentabilitetit të sistemit bankar ndërsa shihet se pavarësisht nga niveli i lartë i kthimit nga kapitali aksioner, nuk evidentohet shpërndarja e fitimeve nga aksionerët. Përkundrazi, të ardhurat kanë shërbyer si një mbështetje e mirë e bankave për të kryer biznes nëpërmjet injektimit të tyre në kapital.

Gjatë vitit 2005, sistemi bankar ka shënuar tendenca pozitive në drejtim të shpërndarjes më të mirë të burimeve financiare dhe për rrjedhojë, edhe të aktiveve ndërmjet bankave. Pavarësisht zhvillimeve pozitive, bankat më të mëdha (të agreguara në grupin 3), vazhdojnë të mbizotërojnë tregun bankar. Pësha e totalit të aktivitetit për këto banka ndaj totalit të aktiveve të sistemit prej 72.5 për qind, tregon qëndrueshmëri të veprimtarisë së tyre. Gjithsesi, tendenca në rënie e kontributit të grupit G3 në rritjen e sistemit flet për reduktim të përqendrimit të aktivitetit bankar.

Tabelë 5. Indeksi H (Herfindahl) i përqendrimit të aktiveve dhe depozitave.

	2000	2001	2002	2003	2004	2005
Indeksi H (aktivet)	0.44	0.37	0.32	0.30	0.27	0.21
Indeksi H (pasivet)	0.50	0.43	0.37	0.35	0.31	0.24

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Gjatë vitit 2005, aktivet e sistemit bankar shënuan rritje me 70.1 miliardë lekë (ose 16.4 për qind), rreth 17.3 miliardë lekë më e lartë se rritja e aktiveve e evidentuar në vitin 2004. Përrjashtimisht bankave të mëdha, në zgjerimin e bilancit të sistemit kontribuan dhe disa nga bankat e mesme e të vogla.

Tabelë 6. Totali i aktiveve (ecuria në vite), miliardë lekë

	Dhjetor '99	Dhjetor '00	Dhjetor '01	Dhjetor '02	Dhjetor '03	Dhjetor '04	Dhjetor '05
Totali i aktiveve	249.5	270.8	318.5	339.3	373.6	426.4	496.6
Në % ndaj PBB	49.2	50.2	53.5	51.6	50.2 ²	51.9	59.3

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Gjatë vitit 2005, teprica e kredisë së sistemit bankar shënoi rritje me 57.6 miliardë lekë⁴ ose 82 për qind, nga 19.3 miliardë lekë për vitin e mëparshëm. Ritmi i lartë rritës flet për shtrirjen e konsiderueshme të sistemit bankar në kredihënie, ngjarje kjo e parashikuar në momentin e privatizimit të ish - Bankës së Kursimeve nga Raiffeisen Bank(RZB). Pavarësisht se RZB evidenton në fund të vitit 2005 një portofol huaje relativisht të vogël ndaj totalit të aktiveve, është kjo bankë e cila ka dhe kontributin më të madh në rritjen e portofolit të huave, me rreth 28 për qind. Edhe bankat e tjera, megjithëse nuk dominojnë tregun bankar, kanë shfaqur ecuri të mirë në lidhje me aktivitetin kreditues.

Treguesi “kredi me probleme / tepicës së kredisë (neto)”, i cili mat madhësinë neto të ekspozimit ndaj rrezikut të kredisë shënon nivele të ulëta, madje me një tendencë në rënie përgjatë periudhave⁵.

Së fundi, aftësia e sistemit bankar për të mbuluar me kapital humbjet e rrjedhura nga kreditë⁶ evidentohet e përmirësuar, rrjedhojë e ritmit më të lartë rritës të kapitalit rregullator (+34.7 për qind), kundrejt rritjes së tepicës neto të kredisë me probleme⁷ (+23 për qind). Madhësitë relativisht jomateriale të raporteve të mësipërme flasin për ekspozim të kufizuar të sistemit bankar ndaj rrezikut të kredisë.

Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit⁸ për sistemin bankar në fund të vitit shënon nivelin 19 për qind ose rreth 3 pikë përqindjeje më të ulët se në fundvitin 2004. Bankat kanë respektuar nivelin minimal të mjaftueshmërisë së kapitalit prej 12 për qind, ndërsa evidentohen disa banka të cilat gjatë vitit 2005 kanë patur nivele të këtij treguesi shumë afër nivelit minimal. Rënia e treguesit të rëndësishëm të mjaftueshmërisë së kapitalit përbën një trend të konsoliduar gjatë gjithë vitit 2005, në vijim dhe në përputhje me trendin rënës edhe për vitet e mëparshme. Ndikimin kryesor në rënie e niveleve të treguesit e jep rritja me ritme shumë më të larta e aktiveve të klasifikuara sipas rrezikut, rreth 57 për qind ndaj nivelit të kapitalit rregullator prej rreth 35 për qind.


Një vështrim në mjaftueshmërinë e kapitalit sipas grupbankave të sistemit dallon të njëjtin pozicionim të treguesit si dhe në fundvitin 2004. G1 ruan nivelin më të lartë të treguesit të mjaftueshmërisë 35 për qind, G2 shënon nivelin 19 për qind dhe G3 njeh nivelin më të ulët 14 për qind. Tendencë në rënie e treguesit është më e evidente në grupin e bankave të vogla, disa prej të cilave kanë tentuar në një zgjerim të shpejtë të rrjetit bankar apo rritjen e shpejtë në aktivitete me rrezik të lartë.

	Sistemi bankar	G1	G2	G3
Dhjetor 2005	18.6	35.0	19.4	14.4
Dhjetor 2004	21.6	47.3	17.8	17.3
Dhjetor 2003	28.5	72.0	21.4	23.0

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Likuiditeti i sistemit bankar ka qenë i kënaqshëm edhe për vitin 2005. Bankat kanë qenë më aktive në tregun ndërbankar për të plotësuar nevojat e tyre operacionale, ndërsa Banka e Shqipërisë ka qenë prezente në treg për thithjen e likuiditeteve të tepërta apo injektimin e likuiditetit. Gjithashtu, treguesit kryesorë të sistemit për likuiditetin prezantojnë nivele të cilat nuk kanë cënuar situatën e likuiditetit, ndërsa politika monetare e Bankës së Shqipërisë për të mbajtur norma reale interesi në lekë dhe një normë inflacioni nën

Grafik 1. Peshat e grupbankave në sistem sipas totalit të aktiveve⁹.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 7. Mjaftueshmëria e kapitalit, në përqindje.

kontroll, si edhe rritja e normave të interesit për monedhat e huaja kryesore, veçanërisht usd, kanë kontribuar jo vetëm në qëndrueshmërinë e depozitave, por edhe në rritjen e tyre në sistem.

IV.3 INSPEKTIMET NË VEND

Edhe gjatë vitit 2005, Banka e Shqipërisë bazuar në përgjegjësitë ligjore si autoriteti mbikëqyrës i bankave dhe i subjekteve të tjera si institucione financiare jobanka, shoqërive të kursim-kreditit dhe zyrave të këmbimit valutor që kryejnë veprimtari financiare të licencuara prej saj, nëpërmjet mbikëqyrjes nga jashtë dhe inspektimeve në vend është përpjekur të sigurojë një veprimtari të shëndoshë bankare, duke ruajtur stabilitetin e sistemit bankar dhe duke forcuar besimin e publikut tek sistemi bankar.

Në vitin 2005 procesi mbikëqyrës ka pësuar përmirësime të vazhdueshme duke u orientuar sipas rrezikut të institucioneve të veçanta. Kështu, vëmendje e veçantë i është kushtuar bankave dhe subjekteve jobanka me problematikë më të madhe duke iu bërë një analizë më e thellë veprimtarive me rrezik më të lartë. Kjo vëmendje ka qenë e kushtëzuar edhe nga hyrja në treg me produktet e saj e Bankës Raiffeisen, duke i dhënë një dimensionim tjetër konkurrencës në tregun bankar. Rritja e ndjeshme e kredidhënies nga bankat, bëri që të forcoheshin kërkesat për një analizë më cilësore të klientëve kredimarrës. Si pasojë e rritjes së ndjeshme të portofolit të kredisë në veçanti dhe e rritjes së konkurrencës në përgjithësi, në sistemin bankar janë ndjekur me kujdes efektet që kanë sjellë këto në mjaftueshmërinë e kapitalit, në cilësinë e portofolit të kredisë, në normat e interesit, në forcimin e sistemeve të kontrollit të bankave të nivelit të dytë, duke bërë rekomandime për përmirësime në sistemet e teknologjisë së informacionit, për kushtet e sigurisë në kryerjen e veprimtarisë, për forcimin e rolit të kontrollit të brendshëm dhe të strukturave drejtuese në përgjithësi etj..

Procesi i mbikëqyrjes gjatë vitit 2005 është përmirësuar në aspektin e komunikimit me strukturat drejtuese të bankave si dhe të bashkëpunimit me autoritetet mbikëqyrëse të vendeve prej të cilave vijnë investimet e huaja në sistemin tonë bankar. Kështu, gjatë vitit 2005 janë realizuar mjaft takime me anëtarë të bordeve drejtuese të bankave, me anëtarë të komiteteve të kontrollit si dhe me drejtues ekzekutivë të bankave. Në këto takime është diskutuar për problematikën e bankave të veçanta, gjendjen e tregut si dhe masat që bankat duhet të marrin për të përmbushur rekomandimet e lëna nga ana e Bankës së Shqipërisë.

Gjatë vitit 2005, një vëmendje më e madhe i është kushtuar bashkëpunimit me autoritetet mbikëqyrëse. Janë nënshkruar marrëveshjet e bashkëpunimit me Autoritetin e Pagesave të Kosovës, me Bankën Kombëtare të Maqedonisë dhe me Bankën Qendrore të Malit të Zi. Gjithashtu, janë shkëmbyer informacionet e përgjithshme mbi përbërjen e sistemit bankar, janë vendosur kontakte pune dhe është shkëmbyer informacion me Bankën e Italisë si edhe ka filluar një bashkëpunim mjaft i frytshëm me Autoritetin Mbikëqyrës të Tregut Financiar

në Austri. Po kështu, janë ripërtërirë marrëdhëniet me Bankën e Greqisë, me Autoritetin Mbikëqyrës në Turqi dhe me Bankën Kombëtare të Bullgarisë.

Gjatë vitit 2005 janë kryer këto kontrolle:

1. Banka: 15 kontrolle të plota , 14 kontrolle të pjesshme.
2. Institucione jobanka: 7 kontrolle të plota, 7 kontrolle të pjesshme.
3. Shoqëri të Kursim Kreditit: 2 kontrolle të plota, 2 kontrolle të pjesshme.
4. Zyra këmbimesh valutore: 41 kontrolle.

Objektivi kryesor ka qenë që të sigurohet një veprimtari e shëndoshë dhe e sigurtë në aktivitetin e bankave dhe të subjekteve jobanka. Në funksion të këtij qëllimi kanë qenë dhe rekomandimet e lëna nga Banka e Shqipërisë.

Në përgjithësi, gjendja e sistemit bankar, e vlerësuar nga inspektimet në vend paraqitet e mirë. Disa nga gjetjet e dala nga procesi i inspektimit në vend gjatë vitit 2005 janë:

- Një rritje mjaft e shpejtë e kredidhënies ofruar klientëve. Një pjesë e madhe e bankave janë mjaft agresive në drejtim të kreditimit dhe kanë rritur mjaft gamën e produkteve të tyre. Përveç kredive për biznesin, një rritje të ndjeshme ka pësuar kredia për individë, ku peshën kryesore e zënë kredia për shtëpi dhe kredia konsumatore. Bankat kanë përmirësuar sistemet e tyre të brendshme të kredidhënies si dhe kanë rritur mjaft personelin e tyre, që lidhet me procesin kreditues. Kjo rritje e kredidhënies përveç efekteve pozitive që ka në rritjen ekonomike, ka bërë që publiku t'i afrohet gjithnjë e më tepër sistemit bankar.
- Një zgjerim i mëtejshëm i rrjetit të degëve dhe agjencive. Ndërsa viti 2004 ishte viti kur bankat filluan zgjerimin e shpejtë të rrjetit të tyre me 30 degë dhe agjenci, viti 2005 shënon një përshejtim të ritmit të rritjes së këtij rrjeti. Kështu gjatë vitit 2005, janë hapur 48 degë dhe agjenci të reja. Pjesa më e madhe e tyre (23) janë hapur në Tiranë, por një pjesë e konsiderueshme është hapur në qytetet e vogla të vendit, të cilat nuk kanë qenë të mbuluara mirë me shërbime bankare. Kjo rritje e shpejtë e rrjetit të bankave ka kontribuar në një mbulim më të mirë të popullatës me shërbime bankare.
- Zhvillimet pozitive përsa i përket zgjerimit të rrjetit të bankave dhe rritjes së kredidhënies dhe shërbimeve të tjera, kanë bërë që publiku t'i afrohet gjithnjë e më shumë sistemit bankar çka ka sjellë dhe një rritje të konsiderueshme të aktiveve të bankave. Rritjen më të madhe e kanë patur ato banka, të cilat kanë qenë më agresive në rritjen e rrjetit të tyre dhe të kredidhënies.
- Performanca e sistemit bankar është mjaft e mirë dhe rezultati neto i sistemit bankar është më i madh sesa një vit më parë. Kjo ka ardhur si rezultat i rritjes së aktivitetit, i rritjes së ndjeshme të kredidhënies dhe i të ardhurave nga aktivitetet e tjera.
- Megjithëse ka pasur rënie në krahasim me një vit më parë, likuiditeti i bankave paraqitet i lartë, përgjithësisht si rezultat i investimeve në zëra likuidë.

- Kemi patur një rritje të konsiderueshme të numrit të ATM-ve dhe të kartave të debitit dhe kreditit. Këto karta po fitojnë një përdorim gjithnjë e më të madh nga ana e popullatës. Për momentin, ato përdoren kryesisht për tërheqjen e *cash-it* pranë ATM-ve, por një zgjerim po merr dhe përdorimi i tyre si mjete pagese. Kështu mjaft “pika shitje” (Point of Sale) janë instaluar pranë njërive të shitjes nga ku klientët mund të kryejnë transaksione në mënyrë elektronike.

Problemet e konstatuara nga kontrollet në vend mund t’i ndajmë si më poshtë:

- Probleme që lidhen me administrimin e lartë (këshilli drejtues dhe komiteti i kontrollit). Rekomandimet e kontrolleve kanë synuar rritjen e përgjegjësisë së këtyre organeve duke theksuar (probleme në vëmendje të këshillit drejtues) problemet të cilat janë gjykuar kritike për të siguruar një aktivitet të shëndoshë dhe të sigurtë të bankave. Theksimi i këtyre rekomandimeve ka si qëllim ushtrimin nga këto organe të kompetencave dhe përgjegjësive të tyre, në plotësimin e bankave me politika dhe procedura të mjaftueshme për një aktivitet të shëndoshë dhe të sigurtë për to.

Eliminimi i konfuzionit apo i ngadalësisë së këshillave drejtues apo divizioneve të kontrollit (në bankat - mëmë) në drejtim të zgjidhjes së problemeve të bankave (filiale apo degë) që ushtrojnë aktivitetin në Shqipëri. Edhe për komitetet e kontrollit është kërkuar rritja e pranisë së tyre në banka, bashkëpunim më i ngushtë me kontrollin e brendshëm, rritje e përgjegjësisë për problemet e prezantuara etj..

Një nga rekomandimet e dhëna më shpesh lidhet me plotësimin e dokumentacionit të drejtuesve të lartë, të cilët duhet të marrin miratim paraprak nga Banka e Shqipërisë. Shpesh ky dokumentacion dërgohet me shumë vonesë. Organet drejtuese të bankave në përgjithësi kanë reaguar pozitivisht ndaj rekomandimeve. Në funksion të rritjes së bashkëpunimit midis tyre dhe Bankës së Shqipërisë, siç është theksuar dhe më sipër janë shtuar takimet dhe kontaktet midis të dyja palëve.

- Probleme që lidhen me kuadrin e brendshëm rregullativ të bankave. Me zgjerimin e aktivitetit dhe rritjen e kompleksitetit të shërbimeve bankare, vazhdimisht lind nevoja për pasurimin dhe përmirësimin e kuadrit të brendshëm rregullativ. Ky problem është më i prekshëm për bankat e reja, prandaj atyre u është kushtuar kujdes i veçantë nëpërmjet kontrolleve më të shpeshta, për të vlerësuar plotësimin e politikave dhe procedurave të brendshme, si dhe cilësinë e tyre.

Edhe në këtë drejtim, bankat në përgjithësi kanë reaguar mirë, por është e nevojshme që politikat dhe rregulloret e brendshme të jenë të miratuara edhe nga këshillat drejtues. Lidhur me zbatimin e kuadrit të brendshëm rregullativ, vihen re shmangie nga disa banka. Në këtë kontekst është rekomanduar rritja e përgjegjësisë dhe e anës cilësore të punës së kontrollit të brendshëm dhe komitetit të kontrollit.

- Probleme që lidhen me zbatimin e rregulloreve. Megjithëse ka patur përpjekje nga bankat për një zbatim sa më të mirë të kuadrit rregullator të Bankës së Shqipërisë, përsëri vihen re moszbatime të rregulloreve apo shkelje të kufijve të përcaktuar në to, në disa raste dhe përsëritje të shkeljeve. Rregulloret për të cilat vihen re më tepër shkelje:
 - a. Rregullorja "Për administrimin e rrezikut të kredisë". Klasifikimi i kredive dhe shtesa e provigjoneve për kreditë e riklasifikuara ka qenë nga çështjet më të debatuar midis kontrollorëve dhe drejtuesve të bankës. Analiza më të thella financiare të kredimarrësve, vizitat në vend, plotësimi i dosjeve me dokumentacionin e nevojshëm janë disa nga rekomandimet për procesin kreditues të bankave.
 - b. Rregullorja "Për pozicionet e hapura valutore". Vlen të theksohet se jo të gjitha bankat kanë shmangie të tilla. Ekziston një numër i vogël bankash, të cilat kanë shkelur kërkesat e kësaj rregulloreje.
 - c. Rregullorja "Për kontrollin e rreziqeve të mëdha". Tejkallimet e kufijve të përqëndrimit për një përfitues vihen re kryesisht për vendosjet në banka (sidomos për degët e bankave të huaja) dhe disa kredimarrës.
 - d. Rregullorja "Për veprimtarinë valutore". Vërejtjet për zbatimin e kësaj rregulloreje lidhen kryesisht me qëllimin e transfertave, dokumentimin e transfertave me anë të aktzhdoganimeve. Në mjaft banka është rekomanduar trainimi i personelit me formatet dhe elementet e vlefshmërisë së aktzhdoganimeve, që pranohen si dokumente justifikuese për transfertat tregtare.
 - e. Rregullorja "Për parandalimin e pastrimit të parave". Zbatimi me korrektësi i kërkesave të kësaj rregulloreje për caktimin e personave përgjegjës në bankë për parandalimin e pastrimit të parave, në drejtim të identifikimit të klientëve dhe raportimit të transaksioneve sipas kufijve të caktuar, në drejtim të trainimit të personelit për parandalimin e pastrimit të parave.
- Probleme që lidhen me sistemin e teknologjisë dhe informacionit. Gjatë vitit 2005, falë dhe asistencës së specialistëve norvegjezë u bë përmirësimi i procedurave të ekzaminimit në vend për sistemin e teknologjisë dhe informacionit. Gjatë kontrolleve të kryera në banka, rezultuan një sërë problemesh që lidheshin kryesisht me hartimin e strategjisë së teknologjisë së informacionit si dhe me hartimin e procedurave për zbatimin e kësaj strategjie. Gjithashtu, duhet bërë vlerësimi i rrezikut të teknologjisë së informacionit dhe dokumentimit të tij, krijimi i strukturave organizative të nevojshme për sigurimin e cilësisë së teknologjisë së informacionit dhe auditimit të saj, hartimi i planit të recuperimit në raste fatkeqësish, gjenerimi automatik i informacioneve të nevojshme, modulet e përdorura për fushat e ndryshme të aktivitetit, ndarja e të drejtave lidhur me hedhjen e të dhënave dhe autorizimet e veprimeve etj..

Në raportet e kontrolleve të këtij viti u vlerësua reagimi i bankave lidhur me rekomandimet e dhëna. Vërehet se një pjesë e mirë e këtyre problemeve vazhdojnë të ekzistojnë. Për shkak të kostove të larta që shoqërojnë ndryshimet e nevojshme në këto sisteme, bankat po reagojnë relativisht ngadalë.

- Probleme që lidhen me kontabilitetin. Problemet që kanë të bëjnë me zbatimin e Manualit të Kontabilitetit Bankar burojnë nga fakti që bankat janë lejuar të mbajnë kapitalin në valutë të huaj. Disa nga bankat vazhdojnë të mbajnë fitimin dhe aktivet e qëndrueshme në monedhë të huaj, në kundërshtim me Manualin e Kontabilitetit Bankar.
- Probleme të tjera. Probleme të tjera të evidentuara gjatë ekzaminimeve kanë të bëjnë me përsosjen në drejtim të arritjes së objektivave të vendosur në planbuxhetet, shtimin e personelit dhe trainimin e tyre, përmirësimet në pagat e punonjësve, rrjedhjet e personelit në disa banka etj..

Përveç kontrolleve të plota, janë zhvilluar dhe 14 kontrolle të pjeshme. Kontrollat e pjeshme kanë patur si qëllim kryesisht vlerësimin e realizimit të rekomandimeve të kontrolleve të plota. Nga këto kontrolle ka rezultuar se bankat, subjektet jobanka apo shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre kanë reaguar në përgjithësi, pozitivisht ndaj këtyre rekomandimeve.

Vlerësimi i cilësisë së portofolit të kredisë. Në muajin tetor 2005 u zhvillua një ekzaminim horizontal në tetë bankat, që kanë peshën më të madhe të kredisë në sistem, për të vlerësuar politikat dhe procedurat, organizimin, analizimin, monitorimin, kontrollin e brendshëm dhe cilësinë e portofolit të kredisë. Nga këto ekzaminime rezultoi se bankat kanë përmirësuar strukturat e tyre si dhe politikat dhe procedurat në drejtim të kredidhënies. Gjithsesi, duhet të bëhet ende punë për përmirësimin e mëtejshëm të këtyre politikave dhe procedurave, të bëhet një organizim më i mirë i departamenteve të kredisë në drejtim të analizës dhe monitorimit, të rritet efikasiteti i punës së kontrollorit të brendshëm si dhe t'i kushtohet më tepër vëmendje zbatimit të rregullores "Për administrimin e rrezikut të kredisë", për klasifikimin e kredive dhe sidomos gjatë krijimit të provigjoneve për kreditë. Gjithashtu, nga këto ekzaminime rezultuan detyra dhe për përmirësimin e kuadrit rregullator dhe manualit të ekzaminimit në Bankën e Shqipërisë.

INSTITUCIONE JOBANKA

Gjatë vitit 2005 janë kontrolluar të gjitha institucionet financiare jobanka (7 institucione). Problematika e evidentuar gjatë kontrolleve paraqitet si më poshtë:

Shkelja e normave mbikëqyrëse dhe raportimet. Këto shkelje kanë të bëjnë me normat e kredive me probleme (për të dyja institucionet që ofrojnë kredi), normat e likuiditetit dhe të kapitalit. Edhe raportimet që duhet të kryejnë këto institucione nuk janë gjithmonë të rregullta dhe në kohën e duhur. Deri tani nuk ka patur një format të përcaktuar dhe një linjë të qartë për raportimet (njësitë e Departamentit të Mbikëqyrjes apo Teknologjisë të Informacionit). Kohët e fundit është përcaktuar formati dhe linja e raportimit. Kjo do të ndihmojë në formimin e bazës së të dhënave për çdo institucion, krahasimin dhe agregimin e tyre, ndjekjen më të mirë të raportimeve dhe identifikimin e hershëm të shkeljes së normave të mbikëqyrjes.

Shkelja e kushteve të licencës. Shkeljet e evidentuara të kushteve të licencës jepen më poshtë:

- a. Hapja e llogarive nga ana e institucioneve për klientët. Në këto raste është kërkuar që në marrëveshjen e nënshkruar nga të dyja palët të përcaktohet qartë qëllimi i hapjes së llogarisë (vetëm për veprimtaritë e lejuara nga licenca).
- b. Ofrimi i kredive *overdraft* (është kërkuar ndërprerja e menjëhershme e këtij aktiviteti).
- c. Zvogëlimi i kapitalit nën kufirin e lejuar për të marrë licencën si rezultat i humbjeve. Është kërkuar shtimi i kapitalit në nivelin e licencës.

Probleme të sistemeve të regjistrimit të informacionit. Disa nga këto institucione e kanë filluar aktivitetin e tyre me nivele modeste të veprimtarisë dhe të kapitalit dhe transaksionet e tyre nuk janë komplekse. Për këto arsye sistemet që përdorin për kontabilizimet dhe ruajtjen e informacionit janë manuale. Me rritjen e aktivitetit dhe të aktiveve, që kanë nevojë për monitorim të kujdesshëm, si dhe për të ruajtur informacionin në përputhje me përcaktimet ligjore, këto sisteme nuk i plotësojnë më kërkesat. Në këto raste, është rekomanduar të sigurohet një sistem informacioni i përshtatshëm dhe i automatizuar, në të cilin të regjistrohen saktësisht të gjitha veprimet dhe të gjenerohet informacioni i nevojshëm për raportime në Bankën e Shqipërisë dhe tek autoritetet e tjera. Nga ana tjetër, është e nevojshme që këto institucione të njohin më mirë dhe të zbatojnë me rigorozitet Manualin e Kontabilitetit Bankar (ato pjesë të tij që mbulojnë veprimtaritë e tyre të licencuara).

Rekomandime të tjera. Rekomandimet e tjera kanë patur si qëllim shtimin e masave për të monitoruar dhe për t'u mbrojtur nga rreziqet e aktivitetit, luftën kundër pastrimit të parave, përmirësimin e strukturës dhe të kuadrit të brendshëm rregullativ, zbatimin rigoroz të rregullores "Për veprimtarinë valutore" etj..

Gjatë vitit 2005 janë organizuar 2 kontrolle të plota dhe 2 kontrolle të pjesshme në dy unionet e shoqërive të kursimit-kreditit që grumbullojnë depozita nga anëtarët e tyre dhe ofrojnë kredi për ta. Gjatë kontrollit u konstatua se veprimtaria e unionit dhe anëtarëve të tij në përgjithësi ishte në përputhje me ligjin dhe me kuadrin rregullator të miratuar deri tani.

Aktualisht ekzistojnë rreth 57 zyra të licencuara të këmbimeve valutore 7 prej tyre të licencuara këtë vit. Gjatë vitit 2005 janë inspektuar rreth 41 zyra këmbimi dhe ndër problemet kryesore të evidentuara mund të përmendim mosmbajtjen e kontabilitetit në përputhje me ligjin, mosruajtjen e kopjeve të faturave për çdo veprim këmbimi, raportime jo të rregullta në Bankën e Shqipërisë. Për këto probleme janë lënë rekomandimet përkatëse.

SHËNIME

¹ Totali i rezultatit neto nga interesat dhe veprimtaritë e tjera.

² Rënia e peshës është pasojë e aplikimit të metodës së re llogaritëse për PBB-në e vlerësuar.

³ Në tremujorin e dytë kemi kalimin e Degës së Bankës Alpha nga grupi G3 në grupin G2 dhe të degës së Bankës Credins nga grupi G1 në grupin G2.


⁴ Ndërsa teprica e kredisë në lekë është rritur me 17.5 miliardë lekë ose 128 për qind, ajo në valutë shënon rritje me 40.1 miliardë lekë ose 71 për qind.

⁵ Ky tregues llogaritet 1 për qind nga 1.4 për qind në fundvitin 2004.

⁶ Raporti "kredi me probleme neto / kapitalit rregullator" llogaritet 4.3 për qind, nga 4.8 për qind në fundvitin 2004.

⁷ Teprica neto e kredisë me probleme për sistemin bankar evidentohet rreth 1.2 miliardë lekë nga 976 milionë lekë në fundvitin 2004.

⁸ RMK llogaritet si raport i kapitalit rregullator me aktivet e klasifikuara sipas rrezikut të shprehur në përqindje.



KAPITULLI V

AKTIVITETE TË TJERA TË BANKËS SË SHQIPËRISË

KAPITULLI V. AKTIVITETE TË TJERA TË BANKËS SË SHQIPËRISË

V.1 INTEGRIMI DHE BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

V.1.1 INTEGRIMI EVROPIAN

Edhe gjatë vitit 2005, Banka e Shqipërisë ka qenë e angazhuar në bisedimet zyrtare për nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA) ndërmjet Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian. Negociatorët e Bankës së Shqipërisë kanë marrë pjesë në Raundin e Gjashtë Zyrtar të negociatave, të zhvilluar në maj si dhe në Raundin e Nëntë dhe të Dhjetë Teknik të zhvilluar përkatësisht në muajt shkurt dhe shtator. Gjatë këtyre negociatave, i është dhënë forma përfundimtare neneve dhe anekseve për zbatimin e të cilave Banka e Shqipërisë është institucioni përgjegjës.

Banka e Shqipërisë, në bashkëpunim me Ministrinë e Integritimit Evropian, ka marrë pjesë aktivisht edhe në hartimin e Planit Kombëtar të Përafrimit të Legjislacionit vendas me atë të BE-së dhe zbatimit të MSA-së (PKPL), i cili u miratua në muajin maj. Ky Plan përmbledh të gjitha masat legjislative dhe zbatuese, që duhet të adoptohen nga institucionet shqiptare brenda afateve të përcaktuara qartë. Sipas PKPL-së, Banka e Shqipërisë do të jetë përgjegjëse për hartimin e ligjeve dhe akteve të tjera nënligjore, si dhe për marrjen e masave zbatuese në kapitujt e stabilitetit makroekonomik, lëvizjes së lirë të kapitalit dhe lirisë për të ofruar shërbime bankare.

Në kuadër të zbatimit të PKPL-së, Banka e Shqipërisë ka përgatitur edhe dy raporte të progresit për periudhat qershor-shtator dhe tetor-dhjetor, në të cilët bëhet një përshkrim i detajuar i masave të zbatuara. Më konkretisht, në muajin qershor është rishikuar rregullorja "Rregulla dhe procedura të Sistemit Shqiptar të Pagesave Ndërbankare – AIPS", e cila është në përputhje të plotë me Direktivën 98/26/EC "Mbi finalitetin e rregullimeve në sistemet e pagesave dhe të letrave me vlerë". Në të njëjtën kohë, është rishikuar rregullorja "Mbi zhvillimin e kleringut" si dhe është miratuar rregullorja "Rregulla dhe procedura të sistemit shqiptar të kryqëzimit të pagesave me vlerë të vogël – AECH". Gjatë kësaj kohe, është përfunduar edhe projektligji "Për disa ndryshime në ligjin "Për bankat në Republikën e Shqipërisë"" si dhe ka filluar faza e diskutimit me institucionet dhe aktorët e interesuar.

Më 9 nëntor, Komisioni Evropian publikoi Raportin e tij Vjetor mbi Shqipërinë. Komisioni vlerësoi ruajtjen e stabilitetit makroekonomik, vendosjen e një kuadri të përshtatshëm të mbikëqyrjes bankare si dhe zhvillimin e sistemeve të pagesave në vendin tonë. Nga ana tjetër, Komisioni bëri thirrje për lehtësimin e mëtejshëm të lëvizjes së lirë të kapitalit dhe një angazhim të bashkërendim më të madh të përpjekjeve në kuadër të luftës kundër pastrimit të parave. Bazuar në përfundimet e Raportit Vjetor, Këshilli Evropian i BE-së ka miratuar

në dhjetor një Dokument të rishikuar të Partneritetit Evropian, ku rradhit përparësitë afatshkurtra dhe afatmesme për Shqipërinë. Në këtë kuadër, Banka e Shqipërisë do të angazhohet për rishikimin e disa pjesëve të PKPL-së për t'iu përgjigjur më mirë prioriteteve të Partneritetit të ri Evropian.

Përveç çështjeve të lidhura me MSA-në, Banka e Shqipërisë ka marrë pjesë edhe në dy takime të zhvilluara midis BE-së dhe Shqipërisë në kuadër të Marrëveshjes së Tregtisë dhe Bashkëpunimit të vitit 1992, përkatësisht në Takimin e Gjashtë të Grupit të Punës Shqipëri-BE për Çështjet Ekonomike dhe Financiare (prill) dhe në Takimin e Tetë të Komitetit të Përbashkët Shqipëri-BE (maj). Në këto takime ndërmjet të tjerash është diskutuar edhe mbi parametrat makroekonomikë si: rritja e PBB-së, inflacioni, deficitit tregtar, deficitit i llogarisë korente, investimet e huaja direkte, dërgesat e emigrantëve si dhe mbi zhvillimet në sektorin bankar shqiptar.

V.1.2 BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

- Marrëdhëniet me Fondin Monetar Ndërkombëtar

Viti 2005 shënoi vazhdimin e marrëdhënieve mjaft të ngushta të bashkëpunimit midis Bankës së Shqipërisë dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN). Kështu, në kuadër të konsultimeve për vlerësimin e zbatimit të detyrimeve që rrjedhin nga marrëveshja trevjeçare PRGF (Zbutja e Varfërisë dhe Rritja Ekonomike) dhe negociatave për një marrëveshje të re midis autoriteteve shqiptare dhe FMN-së, gjatë vitit 2005 Shqipërinë e kanë vizituar tre misione të FMN-së, përkatësisht në muajt maj, tetor dhe nëntor.

Gjatë qëndrimeve të tyre në Shqipëri, misionet e FMN-së kanë patur takime të veçanta me administratorët e Bankës së Shqipërisë, në të cilat janë vlerësuar në përgjithësi mjaft pozitivisht arritjet e Bankës së Shqipërisë në kuadër të Memorandumit të Politikave Ekonomike dhe Financiare të nënshkruar midis Bankës së Shqipërisë, Qeverisë Shqiptare dhe FMN-së, me një theks të veçantë mbi ruajtjen e stabilitetit makroekonomik, rritjen ekonomike, kontrollin e trysnive inflacioniste si edhe hapat e ndërmarrë për zhvillimin dhe konsolidimin e sektorit bankar. Tema të tjera që janë diskutuar në këto takime si dhe në kontaktet e anëtarëve të misionit me specialistët e Bankës së Shqipërisë kanë qenë zhvillimet monetare dhe inflacioni, zhvillimet në kursin e këmbimit, rritja e kreditimit, zhvillimet në sektorin real si dhe kuadri rregullativ i mbikëqyrjes bankare.

Vend të veçantë gjatë vitit 2005 kanë zënë dhe mbledhjet vjetore të FMN-së dhe Bankës Botërore, ku delegacioni i Bankës së Shqipërisë ka marrë mbështetjen maksimale në drejtim të vazhdimësisë së reformave, duke rritur përgjegjësinë dhe angazhimet për realizimin e objektivave të institucionit.

Bordi Ekzekutiv i FMN-së gjatë vitit 2005, mbi bazën e raporteve të misioneve të tij dhe synimeve të shprehura nga Qeveria Shqiptare në Memorandumin e Politikave Ekonomike dhe Financiare, në muajt shkurt dhe gusht, ka bërë

përkatësisht rishikimin e pestë dhe të gjashtë të ecurisë ekonomike nën programin për Zbutjen e Varfërisë dhe Rritjen Ekonomike (PRGF), të miratuar më 21.06.2002. Gjatë këtyre rishikimeve, në përgjithësi është vlerësuar ecuria e kënaqshme e Shqipërisë gjatë vitit të tretë dhe të fundit të programit PRGF, me një rritje ekonomike të fortë, administrim me zotësi të likuiditetit nga Banka e Shqipërisë, normë të ulët të inflacioni, ulje të deficitit të llogarisë korente, sektor financiar dinamik etj.. Bordi Ekzekutiv i FMN-së mbi këto baza ka miratuar lëvrimin e dy transeve me respektivisht rreth 6.1 milionë dhe 5.8 milionë dollarë amerikanë si dhe ka vendosur për zgjatjen e programit deri në datën 20.11.2005.

Në muajin nëntor, autoritetet shqiptare negociuan me misionin e FMN-së mbi marrëveshjen e re, e cila pritet të miratohet në janar të vitit 2006. Kjo marrëveshje pritet të jetë një përzierje midis programit për Zbutjen e Varfërisë dhe Rritjen Ekonomike (PRGF) dhe programit Lehtësia e Financimit Afatmesëm (Extended Fund Facility), i cili parashikon një huamarrje më afër termave tregtarë.

Gjatë vitit 2005, si edhe në vitet e kaluara, Banka e Shqipërisë ka përfituar nga asistenca teknike e FMN-së në lidhje me trainimin e personelit të saj si dhe organizimin e konferencave dhe seminareve të ndryshme. Asistenca e deritanishme e FMN-së për Bankën e Shqipërisë vlerësohet shumë e frytshme dhe me një ndikim të konsiderueshëm në arritjen e standardeve bashkëkohore në fushën e bankingut qendror.

- **Marrëdhëniet me Grupin e Bankës Botërore**

Bashkëpunimi i suksesshëm midis Bankës së Shqipërisë dhe Bankës Botërore ka vazhduar me intensitet edhe gjatë vitit 2005. Ky bashkëpunim është përqendruar në asistencën financiare dhe teknike që Banka Botërore vazhdon t'i japë Bankës së Shqipërisë.

Në këtë kuadër, me rëndësi të veçantë është mbështetja financiare për Projektin e Kryqëzimit të Pagesave në Vlerë të Vogël (AECH), i cili përfundoi me sukses dhe u përfundua në muajin korrik. Sistemi i shlyerjes së pagesave në shumën të vogla mundëson reduktimin e ndjeshëm të kohës së procesimit të këtyre pagesave, duke rritur kështu popullaritetin e pagesave bankare dhe duke i ofruar klientëve të bankave një shërbim më cilësor. Në të njëjtën kohë, ky sistem shënon një hap tjetër të hedhur drejt modernizimit të mëtejshëm të sistemit të pagesave dhe afrimit të tij me standardet ndërkombëtare, duke kontribuar në pakësimin e *cash-it* në ekonomi.

Gjithashtu, asistenca financiare nga Banka Botërore ka konsistuar edhe në mbështetjen e Programit për Vlerësimin e Sektorit Financiar (FSAP), i cili është hartuar në bashkëpunim me ekipin e FMN-së. Për këtë qëllim, misioni i përbashkët i këtyre dy institucioneve e ka vizituar Shqipërinë në muajt shkurt dhe maj, ndërkohë që përfundimet e Raportit FSAP janë bërë publike në korrik. Raporti FSAP përgjithësisht vlerësoi me nota pozitive formulimin, vendimmarrjen si dhe zbatimin e politikës monetare dhe në të njëjtën kohë, e vlerësoi sistemin

bankar shqiptar si të qëndrueshëm dhe të shëndetshëm. Raporti FSAP doli edhe me një grup rekomandimesh për institucionet përgjegjëse, për ruajtjen e stabilitetit financiar në vend. Mbështetur në rekomandimet e mësipërme, Banka e Shqipërisë është angazhuar në bashkëpunim me institucionet përkatëse për hartimin e një plani konkret masash zbatimi, i cili do të adresojë përparësitë e paraqitura në Raportin FSAP.

Gjatë vitit 2005, vlen të përmendet nënshkrimi në muajin shtator, në selinë e Bankës Botërore në Washington, i marrëveshjes "Për Administrim dhe Konsulencë të Investimit të Rezervës Valutore". Kjo marrëveshje, përveç administrimit të një pjese të rezervës valutore të Bankës së Shqipërisë nga ana e Bankës Botërore, parashikohet të sjellë edhe asistencë e programe kualifikuese për stafin teknik të Bankës së Shqipërisë, të përfshirë në procesin e administrimit të rezervës valutore.

- Marrëdhëniet me bankat qendrore dhe asistencë teknike

Marrëdhëniet me bankat qendrore jashtë rajonit kanë vazhduar edhe gjatë vitit 2005 përgjithësisht, në të njëjtin nivel me vitin paraardhës. Vlen të përmenden marrëdhëniet me bankat qendrore të Francës, Gjermanisë, Holandës, Republikës Çeke, SHBA-së, Anglisë, Austrisë dhe Polonisë, të cilat kanë vazhduar të ofrojnë asistencë teknike për Bankën e Shqipërisë, kryesisht nëpërmjet organizimit të kurseve dhe seminareve afatshkurtra në fusha të specializuara.

Njëkohësisht, janë vendosur marrëdhënie më të ngushta bashkëpunimi me Bankën Qendrore Evropiane, e cila nga ana e saj ka shprehur interesin për të ndihmuar bankat qendrore të rajonit në rrugën e tyre drejt Sistemit Evropian të Bankave Qendrore (SEBQ). Gjatë vitit 2005, janë intensifikuar marrëdhëniet dypalëshe edhe me Bankën e Italisë nëpërmjet rigjallërimit të bashkëpunimit teknik. Në këtë kuadër, pjesëtarë të personelit të Bankës së Shqipërisë kanë marrë pjesë në seminare dhe vizita pune, të organizuara pranë këtij institucioni.

Viti 2005 shënoi një përparim të dukshëm edhe për sa i përket bashkëpunimit ndërmjet bankave qendrore të rajonit. Vlen të përmenden memorandumet e mirëkuptimit në fushën e mbikëqyrjes bankare, të nënshkruara me Bankën Qendrore të Republikës së Maqedonisë dhe me Bankën Qendrore të Malit të Zi. Këto memorandume përmbajnë parimet kryesore mbi shkëmbimin e informacionit në lidhje me licencimin dhe mbikëqyrjen e bankave në vendet përkatëse. Në të njëjtën kohë, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Ardian Fullani, ka zhvilluar takime zyrtare me guvernatorët e Bankës së Greqisë dhe Bankës Kombëtare të Serbisë, ku është vendosur për ndërtimin e marrëdhënieve më të ngushta të bashkëpunimit midis institucioneve respektive.

Në vijim të kujdesit të veçantë që Banka e Shqipërisë i kushton konsolidimit dhe intensifikimit të marrëdhënieve me Autoritetin e Bankave dhe Pagesave të Kosovës (ABPK), një delegacion i Bankës së Shqipërisë i kryesuar nga z. Fullani, ka zhvilluar në muajin korrik një vizitë pune pranë këtij institucioni, gjatë së

cilës është rënë dakord edhe mbi pikat ku duhet të përqendrohet bashkëpunimi dypalësh në të ardhmen. Në kuadër të kësaj vizite, është nënshkruar edhe Memorandumi i Mirëkuptimit me ABPK-në në fushën e mbikëqyrjes bankare, i cili zëvendëson memorandumimin e mëparshëm.

Banka e Shqipërisë ka përfituar asistencë teknike edhe nga ana e GTZ-së, në bazë të programit "Përafrimi i Bankës së Shqipërisë si bankë qendrore me SEBQ-në", në kuadër të Protokollit të Bashkëpunimit Teknik dhe Financiar midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë. Gjatë vitit 2005, janë përcaktuar fushat prioritare të bashkëpunimit me GTZ-në si dhe ka filluar konkretizimi i asistencës teknike në disa fusha siç janë: integrimi evropian, komunikimi, sistemet e pagesave, çështjet ligjore etj..

Asistencë teknike Bankës së Shqipërisë i është ofruar edhe nga Financial Services Volunteer Corps (FSVC), kryesisht në lidhje me çështjet ligjore të mbikëqyrjes bankare si dhe të parandalimit të pastrimit të parave.

V.2 EMISIONI I MONEDHËS


Viti 2005 ka shënuar zhvillime pozitive në drejtim të administrimit me efektivitet të monedhës kombëtare, duke iu përgjigjur në kohë kërkesave të ekonomisë për para, duke siguruar mbrojtjen e autenticitetit dhe cilësisë së monedhës kombëtare të hedhur në qarkullim, si dhe duke evidentuar vlerat kulturore e historike të kombit tonë, nëpërmjet projekteve për prodhimin e monedhave numizmatike për koleksionistë vendas dhe të huaj.

V.2.1 ECURIA E MONEDHËS NË QARKULLIM

Sasia e monedhës në qarkullim gjatë vitit 2005 vazhdoi rritjen e përvitshme, në mbështetje të rritjes ekonomike të vendit. Për vitin 2005 paraja në qarkullim u rrit me 8.42 për qind ose 11.9 miliardë lekë, duke arritur në nivelin 153.5 miliardë lekë në fund të vitit. Edhe gjatë këtij viti, ecuria e parasë në qarkullim ndoqi të njëjtën tendencë vjetore duke ruajtur të njëjtin sezonalitet të vërejtur edhe në vitet e mëparshme. Sasia e lartë e parasë në qarkullim, që rezultoi në fund të vitit 2004 për shkak të shpenzimeve të fundvitit, filloi të rikthehet në Bankën e Shqipërisë në tremujorin e parë dhe fillimin e tremujorit të dytë të vitit 2005, duke shkaktuar rënie të parasë në qarkullim në muajt janar, shkurt, mars, prill, maj.


Kësaj tendence në pjesën e parë të vitit, i korrespondon një nivel i lartë arkëtimesh nga bankat e nivelit të dytë dhe një nivel i ulët pagesash drejt sistemit bankar. Në gjysmën e dytë të vitit

Grafik 1. Ecuria e monedhës në qarkullim (në milionë lekë).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 2. Arkëtime / Pagesa viti 2005 (në milionë lekë).




Burimi: Banka e Shqipërisë.

vërejmë një rritje të sasisë së parasë në qarkullim, e ndikuar kjo nga shpenzimet e sezonit turistik në muajt qershor, korrik, gusht si dhe nga fushata elektorale. Këtyre shpenzimeve u janë përgjigjur nivele të larta pagesash nga Banka e Shqipërisë, në drejtim të bankave të nivelit të dytë dhe nivele më të ulëta të arkëtimeve. Të njëjtën prirje shfaq dhe muaji dhjetor, si pasojë e shpenzimeve të kryera nga konsumatorët për festat e fundvitit, sektori publik për realizimin e zërave të buxhetit dhe ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në treg.

Arkëtimet e parave të bankave të nivelit të dytë nga Banka e Shqipërisë gjatë vitit 2005 arritën në nivelin 109.6 miliardë lekë, duke shënuar një rritje prej 19.8 për qind krahasuar me nivelin e arkëtimeve në vitin 2004, kurse pagesat për në bankat e nivelit të dytë arritën në nivelin 121.5 miliardë lekë me një rritje prej 15.4 për qind krahasuar me nivelin e pagesave në vitin 2004.

Grafik 3. Kartëmonedhat dhe monedhat në qarkullim në vitet 2003, 2004 dhe 2005.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Rritja e vëllimit të arkëtim/pagesave nënkupton edhe rritjen sasisë së përpunimit të fondeve, e cila është kryer duke përdorur makina përpunimi që sigurojnë saktësi në numërim e kontroll, si dhe seleksionimin e kartëmonedhave të dëmtuara dhe të falsifikuara, duke bërë të mundur rritjen e cilësisë së kartëmonedhave të hedhura në qarkullim dhe ruajtjen e autenticitetit të monedhës kombëtare.

Bankat e nivelit të dytë janë furnizuar me fonde sipas kërkesave të paraqitura prej tyre por duke synuar në të njëjtën kohë dhe arritjen e objektivit për realizimin e strukturës së monedhës në qarkullim për fundin e vitit 2005.

V.2.2 SHPEJTËSIA E QARKULLIMIT TË PARASË

Në kuadrin e programit për reduktimin e cash-it në ekonomi, nëpërmjet zgjerimit të veprimtarisë së publikut dhe subjekteve tregtare me bankat e nivelit të dytë, vëmendje i është kushtuar dhe furnizimit të bankave me kartëmonedha për plotësimin e kërkesave të klientëve të tyre, për tërheqjen e parave me sisteme automatike (ATM). Numri i ATM-ve të instaluar nga bankat, ka ardhur gjithnjë në rritje edhe me zgjerimin e rrjetit të degëve të bankave të nivelit të dytë. Kjo ka ndikuar në rritjen e shpejtësisë së qarkullimit të parasë,¹ e cila për vitin 2005 rezultoi në nivelin 0.707 herë, e krahasuar kjo me nivelin 0.675 herë të vitit 2004. Ndikimin më të madh në rritjen e shpejtësisë së parasë e kanë prerjet 5,000 lekë, 1,000 lekë dhe 500 lekë, që janë dhe prerjet me të cilat punojnë ATM-të, shpejtësia e qarkullimit të të cilave është rritur me 20 për qind krahasuar me vitin 2004.

	2003	2004	2005
Nr. ATM	15	69	165
% Rritjes	-	360%	139%

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 1. Numri i ATM-ve të instaluar nga sistemi bankar sipas viteve.


Tabelë 2. Struktura e parasë në qarkullim (në përqindje).

Prerja	5000	1000	500	200	100	100	50	20	10	5	1
Struktura dt.31.12.2004	25.77	46.13	24.81	2.18	1.11	15.78	35.44	28.25	15.69	4.54	0.30
Struktura dt.31.12.2005	29.86	44.83	22.47	2.03	0.80	12.14	37.07	29.48	16.35	4.65	0.30

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Kurse, përsa i përket prerjeve të tjera dhe monedhave metalike, shpejtësia e qarkullimit e tyre është zvogëluar në përputhje me objektivin për rritjen e sasisë së monedhave metalike në dispozicion të publikut.

Grafik 4. Shpejtësia e qarkullimit të kartëmonedhave sipas prerjeve.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

V.2.3 MONEDHAT E FALSIFIKUARA DHE MBROJTJA NDAJ TYRE

Vëmendje e veçantë i është kushtuar dhe mbrojtjes së kartëmonedhës shqiptare nga falsifikimi dhe ruajtjes së autenticitetit të saj, me qëllim mbrojtjen e publikut dhe rritjen e besimit të tij në monedhën kombëtare. Kartëmonedhat e falsifikuara të konfiskuara, të cilat u hoqën nga qarkullimi gjatë vitit 2005 përbënin 10 për qind të sasisë totale të kartëmonedhave të falsifikuara të konfiskuara, duke filluar nga viti 1992.

Peshën më të madhe në kartëmonedhat e falsifikuara të konfiskuara gjatë vitit 2005 sikurse dhe gjatë vitit të mëparshëm, e zë prerja 1,000 lekë, por cilësia e falsifikimeve është tepër e dobët dhe ato mund të dallohen lehtësisht. Sasia totale e kartëmonedhave false të konfiskuara nga viti 1992 e deri më sot, në raport me sasinë e përgjithshme të kartëmonedhave të hedhura në qarkullim nga Banka e Shqipërisë, përbën vetëm 0.032 për qind të tyre, shifër kjo tërësisht e papërfillshme dhe që nuk cënon besimin e publikut në monedhën kombëtare.

Tabelë 3. Pesha e kartëmonedhave të falsifikuara sipas prerjeve gjatë vitit 2005 (në përqindje).

Prerja	5000	1000	500	200	100
%	0	73	19.5	7	0.5

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 4. Pesha e kartëmonedhave të falsifikuara sipas prerjeve nga viti 1992 (në përqindje).

Prerja	5000	1000	500	200	100
%	0	59	32	9	0

Burimi: Banka e Shqipërisë.

V.3 ZHVILLIME NË FUNKSIONIN E KONTROLLIT TË BRENDSHËM

Në vitin 2005 inspektorët e Departamentit të Kontrollit i kryen detyrat e tyre në përputhje me kërkesat e nenit 54 të ligjit "Për Bankën e Shqipërisë" dhe të rregullores së Departamentit të Kontrollit, të miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 59, datë 04.07.2001.

Gjatë këtij viti janë realizuar 47 audite e kontrole, me një mesatare mujore të auditeve prej rreth 4 në muaj. Në zbatim të programit vjetor kanë qenë 46 audite dhe vetëm 1 ishte procedurë e veçantë, e realizuar sipas sugjerimit të administratorëve të Bankës së Shqipërisë. Rekomandimet e dhëna kanë pasur objektiv zbatimin korrekt të ligjeve, të akteve nënligjore, të vendimeve të Këshillit Mbikëqyrës e rregullave të tjerë të vendosur, me synim forcimin e mëtejshëm të sistemeve të kontrollit të brendshëm, duke kontribuar në këtë mënyrë në rritjen e rolit parandalues të kontrollit.

V.4 NDRYSHIME TË LEGJISLACIONIT BANKAR GJATË VITIT 2005

Gjatë vitit 2005 kuadri ligjor dhe rregullator ka vijuar të plotësohet dhe të përmirësohet më tej. Këto përmirësime janë kryer në kuadër të angazhimeve

që rrjedhin nga procesi i Stabilizim-Asociimit me Bashkimin Evropian si dhe janë diktuar nga nevojat e zhvillimit me ritme të shpejta të sistemit bankar shqiptar.

Në kuadrin e procesit të Stabilizim-Asociimit, Banka e Shqipërisë ka realizuar në mënyrë të kënaqshme prioritetet afatshkurtra të përcaktuara në Planin Kombëtar të Përafrimit të Legjislacionit Vendas me atë të BE-së dhe Zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit. Si masa legjislative ishin parashikuar ndër të tjera: (i) ndryshimi i ligjit ekzistues "Për bankat në Republikën e Shqipërisë"; (ii) rishikimi i rregullores për "Rregullat dhe Procedurat e Sistemit Shqiptar të Pagesave Ndërbankare – AIPS"; (iii) miratimi i rregullores për "Rregullat dhe Procedurat e Sistemit Shqiptar të Kryqezimit të Pagesave me Vlerë të Vogël (AECH)", të cilat do të paraqiten dhe në vijim sipas fushave të veprimtarisë së Bankës së Shqipërisë.

V.4.1 LEGJISLACIONI PËR MBIKËQYRJEN BANKARE

Gjatë këtij viti është punuar për përmirësimin e ligjit ekzistues "Për bankat në Republikën e Shqipërisë". Këto përmirësime janë diktuar nga nevoja e përshtatjes dhe e zbatimit të direktivave evropiane në këtë fushë, si dhe të parimeve të Bazelit për një mbikëqyrje efektive. Projekti i ri sjell kuadrin ligjor bankar më pranë standardeve evropiane në fushën e mbikëqyrjes, duke u bazuar dhe në përvojën dhe modelet ligjore të vendeve të rajonit të Ballkanit Perëndimor, të cilat janë pranë asociimit me Bashkimin Evropian.

Projektligji i ri përmirëson ligjin ekzistues në disa drejtime, ku përfshihen futja e disa koncepteve të reja që lidhen kryesisht me (i) mbikëqyrjen e konsoliduar. Njëkohësisht, projekti parashikon (ii) kërkesa më të forta dhe më të qarta në procesin e licencimit të institucioneve që kryejnë veprimtari bankare; (iii) kërkesa më të forta në drejtim të transparencës së veprimtarisë bankare; (iv) njohje më të mirë të përgjegjësisë së këshillit drejtues dhe të komitetit të kontrollit në drejtimin e veprimtarisë së bankës; (v) procedura më të qarta në drejtim të marrjes së një banke në administrim ose të kalimit të saj në likuidim etj..

Për këtë projekt të ligjit po punohet ngushtë me Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe aktualisht është në proces diskutimi me industrinë bankare dhe me institucione të tjera të rëndësishme të vendit. Miratimi i tij do të lindë dhe nevojën e rishikimit të të gjithë kuadrit nënligjor dhe rregullator, në zbatim të ligjit ekzistues "Për bankat në Republikën e Shqipërisë". Megjithatë, Banka e Shqipërisë gjatë vitit 2005, bazuar në kuadrin ligjor aktual ka rishikuar dhe miratuar një sërë aktesh, të cilat kanë patur për synim konsolidimin e mbikëqyrjes për të siguruar një veprimtari të shëndoshë bankare dhe financiare në vend. Ndër to vlen të përmenden:

1. Ndryshimi i shumës së kapitalit fillestar minimal të paguar për licencimin e një banke dhe i shumës së kapitalit të dhuruar fillestar për licencimin e degës së një banke të huaj nga 700 milionë në 1 miliard

lekë (Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 03, datë 26.01. 2005, për “Një ndryshim në rregulloren “Për dhënien e licencës, për të ushtruar veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë”” dhe në zbatim të tij vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 04, datë 26.01. 2005 për “Caktimin e afateve të plotësimit të kërkesës për rritjen e kapitalit të kërkuar të bankave”).

Qëllimi i ndryshimit të shumës së kapitalit fillestar është krijimi i kushteve të shëndosha për mbarëvajtjen e veprimtarisë bankare në vend, duke siguruar aftësi të mjaftueshme paguese të bankave të nivelit të dytë.

2. Vendimi i Këshillit Mbikëqyrës nr. 28, datë 30.03.2005, për miratimin e rregullore “Për mbikëqyrjen e transaksioneve bankare në rrugë elektronike”, e cila ka për qëllim përcaktimin:
 - a) e kushteve organizative, kushteve në lidhje me personelin dhe kushteve teknike për realizimin e veprimtarisë bankare në rrugë elektronike (e-banking);
 - b) e kërkesave lidhur me verifikimin e kryer nga Banka e Shqipërisë për shërbimin e-banking; dhe
 - c) e parimeve të administrimit të rrezikut të shërbimit e-banking.
3. Vendimi nr. 31, datë 27.04.2005, për një ndryshim në rregulloren “Për normat e mbikëqyrjes së subjekteve jobanka që ushtrojnë veprimtari financiare”, i cili rregullon mënyrën e raportimit të subjekteve jobanka në Bankën e Shqipërisë sipas sistemit raportues të përcaktuar nga Banka e Shqipërisë, në një afat jo më vonë se 40 ditë pas mbylljes së tremujorit.
4. Vendimi nr. 43, datë 08.06.2005, për miratimin e rregullore “Për mbikëqyrjen e shoqërive të kursim-kreditit dhe të unioneve të tyre” dhe vendimi nr. 44, datë 08.06.2005 “Për miratimin e sistemit raportues për shoqëritë e të kursim-kreditit dhe të unioneve të tyre”. Këto vendime kanë sjellë një regjim të ri dhe të përmirësuar të mbikëqyrjes së këtyre subjekteve si dhe një sistem të sofistikuar dhe të detajuar të raportimit të këtyre subjekteve.
5. Vendimi nr. 32, datë 27.04.2005, për miratimin e “Sistemit raportues për subjektet jobanka që ushtrojnë veprimtari financiare”, i cili filloi të zbatohet për herë të parë për tremujorin e parë të vitit 2005, sipas formularëve bashkëlidhur këtij vendimi.
6. Vendimi nr. 45, datë 08.06.2005, për disa ndryshime në udhëzimin “Për kapitalin rregullator të bankës”, i cili ndryshon përkufizimin dhe kriteret e përfshirjes së tij në kapitalin e fitimit ushtrimor të fundit të vitit, duke nënkuptuar me të fitimin ushtrimor të periudhës 01.01 deri 31.12. Ky fitim ushtrimor në bazë të këtij vendimi, përfshihet në kapitalin bazë kur plotësohen në mënyrë të njëkohshme kushtet e mëposhtme:

- a) të jetë verifikuar nga Komiteti i Kontrollit dhe eksperti kontabël i autorizuar,
 - b) të jetë i pakësuar me detyrimin ndaj shtetit për tatimfitimin dhe me masën e dividendëve të parashikuar për t'u shpërndarë.
7. Vendimi nr. 46, datë 08.06.2005, për miratimin e disa ndryshimeve në rregulloren "Për mjaftueshmërinë e kapitalit", i cili përcakton se ndër zërat që zbriten janë dhe "pjesa e zërave të aktivitetit të bilancit të bankës, të garantuar me llogari garancie dhe/ose llogari të bllokuar për garanci të kontabilizuar tek zërat e detyrimeve të bilancit të bankës."
 8. Vendimi nr. 68, datë 28.07.2005, për miratimin e rregullores "Për mbikëqyrjen e konsoliduar", e cila krijon mundësinë e vlerësimit të pozicionit ndaj rrezikut/rreziqeve jo vetëm të veprimtarisë së vetë shoqërisë, por edhe të veprimtarisë së filialeve dhe të pjesëmarrjeve të saj në shoqëri të tjera.
 9. Vendimi nr. 102, datë 28.12.2005, për miratimin e udhëzimit "Për kushtet minimale teknike dhe të sigurisë të mjediseve të punës të subjekteve që licencohen nga Banka e Shqipërisë", me të cilin përcaktohen kushtet për mbrojtjen e paprekshmërisë fizike të të gjitha mjediseve ku zhvillon veprimtarinë subjekti (duke përfshirë mbrojtjen me mjete elektronike dhe atë me personel përkatës sigurie) dhe të personave që i përdorin këto mjedise, si dhe procedurat për mbrojtjen e sistemeve të teknologjisë së informacionit dhe kërkesat për fillimin dhe zhvillimin e veprimtarisë operacionale të subjektit.
 10. Vendimi nr. 88, datë 16.11.2005, për një ndryshim në rregulloren "Për licencimin e subjekteve jobanka", i cili përcakton se përjashtimisht nga pika 1.4.1. subjektet që kryejnë vetëm veprimtarinë e qirasë financiare nuk konsiderohen si subjekte jobanka, sipas përcaktimit të dhënë në këtë rregullore dhe se veprimtaria e këtyre subjekteve rregullohet në bazë të ligjit nr.9396, datë 12.05.2005 "Për qiranë financiare" dhe të akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

V.4.2 LEGJISLACIONI PËR HARTIMIN EDHE ZBATIMIN E POLITIKËS MONETARE

Në fushën e zbatimit të Politikës Monetare në vija të përgjithshme, rregulloret e reja kanë reflektuar zhvillimet më të fundit në tregun financiar si dhe sjellin një përmirësim të komunikimit midis Bankës së Shqipërisë dhe bankave të nivelit të dytë. Disa nga këto rregullore janë si më poshtë vijon:

1. Vendimi nr. 64, datë 20.07.2005 "Për krijimin e Komitetit të Zbatimit të Politikës Monetare". Ky komitet, bazuar në vendimet e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë që lidhen me politikën monetare, si dhe në situatën e tregjeve financiare, ka kompetencën e marrjes së

vendimeve lidhur me ndërhyrjet në tregun e parasë dhe në tregun e brendshëm të këmbimeve valutore. Krahas këtij funksioni, ky komitet ka dhe rolin e këshilltarit për Këshillin Mbikëqyrës së Bankës së Shqipërisë, veçanërisht për çështje që lidhen me qëndrimin e politikës monetare për normën bazë të interesit.

2. Vendimi nr. 13, datë 09.02.2005, për miratimin e “Kontratës - tip për marrëveshjet e riblerjeve dhe të anasjellta të riblerjeve të letrave me vlerë”.
3. Vendimi nr. 57, datë 13.07.2005, për miratimin e rregullores “Për kredinë lombard”, e cila parashikon akordimin e kredisë lombard nga Banka e Shqipërisë çdo banke që konstatohet të ketë mungesë likuiditeti por që është financiarisht e qëndrueshme. Me anë të kësaj kredie arrihet plotësimi i nevojave afatshkurtra për likuiditet të bankave të nivelit të dytë. Kjo lloj kredie përfaqëson instrumentin më të fundit kreditues për sistemin bankar si dhe kredinë më të shtrenjtë në dispozicion të bankave të nivelit të dytë.
4. Vendimi nr. 92, datë 30.11.2005, për miratimin e rregullores “Mbi kredinë brenda ditës për bankat e nivelit të dytë”, e cila përcakton kriteret e dhënies së kredisë njëditore si një instrument huadhënieje për bankat e nivelit të dytë, me afat më të vogël se një ditë pune për plotësimin e nevojave të bankave për likuiditet brenda ditës dhe garantimin i vijueshmërisë normale të funksionimit të sistemit ndërbankar të pagesave.
5. Vendimi nr. 59, datë 13.07.2005, për miratimin e rregullores “Për kredinë njëditore”, e cila përcakton procedurën e dhënies së kredisë njëditore si një instrument afatshkurtër borxhi në dispozicion të bankave të nivelit të dytë, i cili ka për qëllim të shtojë likuiditetin në sistemin bankar dhe të ndihmojë në administrimin e normave afatshkurtra të interesit dhe e cila akordohet për bankat dhe për degët e bankave që kanë llogari në Bankën e Shqipërisë.
6. Vendimi nr.84, datë 16.11.2005, për miratimin e rregullores “Mbi tregun sekondar ndërbankar të letrave me vlerë të Qeverisë të Republikës së Shqipërisë”, i cili organizon tregun sekondar të letrave me vlerë të emetuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë. Ky treg shërben për tregtimin e letrave me vlerë të lartpërmendura në ankandet e tregut primar si dhe përdorimin e letrave me vlerë si mjete për garantimin e kryerjes (ekzekutimit) së operacioneve të ndryshme në tregun ndërbankar.
7. Vendimi nr. 56, datë 13.07.2005, për miratimin e rregullores “Mbi transaksionet e shitblerjeve me të drejta të plota” që i referohen operacioneve të Bankës së Shqipërisë për shitblerjen me të drejta të plota në treg, të bonove të thesarit dhe të letrave të tjera me vlerë;

8. Vendimi nr.38, datë 19.05.2005, për miratimin e rregullores “Mbi procedurat e ndërhyrjes së Bankës së Shqipërisë në tregun e brendshëm të këmbimeve valutore”, e cila përcakton procedurat e ndërhyrjes së Bankës së Shqipërisë në tregun e brendshëm të këmbimeve valutore, në zbatim të objektivave të saj të përcaktuar në ligj.

V.4.3 LEGJISLACIONI PËR SISTEMIN E PAGESAVE

Vendimi nr. 54, datë 29.06.2005, për disa ndryshime në “Rregullat dhe procedurat e Sistemit Shqiptar të Pagesave Ndërbankare – AIPS” dhe vendimi nr. 51, datë 29.06.2005, për miratimin e rregullores “Për procedurat e Sistemit të Kryqëzimit të Pagesave me Vlerë të Vogël (AECH)”. Këto akte nënligjore rregullojnë veprimtarinë e sistemit AIPS dhe AECH si dhe përmirësojnë kuadrin rregullativ në fuqi, në fushën e sistemit të pagesave në Shqipëri lidhur me disa mangësi të vërejtura gjatë procesit të zbatimit me efektivitet të këtij sistemi, duke synuar që të kenë një ndikim pozitiv në mirëfunksionimin e tij.

V.5 ZHVILLIMET NË SISTEMIN E E PAGESAVE

Ligji nr. 8269 “Për Bankën e Shqipërisë” përcakton si detyrë të Bankës së Shqipërisë nxitjen e funksionimit normal të sistemit të pagesave. Për të arritur këtë objektiv të saj, Banka e Shqipërisë është përfshirë në disa aktivitete të rëndësishme që janë:

- organizimi dhe shlyerja e pagesave dhe e letrave me vlerë në territorin e Republikës së Shqipërisë nëpërmjet infrastrukturës së krijuar nga vetë ajo për këtë qëllim;
- zhvillimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i infrastrukturës së sistemeve të pagesave për të qenë sa më afër standardeve ndërkombëtare;
- hartimi dhe reformimi i kuadrit rregullator e procedural për sistemin dhe instrumentet e pagesave;
- mbikëqyrja e sistemit të pagesave.

Mbikëqyrjes së sistemit të pagesave, si një përgjegjësi e rëndësishme e bankës qendrore në sistemin e pagesave, po i kushtohet një vëmendje e veçantë. Komiteti Kombëtar i Pagesave, si një forum ndërbankar i përhershëm si dhe Zyra për Politikën dhe Mbikëqyrjen e Sistemit të Pagesave e sapokrijuar në strukturat e Bankës së Shqipërisë, realizojnë bashkërendimin e punës për realizimin e mbikëqyrjes së sistemit të pagesave.

V.5.1 ZHVILLIMET NË SISTEMIN E PAGESAVE

- Sistemi Shqiptar i Pagesave Ndërbankare – AIPS

Viti 2005 ishte viti i dytë i funksionimit të Sistemit Shqiptar të Pagesave Ndërbankare (AIPS). Gjatë këtij viti sistemi ka realizuar shlyerjen bruto

dhe në kohë reale të pagesave me vlerë të madhe sipas rregullave dhe procedurave në fuqi për sistemin e pagesave, pa patur shmangie apo probleme thelbësore. Gjatë vitit 2005, nëpërmjet sistemit AIPS u qarkullua një vëllim prej 2,201 miliardë lekësh, ku afërsisht 55 për qind përbëhej nga veprime të iniciuara nga Banka e Shqipërisë, 22 për qind nga veprimet e letrave me vlerë, ndërsa 23 për qind nga veprimet ndërbankare dhe për klientelën.

Tabelë 5. Shpërndarja e veprimeve në numër dhe në vlerë (në miliardë lekë).

	2004		2005	
	Numër	vlerë	numër	vlerë
Banka e Shqipërisë	15,143	1,254.10	13,598	1,215.72
LV të qeverisë	216	559.21	451	479.65
Pagesa ndërbankare	5,075	276.15	5,732	419.03
Pagesa për klientë	7,407	63.53	9,169	76.04
Kliringu neto	739	23.44	580	10.58
Totali	28,580.00	2,176.43	29,530.00	2,201.02

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Gjatë vitit 2005 pati një rritje prej rreth 13 për qind në numrin e pagesave ndërbankare, e shoqëruar me një rritje të konsiderueshme prej rreth 52 për qind të vlerës së tyre. Gjithashtu dhe pagesat për klientë patën një rritje prej rreth 24 për qind në numër dhe rreth 20 për qind në vlerë. Zëri që ka pësuar një ulje prej rreth 10 për qind në numër dhe rreth 3 për qind në vlerë, janë pagesat e iniciuara nga Banka e Shqipërisë, të cilat përbëhen kryesisht nga operacionet monetare, veprime me cash-in dhe buxheti i shtetit.

Sistemi AIPS ofron mundësinë e administrimit të likuiditetit nga secila bankë dhe gjithashtu, i krijon mundësi Bankës së Shqipërisë si operator i sistemit, për administrimin total të likuiditetit në sistem. Me qëllim përmirësimit e punës në këtë drejtim, gjatë vitit 2005 u shfuqizua rregullorja ekzistuese "Mbi kredinë brenda ditës", për t'u zëvendësuar me rregulloren e re "Mbi kredinë brenda ditës për bankat e nivelit të dytë" miratuar me vendim nr. 92, datë 30.11.2005 të Këshillit Mbikëqyrës. Kjo rregullore e re e bën më të administrueshëm dhe më efikas përdorimin e këtij instrumenti.

Politika e çmimeve në sistemin AIPS bazohet në rekuperimin e kostove të ndërtimit të sistemit. Po mendohet që në të ardhmen, kësaj politike t'i shtohet dhe një aspekt tjetër që ka të bëjë me optimizimin e rrjedhjes së pagesave në sistem. Tarifimi orar me çmime më të ulëta në orët e para të punës së sistemit, do të inkurajojë dërgimin e pagesave sa më herët duke ulur kështu në mënyrë të konsiderueshme rrezikun e likuiditetit.

Aktualisht në sistemin AIPS, kërkesat për shlyerje vijnë nga veprimet me letrat me vlerë, kliringu i çeqeve dhe i urdhërpagesave. Gjatë vitit 2005 është punuar për realizimin e një marrëveshje me VISA International, për të shlyer veprimet nga kartat në lekë të bankave të nivelit të dytë në Shqipëri, anëtare të Visa International. Në dhjetor u krye nënshkrimi i marrëveshjes dhe pritet që ajo të zbatohet në fillim të vitit 2006.

- Sistemi i Kryqëzimit të Pagesave me Vlerë të Vogël – AECH

Muaji korrik i vitit 2005 shënoi fillim e operacioneve të Sistemit Shqiptar për Kryqëzimin e Pagesave me Vlerë të Vogël – AECH. Zbatimi i sistemit AECH realizoi automatizimin e shërbimit të kleringut të pagesave me vlerë të vogël dhe pasuroi më tej infrastrukturën e sistemit të pagesave. Ky sistem është mbështetur dhe integrohet tek sistemi AIPS dhe është realizuar në përputhje me standardet dhe parimet më të mira ndërkombëtare, si dhe duke u bazuar në teknologji moderne e bashkëkohore. Sistemi AECH u realizua nën asistencën dhe konsulencën e Bankës Botërore.

Sistemi AECH synon në:

- i) rritjen e automatizimit të proceseve e njëkohësisht rritjen e saktësisë, shpejtësisë dhe uljen e kostove të përpunimit për pagesat me vlerë të vogël mes bankave;
- ii) ofrimin, Bankës së Shqipërisë dhe bankave të nivelit të dytë, të mjeteve eficiente për monitorimin dhe administrimin e likuiditetit dhe shmangien e reziqeve të kreditit dhe likuiditetit; dhe
- iii) pasurimin e infrastrukturës mbështetëse për zhvillime të mëtejshme në sistemet e pagesave dhe sistemeve të tjera financiare të lidhura me to.

Pjesëmarrës në sistem janë bankat e nivelit të dytë dhe Banka e Shqipërisë. Kjo e fundit është në rolin e pronarit të sistemit si edhe mbikëqyr, organizon, administron dhe operon sistemin.

Sistemi AECH mundëson shlyerjen me bazë neto të të gjitha pagesave me vlerë të vogël, të kanalizuar në mënyrë elektronike në sistem nga bankat, në orare të përcaktuara sipas një numri të përcaktuar seancash kleringu. Ekzekutimi i këtyre instruksioneve të shlyerjes neto kryhet në mënyrë të parevokueshme dhe të pakushtëzuar në sistemin AIPS. Bankat kanë mundësi të monitorojnë dhe të administrojnë radhën e pagesave në grup si dhe likuiditetet e tyre.

Baza ligjore për funksionimin e sistemit përbëhet nga rregullorja “Për procedurat e Sistemit të Kryqëzimit të Pagesave me Vlerë të Vogël (AECH)” miratuar me vendimin nr. 51, datë 29.06.2005 të Këshillit Mbikëqyrës, Kontrata e Pjesëmarrjes në Sistem, si dhe rregullat e procedurat për çdo pjesëmarrës në sistem.

Gjatë 5 muajve të operimit të sistemit AECH, në vitin 2005 sistemi ka realizuar me efektivitet klerimin dhe shlyerjen e pagesave me vlerë të vogël. Gjatë kësaj kohe sistemi AECH përpunoi një vëllim total pagesash prej 24 780 pagesa me vlerë të vogël, me një vlerë prej 3.9 miliard lekësh.

- Kleringu i çqeve

Edhe gjatë vitit 2005, çeku mbetet një instrument pagese në nivele modeste, dhe përdorimi i çekut bankar është i kufizuar. Numri i çqeve të kleruara në

seancat e kleringut gjatë vitit 2005 ishte 2 521, me një vlerë 10.28 miliardë lekë.

- Mjetet elektronike

Gjatë vitit 2005 kemi një përmirësim të vazhdueshëm dhe shtim të përpjekjeve të sistemit bankar për përmirësimin dhe modernizimin e infrastrukturës së pagesave, duke investuar më tej në drejtim të përdorimit të mjeteve elektronike të pagesave. Numri i terminaleve pranuese është rritur në mënyrë të konsiderueshme, në krahasim me rritjen e vitit të kaluar. Në fund të vitit 2005 numri i ATM-ve ishte 205, kurse i POS/EFTPOS-eve 779, kundrejt 93 dhe 155 respektivisht për fundvitin 2004. Sipas raportimeve të bankave pranë Bankës së Shqipërisë, pajisjet pranuese të kartave (ATM dhe POS) operojnë kryesisht në lekë, por gjatë këtij viti janë vënë në funksionim dhe POS/EFTPOS-e në valutë dhe saktësisht në usd. Gjatë vitit 2005, numri i kartave (cash-i, debiti dhe krediti) në përdorim, u rrit me rreth 7 herë (në dhjetor 2005 numëroheshin 225,913 karta).

Kartat janë lëshuar kryesisht në lekë. Gjithashtu, vëmë re një ndryshim të trendit në krahasim me vitin 2004. Nëse në 2004 ishte karta me funksion cash-i ajo që mbizotëronte, në vitin 2005 vërejmë një rritje të përshpejtuar (nga 6 552 karta në dhjetor 2004 në 182 113 karta në dhjetor 2005) të numrit të kartave me funksion debiti. Gjithashtu, gjatë vitit 2005 vihet re dhe shtimi jo vetëm në numër (rreth 3 herë) por edhe në llojshmëri i kartave të kreditit.

SHËNIME

¹ Flitet për "Ciklin e shkurtër të qarkullimit" të parasë (banka të nivelit të dytë – Banka e Shqipërisë).



RAPORTI I AUDITORËVE
TË PAVARUR
DHE PASQYRAT
FINANCIARE
PËR VITIN E MBYLLUR
MË 31 DHJETOR 2005

RAPORTI I AUDITORËVE TË PAVARUR DHE PASQYRAT FINANCIARE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2005

RAPORTI I AUDITORËVE TË PAVARUR

Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë:

Ne kemi audituar bilancin e pakonsoliduar të bashkëngjitur të Bankës së Shqipërisë ("Banka") më datën 31 dhjetor 2005, si dhe pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, pasqyrën e ndryshimeve të kapitalit të vet dhe rezervave dhe pasqyrën e rrjedhjes së parasë për vitin ushtrimor të mbyllur në këtë datë. Drejtimi i Bankës është përgjegjës për përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare. Përgjegjësia jonë është të japim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimin e kryer nga ana jonë.

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të planifikojmë dhe të zbatojmë procedurat e auditimit, për të dhënë një siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare janë pa gabime materiale. Një auditim përfshin ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shifrat dhe informacionet e tjera të pasqyrave financiare. Auditimi, gjithashtu, përfshin vlerësimin e parimeve kontabël të përdorura dhe të parashikimeve kryesore të bëra nga Drejtimi, si dhe jep një vlerësim të përgjithshëm mbi paraqitjen e pasqyrave financiare. Ne besojmë se auditimi i kryer nga ne siguron një bazë të arsyeshme për opinionin e dhënë.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të pakonsoliduara paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Bankës në datën 31 dhjetor 2005 dhe rezultatin e aktiviteteve të saj, ndryshimeve në kapitalin e vet dhe rezervave dhe rrjedhjes së parasë, për vitin ushtrimor të mbyllur në këtë datë, në përputhje me politikat kontabël të përshtatura nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, të paraqitura në Shënimin 2 të pasqyrave financiare.

Janis Shkollari

Tiranë, Shqipëri

13 mars 2006

BILANCI

MË 31 DHJETOR 2005 DHE 2004

(të gjitha balancat janë në milionë lekë, nëse nuk është shënuar ndryshe.)

	Shënim nr.	31 dhjetor 2005	31 dhjetor 2004
AKTIVET			
Aktive në monedhë të huaj			
Ari dhe metale të çmuara	3	708	540
Depozita tek Fondi Monetar Ndërkombëtar	4	8,431	16,817
Depozita në bankat jorezidente	5	10,175	11,489
Letra me vlerë të disponueshme për shitje	6	133,464	104,450
Aktive të tjera	7	551	559
Totali i aktiveve në monedhë të huaj		153,329	133,855
Aktive në monedhën vendase			
Ari dhe metale të çmuara	3	50	40
Kredi tranzite	8	207	277
Letra me vlerë të disponueshme për shitje	9.1	66,821	63,786
Investime të mbajtura deri në maturim	9.2	1,725	1,649
Aktive të tjera	10	2,523	2,553
Totali i aktiveve në monedhën vendase		71,326	68,305
Totali i aktiveve		224,655	202,160
DETYRIMET			
Detyrime në monedhë të huaj			
Detyrime ndaj Fondit Monetar Ndërkombëtar	11	16,145	15,948
Detyrime ndaj institucioneve financiare jorezidentë	12	1,319	1,527
Totali i detyrimeve në monedhë të huaj		17,464	17,475
Detyrime në monedhën vendase			
Para në qarkullim	13	153,550	141,630
Detyrime ndaj bankave rezidente	14	45,182	39,318
Detyrime ndaj qeverisë	15	6,356	5,302
Të ardhura për t'u shpërndarë	16	129	106
Detyrime të tjera	17	761	578
Totali i detyrimeve në monedhën vendase		205,978	186,934
KAPITALI DHE REZERVAT			
Kapitali themeltar			
Rezerva ligjore		3,750	3,750
Rezerva e rivlerësimit	18	(11,469)	(14,824)
Rezerva të tjera	19	8,182	8,075
Totali i kapitalit të vet dhe rezervat		1,213	(2,249)
Totali i detyrimeve, kapitali i vet dhe rezervat		224,655	202,160

Shënimet mbi pasqyrat financiare nga faqja 9 deri në faqen 37 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE
PËR VITET E MBYLLURA MË 31 DHJETOR 2005 DHE 2004
(të gjitha balancat janë në milionë lekë, nëse nuk është shënuar ndryshe.)

	Shënim nr.	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2005	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2004
Veprime me jorezidentë			
Të ardhura nga interesa dhe komisione	20	4,345	3,209
Shpenzime për interesa dhe komisione	21	(660)	(683)
Totali neto nga veprimet me jorezidentë		3,685	2,526
Veprime me rezidentë			
Të ardhura nga interesa dhe komisione	22	4,328	5,271
Shpenzime për interesa dhe komisione	23	(1,393)	(1,344)
Totali neto nga veprime me rezidentë		2,935	3,927
(Shpenzime) / të ardhura operative të tjera, neto	24	(360)	144
Totali neto i të ardhurave operative		6,260	6,597
Shpenzime të tjera administrative			
Shpenzime të personelit	25	(528)	(436)
Shpenzime zhvlerësimi të aktiveve të trupëzuara	10	(115)	(110)
Shpenzime amortizimi të aktiveve të patrupëzuara	10	(159)	(339)
Shpenzime të përgjithshme dhe administrative		(280)	(253)
Totali i shpenzimeve të tjera operative		(1,082)	(1,138)
FITIMI NETO		5,178	5,459

Shënimet mbi pasqyrat financiare nga faqja 9 deri në faqen 37 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

PASQYRA E NDRYSHIMEVE TË KAPITALIT TË VET DHE REZERVAVE
PËR VITET E MBYLLURA MË 31 DHJETOR 2005 DHE 2004
(të gjitha balancat janë në milionë lekë, nëse nuk është shënuar ndryshe.)

	Kapitali themeltar	Rezerva ligjore	Rezerva e rivlerësimit	Rezerva të tjera	Fitimi i pashpërndarë	Totali
Gjendja më 31 dhjetor 2003	750	3,750	(6,330)	7,878	-	6,048
Fitimi neto i vitit	-	-	-	-	5,459	5,459
Rivlerësimi i valutave të huaja dhe arit	-	-	(8,333)	-	-	(8,333)
Rivlerësimi i letrave me vlerë	-	-	(133)	-	-	(133)
Rimarrje e tepicës nga rivlerësimi i aktiveve fikse	-	-	(28)	-	28	-
Shpërndarja e fitimit të vitit	-	-	-	197	(5,487)	(5,290)
Gjendja më 31 dhjetor 2004	750	3,750	(14,824)	8,075	-	(2,249)
Fitimi neto i vitit	-	-	-	-	5,178	5,178
Rivlerësimi i valutave të huaja dhe arit	-	-	3,841	-	-	3,841
Rivlerësimi i letrave me vlerë	-	-	(447)	-	-	(447)
Rimarrje e tepicës nga rivlerësimi i aktiveve fikse	-	-	(29)	-	29	-
Të tjera rivlerësime	-	-	(10)	-	-	(10)
Shpërndarja e fitimit të vitit	-	-	-	107	(5,207)	(5,100)
Gjendja më 31 dhjetor 2005	750	3,750	(11,469)	8,182	-	1,213

Shënimet mbi pasqyrat financiare nga faqja 9 deri në faqen 37 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

PASQYRA E RRJEDHJES SË PARASË

PËR VITET E MBYLLURA MË 31 DHJETOR 2005 DHE 2004

(të gjitha balancat janë në milionë lekë, nëse nuk është shënuar ndryshe.)

	Shënim nr.	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2005	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2004
Rrjedhja e parasë nga operacionet			
Fitimi neto i vitit		5,178	5,459
Zëra jo në para në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve			
Provizgjone për hua të dyshimta		6	17
Zhvlerësimi dhe amortizimi		274	449
Amortizimi i skontos së letrave me vlerë të disponueshme për shitje		(3,760)	(4,643)
Të ardhura nga interesat		(4,300)	(3,208)
Shpenzime për interesat		1,457	1,405
Humbje/(fitim) nga shitja e letrave me vlerë të disponueshme për shitje		397	(80)
Amortizimi i grantit (të ardhura për t'u shpërndarë)		(41)	(79)
Rrjedhja e parasë para lëvizjes së kapitalit punues		(789)	(680)
Ndryshime në kapitalin punues			
Pakësimi në depozita me FMN		8,359	1,248
Pakësimi në aktive të tjera (në monedhë të huaj)		8	27
Pakësimi në kreditë tranzite		70	107
Rritja në aktive të tjera (në monedhë vendase)		(36)	(107)
Rritja/(pakësimi) në detyrimet ndaj FMN		197	(1,530)
Pakësimi në detyrimet ndaj institucioneve financiare		(208)	(220)
Rritja në detyrimet ndaj bankave rezidente		7,629	4,292
Rritja/(pakësimi) në detyrimet ndaj qeverisë		1,054	(162)
Rritja në pasive të tjera (në monedhë të vendase)		181	169
Grant i marrë		64	68
Rrjedhja e parasë e gjeneruar nga operacionet		17,318	3,892
Interesa të marrë		3,993	2,955
Interesa të paguar		(1,465)	(1,408)
Paraja neto e gjeneruar në aktivitete operacionale		19,057	4,759

PASQYRA E RRJEDHJES SË PARASË (VAZHDIM)
 PËR VITET E MBYLLURA MË 31 DHJETOR 2005 DHE 2004
 (të gjitha balancat janë në milionë lekë, nëse nuk është shënuar ndryshe.)

	Shenim nr.	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2005	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2004
Rrjedhja e parasë nga investimet			
Blerja e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara		(152)	(88)
Blerja e aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara		(59)	(168)
Blerja e letrave me vlerë të disponueshme për shitje (në monedhë të huaj)		(234,083)	(83,507)
Blerje e letrave me vlerë të disponueshme për shitje (në monedhë vendase)		(180,421)	(182,577)
Shitja e letrave me vlerë të disponueshme për shitje (në monedhë të huaj)		207,802	57,493
Shitja e letrave me vlerë të disponueshme për shitje (në monedhë vendase)		181,506	195,614
(Pakësimi) / rritja në marrëveshjet e riblerjes		(1,758)	1,059
Efekti i kursit të këmbimit		158	(271)
Paraja neto e përdorur në investime		(27,007)	(12,445)
Rrjedhja e parasë prej financimit			
Rivlerësimi i rezervave të tjera		(10)	-
Rritja në rezerva të tjera		107	197
Rritja në emetimin e parasë në qarkullim		15,000	13,500
Fitimi i shpërndarë		(5,207)	(5,487)
Paraja neto e gjeneruar nga investimet		9,890	8,210
Rritja në para gjatë vitit		1,940	524
Paraja dhe ekuivalentet e saj në fillim të vitit	26	22,450	21,926
Paraja dhe ekuivalentet e saj në fund të vitit	26	24,390	22,450

Shënimet mbi pasqyrat financiare nga faqja 9 deri në faqen 37 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE

PËR VITET E MBYLLURA MË 31 DHJETOR 2005 DHE 2004

(të gjitha balancat janë në milionë lekë, nëse nuk është shënuar ndryshe.)

1. INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME

Banka e Shqipërisë ("Banka") është banka qendrore e Republikës së Shqipërisë, që ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me ligjin nr. 8269, datë 23 dhjetor 1997 "Për Bankën e Shqipërisë".

Në zbatim të këtij ligji detyrat kryesore të Bankës janë si vijon:

- arritja dhe ruajtja e stabilitetit të çmimeve;
- nxitja dhe mbështetja e zhvillimit të një regjimi të këmbimeve valutore;
- administrimi i parasë në qarkullim;
- administrimi i normave të interesit;
- hartimi, miratimi dhe zbatimi i politikës monetare të Republikës së Shqipërisë;
- mbikëqyrja e aktiviteteve të bankave të nivelit të dytë përfshirë dhënien e licencave të të gjitha bankave;
- dhënia e licencave për ushtrimin e aktivitetit brenda territorit të Republikës së Shqipërisë të institucioneve bankare ndërkombëtare.

Banka i nënshtrohet ligjeve të miratuara nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë dhe ligjit "Për Bankën e Shqipërisë".

2. PËRMBLEDHJE E DISA PARIMEVE TË RËNDËSISHME KONTABËL

(a) Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me ligjin shqiptar "Mbi kontabilitetin" dhe në përputhje me parimet e kontabilitetit, të përshtatura nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë. Kjo politikë kontabël është gjerësisht në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF") të aprovuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ("BSNK"), me përjashtim të disa standardeve si SNK 16, SNK 21, SNK 19, SNK 26, SNK 27 dhe SNK 20. Këto standarde dhe interpretime njiheshin më parë si Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit ("SNK"). Sipas bazës rregullative vendase, SNRF përdoren në përgatitjen e pasqyrave financiare të bashkëngjitura deri në fazën ku nuk bien në kundërshtim me ligjin shqiptar "Mbi kontabilitetin" apo rregullore të tjera vendase.

Parimet e kontabilitetit më domethënëse që janë përdorur nga Banka në pasqyrat financiare janë përshkruar shkurtimisht si më poshtë.

Pasqyrat financiare të paraqitura përfshijnë llogaritë e Bankës, përgatitur mbi bazën e kostos historike të kontabilitetit, përshtatur për të përfshirë rivlerësimin e portofolit të letrave me vlerë, të valutave të huaja, të arit, të ndërtesës qendrore, si dhe të aktiveve dhe detyrimeve të tjera financiare të disponueshme për shitje.

Pasqyrat financiare paraqiten në monedhën vendase të Republikës së Shqipërisë, Lek Shqiptar ("Lek").

2. PËRMBLEDHJE E DISA PARIMEVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

(a) Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)

Banka kontrollon aktivitetin e Shtypshkronjës, një njësi biznesi e cila merret me shtypshkrimin e materialeve të Qeverisë që përmbajnë elemente të sigurisë së lartë, si dhe të publikimeve të Bankës së Shqipërisë. Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë më datë 1 prill 2003, vendosi që Shtypshkronja të mbetet përkohësisht në varësi administrative të Bankës së Shqipërisë, si pjesë e veçantë e strukturës organizative të saj. Operacionet financiare të Shtypshkronjës nuk janë konsoliduar me ato të Bankës për faktin se Shtypshkronja nuk ka kryer rivlerësimin e mjeteve financiare dhe ndërtesave të saj, konform me rivlerësimin e mjeteve financiare dhe ndërtesave të Bankës.

Pozicioni financiar i Shtypshkronjës më 31 dhjetor 2005 dhe 2004 është i pasqyruar në shënimin 25 të këtyre pasqyrave financiare.

(b) Shmangie nga Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar

Standardet më të rëndësishme që nuk kanë gjetur zbatim gjatë vitit 2005, mund të përmbliidhen sa më poshtë:

- SNK 16: "Pasuria, toka dhe pajisjet".

Metodologjia e zbatuar për rivlerësimin e ndërtesës qendrore, siç është detajuar në shënimin 10, nuk është në përputhje me kërkesat e SNK 16 mbi pasurinë, tokën dhe pajisjet në faktin se rivlerësimi nuk u krye nga vlerësues të pavarur profesionalisht të kualifikuar, rrjedhjet e ardhshme të parasë nuk u skontuan dhe nuk u rivlerësuan të gjitha njësitë përbërëse të kategorisë së ndërtesave.

- SNK 21: "Efektet e ndryshimit të kurseve të këmbimit".

Ligji mbi Bankën e Shqipërisë kërkon njohjen e fitimit/humbjes së realizuar nga rivlerësimi i kursit të këmbimit në bilanc, në llogarinë "Kapitali dhe rezervat" dhe jo si e ardhur/shpenzim për periudhën në të cilën rivlerësimi ka ndodhur.

- SNK 19: "Përfitimet e punonjësve" dhe SNK 26 "Kontabiliteti dhe raportimi i fondit të pensionit".

Pasqyrimi dhe kontabiliteti i Fondit të Pensionit nuk është bërë në përputhje me SNK 19 dhe SNK 26. Detyrimi ndaj fondit të pensionit është shprehur si vlerë neto, por përlogaritja e këtij detyrimi nuk i është përmbajtur specifikimeve të standardit, për shkak se nuk është bërë asnjë vlerësim aktuarial.

- SNK 27: "Pasqyrat financiare të konsoliduara dhe kontabiliteti i investimit në filiale".

Në pasqyrat financiare të Bankës nuk është bërë konsolidimi i raporteve financiare në lidhje me aktivitetin e Shtypshkronjës, njësi që administrohet nga Banka, siç sqarohet sa më sipër.

- SNK 20 "Kontabiliteti për grantet qeveritare".

Gjatë viteve 1992 – 1993 Banka ka marrë grante nga Komuniteti Evropian dhe Qeveria Zvicerane për përmirësimin e bilancit të pagesave të Qeverisë së Shqipërisë. Këto grante janë prezantuar nga Banka në zërin "Rezerva për bilancin e pagesave". Kjo politikë nuk është në përputhje me SNK 20, e cila kërkon që grantet e marra nga qeveritë duhet të njihen si e ardhur në periudhat e nevojshme, për t'i përputhur ato me kostot korrespondente të cilat ato synojnë të kompensojnë, në një bazë sistematike.

2. PËRMBLEDHJE E DISA PARIMEVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

(c) Interesa dhe komisione

Në përgatitjen e pasqyrave financiare të ardhurat dhe shpenzimet nga/për interesa njihen sipas kontabilitetit të të drejtave të konstatuara. Të ardhurat dhe shpenzimet për interesa përfshijnë edhe amortizimin e çdo primi apo skontoje nga blerja e instrumenteve financiare.

Të ardhurat dhe shpenzimet nga komisionet regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në momentin që shërbimi kryhet ose paguhet.

(d) Konvertimi i valutave të huaja

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në lekë me kursin zyrtar të këmbimit të Bankës, në datën e kryerjes së transaksionit. Aktivët dhe pasivët në monedhë të huaj konvertohen në lekë me kursin zyrtar të këmbimit të Bankës në datën e bilancit. Fitimi ose humbja e përealizuar nga konvertimi i kurseve të këmbimit njihen në llogarinë "Rezerva të rivlerësimit".

Kurset zyrtare të këmbimit të përdorura nga Banka (njësi e monedhës së

huaj përkatëse e shprehur në lekë) për monedhat e huaja më kryesore, më 31 dhjetor 2005 dhe 2004 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2005	31 dhjetor 2004
Dollari amerikan ("Usd")	103.58	92.64
Monedha evropiane ("Eur")	122.58	126.35
Stërlina angleze ("Gbp")	178.65	178.69
Të drejta të veçanta tërheqjeje ("Sdr")	148.03	143.39
Jen japonez ("Jpy")	0.8826	0.9036
Ari ("Xau")	1 onz = 53,136.54	1 onz = 40,576.32

2. PËRMBLEDHJE E DISA PARIMEVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

(e) Aktivet financiare

Të gjitha aktivet financiare shprehen fillimisht me kosto, që konsiderohet çmimi i blerjes përfshirë shpenzimet e lidhura me blerjen e aktivit financiar.

Aktivët financiarë klasifikohen si më poshtë:

Hua të krijuara nga Banka.

Huatë janë aktive financiare me pagesa fikse ose të paracaktuara, të cilat nuk tregtohen në një treg aktiv por krijohen nga Banka për t'i siguruar fonde huamarrësit. Huatë përfshijnë huatë për punonjësit.

Në çdo datë raportimi ato paraqiten në pasqyrat financiare me koston e amortizuar, duke zbritur çdo humbje nga rënia e vlerës për të reflektuar shumat që nuk mund të rekuperohen më.

Të mbajtura deri në maturim.

Letrat me vlerë të mbajtura deri në maturim, janë instrumente financiare të cilat mbartin pagesa fikse ose të përcaktuara dhe me maturime fikse, për të cilat Banka ka qëllimin pozitiv dhe mundësinë për t'i mbajtur deri në maturim.

Letrat me vlerë të mbajtura deri në maturim njihen duke u bazuar në datën e tregtimit dhe fillimisht regjistrohen me kosto. Në çdo datë raportimi ato paraqiten në pasqyrat financiare me vlerën e amortizuar, duke zbritur humbjen nga rënia në vlerë, e cila njihet për të reflektuar shumat e parekuperueshme.

Të disponueshme për shitje.

Letrat me vlerë që klasifikohen si të disponueshme për shitje paraqiten në pasqyrat financiare me vlerën reale. Ndryshimet në vlerën reale pasqyrohen si një komponent i veçantë i kapitalit derisa investimi shitet, arkëtohet ose nuk zotërohet më, dhe në këtë moment fitimi apo humbja e akumuluar e njohur deri në atë moment në kapital, njihet si e ardhur ose shpenzim.

Vlera reale.

Për letrat me vlerë që tregtohen në tregje financiare të organizuara, vlera reale përcaktohet duke iu referuar çmimeve të kuotuar në bursë, në momentin e mbylljes së aktivitetit të biznesit në datën e bilancit.

Për letrat me vlerë, për të cilat nuk ekziston një çmim i kuotuar në bursë, një vlerësim i arsyeshëm i vlerës reale përcaktohet duke iu referuar vlerës aktuale të tregut të një letre tjetër me vlerë, e cila është e përafërt në natyrë.

2. PËRMBLEDHJE E DISA PARIMEVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

(e) Aktivitet financiar (vazhdim)

Rënia në vlerë dhe paarkëtueshmëria e aktiveve financiare.

Në çdo datë bilanci bëhet një vlerësim për të përcaktuar nëse ekziston një provë objektive që një aktiv financiar ose një grup aktivesh financiare mund të ketë pësuar rënie në vlerë. Në qoftë se një evidencë e tillë ekziston, përcaktohet shuma që vlerësohet të merret nga ai aktiv dhe ndonjë humbje nga rënia në vlerë, duke u bazuar në vlerën neto aktuale të rrjedhjes së ardhshme të parasë që pritet të merret, dhe diferenca midis shumës që vlerësohet të merret dhe vlerës kontabël njihet si më poshtë:

- për huatë e krijuara nga Banka - shuma e rekuperueshme e huasë së krijuar llogaritet bazuar mbi vlerësimin në fund të vitit për huatë, duke përfshirë dhe interesin e akumuluar. Në përcaktimin e shumave të rekuperueshme nga huatë për personelin, drejtuesit duhet të konsiderojnë shumë faktorë, duke përfshirë dhe historinë e pagesave të ish-punonjësve. Provigjoni për rënien në vlerë të huave, raportohet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve si një shpenzim dhe zbritet nga kategoria përkatëse e aktiveve në bilanc. Kur vendoset që një hua nuk mund të rekuperohet më, të gjitha procedurat e nevojshme ligjore janë përfunduar dhe humbja përfundimtare është përcaktuar, huaja hiqet nga librat;
- për aktivet financiare të mbajtura deri në maturim – vlera e mbartur e aktivitetit ulet deri në shumën që vlerësohet të merret në mënyrë direkte ose nëpërmjet përdorimit të një llogarie provigjoni dhe shuma e humbjes përfshihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve; dhe
- për aktivet financiare të disponueshme për shitje – në qoftë se rënia në vlerën e tregut e një aktivi të disponueshëm për shitje është kaluar direkt në kapital dhe ka një evidencë objektive që aktivi mund të ketë rënie në vlerë, humbja e akumuluar që është njohur direkt në kapital do të hiqet nga kapitali dhe do të njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve edhe nëse aktivi financiar është paraqitur në pasqyrat financiare.

(f) Marrëveshjet e riblerjes dhe marrëveshjet e anasjellta të riblerjes

Letrat me vlerë blerë nën marrëveshje për t'i rishitur (marrëveshje riblerjeje e anasjelltë) dhe letrat me vlerë shitur nën marrëveshje për t'i riblerë (marrëveshjet e riblerjes) janë trajtuar përgjithësisht si të kolateralizuara dhe regjistrohen me shumën e para dhënë / marrë, plus interesin e përlllogaritur.

Marrëveshjet e riblerjes regjistrohen në bilanc në zërin "Detyrime ndaj bankave vendase". Bazuar mbi rregulloren e Bankës së Shqipërisë mbi marrëveshjet e riblerjes, bankës nuk i duhet të krijojë kolateral për këto letra me vlerë.

Interesi i fituar mbi marrëveshjet e anasjellta të riblerjes dhe interesi i paguar mbi marrëveshjet e riblerjes, njihen si të ardhura ose shpenzime nga interesi gjatë jetëgjatësisë së çdo marrëveshjeje, duke përdorur normën bazë të interesit të shpallur me vendim të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës.

2. PËRMBLEDHJE E DISA PARIMEVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

(g) Aktive të qëndrueshme

Aktivitet e qëndrueshme shprehen me koston historike zvogëluar me amortizimin e akumuluar, me përjashtim të ndërtesës qendrore të Bankës, e cila është vlerësuar më 29 mars 2000 (Shënimi 10).

Në qoftë se vlera e tregut e një aktivi të qëndrueshëm është më e vogël sesa vlera kontabël, për shkak të rrethanave të konsideruara jo të përkohshme, aktivi zvogëlohet deri në vlerën reale.

Fitimet ose humbjet nga heqja (shitjet ose nxjerrjet jashtë përdorimit) e aktiveve të qëndrueshme regjistrohen në llogarinë humbje-fitim të vitit në të cilin aktivi është hequr.

Amortizimi llogaritet mbi të gjitha aktivet fikse bazuar në koston historike. Amortizimi vjetor llogaritet me metodën lineare, duke përdorur normat specifike të amortizimit për çdo aktiv të amortizueshëm, bazuar në jetëgjatësinë e vlerësuar të aktivitet. Jetëgjatësia e zbatuar në vitin 2005 është e njëjtë me atë të vitit 2004:

	2005
Ndërtesa-godina qendrore	40 vjet
Ndërtesat-në degë	25 vjet
Mjete transporti	5-10 vjet
Pajisje zyre	3-20 vjet
Programe kompjuteri	2 vjet

(h) Kosto të shtypjes dhe të prerjes së parasë

Kostot e printimit të kartëmonedhave dhe të prerjes së monedhave

kapitalizohen si aktive fikse të patrupëzuara dhe amortizohen respektivisht me 2.5 vjet dhe 10 vjet.

(i) Tatimi dhe shpërndarja e fitimit

Banka është e përjashtuar nga tatimi mbi fitimin në bazë të ligjit "Për Bankën e Shqipërisë" dhe kërkohet me ligj që 100 për qind e fitimit të kalojë direkt në buxhetin e Shtetit, pas plotësimit të niveleve të fondeve rezervë të kërkuara nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë.

(j) Rezerva ligjore

Në përputhje me ligjin "Për Bankën e Shqipërisë", Banka ka krijuar një rezervë ligjore në të cilën, 25 për qind e fitimit neto të vitit transferohet derisa shuma e rezervës arrin 500 për qind të kapitalit themeltar.

2. PËRMBLEDHJE E DISA PARIMEVE TË RËNDËSISHME KONTABËL
(VAZHDIM)

(k) Grantet

Grantet regjistrohen fillimisht në bilanc me shumën e marrë. Grantet që lidhen me zëra shpenzimi kalohen te pasqyra e të ardhurave e shpenzimeve gjatë periudhës që është bërë shpenzimi. Grantet që lidhen më blerjen e pronave, të pajisjeve dhe të programeve kompjuterike kalohen te pasqyra e të ardhurave e shpenzimeve përgjatë jetës së aktivit përkatës, në shumën që i përket zhvlerësimit/amortizimit që i zbritet aktivitetit.

(l) Paraja dhe ekuivalentet e saj

Për qëllimin e përgatitjes së pasqyrës së rrjedhjes së parasë, paraja dhe ekuivalentet e saj ndahen në Arka në Lek dhe në monedha të huaja, dhe depozita në monedhë të huaj me maturitet të mbetur më pak se tre muaj.

(m) Përdorimi i parashikimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon nga drejtimi i Bankës që të bëjë parashikime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, dhe paraqitjen e aktiveve dhe detyrimeve kontigjente, llogaritur në datën e përgatitjes së pasqyrave financiare dhe shumat e raportuara të të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë periudhave të raportuara. Ky parashikim bëhet sepse rezultatet faktike mund të ndryshojnë nga ato të parashikuara.

(n) Krahasimi

Disa shifra krahasuese në pasqyrën e rrjedhjes të parasë janë riklasifikuar që të jenë konform prezantimit të vitit aktual.

2. PËRMBLEDHJE E DISA PARIMEVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

(o) Aktive të administruara

Më 31 dhjetor 2005, Banka mbante në kujdestari bono thesari afatshkurtra, me vlerë nominale 292 miliardë lekë, të emetuara nga Ministria e Financave, si edhe ar dhe metale të tjera të çmuara në emër të Qeverisë me vlerë tregu prej 4,694 milionë lekësh.

Meqë Banka luan rolin e një kujdestari për këto aktive, ajo nuk mbart asnjë lloj rreziku krediti.

Më 31 dhjetor 2005 dhe 2004 vlera e arit në emër të Qeverisë përbëhet si më poshtë:

	31 dhjetor 2005	31 dhjetor 2004
Ar i standardizuar jashtë vendit	2,970	2,268
Ar i pastandardizuar brenda vendit	1,564	1,194
Metale të tjera të çmuara	160	115
Totali	4,694	3,577

Interesat e marrë nga depozitimi i rezervave të arit të Qeverisë njihen si të ardhura nga interesat për Qeverinë, duke rritur detyrimin ndaj tyre. Për vitin 2005 interesat e marrë janë rreth 6 onz. Ndryshimi i vlerave të administruara prej 1,117 milionë lekësh, rezulton nga luhatja e kurseve të këmbimit (Shënimi 3).

Këto llogari nuk pasqyrohen në pozicionin financiar të Bankës.

3. ARI DHE METALE TË ÇMUARA

Më 31 dhjetor 2005, vlera e arit të vendosur në depozita, mjete të Bankës ishte 708 milionë lekë (2004 – 540 milionë lekë), e cila përbëhet prej 13,319 onz në shufra prej ari (2004 – 13,319 onz ar).

Ari është vlerësuar me kursin e këmbimit fiks të Londrës në datën e bilancit. Diferenca prej 168 milionë lekësh (2004 – 56 milionë lekë), rezulton nga rivlerësimi i arit dhe është regjistruar në rezervën e rivlerësimit. Më 31 dhjetor 2005, një onz ar u vlerësua me 513 usd (2004 – 438 usd).

Ari dhe metale të tjera të çmuara të përfshira në aktive vendase, përfshin gjendjet e platinit dhe të argjendit në kasafortë, të vlerësuar me kursin e këmbimit fiks të Londrës në datën e bilancit, me një shumë totale prej 45 milionë lekësh më 31 dhjetor 2005 (2004 – 36 milionë lekë) si edhe ar i pastandardizuar në 5 milionë lekë (2004 – 4 milionë lekë).

4. DEPOZITA TEK FONDI MONETAR NDËRKOMBËTAR

	31 dhjetor 2005	31 dhjetor 2004
Fondi Monetar Ndërkombëtar	7,128	7,476
E drejta speciale e tërheqjes ("Sdr")	1,295	9,306
Interes i përllogaritur	8	35
Totali	8,431	16,817

Kuotat tek Fondi Monetar Ndërkombëtar ("FMN") rezultojnë prej anëtarësisë së Republikës së Shqipërisë në FMN, në përputhje me ligjin nr. 8269, datë 23 dhjetor 1997 "Për Bankën e Shqipërisë", e cila ka si kundërparti huatë e dhëna për Republikën e Shqipërisë siç paraqitet në Shënimin 11.

E drejta speciale e tërheqjes përfaqëson depozitat e vendosura pranë Fondit Monetar Ndërkombëtar, të cilat gjatë vitit 2005 pjesërisht u zbërthyen sipas monedhave përbërëse (Euro, Gbp, Usd dhe Jpy) për arsye të administrimit më aktiv të këtyre fondeve.

Depozitat në Sdr kanë një interes, i cili është i përcaktuar në bazë javore. Norma e interesit më 31 dhjetor 2005 ishte 3.03 për qind (2004 – 2.22 për qind).

5. DEPOZITA NË BANKAT JOREZIDENTE

	31 dhjetor 2005	31 dhjetor 2004
Llogari rrjedhëse	7,996	11,109
Depozita afatshkurtra	2,175	379
Interes i përllogaritur	4	1
Totali	10,175	11,489

Depozitat afatshkurtra dhe llogaritë rrjedhëse në bankat e huaja, kanë norma interesi që variojnë nga 1.25 për qind deri në 4.53 për qind (2004 – nga 1 për qind deri në 4.56 për qind).

Depozitat dhe llogaritë rrjedhëse në bankat e huaja janë në Euro, Usd, Gbp dhe Jpy, të cilat sipas çdo monedhe të huaj u përgjigjen gjendjeve të mëposhtme:

	31 dhjetor 2005	31 dhjetor 2004
	në milionë	në milionë
EURO	25	27
USD	28	85
GBP	11	1
JPY	2,615	-

6. LETRAT ME VLERË TË DISPONUESHME PËR SHITJE (NË MONEDHË TË HUAJ)

Portofoli i letrave me vlerë të huaja i paraqitur në vlerë tregu është si më poshtë:

	31 dhjetor 2005	31 dhjetor 2004
Nota thesari të Qeverisë Amerikane	40,218	34,277
Nota thesari të Qeverisë Franceze	54,219	41,450
Nota thesari të Qeverisë Angleze	4,606	-
Investime afatmesme të Bankës për Rregullime Nërkombëtare	4,577	5,672
Nota të agjencive amerikane	2,584	4,625
Bono thesari të Qeverisë Franceze	2,443	1,746
Investime me kurs fiks (FIX BIS)	24,817	16,680
Totali	133,464	104,450

6. LETRAT ME VLERË TË DISPONUESHME PËR SHITJE (NË MONEDHË TË HUAJ) (VAZHDIM)

Portofoli i letrave me vlerë të huaja i paraqitur në vlerë nominale në valutë është si më poshtë:

	31 dhjetor 2005	31 dhjetor 2004
USD		
Nota thesari të Qeverisë Amerikane	388	370
Investime afatmesme të BIS	24	-
Nota të agjencive amerikane	25	50
Investime me kurs fiks (FIX BIS)	77	61
Totali	514	481
EURO		
Nota thesari të Qeverisë Franceze	442	328
Investime afatmesme të BIS	10	20
Bono thesari të Qeverisë Franceze	20	14
Investime me kurs fiks (FIX BIS)	125	69
Totali	597	431
GBP		
Nota thesari të Qeverisë Angleze	26	-
Investime afatmesme të BIS	4	18
Investime me kurs fiks (FIX BIS)	9	12
Totali	39	30

Notat e thesarit të Qeverisë Amerikane janë të shprehura në Usd dhe kanë kurse kuponash që variojnë nga 1.5 për qind në 4.62 për qind. Interesi paguhet në baza gjashtëmujore dhe maturimet variojnë nga mars 2006 deri në tetor 2010. *Yield*-i varion nga 1.6 për qind në 4.5 për qind (2004 – 1.05 për qind në 4.65 për qind).

Notat e thesarit të Qeverisë Franceze janë të shprehura në Euro me kurse kuponash midis 2.25 për qind në 5.5 për qind. Interesi është i pagueshëm në bazë vjetore dhe maturimet variojnë nga mars 2006 deri në korrik 2010. *Yield*-i është nga 2.03 për qind në 3.08 për qind (2004 – nga 2.06 për qind në 4.21 për qind).

Notat e thesarit të Qeverisë Angleze janë të shprehura në Gbp dhe kanë kurse kuponash që variojnë nga 5 për qind në 8.5 për qind. Interesi paguhet në bazë gjashtëmujore dhe maturimet variojnë nga dhjetor 2006 deri në mars 2008. *Yield*-i varion nga 4.15 për qind në 5.82 për qind.

Investimet afatmesme të Bankës për Rregullime Nërkombëtare përbëhen nga letra me kupona fikse, të përcaktuara në Usd, Euro dhe Gbp me kurse që variojnë nga 2.95 për qind në 4.3 për qind. Interesi është i pagueshëm në bazë vjetore për investimet në Euro dhe gjashtëmujore për investimet në Gbp, dhe maturimet variojnë midis shtator 2007 dhe shtator 2010. *Yield*-i varion nga 2.87 për qind në 5.1 për qind (2004 – 2.47 për qind në 5.27 për qind).

6. LETRAT ME VLERË TË DISPONUESHME PËR SHITJE (NË MONEDHË TË HUAJ) (VAZHDIM)

Notat e agjencive amerikane janë të shprehura në Usd me kurse kuponi që variojnë midis 2 për qind dhe 2.5 për qind. Interesi është i pagueshëm në baza gjashtëmujore dhe kufijtë e maturimit janë janar 2006 dhe shkurt 2007. *Yield*-et variojnë nga 2 për qind në 2.4 për qind (2004 – 1.14 për qind në 2.44 për qind).

Bonot e thesarit të Qeverisë Franceze janë të shprehura në Euro dhe maturohen në data të ndryshme midis janarit të vitit 2006 dhe marsit të vitit 2006. Ato janë blerë me *yield*-e 2.1 për qind (2004 – 2.11 për qind në 2.21 për qind).

Investime me kurs fiks (FIX BIS) të emtuara nga Banka për Rregullime Nërkombëtare janë të shprehura në Usd, Euro dhe Gbp me *yield*-e që variojnë nga 2.04 për qind në 4.53 për qind (2004 – 1.85 për qind në 4.99 për qind) dhe me kufij maturiteti nga shkurt 2006 në dhjetor 2006.

7. AKTIVE TË TJERA (NË MONEDHË TË HUAJ)

Më 31 dhjetor 2005, aktive të tjera të huaja përbëhen nga arka në valutë me një vlerë 11 milionë lekë (2004 – 11 milionë lekë) si dhe nga kuotizacionet për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në institucionet ndërkombëtare.

	31 dhjetor 2005	31 dhjetor 2004
Arka në valutë	11	11
Të tjera: Kuotizacione në institucionet ndërkombëtare		
Bankën Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim	361	357
Agjencinë Ndërkombëtare të Zhvillimit	12	35
Agjencinë e garantimit të investimeve shumëpalëshe	6	12
Korporatën Ndërkombëtare Financiare	76	68
Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim	61	54
Bankën Islamike të Zhvillimit	24	22
Totali i të tjera	540	548
Totali	551	559

8. KREDI TRANZITE

Totali prej 207 milionë lekë (2004 – 277 milionë lekë) përfaqëson kredi për sektorin e shërbimeve, akorduar Bankës Italo–Shqiptare për t’iu shpërndarë huamarrësve, me qëllim mbështetjen e programeve qeveritare (Shënimi 12). Për këtë hua nuk është vendosur kolateral.

9. INVESTIME NË LETRA ME VLERË (NË MONEDHË VENDASE)

9.1 Letra me vlerë të disponueshme për shitje

	31 dhjetor 2005	31 dhjetor 2004
Bono thesari afatshkurtra	66,821	63,786
Totali	66,821	63,786

Më 31 dhjetor 2005 letrat me vlerë afatshkurtra në lekë përfaqësojnë bono thesari me kupon zero të Qeverisë Shqiptare me afat maturimi 3 dhe 6-mujor, të cilat maturohen në periudhën janar - qershor 2006. Yield-i i tyre në blerje varion nga 5.38 për qind deri në 8.64 për qind (2004 – 6.10 për qind në 8.10 për qind).

9.2 Investime të mbajtura deri në maturim

	31 dhjetor 2005	31 dhjetor 2004
Obligacione me kupon zero për kapitalizimin e Bankës Kombëtare Tregtare ("BKT")	1,725	1,649
Totali	1,725	1,649

Letrat me vlerë për kapitalizimin e Bankës Kombëtare Tregtare kanë të bëjnë me obligacione zero kupon, të cilat janë lëshuar nga Qeveria për të

zëvendësuar pjesëmarrjen në kapital në Bankën Kombëtare Tregtare. Letrat me vlerë fitojnë një normë kthimi prej 6 për qind në vit dhe maturohen në janar 2006.

10. AKTIVE TË TJERA (NË MONEDHË VENDASE)

	31 dhjetor 2005	31 dhjetor 2004
Aktive të trupëzuara, neto	1,464	1,427
Aktive të patrupëzuara, neto	278	378
Kredi punonjësve	707	613
Debitorë të tjerë	5	44
Numizmatika	38	63
Inventari	25	26
Të tjera	6	2
Totali	2,523	2,553

10. AKTIVE TË TJERA (NË MONEDHË VENDASE) (VAZHDIM)

Vlera neto kontabël e aktiveve fikse për çdo kategori paraqitet si më poshtë:

	Toka, ndërtesa dhe konstruksione të përgjithshme	Pajisje të përgjithshme	Mjete transporti	Totali i aktiveve fikse të trupëzuara
Kosto/Vlerësimi				
Gjendja më 1 janar 2005	1,440	562	161	2,163
Shtesat	20	120	12	152
Gjendja më 31 dhjetor 2005	1,460	682	173	2,315
Amortizimi i akumuluar				
Gjendja më 1 janar 2005	182	424	130	736
Shpenzimi vjetor	38	66	11	115
Gjendja më 31 dhjetor 2005	220	490	141	851
Vlera kontabël neto				
Gjendja më 31 dhjetor 2005	1,240	192	32	1,464
Gjendja më 31 dhjetor 2004	1,258	138	31	1,427

Ndërtesa qendrore e Bankës, e përfshirë nën kategorinë "Toka, ndërtesa dhe konstruksione të përgjithshme" u rivlerësua në vitin 2000 në shumën 1,143 milionë lekë, nga kosto historike plotësisht e amortizuar prej 7 milionë lekësh. Rivlerësimi u bë më 29 mars 2000, me datë efektive 1 janar 2000, nga një komision i brendshëm vlerësuesish. Vlerësimi nuk u bë mbi bazën e rrjedhjeve të ardhshme të parasë të skontuara, por bazuar mbi vlerën e përafërt të tregut të dhënie/marrje me qira të pronësisë së patundshme, me jetëgjatësi mbi 50 vjet. Ndërtesat e tjera në pronësi të Bankës nuk u vlerësuan.

Rivlerësimi prej 1,143 milionë lekësh pasqyrohet tek rezerva e rivlerësimit dhe amortizohet çdo muaj, në përputhje me normën e amortizimit përkatëse.

Sipas ligjit shqiptar, titulli i pronësisë së ndërtesës së Bankës është i paqartësuar. Banka është në proces për zgjidhjen e statutit të pronësisë për objektet që administrohen prej saj.

10. AKTIVE TË TJERA (NË MONEDHË VENDASE) (VAZHDIM)

Vlera neto kontabël e aktiveve fikse të patrupëzuara për çdo kategori paraqitet si më poshtë:

Në lekë (mln)	Programe kompjuterike	Kartëmonedha të prera dhe monedha të shtypura	Totali i aktiveve fikse të patrupëzuara
Kosto/Vlerësimi			
Gjendja më 1 janar 2005	277	2,454	2,731
Shtesat	59	-	59
Gjendja më 31 dhjetor 2005	336	2,454	2,790
Amortizimi i akumuluar			
Gjendja më 1 janar 2005	193	2,160	2,353
Shpenzimi për vitin	73	86	159
Gjendja më 31 dhjetor 2005	266	2,246	2,512
Vlera kontabël neto			
Gjendja më 31 dhjetor 2005	70	208	278
Gjendja më 31 dhjetor 2004	84	294	378

Në 31 dhjetor 2005, kreditë e punonjësve përfshijnë provigjone 6 milionë lekë për çështje gjyqësore (31 dhjetor 2004 – 10 milionë lekë).

Më 31 dhjetor 2005, Banka përlllogariti vlerën e regjistruar të kolateralit për kreditë afatgjata dhënë punonjësve të bankës, në shumën 851 milionë lekë dhe për 31 dhjetor 2004 është 626 milionë lekë.

Në zërin "Debitorë të tjerë" përfshihen edhe provigjone të përlllogaritura prej 4 milionë lekësh për vlerat e paarkëtuara nga Qeveria Shqiptare, që rrjedhin nga transaksionet e viteve të mëparshme me Bankën Botërore (Shënimi 24).

11. DETYRIME NDAJ FONDIT MONETAR NDËRKOMBËTAR

	31 dhjetor 2005	31 dhjetor 2004
Huaja e Uljes së Varfërisë dhe Zhvillimit	9,513	8,953
Llogaria e letrave me vlerë tek Fondi Monetar Ndërkombëtar	4,881	5,148
Llogari e Fondit Monetar Ndërkombëtar në lekë	1,751	1,847
Totali	16,145	15,948

Huatë e Uljes së Varfërisë dhe Zhvillimit janë të lidhura me kuotizacionin e Republikës së Shqipërisë në FMN dhe janë tërhequr në emër të qeverisë për reformat makroekonomike. Këto hua përbëhen nga këta tre komponentë:

Huaja fillestare e Uljes së Varfërisë dhe Zhvillimit u disbursua në vitin 1993 e kthyeshme për 10 vjet, filloi në vitin 1999. Gjendja e kësaj huaje më 31 dhjetor 2005 ishte zero (2004 – 706,000 sdr).

Një hua shtesë nën këtë marrëveshje, e njohur si “Huaja e Uljes së Varfërisë dhe Zhvillimit” u miratua me marrëveshjen e datës 13 maj 1998 prej 45,040,000 sdr, duke u disbursuar nga viti 1999 deri në vitin 2001. Gjendja më 31 dhjetor 2005 ishte 36,265,400 sdr (2004 – 41,728,200 sdr). Kjo, gjithashtu, është një hua dhjetëvjeçare e kthyeshme deri në vitin 2011, në 10 këste çdo gjashtë muaj duke filluar që nga viti 2004. Norma e interesit për t’u paguar pas periudhës pa interes është 0.5 për qind dhe është e pagueshme çdo gjashtë muaj.

Huaja “Huaja e Uljes së Varfërisë dhe Zhvillimit 3” për Shqipërinë u miratua me marrëveshjen e datës 21 qershor 2002 në shumën 28,000,000 sdr. Disbursimi i fundit u bë më 20 qershor 2005. Gjendja në fund të vitit 2005 është 28,000,000 sdr (2004 - 20,000,000 sdr) me një interes prej 0.5 për qind, i pagueshëm çdo gjashtë muaj. Principali i huasë do të fillojë të shlyhet pas pesë vjet e gjysmë, brenda pesë vjetëve me 10 këste të barabarta.

12. DETYRIME NDAJ INSTITUCIONEVE FINANCIARE JOREZIDENTE

	31 dhjetor 2005	31 dhjetor 2004
Detyrime tranzite (Shënimi 8)	207	277
Hua e Republikës së Greqisë	1,079	1,112
Detyrime ndaj Bankës Botërore	28	133
Interes i përlogaritur	5	5
Totali	1,319	1,527

Huaja dhënë për zhvillim nga Banka Evropiane e Investimeve prej 207 milionë lekësh përbëhet nga 0.5 milionë usd dhe 1.2 milionë euro (Shënimi 8). Interesi paguhet nga përfituesit e këtyre kredive tranzite (bankat dhe kompanitë vendase) drejtpërsëdrejti tek siguresit e financimit.

Huaja e Republikës së Greqisë (prej 8.8 milionë euro) është dhënë me qëllim financimin e bilancit të pagesave të Republikës së Shqipërisë. Norma vjetore e interesit është 1.17 për qind dhe është e pagueshme çdo 6 muaj. Huaja maturohet në vitin 2018.

Detyrimi ndaj Bankës Botërore përbëhet nga llogaritë e organizatave ndërkombëtare IBRD, IDA, MIGA pranë Bankës së Shqipërisë.

13. PARA NË QARKULLIM

Banka ka të drejtën ekskluzive të emetimit të monedhës kombëtare. Ky zë përfshin kartëmonedha dhe monedha vendase në qarkullim të emetuara nga Banka.

Më 31 dhjetor 2005 dhe 2004 shuma e kartëmonedhave dhe monedhave në qarkullim është si më poshtë:

Vlera nominale Lekë	31 dhjetor 2005		31 dhjetor 2004	
	Copë (në mijë)	Totali Lekë (milionë)	Copë (në mijë)	Totali Lekë (milionë)
100	12,167	1,217	15,515	1,552
200	15,481	3,096	15,307	3,061
500	68,373	34,187	69,623	34,812
1,000	68,218	68,218	64,720	64,720
5,000	9,087	45,435	7,232	36,162
Monedha		1,397		1,323
		153,550		141,630

14. DETYRIME NDAJ BANKAVE REZIDENTE

	31 dhjetor 2005	31 dhjetor 2004
Në monedha të huaja		
Rezerva e detyruar	14,683	10,826
Llogari të bankave të nivelit të dytë	118	65
Depozita të marra si garanci	-	104
	14,801	10,995
Në monedhë vendase		
Rezerva e detyruar	26,980	24,655
Llogari të bankave të nivelit të dytë	1,800	529
Marrëveshjet e riblerjes	505	2,263
Depozita njëditore	1,082	855
	30,367	28,302
Interes i përlogaritur	14	21
Totali	45,182	39,318

Interes mbi llogarinë e rezervave të detyrueshme llogaritet si më poshtë:

- gjendjet në lekë: 70 për qind e *yield*-it të marrëveshjeve repo: 3.5 për qind më 31 dhjetor 2005 (70 për qind e *yield*-it të marrëveshjeve repo: 3.675 për qind më 31 dhjetor 2004);
- gjendjet në usd: 70 për qind e normës së usd libor njëmuajore: 3.07 për qind më 31 dhjetor 2005 (70 për qind e normës së usd libor njëmuajore: 1.69 për qind më 31 dhjetor 2004);
- gjendjet në euro: 70 për qind e normës së euro libor njëmuajore: 1.7 për qind më 31 dhjetor 2005 (70 për qind e normës së euro libor njëmuajore: 1.52 për qind më 31 dhjetor 2004).

Banka nuk paguan interes mbi llogaritë rrjedhëse dhe depozitat e korrespondentëve.

Depozitat me afat njëditor kanë normë interesi prej 3.25 për qind (2004 – 2.25 për qind).

15. DETYRIME NDAJ QEVERISË

	31 dhjetor 2005	31 dhjetor 2004
Fitim për t'iu derdhur qeverisë	547	400
Depozita në emër të qeverisë	5,785	4,880
Të tjera	24	22
Totali	6,356	5,302

Fitimi për t'iu derdhur qeverisë lidhet me pjesën e mbetur të fitimit të vitit 2005, i cili nuk i është shpërndarë Qeverisë në fund të vitit, bazuar në vendimin nr.17 më datë 15 mars 2006, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

Depozita në emër të qeverisë përfshin llogarinë kryesore prej 3,338 milionë lekësh, si dhe fonde të donatorëve ndërkombëtarë të depozituara në Bankë për transferim të mëtejshëm në projektet e ndihmës në Shqipëri, prej 2,447 milionë lekësh.

Zëri "Të tjera" përfaqëson fonde të marra nga Banka për një hua të dhënë qeverisë nga Banka Arabe Islamike e Zhvillimit prej 24 milionë lekësh (2004 – 22 milionë lekë).

16. TË ARDHURA PËR T'U SHPËRNDARË

	31 dhjetor 2005	31 dhjetor 2004
Ndihma nga Banka Botërore	289	225
Amortizimi i ndihmës nga Banka Botërore	(196)	(155)
Të tjera	36	36
Totali	129	106

"Ndihma nga Banka Botërore" i referohet ndihmave të përfituara nga Banka gjatë viteve 2002-2005, respektivisht për blerjen e pajisjeve dhe programeve kompjuterike për zbatimin e projektit ATM "Sistemi kontabël dhe i administrimit të thesarit" prej 157 milionë lekësh, projektit AIPS "Sistemi Shqiptar i Pagesave Ndërbankare" prej 68 milionë lekësh, si dhe projektit AECH "Sistemi i Kryqëzimit të Pagesave me vlerë të vogël" prej 64 milionë lekësh.

“Të tjera” prej 36 milionë lekësh përfaqëson vlerën e dy godinave dhuratë në qytetet Korçë dhe Berat.

17. DETYRIME TË TJERA (NË MONEDHË VENDASE)

	31 dhjetor 2005	31 dhjetor 2004
Detyrimi ndaj Shtypshkronjës (Shënimi 27)	212	217
Depozita të individëve nga pjesëmarrja në bono thesari	469	272
Detyrimi ndaj fondit të pensionit, neto	6	1
Të tjera	74	88
Totali	761	578

Skema e fondit të pensionit përbëhet nga kontributi i punonjësve në vlerën 2 për qind të pagës së tyre bruto si dhe kontributi i punëdhënësit 15 për qind mbi totalin e pagave.

Detyrimi ndaj planit të pensionit neto për fundvitet 31 dhjetor 2005 dhe 2004 përbëhet si më poshtë:

	31 dhjetor 2005	31 dhjetor 2004
Vlera e detyrimit 2 për qind i kontributit	19	15
Rezultati nga investimi i kontributit prej 2 për qind	4	3
Vlera reale e portofolit të letrave me vlerë	(21)	(17)
Detyrimi neto i kontributit prej 2 për qind	2	1

	31 dhjetor 2005	31 dhjetor 2004
Vlera e detyrimit 15 për qind i kontributit	203	161
Rezultati nga investimi i kontributit prej 15 për qind	73	56
Vlera reale e portofolit të letrave me vlerë	(272)	(217)
Detyrimi neto i kontributit prej 15 për qind	4	-

Në zërin “Të tjera”, përfshihen kryesisht shpenzime të llogaritura prej 23 milionë lekësh (2004 – 29 milionë lekë), të cilat lidhen me mirëmbajtjen e sistemit ATM, mirëmbajtjen e makinerive për paratë, shërbime ROJTERI, shërbime për informacione statistikore etj.. Në këtë zë janë përfshirë edhe shuma e disa pretendimeve për disa çështje ligjore, krijuar në kushte normale biznesi. Një provigjon neto prej 22 milionë lekësh është krijuar në lidhje me këto pretendime, për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2005 (2004 – 20 milionë lekë) (Shënimi 24).

18. REZERVA E RIVLERËSIMIT

Përbërësit e rezervës së rivlerësimit janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2005	31 dhjetor 2004
Rivlerësimi i valutave të huaja dhe arit	(12,164)	(16,005)
Rivlerësimi i letrave me vlerë	(310)	137
Rivlerësimii monedhave dhe kartëmonedhave historike	22	32
Rivlerësimi i ndërtesës në qendër (Shënim 10)	983	1,012
Totali	(11,469)	(14,824)

Gjatë vitit 2005, rezervat për rivlerësimin e valutave të huaja dhe arit janë rritur me një vlerë prej 3,841 milionë lekësh (2004 - pakësuar me 8,333 milionë lekë) për shkak të luhatjeve në kursin e këmbimit të valutave gjatë vitit.

Në përputhje me ligjin “Për Bankën e Shqipërisë” (neni 64, pika b) dhe me ligjin nr. 9339, datë 21 dhjetor 2004 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2005”, Ministria e Financave ka emetuar letra me vlerë të qeverisë me një total prej 7,672 milionë lekësh për mbulimin e diferencave nga rivlerësimi i valutave, krijuar më 2003. Këto letra me vlerë u emetuan në 1 shkurt 2005, me një maturitet të rinovueshëm prej gjashtë muajsh dhe një normë interesi prej 7.10 për qind, që u rinovua në 1 gusht, 2005 me një normë interesi prej 6.588 për qind, me një maturitet prej gjashtë muajsh. Gjithashtu, në 1 shtator 2005 Ministria e Financave emetoi letra me vlerë në shumën 3,828 milionë lekë, që maturohen në 3 mars 2006, dhe kanë një normë interesi 9.94 për qind.

19. REZERVA TË TJERA

Përbërësit e rezervave të tjera janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2005	31 dhjetor 2004
Rezervë speciale për bilancin e pagesave	7,209	7,209
Fondi i investimit	301	301
Të tjera	672	565
Totali	8,182	8,075

Rezerva speciale për bilancin e pagesave ka të bëjë me grante të dhëna nga Komuniteti Evropian për Shqipërinë, si asistencë financiare për të mbështetur vendin në procesin e transformimit të ekonomisë në një ekonomi tregu. Këto grante i përkasin periudhës 1992 – 1993, në mbështetje të qëndrueshmërisë së bilancit të pagesave si dhe për të forcuar pozicionin e rezervave. Kjo rezervë ka mbetur e pandryshuar që nga viti 1995.

19. REZERVA TË TJERA (VAZHDIM)

Fondi i investimit përbëhet nga një fond i krijuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës me qëllim blerjen e një godine të re për Bankën.

“Të tjera” përfshin rezervat të krijuara me vendim të Këshillit Mbikëqyrës, nga

shpërndarja e fitimit gjatë viteve 2002-2005. Një shpërndarje e mëtejshme prej 107 milionë lekësh u bë nga fitimi i vitit 2005.

20. TË ARDHURA NGA INTERESA DHE KOMISIONE (JOREZIDENTËT)

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2005	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2004
Të ardhura nga interesat e letrave me vlerë	3,578	2,739
Interesa nga depozitat me afat	508	253
Interesa nga depozitat në sdr	170	177
Të tjera	89	40
Totali	4,345	3,209

21. SHPENZIME PËR INTERESA DHE KOMISIONE (JOREZIDENTËT)

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2005	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2004
Amortizimi i primit të letrave me vlerë	594	622
Shpenzime për interesa nga huatë e institucioneve të huaja	13	13
Shpenzime për interesa nga llogaritë e FMN	48	47
Të tjera	5	1
Totali	660	683

22. TË ARDHURA NGA INTERESA DHE KOMISIONE (REZIDENTËT)

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2005	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2004
Të ardhura nga interesat e letrave me vlerë	4,194	5,172
Interesa nga huatë qeveritare	30	65
Të tjera	104	34
Totali	4,328	5,271

23. SHPENZIME PËR INTERESA DHE KOMISIONE (REZIDENTËT)

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2005	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2004
Shpenzime për interesa mbi rezervën e detyruar	1176	1,085
Shpenzime për interesa mbi marrëveshjet repo	196	236
Të tjera	21	23
Totali	1,393	1,344

24. (SHPENZIME) / TË ARDHURA TË TJERA OPERATIVE, NETO

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2005	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2004
Fitimi (humbje)/fitim nga shitja e aktiveve financiare	(397)	80

Amortizimi i granteve në të ardhura	42	79
Provizione për çështje legale (Shënimi 10 dhe 17)	(6)	(17)
Të tjera	1	2
Totali	(360)	144

25. SHPENZIME TË PERSONELIT

Shpenzime të personelit përfshijnë pagat e personelit, shpenzimet për sigurime shoqërore, kontributet për planin e pensionit dhe shpenzime të tjera.

Shpenzimet për sigurime shoqërore përfaqësojnë kryesisht kontributin e detyruar ndaj Institutit të Sigurimeve Shoqërore. Më 31 dhjetor 2005, Banka ka patur 427 punonjës (2004 – 323 punonjës).

26. PARAJA DHE EKUIVALENTET E SAJ

	31 dhjetor 2005	31 dhjetor 2004
Depozita në bankat e huaja (Shënimi 5)	10,171	11,488
Monedha vendase	13,450	10,371
Arka në valutë (Shënimi 7)	11	11
Ari i mbajtur jashtë vendit (Shënimi 3)	708	540
Ari dhe metalet e tjera të çmuara të mbajtura në vend (Shënimi 3)	50	40
Totali	24,390	22,450

27. SHTYPSHKRONJA

Siç është detajuar në Shënimin 2(b), Banka kontrollon aktivitetin e Shtypshkronjës. Pozicioni financiar i Shtypshkronjës më 31 dhjetor 2005 dhe 2004 paraqitet si më poshtë:

	31 dhjetor 2005	31 dhjetor 2004
AKTIVET		
Aktive të qëndrueshme të trupëzuara	16	23
Inventari	37	60
Klientë	2	1
Për t'u arkëtuar nga Banka (Shënimi 17)	212	217
Totali i aktiveve	267	301
KAPITALI DHE DETYRIMET		
Kapitali themeltar	51	52
Rezerva ligjore	19	19
Rezerva e investimit	24	24
Rezerva të tjera	6	6
Fitimi i mbartur	161	159
Totali i kapitalit	261	260
Detyrime të tjera	6	41
Totali i kapitalit dhe detyrimeve	267	301

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2005	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2004
Të ardhura	99	117
Shpenzime	(97)	(114)
Fitimi i vitit	2	3

28. ANGAZHIME DHE GARANCI

Banka mban disa llogari në monedhë të huaj, në lidhje me marrëveshjet e lidhura nga Qeveria e Shqipërisë dhe qeverive ose organizatave financiare të huaja. Meqë këto llogari nuk përbëjnë as aktiv as detyrim për Bankën e Shqipërisë, ato nuk janë përfshirë në bilancin e Bankës.

Në datën 10 nëntor 2005, Banka e Shqipërisë ka lëshuar një garanci njëvjeçare në favor të Raiffeisen Bank Sh.a., që nënkupton angazhimin që Banka e Shqipërisë ndërmerr, për të garantuar shumën deri në 29 miliardë lekë bono thesari të Qeverisë Shqiptare në portofolin e Raiffeisen Bank. Çmimi i kësaj garancie është 0.2 për qind me baza vjetore dhe paguhet çdo tre muaj.

29. PALËT E LIDHURA

Palët konsiderohen si të lidhura në qoftë se njëra palë ka aftësinë të kontrollojë tjetrën apo të ushtrojë një influencë domethënëse mbi palën tjetër në marrjen e vendimeve financiare apo të tjera.

Duke marrë në konsideratë çdo palë të lidhur të mundshme, vëmendje i kushtohet thelbit së marrëdhënies dhe jo formës së mirëfilltë ligjore.

Banka e Shqipërisë nuk ka palë të lidhura përveçse marrëdhënieve me drejtuesit dhe anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës. Më 31 dhjetor 2005 dhe 2004, transaksionet e realizuara me palët e lidhura përbëhen nga:

	31 dhjetor 2005	31 dhjetor 2004
Kredi të tjera të brendshme		
Kredia për stafin		
- Drejtorët dhe anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës	79	46
Totali	79	46

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2005	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2004
Shpenzime administrative		
Shpenzime celulare		
- Drejtorët dhe anëtarët e këshillit mbikëqyrës	4	3
Paga dhe bonuse		
- Drejtorët dhe anëtarët e këshillit mbikëqyrës	67	42
Totali i shpenzimeve administrative	71	45

30. ADMINISTRIMI I RREZIKUT

Rezerva valutore administrohet nga Banka e Shqipërisë dhe investimi i saj realizohet nga Departamenti i Operacioneve Monetare, i cili bazohet në rregulloren "Mbi politikën e administrimit të rezervës valutore", që miratohet nga Këshilli Mbikëqyrës. Rezerva valutore investohet në instrumente financiare afatshkurtra dhe letra me vlerë me të ardhura konstante.

Reziku i likuiditetit

Politikat e monitorimit dhe të adresimit ndaj rrezikut të likuiditetit përcaktohen nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës. Departamenti i Operacioneve Monetare të Bankës monitoron rrezikun e likuiditetit në mënyrë të vazhdueshme, duke analizuar treguesit e likuiditetit, boshllëqet dhe skenarët ekonomikë. Politikat e administrimit të likuiditetit vendosen për të siguruar që edhe në kushte të vështira, Banka të jetë në gjendje të përmbushë detyrimet e saj.

Reziku i kreditit

Departamenti i Operacioneve Monetare të Bankës, nën kontrollin e Këshillit Mbikëqyrës, është përgjegjës për përcaktimin e rrezikut të kreditit, që shoqëron operacionet e Bankës. Rreziku i kreditit zbutet nga ana e Bankës duke kryer transaksione të shumta me institucione qeveritare dhe ndërkombëtare. Kreditë për bankat vendase sigurohen nga bonot e thesarit të Qeverisë.

Reziku i çmimeve

Faktorët kyç të rrezikut të çmimeve që ndikojnë Bankën janë:

- rreziku i monedhave, i shoqëruar me ndryshime në vlerën e instrumenteve financiare për shkak të ndryshimeve në kurset e këmbimit; dhe
- rreziku i normave të interesit, i shoqëruar me ndryshime në vlerën e instrumenteve financiare për shkak të ndryshimeve në normat e interesave të tregut.

Ekspozimi i Bankës ndaj rrezikut të monedhave monitorohet vazhdimisht nga Departamenti i Operacioneve Monetare. Aktivitetet financiare, të mbajtura në monedhë të huaj janë paraqitur në secilin prej shënimeve korresponduese në pasqyrat financiare.

Rreziku i normave të interesit monitorohet nga Departamenti i Operacioneve Monetare të Bankës. Banka e zbut këtë rrezik duke mbajtur një tepricë të konsiderueshme të aktiveve interesprurëse mbi pasivet që paguajnë interes (siç detajohet në Shënimin 31 më poshtë). Banka mban një portofol aktivesh dhe pasivesh financiare me interes, të tillë që e ardhura e gjeneruar nga interesi neto është në mënyrë të ndjeshme më e lartë se kërkesat operative, gjë që minimizon efektet e mundshme negative të ndryshimeve në normat e interesit. Normat e interesit që zbatohen mbi aktivet dhe detyrimet financiare paraqiten në çdo shënim korrespondues të pasqyrave financiare.

31. NDJESHMËRIA E NORMAVE TË INTERESIT (ANALIZA E MATURITETIT TË MBETUR)

	Deri në një muaj	Një deri në tre muaj	Tre deri në gjashtë muaj	Gjashtë deri në një vit	Një deri në pesë vjet	Mbi pesë vjet	Jo të ndjeshëm ndaj interesit	Totali
Aktivet								
Ari dhe metalet e çmuara	-	-	-	-	-	-	540	540
Depozita tek Fondi Monetar Ndërkombëtar	-	9,341	-	-	-	-	7,476	16,817
Depozita në bankat jorezidente	11,489	-	-	-	-	-	-	11,489
Letra me vlerë të disponueshme për shitje	7,850	4,110	13,569	14,710	64,211	-	-	104,450
Aktive të tjera	-	-	-	-	-	-	559	559
Ari dhe metalet e çmuara	-	-	-	-	-	-	40	40
Kredi tranzite	-	-	-	-	-	-	277	277
Letra me vlerë të disponueshme për shitje	21,879	25,034	16,873	-	-	-	-	63,786
Investime të mbajtura deri në maturim	-	-	-	1,649	-	-	-	1,649
Aktive të tjera	-	-	-	-	-	613	1,940	2,553
	41,218	38,485	30,442	16,359	64,211	613	10,832	202,160
Detyrimet dhe kapitali i vet								
Detyrime ndaj Fondit Monetar Ndërkombëtar	-	-	407	477	6,203	1,866	6,995	15,948
Detyrime ndaj institucioneve financiare jorezidente	-	-	-	5	-	1,112	410	1,527
Para në qarkullim	-	-	-	-	-	-	141,630	141,630
Detyrime ndaj bankave rezidente	38,724	-	-	-	-	-	594	39,318
Detyrime ndaj qeverisë	-	-	-	-	-	-	5,302	5,302
Të ardhura për t'u shpërndarë	-	-	-	-	-	-	106	106
Detyrime të tjera	-	6	-	-	-	-	572	578
Kapitali dhe Rezervat	-	-	-	-	-	-	(2,249)	(2,249)
	38,724	6	407	482	6,203	2,978	153,360	202,160
Ndryshimi i bilancit më 31 dhjetor 2004	2,494	38,479	30,035	15,877	58,008	(2,365)	(142,528)	-
Ndryshimi i akumuluar nga ndjeshmëria e normave të interesit 31 dhjetor 2004 Ndryshim i ndjeshëm -2003	2,494	40,973	71,008	86,885	144,893	142,528	-	-

31. NDJESHMËRIA E NORMAVE TË INTERESIT (ANALIZA E MATURITETIT TË MBETUR) (VAZHDIM)

	Deri në një muaj	Një deri në tre muaj	Tre deri në gjashtë muaj	Gjashtë deri në një vit	Një deri në pesë vjet	Mbi pesë vjet	Jo të ndjeshëm ndaj interesit	Totali
Aktivet								
Ari dhe metalet e çmuara	-	-	-	-	-	-	708	708
Depozita tek Fondi Monetar Ndërkombëtar	-	1,295	-	-	-	-	7,136	8,431
Depozita në bankat jorezidente	7,868	-	-	-	-	-	2,307	10,175
Letra me vlerë të disponueshme për shitje	1,747	8,744	4,886	20,877	97,210	-	-	133,464
Aktive të tjera	-	-	-	-	-	-	551	551
Ari dhe metalet e çmuara	-	-	-	-	-	-	50	50
Kredi tranzite	-	-	-	-	-	-	207	207
Letra me vlerë të disponueshme për shitje	23,371	25,038	18,412	-	-	-	-	66,821
Investime të mbajtura deri në maturim	1,725	-	-	-	-	-	-	1,725
Aktive të tjera	-	-	-	-	-	707	1,816	2,523

	34,711	35,077	23,298	20,877	97,210	707	12,775	224,655
Detyrimet dhe kapitali i vet								
Detyrime ndaj Fondit Monetar Ndërkombëtar	-	263	264	597	5,338	3,051	6,632	16,145
Detyrime ndaj institucioneve financiare jorezidente	-	-	-	5		1,079	235	1,319
Para në qarkullim	-	-	-	-	-	-	153,550	153,550
Detyrime ndaj bankave rezidente	43,264	-	-	-	-	-	1,918	45,182
Detyrime ndaj qeverisë	-	-	-	-	-	-	6,356	6,356
Të ardhura për t'u shpërndarë	-	-	-	-	-	-	129	129
Detyrime të tjera	-	-	-	-	-	-	761	761
Kapitali dhe rezervat	-	-	-	-	-	-	1,213	1,213
	43,264	263	264	602	5,338	4,130	170,794	224,655
Ndryshimi i bilancit më 31 dhjetor 2005	(8,553)	34,814	23,034	20,275	91,872	(3,423)	(158,019)	-
Ndryshimi i akumuluar nga ndjeshmëria e normave të interesit Ndryshim i ndjeshëm -2003	(8,553)	26,261	49,295	69,570	161,442	158,019	-	-

32. POZICIONI NETO MONETAR

	LEK	USD	EURO	GBP	Të tjera	Totali
Aktivet						
Ari dhe metalet e çmuara	-	-	-	-	708	708
Depozita tek Fondit Monetar Ndërkombëtar	6,632	-	-	-	1,799	8,431
Depozita në bankat jorezidente	-	2,863	3,012	1,992	2,308	10,175
Letra me vlerë të disponueshme për shitje	-	53,275	73,151	7,038	-	133,464
Aktive të tjera	335	209	7	-	-	551
Ari dhe metalet e çmuara	50	-	-	-	-	50
Kredi tranzite	-	57	150	-	-	207
Letra me vlerë të disponueshme për shitje	66,821	-	-	-	-	66,821
Investime të mbajtura deri në maturim	1,725	-	-	-	-	1,725
Aktive të tjera	2,520	2	1	-	-	2,523
Totali i aktiveve më 31 dhjetor 2005	78,083	56,406	76,321	9,030	4,815	224,655
Detyrimet						
Detyrime ndaj Fondit Monetar Ndërkombëtar	6,632	-	-	-	9,513	16,145
Detyrime ndaj institucioneve financiare jorezidente	28	57	1,234	-	-	1,319
Para në qarkullim	153,550	-	-	-	-	153,550
Detyrime ndaj bankave rezidente	30,377	5,897	8,908	-	-	45,182
Detyrime ndaj qeverisë	4,547	646	1,162	1	-	6,356
Të ardhura për t'u shpërndarë	129	-	-	-	-	129
Detyrime të tjera	746	11	4	-	-	761
Totali i detyrimeve më 31 dhjetor 2005	196,009	6,611	11,308	1	9,513	223,442
Pozicioni neto në valutë më 31 dhjetor 2005	(117,926)	49,795	65,013	9,029	(4,699)	1,213
Pozicioni neto në valutë më 31 dhjetor 2004	(106,440)	47,130	50,066	5,586	1,409	(2,249)

